



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE
DEGA E GJUHËS GREKE

Punim për gradën Doktor në Gjuhësi

**PARALELIZMA NË STRUKTURËN
GRAMATIKORE TË SHQIPES E TË
GREQISHTES
(SISTEMI FOLJOR)**

Disertantja

Mirela Xhaferraj (Mitro)

Udhëheqës shkencor

Prof. Dr. Seit Mansaku

Tiranë, maj 2012

Falënderim

Ky punim, që është rezultat i një pune të madhe kërkimore të shtrirë në kohë dhe vende të ndryshme, nuk do të ishte realizuar pa kontributin e çmuar të udhëheqësit shkencor, Prof. Dr. Seit Mansaku, ndihmën e kolegëve të Degës së Gjuhës Greke, mbështetjen e Departamentit të Gjuhëve Sllave e Ballkanike dhe Dekanatit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, si dhe mbështetjen e pakursyer dhe mirëkuptimin e familjes sime.

Në përfundim të tij i falënderoj të gjithë përzemërsisht.

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	V
Objekti – qëllimi i punimit.....	VI
Metodologjia.....	VII
Kreu I : Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin foljor të shqipes e të greqishtes	1
1.1. Zhvillimi historik i sistemit foljor të shqipes e të greqishtes.....	1
1.2. Tiparet themelore të sistemit foljor të shqipes dhe greqishtes.....	5
1.2.1. Zgjedhimi.....	5
1.2.1.1. Zgjedhimi vepror dhe jovepror.....	5
1.2.1.2. Ndarja e foljeve në zgjedhime.....	6
1.2.2. Forma dhe diateza.....	9
1.2.2.1. Format e foljes në shqip dhe greqisht.....	9
1.2.2.2. Kategoria e diatezës.....	10
1.2.3. Mënyrat dhe kohët.....	13
1.2.3.1. Kategoria gramatikore e mënyrës.....	13
1.2.3.2. Kategoria gramatikore e kohës.....	14
1.2.4. Kategoria gramatikore e vetës.....	17
1.2.5. Çështja e aspektit	21
Kreu II. Mjetet e ndërtimit të formave foljore.....	24
2.1. Temat foljore	24
2.2. Mbaresat vetore.....	27
2.3. Prapashtesat trajtëformuese (temëformuese).....	28
2.4. Bashkëtingëlloret kundër hiatit.....	30
2.5. Foljet ndihmëse <i>kam</i> dhe <i>jam</i>	31
2.6. Pjesëzat trajtëformuese.....	33
2.7. Augmenti.....	34
2.8. Dublikacioni.....	35
Kreu III. Mënyrat e foljes.....	38
3.1. Mënyra dëftore.....	38
3.1.1. Kohët sintetike të mënyrës dëftore.....	40
3.1.1.1. Koha e tashme.....	40
3.1.1.2. Koha e pakryer.....	47
3.1.1.2.1. E pakryera e greqishtes e shoqëruar me pjesëza.....	53
<i>Θα (do të) + e pakryer</i>	53
<i>Να (të) + e pakryer</i>	54
3.1.1.3. Koha e kryer e thjeshtë (aoristi).....	55
3.1.1.3.1. Aoristi i greqishtes i shoqëruar me pjesëza	61
<i>Θα (do të) + aoristin</i>	61
<i>Να (të) + aoristin</i>	61
3.1.2. Kohët analitike të mënyrës dëftore të gjuhës shqipe dhe të gjuhës greke	63
3.1.2.1. Koha e kryer.....	65
3.1.2.2. Koha më se e kryer.....	70

3.1.2.3. Koha e kryer e tejskUAR.....	74
3.1.2.4. Koha e ardhme.....	76
3.1.2.5. Koha e ardhme e përparme.....	79
3.1.2.6. Koha e ardhme e së shkuarës.....	80
3.1.2.7. Koha e ardhme e përparme e së shkuarës.....	81
3.2. Mënyra lidhore.....	88
3.2.1. Koha e tashme.....	91
3.2.1.1 Koha e tashme e lidhore në gjuhën shqipe	91
3.2.1.1.1 E tashmja e lidhore me vlerën e mënyrave të tjera.....	94
3.2.1.2 E tashmja e lidhore së greqishtes.....	96
3.2.1.2.2 Lidhorja e greqishtes me vlerën e mënyrave të tjera.....	98
3.2.2. Aoristi i lidhore së gjuhës greke.....	100
3.2.2.1. Lidhorja e greqishtes me parafjalë.....	103
3.2.2.2. Lidhorja e greqishtes me nyje	103
3.2.2.3. Lidhorja e greqishtes pa pjesëzën <i>va</i> , ose e paraprirë nga tregues të tjerë.....	104
3.2.3. E pakryera e lidhore.....	106
3.2.4. E kryera e lidhore.....	110
3.2.5. Më se e kryera e lidhore së shqipes.....	112
3.2.6. Forma “ <i>kam + lidhore</i> ”	114
3.3. Mënyra urdhërore.....	119
3.3.1. Urdhërorja e shqipes	119
3.3.2. Urdhërorja e greqishtes	122
3.3.2.1. E tashmja e urdhërores ose urdhërorja e vazhduar.....	123
3.3.2. 2. Aoristi i urdhërores ose urdhërorja e thjeshtë.....	124
3.4. Mënyra habitore.....	128
3.4.1. Koha e tashme.....	130
3.4.2. Koha e pakryer.....	131
3.4.3. Koha e kryer.....	133
3.4.4. Koha më se e kryer.....	134
3.4.5. Trajta të greqishtes përkthyer me habitoren e shqipes	136
3.5. Mënyra kushtore	141
3.5.1. Koha e tashme.....	141
3.5.2. Koha e kryer.....	142
3.5.3. Modaliteti i mundësisë në gjuhën greke.....	144
3.6. Mënyra dëshirore.....	146
3.6.1. Koha e tashme.....	146
3.6.2. Koha e kryer.....	148
3.6.3. Modaliteti i dëshirës në gjuhën greke.....	149

IV. Format e pashtjelluara të foljes	153
4.1. Pjesorja.....	153
4.1.2. Struktura fjalëformuese dhe përdorimi i pjesores në gjuhën shqipe krahasuar me greqishten.....	154
4.1.3. Struktura fjalëformuese dhe përdorimi i pjesores në gjuhën greke krahasuar me shqipen.....	157
4.2. Forma e pashtjelluar paskajore	163
4.2.1. Paskajorja e shqipes.....	163
4.2.2. Paskajorja e greqishtes	166
4.3. Forma e pashtjelluar përcjellore.....	167
4.4. Forma e pashtjelluar e tipit <i>pa larë</i>	169
4.5. Forma e pashtjelluar e tipit <i>me të larë, një të larë</i>	170
V. Përshtatja në gjuhën shqipe e foljeve të huazuara nga gjuha greke.....	174
5.1. Përshtatja me sistemin fonetik.....	175
5.1.1. Theksimi.....	175
5.1.2. Përshtatja tingullore.....	175
5.2. Përshtatja me sistemin morfologjik.....	176
Përfundime	178
Bibliografi.....	187
Letërsi e vjelë.....	199
Indeks i tabelave dhe paraqitjeve grafike.....	200

Parathënie

Gjuha shqipe dhe gjuha greke, dy nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit, i përkasin familjes së gjuhëve indoevropiane, ku secila prej tyre përbën një degë më vete, por ndërsa greqishtja bën pjesë në gjuhët kentum, shqipja bën pjesë në gjuhët satem. Greqishtja e re është pasardhëse e natyrshme e greqishtes antike, e cila i është nënshtruar një evolucioni natyror gjatë shekujve në të gjitha nivelet, fonetik, leksikor, morfologjik e sintaksor. Falë dokumentimit të hershëm të saj, që fillon që me linearin B në shekullin e 13-të p.K., ekzistojnë mjaft të dhëna për evolimin e saj në të gjitha fazat, nga mikenishtja te dialekti ionik – attik, më vonë te koineja, greqishtja bizantine, katharevusa e dhimotiqi (e njohur si çështja gjuhësore e greqishtes) e deri te greqishtja e re e cila përdoret në ditët e sotme. Nga ana tjetër shqipja nuk ka pasur fatkeqësisht një dokumentim kaq të herët, madje mund të themi ai ka qenë relativisht i vonë, duke vështirësuar studimin e evolimit të saj. Gjuha shqipe dhe ajo greke, dy gjuhë sintetike – analitike, me sistem binar lakimi e një sistem mjaft të zhvilluar zgjedhimi, si gjuhët e dy vendeve fqinje me kontakte të shumta midis tyre, kanë ndikuar te njëra tjetra kryesisht në nivel leksikor, por ndonjëherë studiuesit flasin edhe për ndikime të karakterit gramatikor. Ndaj dhe studimet të cilat u referohen ekskluzivisht dhe vetëm këtyre dy gjuhëve kanë qenë kryesisht në rrafshin leksikor, huazime të shqipes nga greqishtja në të gjitha periudhat e zhvillimit të tyre, ndikime të greqishtes në të folmet e jugut të Shqipërisë, interferenca leksikore të greqishtes në shqip dhe më rrallë edhe huazime të greqishtes nga shqipja, ndërsa dukuritë gramatikore si p.sh. formimi i së ardhmes nëpërmjet foljes volitive dua (θέλω), çështja e paskajores dhe mënjanimit të saj, paravendosja dhe prapavendosja e njëjës shquese, formimi i së kryerës nëpërmjet foljes ndihmëse kam (έχω), janë shqyrtuar kryesisht në kontekstin e gjuhësisë ballkanike. Në këtë kuadër mendojmë se do të ishte i dobishëm një studim që t’u referohej sistemeve foljore të këtyre dy gjuhëve, duke shqyrtuar bashkëpërkimet por edhe dallimet ndërmjet tyre, strukturën gramatikore të foljes, mënyrën e formimit të trajtave foljore dhe përdorimin e tyre gjatë ligjërimit në të dyja gjuhët parë në rrafsh krahasues si dhe mënyrat e përkthimit të tyre nga njëra gjuhë në tjetrën.

Objekti– Qëllimi i punimit

Objekti i këtij punimi është studimi sistematik i strukturës gramatikore foljore të gjuhës shqipe dhe asaj greke në rrafsh krahasues. Mënyra dhe mjetet e formimit të trajtave foljore kohore e mënyrore, por edhe formave të pashtjelluara foljore si dhe situatat ligjërimore në të cilat përdoren në secilën gjuhë dhe mënyrat e dhënies së këtyre trajtave gjatë përkthimit nga njëra gjuhë në tjetrën. Në punim shqyrtohen format foljore sintetike dhe analitike të secilës mënyrë, përkatësisht dëftore, lidhore, dhe urdhërore, për të cilat ka forma të veçanta foljore si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën greke, si edhe mënyrat kushtore, habitore e dëshirore, për të cilat ka forma të posaçme foljore vetëm për gjuhën shqipe. Në secilin rast jepen trajtat analoge foljore për nga forma në gjuhën greke dhe anasjelltas, dhe në rastet kur nuk ekzistojnë të tilla jepen mënyrat alternative të dhënies së kuptimit të foljeve kur ato vendosen në këto trajta. Pjesë e punimit janë edhe trajtat e pashtjelluara të foljes si pjesorja, struktura dhe përdorimi i të cilave ndryshojnë shumë nga shqipja në greqisht, si edhe paskajorja, struktura dhe mënjanimi i saj, përcjellorja e shqipes dhe krahasimi i saj me pjesoren aktive të greqishtes dhe format e tipit *pa larë, me të larë dhe një të larë*, të cilat nuk kanë forma analoge në gjuhën greke.

Ky punim ka si qëllim të studiojë në mënyrë të krahasuar sistemet foljore të të dyja gjuhëve, parë në rrafshin sinkronik, pra trajtat që mund të marrë folja në greqishten e re dhe në shqipen e sotme, paradigma e plotë e saj në mënyrën se si paraqitet gjatë ligjërimimit, por edhe duke bërë vërejtje të karakterit diakronik kur lind nevoja për të sqaruar struktura të ndryshme foljore ose për të ballafaquar struktura apo dukuri të ngjashme apo të njëjta foljore të të dyja gjuhëve, si p.sh. kur bëhet fjalë për formimin e kohës së ardhme nëpërmjet foljes volitive *dua* (*θέλω*), formimi i lidhores me paravendosjen e pjesëzës *të* (*va*), mënjanimi i paskajores në greqishten e re etj. Të bëjë një përjasje ndërmjet strukturave gramatikore të trajtave foljore kohore e mënyrore, mënyrës së përdorimit dhe kuptimit të tyre, në mënyrë që të dalin përfundime të vlefshme për bashkëpërkimet dhe ndryshimet ndërmjet këtyre dy sistemeve, përfundime të cilat të jenë të vlefshme, jo vetëm në sferën e mësimdhënies por edhe në atë të përkthimit, sidomos gjatë përkthimit të trajtave të cilat nuk kanë analoge në gjuhën tjetër, si p.sh. habitorja, dëshirorja, e kryera e tejshkuar, trajtat e pashtjelluara të tipit *pa larë, me të larë dhe një të larë* të shqipes si edhe disa struktura foljore të greqishtes si *θα* (*do të*) + aoristin e dëftores, *va(të)* + aoristin e dëftores, lidhorja e paraprirë nga një parafjalë apo lidhorja me nyje të paravendosur. Pra qëllimi i këtij punimi është të japë një tablo të plotë dhe të qartë të sistemeve foljore të të dyja gjuhëve, parë në një këndvështrim përjasës duke nxjerrë në pah dukuritë e njëjta dhe ndryshimet ndërmjet tyre, e gjithë kjo në funksion, jo vetëm të njohjes më të thellë të gjuhëve dhe përdorimit të drejtë të tyre, por edhe të përkthimit nga njëra gjuhë në tjetrën.

Metodologjia dhe struktura e punimit

Metodologjia që ndoqëm për kryerjen e këtij punimi vijon si më poshtë: Fillimisht bëmë një vështrim sinkronik të sistemeve foljore të të dyja gjuhëve, grumbulluam korpusin e shembujve nga vepra letrare të përkthyer nga origjinali, dhe në disa raste të përkthyer nga dy ose më shumë përkthyes, për të parë këndvështrimin e ndryshëm të tyre si edhe mënyrat alternative se si mund të përkthehet një trajtë foljore nga dy apo më shumë njohës të gjuhës, trajtat e ndryshme apo të njëjta mënyrore e kohore që mund të përdoren prej tyre për të dhënë të njëjtin kuptim leksiko – gramatikor të foljes. Dëshirojmë të theksojmë këtu se vërejtjet që janë bërë gjatë interpretimit të shembujve, janë vetëm në funksion të analizës gjuhësore dhe nuk përbëjnë kritikë përkthimi, gjithashtu një pjesë e shembujve jepen thjesht për efekt ilustrimi të pjesës teorike dhe jo të gjitha interpretohen për sa i përket mënyrës së përkthimit të tyre. Studiuam në veçanti secilën prej formave foljore kohore të të gjitha mënyrave duke dhënë mënyrën e formimit të tyre, përdorimin dhe kuptimin që merr folja kur vendoset në secilën trajtë duke dhënë ilustrimet përkatëse. Këta shembuj përkthehen për të kuptuar mënyrën se si këto trajta foljore transmetohen në gjuhën tjetër duke bërë vërejtjet përkatëse. Gjatë shtjellimit teorik të strukturave foljore shpesh bëhen edhe vërejtje të karakterit diakronik në funksion të kuptimit më të mirë të dukurive gramatikore dhe strukturave të ndryshme apo të njëjta foljore për të dyja gjuhët. Në përfundim të çdo kreu kemi nxjerrë përfundimet përkatëse rreth çështjeve të shqyrtuara. Për qasjen teorike që u është bërë trajtave foljore kohore e mënyrore si në rrafshin sinkronik ashtu edhe në atë diakronik jemi mbështetur në një bibliografi të gjerë nga studiues shqiptarë, grekë e të tjerë që kanë trajtuar çështje të shqipes apo të greqishtes, apo i kanë shqyrtuar disa nga dukuritë e përbashkëta të të dyja gjuhëve në kontekstin e gjuhësisë ballkanike.

Punimi është i konceptuar në pesë krerë pa përfshirë parathënien dhe bibliografinë. Në kreun e parë bëhet vështrim i përgjithshëm mbi sistemin foljor të shqipes e të greqishtes ku fillohet me një vështrim diakronik të dy sistemeve foljore duke parë evolimin e tyre gjatë zhvillimit historik të dy gjuhëve, trajta të trashëguara që nga periudhat e hershme si edhe trajta të cilat janë mënjeluar nga përdorimi duke u zëvendësuar me struktura të tjera. Në vazhdim trajtohen tiparet themelore të sistemit foljor të shqipes dhe greqishtes, kategoritë gramatikore që karakterizojnë foljet në të dyja gjuhët, forma dhe diateza, kohët dhe mënyrat, kategoria gramatikore e vetës, si dhe aspekti i cili karakterizon vetëm sistemin foljor të greqishtes, duke parë ngjashmëritë e ndryshimet midis tyre.

Në kreun e dytë shqyrtohen mjetet që përdoren në secilën gjuhë për ndërtimin e formave foljore si temat foljore, mbaresat vetore, prapashtesat trajtëformuese (temëformuese), bashkëtingëlloret kundër hiatit, foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*, pjesëzat trajtëformuese si dhe augmenti.

Kreu i tretë analizon mënyrat e foljes dhe kohët e secilës prej tyre, duke filluar me mënyrën dëftore, kohët sintetike dhe ato analitike, trajta foljore të cilat i hasim vetëm në gjuhën greke apo vetëm në atë shqipe, formimin dhe përdorimin e tyre gjatë ligjëritimit, mënyrën e përkthimit të tyre nga shqipja në greqisht dhe anasjelltas. Në vazhdim shqyrtohen me radhë mënyrat e tjera: mënyra lidhore, trajtat kohore të kësaj mënyre në secilën gjuhë, përdorimi i tyre me vlerën e mënyrave të tjera, përdorimi i lidhores së greqishtes me parafjalë, me nyje, si edhe përdorimi i formës “*kam + lidhore*” në të dyja

gjuhët, mënyra urdhërore, kohët e saj në gjuhën greke të cilat kanë vetëm ndryshim aspektor midis tyre, përdorimi i urdhërores në shqip dhe përkthimi i trajtave të urdhërores nga shqipja në greqisht dhe anasjelltas, mënyra habitore e shqipes, diskutimet mbi trajtat kohore të saj, formimin dhe përdorimin e tyre si dhe mënyra e përkthimit në gjuhën greke, shqyrtohen gjithashtu edhe trajta të greqishtes të cilat mund të përkthehen me habitoren e shqipes, mënyra kushtore e shqipes dhe trajtat e saj kohore, ndërkohë që në gjuhën greke nuk kemi trajta të posaçme kohore për të shprehur modalitetin e mundësisë që shpreh kjo mënyrë ku një syth i veçantë merret me trajtimin e modalitetit të mundësisë në gjuhën greke dhe trajtave foljore me të cilat shprehet, mënyra dëshirore e gjuhës shqipe, trajtat e saj kohore dhe formimi i tyre, përdorimi i këtyre formave në ligjërim dhe mënyra e përkthimit të tyre në gjuhën greke ku kjo mënyrë është mënjeluar tashmë pasi ajo ka ekzistuar në greqishten antike. Trajtohet gjithashtu edhe modaliteti i dëshirës në gjuhën greke dhe trajtat foljore me të cilat shprehet.

Në kreun e katërt bëhet një panoramë e trajtave të pashtjelluara të gjuhës shqipe dhe asaj greke ku shqyrtohet pjesorja, struktura fjalëformuese dhe përdorimi i saj, trajta e pashtjelluar paskajore dhe problemet që lidhen me të, trajta e pashtjelluar përcjellore dhe format e pashtjelluara të tipit *pa larë, me të larë* dhe *një të larë*.

Në kreun e pestë trajtohen disa folje të huazuara nga gjuha greke dhe përshtatja e tyre në gjuhën shqipe për sa i përket sistemit fonetik dhe sistemit morfologjik.

Në mbyllje jepen përfundimet e punimit në lidhje me të gjitha çështjet që janë trajtuar në të.

Punimi përfundon me dhënien e bibliografisë së përdorur gjatë kryerjes së tij si dhe veprave letrare të përdorura për shembujt që ilustrojnë teorinë gjatë punimit.

I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SISTEMIN FOLJOR TË SHQIPES E TË GREQISHTES

1.1. Zhvillimi historik i sistemit foljor të shqipes e të greqishtes

Sistemi foljor i të dyja gjuhëve ka pësuar ndryshime të rëndësishme në krahasim me tipin e lashtë indoevropian. Greqishtja, një prej gjuhëve konservatore, siç e quan K. Topalli¹, ka bërë më pak ndryshime duke e ruajtur në përgjithësi sistemin e vjetër, ndërsa shqipja, një prej gjuhëve inovuese e ka ndryshuar atë më shumë. Disa prej këtyre ndryshimeve kanë ndjekur një rrugë të ngjashme me atë që kanë përshkuar shumica e gjuhëve indoevropiane, ndërsa të tjera janë specifike për secilën gjuhë.

Në gjuhën shqipe, ashtu si edhe gjuhët e tjera indoevropiane, fleksioni foljor është riorganizuar në bazë të disa tipareve zgjedhimi, që vërtet ndryshojnë nga njëra gjuhë në tjetrën për sa u përket hollësive, por që të gjitha këto gjuhë kanë të përbashkët faktin që foljet gjatë përdorimit të tyre dalin me larmi formash gramatikore sipas një paradigme të caktuar². Sistemi foljor gjatë evolucionit të tij është riorganizuar tërësisht, evolucion i cili në të shumtën e rasteve është kryer që në periudhën parashkrimore dhe është kushtëzuar nga riorganizimi i kategorive gramatikore të sistemit foljor³. Shumë forma të vjetra të tipit të lashtë indoevropian janë zhdukur, si p.sh.: augmenti, format e ndryshme aspektore, numri dual, por janë krijuar edhe forma të reja, të cilat janë përgjithësisht analitike, si format e kohëve të kryera (*kam lexuar, kisha lexuar* etj.), format e së ardhmes, format analitike të lidhore, format e pashtjelluara ndërtuar mbi bazën e pjesores, forma joveprore e ndërtuar me pjesëzën *u*, format pashtjelluara të cilat janë ndërtuar mbi bazën e emrave prejfoljorë asnjans, format foljore analitike me vlerë aspektore (*po punoj, jam duke punuar*) dhe disa forma foljore analitike me karakter modal që shprehin domosdoshmëri ose mundësi (*do bërë, duhet bërë, mund të bëhet*)⁴.

Një dukuri shumë e hershme indoevropiane është supletivizmi. Në sistemin foljor të gjuhës shqipe ai ka lënë gjurmë vetëm në disa folje shumë të vjetra të shqipes si: *jam – qeshë, shoh – pashë* etj. Këtë dukuri e hasim edhe në gjuhën greke, si atë antike edhe në greqishten e re : *λέγω - έρω - είπα - έίρηκα - έίρηκειν* (gr.a.) / *τρώω – έφαγα, βλέπω – είδα*.

Një tipar tjetër i cili është trashëguar është edhe forma e aoristit sigmatik, i cili në gjuhën shqipe del vetëm në vetën e parë të disa foljeve të vjetra si *dhashë*, tipar ky i cili, siç do ta shohim edhe në vazhdim haset jo vetëm në greqishten e vjetër, por edhe në gjuhën e re greke, ku një pjesë e foljeve e formojnë aoristin sigmatik me bashkëtingëllore fundore të temës së aoristit *-σ-, -ψ-, -ζ-*, ndërsa të tjerat formojnë aoristin josigmatik.

Sistemi foljor i shqipes së dokumentuar ka pësuar ndryshime të mëdha edhe në tipat e zgjedhimit edhe në ndërtimin e temave foljore, kështu nga zgjedhimi në *-mi*, zgjedhimi lashtë atematik kanë mbetur në përdorim vetëm foljet *jam, kam* dhe *thom*⁵. Zgjedhimin

¹ K. Topalli, Sistemi foljor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2010.

² Sh. Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Pjesa II, Tiranë 1976

³ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 2002

⁴ K. Topalli, Sistemi foljor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2010, 58-60.

⁵ Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 2002,300.

në $-\mu$, e hasim edhe në greqishten e vjetër ku foljet në $-\mu$ i përkisnin zgjedhimit të dytë, ndërsa to më $-\omega$ zgjedhimit të parë, ndërsa në greqishten e re nuk hasen folje që t'i përgjigjen këtij zgjedhimi, të gjitha foljet mbarojnë më $-\omega$.

Forma e së ardhmes *do të punoj* ka ardhur si rezultat i gramatikalizimit të foljes *dua*, e ngurosur në formën *do*, me të tashmen e lidhore, fenomen ky që haset edhe në gjuhën greke ku e ardhmja ndërsa në greqishten e vjetër formohej në mënyrë sintetike, në një fazë më të vonshme struktura e saj është ndërtuar nga folja *θέλω* + lidhore, e cila ka evoluar deri në formën e sotme të tipit *θα κάνω*.

Numri dual, i cili përdorej edhe për sistemin emëror, është mënjeluar dhe në shqipe kemi kundërvënien numri njëjës – numri shumë. Gjurmë të numrit dual nuk hasen në shqipen e dokumentuar⁶. Numri dual haset në greqishten antike, por edhe në greqishten e ashtu si edhe në shqipe është mënjeluar.

Gjatë evolucionit të shqipes është përfutur edhe pajisja e lidhore me pjesëzën e pararendur *të*, dukuri e cila ndodh edhe gjatë evolucionit të sistemit foljor të greqishtes ku lidhëria paraprihet nga pjesëza *va*. Të dyja këto pjesëza të lidhore kanë prejardhje lidhëzore si për shqipen ashtu edhe për greqishten.

Për sa i përket dëshirores, ajo paraqet vështirësi për t'u argumentuar historikisht. Ekzistojnë pikëpamje të ndryshme për burimin e saj⁷. Dëshirorja (optativi) e greqishtes së vjetër është mënjeluar dhe në të shumtën e rasteve është zëvendësuar nga lidhëria.

Gjatë evolucionit të sistemit foljor të shqipes janë krijuar edhe formime të reja për të shprehur kuptime të reja gramatikore siç është mënyra habitore, apo forma e pashtjelluar e tipit *pa punuar*, të cilat nuk hasen në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane.

Gjuha greke si gjuhë e familjes indoevropiane paraqet ngjashmëri për shembull me sanskritishten për sa i përket organizimit të sistemit foljor bazuar në tri tema të ndryshme të cilat tregojnë ndryshimet në aspektin e foljes⁸. Për gjuhën greke, për shkak të dokumentimit shumë të hershëm të saj mund të kemi më shumë të dhëna në lidhje me këto ndryshime. Është e vështirë që të përcaktohet me saktësi periudha kohore e shfaqjes së greqishtes së hershme, protohelenike, por dimë se në shekullin e 13-të p.K. përdorej *lineari B*, në qytetërimin mikenas, i cili pasi u zbulua në 1930 nga Arthur Evans dhe u transkriptua nga Michael Ventris më 1952 u vërtetua se i përkiste një forme të hershme të greqishtes. *Lineari B* e ka prejardhjen nga *lineari A*, i cili u përdor nga mesi i shekullit të 18-të dhe deri në mesin e shekullit të 15-të p.K. dhe deri më sot janë publikuar rreth 1500 tekste të shkruar me *linearin A*⁹, që akoma edhe sot nuk është transkriptuar, pra nuk mund të themi nëse është apo jo një fazë akoma më e hershme e greqishtes. Rishfaqja e shkrimit, pas shekujve të errët të historisë së lashtë greke, ndodhi rreth fundit të shekullit të 9-të ose gjysmës së parë të shekullit të 8-të p.K. nëpërmjet alfabetit që sipas të gjitha të dhënave është huazuar nga shkrimi fenikas¹⁰, por deri në fund të shekullit të 8-të p.K.

⁶ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1976, 116

⁷ Për më tepër shih: Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002, 376-387.

⁸ J. Clarkson, *Η διαμόρφωση της ελληνικής γλώσσας*, μετάφραση: Ι. Βλαχόπουλος, Ιστορία της ελληνικής Γλώσσας, Ινστιτούτο Νεοελληνικών σπουδών, Πέμπτη ανατύπωση, 2007

⁹ Y. Duhaux, *Γραμμική Α*, μετάφραση: Ε. Τσελέντη – Α. Καραστάση, Ιστορία της ελληνικής Γλώσσας, Ινστιτούτο Νεοελληνικών σπουδών, Πέμπτη ανατύπωση, 2007

¹⁰ Ε. Βουτυράς, *Η εισαγωγή του αλφαβήτου*, Ιστορία της ελληνικής Γλώσσας, Ινστιτούτο Νεοελληνικών σπουδών, Πέμπτη ανατύπωση, 2007

përdoreshin mjaft lloje të alfabetit grek në mbishkrime¹¹. Në periudhën klasike sistemi foljor i greqishtes antike paraqitej mjaft i pasur në forma kohore e mënyrore. Folja vendosej në 4 mënyra: dëftore, lidhore, dëshirore dhe urdhërore, nga të cilat dëftorja kishte shtatë kohë: të tashmen, të pakryerën, aoristin, të ardhmen, të kryerën, më se të kryerën dhe të ardhmen e përparme, të cilat ishin të gjitha forma sintetike të foljes, përveç të ardhmes së përparme dhe së kryerës e cila, përveç formës sintetike kishte edhe atë analitike, lidhorja dhe urdhërorja mund të formonin vetëm të tashmen, aoristin dhe të kryerën, ndërsa dëshirorja formonte të tashmen, të ardhmen, aoristin dhe të kryerën. Përveç këtyre katër mënyrave folja kishte edhe dy forma emërore paskajoren dhe pjesoren të cilat kishin forma të veçanta për të tashmen, të ardhmen, aoristin dhe të kryerën. Për sa i përket kategorisë gramatikore të numrit folja mund të vendosej në numrin njëjës, në numrin shumës dhe në numrin dual. Vetat ishin tri, si edhe në greqishten e re edhe format ishin po tri: forma veprare, pësore dhe ajo mesore. Theksojmë këtu se në urdhërore folja vendosej edhe në vetën e tretë, gjë e cila nuk ndodh në greqishten e re. Diatezat ashtu si edhe në greqishten e re ishin 4: veprare, mesore, pësore dhe asnjane, ndërsa zgjedhimet dy e ndaheshin sipas mbaresës së foljes në vetën e parë njëjës të së tashmes së dëftores: në zgjedhimin e parë bënin pjesë foljet që mbaronin në vetën e parë njëjës së të tashmes së dëftores me $-\omega$, ndërsa në zgjedhimin e dytë ato që mbaronin me $-\mu$. Fatkeqësisht nuk kemi të dhëna të mjaftueshme për ilirishten e kësaj periudhe. Nga të dhënat e vakëta për të mund të flitet vetëm në nivel leksikor. Njihen vetëm disa fjalë që mendohet se vijnë nga ilirishtja, ndërmjet të cilave antroponime e toponimi, në bazë të të cilave Tzitzilis flet madje edhe për ndikime të ilirishtes në greqishte¹².

Me zhvillimin e koinesë¹³, e cila bazohej në një masë të madhe te dialekti atik, por kishte edhe elemente nga dialektet e tjera dhe u përhap në të gjithë botën helenike dhe u bë mjet komunikimi të përditshëm për një numër të madh njerëzish nga të cilët shkruhej e lexohej, ndërsa jetonin në zona të largëta gjeografikisht ndërmjet tyre e madje për shumë prej tyre kjo gjuhë nuk përbënte gjuhën e tyre amtare¹⁴, gjatë periudhës helenistike e më vonë asaj romake sistemi foljor ashtu si ai emëror e leksikor, pësoi mjaft ndryshime të cilat Browning i rendit si më poshtë¹⁵:

- Nga ana morfologjike nuk ekzistonte më ndryshimi ndërmjet formës mesore dhe asaj pësore, pavarësisht se shumë nga përdorimet e formës mesore vazhdonin edhe në koine. Pra kishim tani vetëm dy forma: formën veprare dhe atë pësore.

¹¹ R. Browning, *H ελληνική γλώσσα μεσαιωνική και νέα*, μετάφρ. Μ. Κονόμη, Αθήνα 1991, 14

¹² X. Τζιτζιλής, *Ελληνική και Ιλλυρική*, Ιστορία της ελληνικής Γλώσσας, Ινστιτούτο Νεοελληνικών σπουδών, Πέμπτη ανατύπωση, 2007

¹³ Termi *koine* përdoret edhe për raste të tjera përveç greqishtes, së cilës i përkiste fillimisht. Arsyeja e këtij zgjerimi të përdorimit të këtij termi është përmbajtja e tij etimologjike, gjuhë e përbashkët/dialekt. Siegel-i përmend mbi 40 koine të cilat shfaqen në bibliografinë e sociolinguistikës, ndërmjet të cilave përfshihen: arabishtja e folur, hebraishtja izraelite, bhojpuri, hindi, latinishtja e Perandorisë Romake, koineja angleze e mjeteve të informimit etj. Për më tepër shih: V. Bubenik, *Η δημιουργία κοινής*, μετάφραση: Ε. Μπακαγιάννη, Ιστορία της ελληνικής Γλώσσας, Ινστιτούτο Νεοελληνικών σπουδών, Πέμπτη ανατύπωση, 2007

¹⁴ P. Mackridge, *H νεοελληνική γλώσσα*, μετάφρ. Κ.Ν. Πετρόπουλος, Εκδόσεις Πατάκη, 1990

¹⁵ Për më tepër shih R. Browning, *vep. e cit.*, 1991, 46 - 57

- Koha e kryer u shkri me aoristin. Edhe pse vazhdonin të përdreshin forma të së kryerës gjatë koinesë, përdoren paralelisht dhe njësoj me format e aoristit.
- Dëshirorja humbet nga përdorimi si kategori gramatikore më vete dhe përdoret vetëm në shprehje të ngurtësuara. Sipas Andriotit¹⁶ dëshirorja humbi përfundimisht rreth viteve 600. Funkcionet e dëshirores u zëvendësuan nga lidhorja dhe formime të tjera perifrastike.
- Edhe pse lidhorja me dëftoren gjatë kësaj periudhe mbeten të ndryshme për sa i përket funksionit të tyre, nga ana e formës ato tashmë përkojnë.
- E ardhmja gjithnjë e më shumë tenton të zëvendësohet nga një sërë formash analitike.
- Aoristi sigmatik përdoret gjithnjë e më shumë duke mënjanuar aoristin jo sigmatik të periudhës klasike.
- Ndodhin thjeshtëzime të mbaresave vetore të foljeve.

Ndryshimet në sistemin foljor vazhdojnë edhe në periudhën e mesjetës. Paskajorja dhe pjesorja gatë gjithë kësaj periudhe vazhdojnë të përdoren në gjuhën e shkruar. Por në këtë kohë si paskajorja ashtu edhe pjesorja gjenden në një periudhë desistematizimi. Paskajorja mbijetoi në gjuhën e folur, ndërsa pozicioni i pjesores ishte dobësuar shumë, madje në disa raste përdorej me funksion ndajfoljor.¹⁷ Në këtë periudhë kemi gjithashtu edhe përdorimin e formës analitike të së kryerës. Ndryshme ndodhin edhe në mbaresat vetore, ndryshime që vazhduan deri në vendosjen e greqishtes së re, struktura e sistemit foljor të së cilës sot paraqitet si më poshtë:

Folja në gjuhën greke vendoset në tri mënyra: dëftore, lidhore dhe urdhërore, por si mënyra pavetore konsiderohen dhe paskajorja me pjesore. Foljet ndahen në dy zgjedhime dhe shfaqen në dy forma, në atë veprorë dhe atë joveprorë, dhe në katër diateza: veprorë, mesore, pjesore dhe asnjëse.

¹⁶ N. Ανδριώτης, *Ιστορία της ελληνικής γλώσσας*, Θεσσαλονίκη 1995, 49

¹⁷ R. Browning, *vep. e cit.*, 1991, 89

1.2. Tiparet themelore të sistemit foljor të shqipes dhe greqishtes

1.2.1. Zgjedhimi

Si gjuha shqipe ashtu edhe gjuha greke kanë një sistem foljor mjaft të pasur në forma gramatikore, të cilat janë pjesërisht sintetike dhe pjesërisht analitike.

1.2.1.1. Zgjedhimi vepror dhe jovepror

Një nga karakteristikat e përbashkëta të shqipes dhe greqishtes është se të dyja gjuhët kanë zgjedhim vepror dhe zgjedhim jovepror.

Për gjuhën shqipe foljet të cilat përdoren në më shumë se një diatezë, siç janë shumica e foljeve kalimtare, kanë si zgjedhimin vepror ashtu edhe atë jovepror, ndërsa foljet jokalimtare përkatësisht foljet mesore të tipit *kollem*, kanë vetëm një lloj zgjedhimi – zgjedhimin vepror, përkatësisht jovepror¹⁸. Format të cilat formojnë paradigmen e foljes gjatë zgjedhimit mund të jenë sintetike apo analitike.

Format sintetike të foljes në gjuhën shqipe formohen nëpërmjet mbaresave vetore, ndërrimeve fonetike që pëson tema e foljes, njëherazi nëpërmjet mbaresash dhe ndërrimesh fonetike, prapashtesave trajtëformuese të cilat mund të plotësohen ndonjëherë edhe me mbaresa vetore dhe me anë të supletivizmit, të plotësuar me mbaresa vetore apo prapashtesa trajtëformuese.

Ndërsa për të formuar trajtat analitike përdoren foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*, përkatësisht për zgjedhimin vepror dhe atë jovepror, dhe pjesëzat formante *të* për lidhoren, *duke* dhe *pa* për trajtat e pashtjelluara, *u* për zgjedhimin jovepror etj.

Edhe në gjuhën greke folja formon paradigmen e saj si në zgjedhimin vepror, ashtu edhe në atë jovepror.

Format sintetike si gjatë zgjedhimit vepror ashtu edhe në atë jovepror formohen nëpërmjet mbaresave vetore-kohore, të cilat i prapavendosen temave foljore dhe janë të ndryshme për secilin zgjedhim, ndërrimeve fonetike të temës së foljes, prapashtesave trajtëformuese dhe supletivizmit. Në greqishten e vjetër për të formuar trajtat foljore kohore e mënyrore përdreshin gjithashtu augmenti dhe dublikacioni, të cilët i hasim në sida raste edhe në greqishten e re, por për to do të flasim më gjerësisht në vazhdim. Këtu përfshijmë edhe pjesoren e paskajoren, ku pjesorja aktive dhe ajo pasive ndryshojnë si nga mbaresa ashtu edhe nga tema foljore, ndërsa për sa i përket paskajores mbaresa është e njëjtë për të dyja format (*-ει*), por ndryshon tema foljore.

Për format analitike si të zgjedhimit vepror ashtu edhe të atij jovepror përdoret folja ndihmëse *έχω* (*kam*), ndonëse për zgjedhimin jovepror hasen edhe format me foljen ndihmëse *είμαι* (*jam*)¹⁹.

¹⁸ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995, 276

¹⁹ Më gjerësisht për këto forma, mënyrën se si formohen dhe dallimet midis tyre do të flasim në kapitullin përkatës.

1.2.1.2. Ndarja e foljeve në zgjedhime

Për gjuhën shqipe kjo është një çështje e cila ka ngjallur diskutime të shumta dhe që akoma nuk është rënë dakord për një zgjidhje përfundimtare. Kjo ndodh për arsye të larmisë së madhe të formave të sistemit foljor dhe ndryshimeve që ai ka pësuar në plan diakronik të karakterit fonetik e gramatikor. Për më tepër në gramatika të ndryshme nuk është përdorur i njëjti kriter, sidomos për sa i përket temës²⁰ së foljes, apo foljeve të parregullta²¹, për klasifikimin e foljeve në zgjedhime. Ne do të paraqesim ndarjen e foljeve në zgjedhime sipas Gramatikës së gjuhës shqipe²² dhe kritereve që paraqiten në të²³, dmth. foljet ndahen në zgjedhime bazuar në tingullin fundor të temës dhe mbaresave vetore të kohës së tashme të mënyrës dëftore të formës veprare. Foljet të cilat gjatë zgjedhimit paraqesin parregullsi që nuk i lejojnë të grupohen me folje të tjera lihen jashtë klasifikimit në zgjedhime dhe trajtohen si të parregullta. Në bazë të këtyre kritereve foljet e gjuhës shqipe ndahen në tre zgjedhime:

Zgjedhimi I, i cili ndahet në dy klasa ku secila prej tyre ndahet në dy nënklasa:

Në klasën I, përfshihen foljet të cilat në dy vetat e para njëjës të së kryerës së thjeshtë marrin mbaresat *-va, ve*.

Nënklasa I përfshin foljet me temë më zanoren *-o-*, ose *-e-* të cilat në numrin shumës të së kryerës së thjeshtësi edhe në pjesore, e zbërthejnë zanoren fundore të temës në një tog zanoresh *-ua-*, *-ye-*, p.sh.: foljet *punoj, rrëfej* dhe foljet me temë më tog zanoresh *-ua-*, *-ye-*, që në njëjës in e të kryerës së thjeshtë e mbledhin atë në *-o-* përkatësisht *-e-*, si p.sh.: *shkruaj, lyej*.

Nënklasa II përfshin ato folje me temë zanore që nuk e zbërthejnë këtë tog zanoresh as në të kryerën e thjeshtë dhe as në pjesore, si p.sh.: *laj, fshij*.

Në kasën II përfshihen ato folje që e zgjerojnë temën në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore.

Nënklasa I përfshin foljet që në të kryerën e thjeshtë dhe pjesore e zgjerojnë temën me prapashtesën *-t-*, ose me prapashtesën *-jt*, p.sh.: *arrij, mbaj*.

Nënklasa II përfshin foljet *bëj* dhe *hyj*, apo edhe ndonjë tjetër, që në njëjës in e të kryerës së thjeshtë dalin me temë të zgjeruar në *-r-*.

Zgjedhimi II, i cili ndahet në dy klasa, nga të cilat e dyta ndahet në tri nënklasa:

Klasa I e këtij zgjedhimi përfshin foljet të cilat dalin me të njëjtën temë në të tashmen, të kryerën e thjeshtë dhe pjesore, p.sh.: *hap, vendos*.

²⁰ Në disa gramatika si ajo e Sami Frashërit, e Xanonit, Tasit, merren si forma themelore ato të paskajores, ndërsa në disa të tjera merret për bazë forma e së tashmes, si tek ajo e Majerit, Pekmezit, Vaingandit, Cipos, Elezi – Dodbibës dhe Demirajt. Sh. Demiraj, *Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime*, Çështje të fonetikës dhe gramatikës së sotme, Tiranë 1972.

²¹ Edhe në këtë pikë hasim mendime të ndryshme jo vetëm në trajtimin e foljeve të parregullta, por edhe në nocionin e tyre. Në gramatikat e Sami Frashërit, Majerit dhe Pekmezit nuk bëhet fare fjalë për folje të parregullta, ndërsa në gramatikat e Xanonit, Sheperit, Xhuvanit, Myderrizit, Cipos, Elezi – Dodbibës dhe Demirajt veçohen foljet e rregullta nga të parregulltat. Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, Çështje të fonetikës dhe gramatikës së sotme, Tiranë 1972

²² Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995

²³ Për më tepër rreth këtyre kritereve shih *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995, 278 - 279

Klasa II përfshin folje të cilat pësojnë ndërrim zanoresh në kohën e tashme, ose në të kryerën e thjeshtë, ose në të dyja njëkohësisht.

Në nënklasën I përfshihen foljet të cilat në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndërrimin *-e-*: *-o-*, ose *-je-*: *-o-*, përkatësisht *-a-*: *-o-*, p.sh.: *dredh, dal, rrah, njoh*.

Në nënklasën II përfshihen foljet me temë të zgjeruar të tipit *përkas*, që pësojnë ndërrimin zanor *a: e* në vetën e dytë e të tretë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore dhe që në të kryerën thjeshtë dalin ose me temë të pazgjeruar, ose me temën e zgjeruar të së tashmes duke pësuar ndërrimin *e: i*, p.sh.: *bërtas, humbas*.

Në nënklasën III përfshihen foljet *shkas, vras, ngas* dhe *gërhas*, të cilat pësojnë ndërrimin *a:e* në vetën e dytë e të tretë njëjës dhe ndërrimin *e:i* në vetën e dytë shumë të së tashmes, ndërsa në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore dalin me temë më zanore.

Zgjedhimi III ndahet në tri klasa:

Në klasën I përfshihen ato folje që në kohën e tashme dalim me temë më zanore, kurse në njëjës in e së kryerës së thjeshtë dalin me temë të zgjeruar me *-r-*, p.sh.: *vë, zë, përzë, nxë*.

Në klasën II përfshihen ato folje që në kohën e tashme dalim me temë më zanore, kurse në të kryerën e thjeshtë dalim me temë më bashkëtingëllore p.sh.: *di, fle, ngre*.

Në klasën III përfshihen foljet *pi* dhe *shitie* që në dy vetat e para të numrit njëjës të së kryerës së thjeshtë marrin mbaresat vetore *-va, -ve*.

Foljet e parregullta sipas këtij klasifikimi ndahen në dy grupe kryesore, folje të parregullta supletive dhe folje të parregullta josupletive.

Në mënyrë skematike ndarjen e foljeve në zgjedhime mund ta paraqesim:




Tabela 1.1

Për sa i përket ndarjes në zgjedhime të foljeve në gjuhën greke, këtu situata nuk paraqitet aq e komplikuar. Foljet në gjuhën greke ndahen në dy zgjedhime²⁴, sipas mbaresave të foljeve në vetën e parë të së tashmes së dëftores veprorë e pësorë.

Në **zgjedhimin e parë**, të cilit i përket pjesa më e madhe e foljeve, bëjnë pjesë foljet të cilat në vetën e parë të së tashmes së dëftores të formës veprorë kanë theks parafundor, ndërsa në vetën e parë njëjës të së tashmes së dëftores të formës pësorë marrin theks tejfundor. Foljet që përfshihen në këtë zgjedhim mbarojnë me *-ω*, në formën veprorë dhe me *-ομαι* në formën pësorë.

Ndërsa në **zgjedhimin e dytë** përfshihen foljet të cilat në vetën e parë të së tashmes së dëftores të formës veprorë kanë theks fundor, ndërsa në vetën e parë njëjës të së tashmes së dëftores të formës pësorë marrin theks parafundor. Foljet që përfshihen në këtë zgjedhim mbarojnë me *-ώ*, në formën veprorë dhe me *-ιέμαι ose -ούμαι* në formën pësorë.

Foljet e zgjedhimit të dytë ndahen në dy klasa, sipas mbaresave që marrin foljet në njëjës in e së tashmes së dëftores, përkatësisht në veprorë dhe pësorë.

Në klasën e parë të veprorës përfshihen foljet të cilat marrin mbaresat: *-ώ, -άς, -ά*, p.sh.: *μιλώ*.

Në klasën e dytë përfshihen foljet të cilat marrin mbaresat: *-ώ, -είς, -εί*, p.sh.: *κατοικώ*.

Ndërsa në klasën e parë të pësorës përfshihen foljet të cilat marrin mbaresat: *-ιέμαι, -έσαι, -ιέται*, p.sh.: *αγαπιέμαι*.

Në klasën e dytë të pësorës përfshihen foljet të cilat marrin mbaresat: *-ούμαι²⁵, -άσαι, -άται*, p.sh.: *θυμούμαι*.

Në mënyrë skematike ndarjen e foljeve të greqishtes në zgjedhime mund ta paraqesim si më poshtë:




Tabela 1.2

²⁴ Edhe në greqishten antike foljet ndaheshin në dy zgjedhime veçse kriteret e ndarjes nuk ishin të njëjta. Për evolucionin dhe dinamikën e bashkimit të zgjedhimeve shiko: Γ. Μπαμπιμώτης, *Το ρήμα της ελληνικής*, Αθήνα, 1972, 175-202.

²⁵ Disa prej foljeve që mbarojnë më *-ούμαι* si p.sh.: *στερούμαι* ndjekin zgjedhimin arkaik. Për mbaresat shiko: Μ. Τριανταφυλλίδης, *Νεοελληνική γραμματική της δημοτικής*, Θεσσαλονίκη, 2005, 342

1.2.2. Forma dhe diateza

Forma dhe kategoria gramatikore e diatezës karakterizojnë foljet si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë greke. Siç e përmendëm edhe më sipër të dyja gjuhët kanë zgjedhim vepror dhe jovepror, kështu që foljet (shumica e tyre, ka edhe folje të cilat përdoren vetëm në një formë) mund të vendosen në dy format, veprorë e joveprorë (pësorë).

1.2.2.1. Format e foljes në shqip dhe greqisht

Në gjuhën shqipe lidhjet midis veprimit dhe kryefjalës së fjalisë morfologjikisht shprehen me dy forma, të cilat i kundërvihen njëra tjetrës, forma veprorë dhe forma joveprorë e foljes²⁶. Foljet në formën veprorë në vetën e parë njëjës të së tashmes së dëftores marrin mbaresën *-j*, ndërsa foljet e zgjedhimit të dytë me temë bashkëtingëllore dhe ato të zgjedhimit të tretë me temë zanore marrin mbaresë zero. Në formën joveprorë në vetën e parë të së tashme së dëftores foljet marrin mbaresën *-em/-hem*.

Kohët analitike në formën veprorë formohen nëpërmjet foljes ndihmëse *kam*, ndërsa ato të formës joveprorë me foljen ndihmëse *jam*.

Jo të gjitha foljet mund të përdoren në të dyja format si në veprorë edhe në atë joveprorë. Shumica e foljeve kalimtare që përdoren në më shumë se një diatezë vendosen në të dyja format p.sh.: *laj – lahem, mësoj – mësohem* etj. Foljet jokalimtare vendosen vetëm në formën veprorë si p.sh.: *pësoj*, ndërsa foljet mesore të tipit *kollem* vendosen vetëm në formën joveprorë.

Grupimi i foljeve në forma në gjuhën greke ka si kriter të vetëm një kriter morfologjik, trajtën e foljes, pra si karakteristikë dalluese e formës merren mbaresat e vetës së parë njëjës së dëftores. Duke pasur parasysh këtë foljet në greqisht ndahen në dy forma: forma veprorë dhe forma pësorë²⁷.

Folje të formës veprorë janë ato të cilat në vetën e parë njëjës të dëftores marrin mbaresën *-ω (-ώ)*, ndërsa foljet janë në formën pësorë kur në vetën e parë njëjës të dëftores marrin mbaresën *-μαι*.

Zakonisht foljet në formën veprorë i përkasin diatezës veprorë dhe ato të formës pësorë, diatezës mesore e pësorë. Foljet e diatezës asnjëse mund të jenë në formën veprorë apo pësorë p.sh. folja *ζω* i përket diatezës asnjëse e formës veprorë, ndërsa folja *κοιμάμαι*, është e diatezës asnjëse por në formën pësorë.

Shumë folje në gjuhën greke mund t'i formojnë të dyja format, si atë veprorë dhe atë pësorë si p.sh.: *αγαπώ – αγαπιέμαι, δένω – δένομαι, γράφω – γράφομαι*. Ndër to hasim folje të cilat kur ndryshojnë formën ndryshojnë edhe kuptimin e tyre, p.sh.: *αφαιρώ (heq, zbres), αφαιρούμαι (hutohem)*. Disa folje, ndërsa në formën veprorë e formojnë të plotë

²⁶ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

²⁷ Kleris dhe Babiniotis përdorin format forma veprorë dhe forma mesoropësorë me argumentin se folja në formën mesoropësorë shpreh edhe diatezën pësorë dhe atë mesorë. Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπινιώτης, Γραμματική της νέας ελληνικής, 10^η έκδοση, 2004, 536.

paradigmën, në pësore formojnë vetëm vetën e tretë p.sh.: *αποφασίζω* /-ει/-ει/-ουμε/-ετε/-ουν - *αποφασίζεται, αποφασίζονται*.

Përveç foljeve të cilat mund të vendosen në të dyja format, ka edhe folje të cilat hasen vetëm në një formë, veprorë apo pësore p.sh. folje si: *ζω* (*jetoj*), *κάνω* (*bëj*), *τρέχω* (*vrapoj*) përdoren vetëm në veprorë. Ka folje që formojnë vetëm formën veprorë, të cilat i përkasin diatezës pësore si folja *παθαίνω* (*pësoj*) apo folja *κόβω* (*pres*, si në rastin *pres flokët te berberi*), që i përkasin diatezës pësore, por janë në formën veprorë. Foljet të cilat përdoren vetëm në pësore quhen folje apotetike dhe disa prej tyre janë në diatezën veprorë si p.sh: *σέβομαι* (*respektoj*), *δέχομαι* (*pranoj*).

A ka përputhje midis formave të foljes në gjuhën shqipe dhe atë greke? Në shumicën e rasteve, po. Foljet të cilat janë në veprorë ose pësore në një formë janë në të njëjtën formë edhe në gjuhën tjetër, por ka edhe raste mospërputhjeje si p.sh.: folja *kollem*, e cila në shqip është në formën joveprorë në greqisht është në veprorë *βήχω*, po ashtu foljet *έρχομαι, έχομαι, κοιμάμαι, ονειρεύομαι* të cilat janë dhe përdoren vetëm në formën pësore në gjuhën greke, në shqip përkatësisht foljet : *vij, uroj, fle, ëndërroj* janë në formën veprorë.

1.2.2.2. Kategoria e diatezës

Kategoria e diatezës është kategoria e cila paraqet ndryshimet më të mëdha në të dyja gjuhët. Ndryshimi fillon që me përcaktimin e kësaj kategorie dhe kriteret që përdoren në secilën gjuhë për ndarjen e foljeve në diateza.

Në gjuhën shqipe diateza është ajo kategori gramatikore nëpërmjet të cilës shprehet lidhja midis veprimit të emërtuar nga folja dhe kryefjalës së fjalisë, lidhje e cila shprehet morfologjikisht me formën veprorë dhe atë joveprorë²⁸. Kategorinë e diatezës e kanë ato folje të cilat mund të përdoren si në formën veprorë ashtu edhe në formën joveprorë me kundërvëniet kuptimore përkatëse²⁹. Por e marrë në një kuptim më të gjerë kjo kategori i përfshin të gjitha foljet edhe foljet të cilat mund të përdoren vetëm në formën veprorë, siç janë foljet jokalimtare, edhe folje të cilat përdoren vetëm në formën joveprorë, siç janë foljet *kollem, dukem, pendohem* etj³⁰. Sipas gramatikës së gjuhës shqipe³¹ mbështetur në llojet e ndryshme të lidhjeve midis veprimit të emërtuar nga folja dhe kryefjalës së fjalisë, si edhe në kundërvënien e formave përkatëse (veprorë - joveprorë), në gjuhën shqipe dallohen katër diateza: diateza veprorë, diateza pësore, diateza vetvetore dhe diateza mesore.

Foljet ndodhen në diatezën **veprorë** kanë formë veprorë dhe emërtojnë një veprim që e kryen kryefjala, shembujt (1), (2).

²⁸ E. Likaj jep një tjetër përkufizim për diatezën, sipas tij: “Kategoria gramatikore e diatezës tregon një gjendje të kryefjalës, që shprehet nga folja në një formë a ndërtim sintaksor të caktuar” dhe sipas këtij përkufizimi ai i grupon foljet në diatezat veprorë, jokalimtare, pësore, mesore e reciproke. Për më shumë shih, E. Likaj, *Disa çështje të kategorisë së diatezës në gjuhën shqipe*, SF 4, 1970.

²⁹ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995

³⁰ *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II*, Akademia e shkencave të Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë, 1976

³¹ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995, 270

- 1) *Ata i kthyen krahët njëri tjetrit dhe po vështronin Tiranën. (Gj.U.V. 142) – Γύρισαν τα νότα στη λίμνη και άρχισαν να παρατηρούν τα Τίρανα. (Σ.Ν.Σ. 170)*
- 2) *Dikush ka hapur varret pa lejen dhe pa dijeninë tonë, - tha prifti. (Gj.U.V. 145) – Κάποιοι άνοιξαν τους τάφους πριν έρθουμε εμείς, είπε ο στρατηγός. (Σ.Ν.Σ. 173)*

Këto folje edhe në gjuhën greke bëjnë pjesë në diatezën veprorë, por siç do ta shohim edhe në vazhdim forma veprorë nuk përbën kriter që ato të jenë ose jo në diatezën veprorë, mjafton që kryefjala të veprojë.

Foljet janë në diatezën **pësore** kur janë në formën joveprorë dhe emërtojnë një veprim që e pëson kryefjala e fjalisë ku vepruesi mund të jetë i shprehur gjuhësisht ose jo. Në këtë diatezë përfshihen të gjitha rastet kur foljet në formën joveprorë emërtojnë një veprim që nuk e kryen kryefjala e fjalisë, shembujt (3), (4).

- 3) *Kur do të thyhet ky zakon i pështirë që gjeneralët të jenë vazhdimisht nën përgjim? (Gj.U.V. 206)- Πότε θα κοπεί αυτή η αποκρουστική συνήθεια οι στρατηγοί να είναι συνεχώς υπό παρακολούθηση; (Σ.Ν.Σ. 242)*
- 4) *Dy- tri herë zgjati duart dhe i tërhoqi në çast sikur t'i digjeshin. (Gj.U.V. 207)- Άπλωσε δυο – τρεις φορές τα χέρια του και τα μάζεψε στη στιγμή σαν να του καίγονταν. (Σ.Ν.Σ. 243)*

Edhe në gjuhën greke këto folje bëjnë pjesë në diatezën pësore, por ndryshe nga gjuha shqipe aty përfshihen edhe folje të formës veprorë që tregojnë se kryefjala nuk vepron për pëson diçka.

Foljet janë në diatezën **vetvetore** atëherë kur janë në formën joveprorë dhe emërtojnë një veprim që kryefjala e fjalisë e kryen dhe e pëson njëkohësisht. Për diatezën vetvetore kemi një nënndarje ku kur kryefjala e fjalisë përfaqëson një vetë që vepron mbi vetën e vet, folja është në diatezën vetvetore të mirëfilltë p.sh.: *krihem, lahem, vishem*. Këto folje në gjuhën greke i përkasin diatezës mesore. Kur kryefjala përfaqëson dy a më shumë persona që veprojnë në mënyrë të ndërsjellë mbi njëri tjetrin, atëherë folja është në diatezën vetvetore të ndërsjellë (reciproke) p.sh.: *përqafohem, përshëndetem, fejohem*. Këto folje në gjuhën greke përfshihen në diatezën mesore dhe quhen folje mesore reciproke.

Foljet janë në diatezën **mesore** kur janë në formën joveprorë dhe emërtojnë një veprim që e kryen vetë kryefjala. Në diatezën mesore përfshihen disa folje të cilat emërtojnë lëvizje si: *hidhem, kthehem, përpiqem, rrotullohem*, shembujt (5) (6). Këto folje në gjuhën greke përfshihen në diatezën veprorë sepse pavarësisht formës tregojnë se kryefjala vepron. Disa folje të cilat emërtojnë veprime psikike – fiziologjike si: *gëzohem, hidhërohem, mërzitem, kollem*, shembulli (7) dhe disa folje të cilat emërtojnë ndryshime në gjendjen fizike, fiziologjike, psikologjike të kryefjalës si: *plakem, rritem, tkurrem*, shembujt (8), (9).

- 5) *Mjaft më jeni qepur si një dado. Lermëni të qetë, dreqi e mori. (Gj.U.V. 206) – Αρκετά μου κάνατε τη νταντά. Αφήστε με ήσυχο. (Σ.Ν.Σ. 242)*
- 6) *Ma ka ënda të ngrihem e të kërcëj valle. (Gj.U.V. 205)- Μου ρθε όρεξη να σηκωθώ να χορέψω. (Σ.Ν.Σ. 242)*

- 7) *Me siguri pati njerëz që u gëzuan sepse bota ka gjithfarë karafilash, por asnjëri nuk guxoi ta shprehte hapur.* (Gj.U.V. 71)- *Σίγουρα υπήρχαν και αυτοί που χάρηκαν, γιατί ο κόσμος έχει κάθε καρδιάς καρύδι, αν και κανένας δεν τολμούσε να το πει ανοιχτά.* (Σ.Ν.Σ. 86)
- 8) *Gjenerali u zymtua.* (Gj.U.V. 206) - *Ο στρατηγός σκοτείνιασε.* (Σ.Ν.Σ. 242)
- 9) *Po ju nuk dini të kërceni, do të bëheni qesharak.* (Gj.U.V. 206)- *Μα δεν ξέρετε να χορεύεται, θα γελοιοποιηθείτε.* (Σ.Ν.Σ. 242)

Ndërsa në gjuhën greke kriteri që përdoret për ndarjen e foljeve në diateza nuk është as morfologjik dhe as sintaksor, por semantik, lidhet me kuptimin e foljes. Diategjë e foljes quhet veprimi, pësimi apo gjendja, domethënë kuptimi që ka folja³².

Folja në gjuhën greke ka katër diateza veprorë, pësore, mesore dhe asnjëse.

Foljet i përkasin diategjës **veprorë** janë ato folje që tregojnë se kryefjala vepron, pavarësisht nëse ato janë në formën veprorë apo joveprorë, pavarësisht nëse janë kalimtare apo jokalmtare. Pra forma dhe tranzitiviteti nuk përdoren si kriterë për ndarjen e foljeve në diateza, kështu folja *εργάζομαι* (*punoj*), është në diategjën veprorë, në formën joveprorë dhe është jokalmtare, edhe folja *δουλεύω* (*punoj*) është në diategjën veprorë, por është në formën veprorë dhe është kalimtare. Në diategjën veprorë janë edhe foljet *γυρίζω* (*kthehem*), *προσπαθώ* (*përpiqem*), *ξεκινώ* (*nisem*), të cilat në gjuhën shqipe i përkasin diategjës mesore.

Tranzitiviteti dhe intranzitiviteti janë cilësi vetëm të foljeve të diategjës veprorë, pra janë vetëm foljet e diategjës veprorë që pavarësisht formës ndahen në kalimtare apo jokalmtare. Folje kalimtare quhen ato folje të diategjës veprorë ku veprimi shkon në një person apo send tjetër, folje të cilat marrin kundrinor, ndërsa jokalmtare quhen ato folje ku veprimi nuk shkon në një person apo send tjetër, folje të cilat nuk mund të marrin kundrinor.

Diategjës **pësore** i përkasin ato folje të cilat tregojnë se kryefjala pëson diçka, pra pranon një veprim që kryhet nga dikush tjetër. Shumica e këtyre foljeve ndodhen në formën joveprorë, por ka edhe folje të formës veprorë si p.sh.: folja *παθαίνω* (*pësoj*), e cila i përket diategjës pësore.

Në diategjën **mesore** bëjnë pjesë foljet ku kryefjala vepron dhe veprimi kthehet po tek ajo p.sh. : *ντόνομαι* (*vishem – vesh veten*), *πλένομαι* (*lahem – laj veten*). Këto folje në gjuhën shqipe i përkasin diategjës vetvetore.

Ndërsa diategjës **asnjëse** i përkasin foljet që tregojnë se kryefjala as vepron e as pëson, po ndodhet në një gjendje p.sh.: *κοιμάμαι* (*fle*), *ζώ* (*jetoj*) etj.

³² Μ. Τριανταφυλλίδης, *ver. e cit.*, 2005, 304

1.2.3. Mënyrat dhe kohët

1.2.3.1. Kategoria gramatikore e mënyrës

Kategorinë gramatikore të mënyrës e hasim në të dyja gjuhët. Siç e pamë edhe më sipër shqipja është relativisht më e pasur në trajta mënyrore, kemi parasysh këtu se gjatë evolucionit të gjuhës greke ka trajta mënyrore, si ajo e dëshirores, të cilat janë mënjanuar nga përdorimi³³.

Në gjuhën shqipe kategoria gramatikore e mënyrës është mjeti kryesor për të shprehur modalitetin, kategori të cilën e kanë vetëm format e shtjelluara të foljes, ndryshe nga gjuha greke, në të cilën pjesorja dhe paskajorja konsiderohen si mënyra pavetore të foljes³⁴. Me anë të kategorisë gramatikore të mënyrës folësi shpreh qëndrimin e tij ndaj veprimit të emërtuar nga folja, duke e paraqitur atë si të vërtetë, të mundshëm, të dëshirueshëm etj³⁵. Për të shprehur këto kuptimi modale shqipja gjatë evolucionit të saj historik ka krijuar tregues gramatikorë të posaçëm, të cilët në disa raste krahas kuptimit modal shprehin edhe atë të kohës³⁶. Në gjuhën shqipe dallohen gjashtë mënyra të foljes: dëftorja, habitorja, lidhorja, kushtorja, dëshirorja dhe urdhëdhorja. Në disa gramatika pranohet si mënyrë më vete dhe e ashtuquajtura mënyra lidhore – habitore³⁷. Debate dhe pikëpamje të ndryshme mes gjuhëtarëve ka edhe për sa u përket mënyrave habitore e kushtore. Disa i pranojnë këto forma foljore si mënyra më vete, ndërsa të tjerë i trajtojnë ato si forma të mënyrës dëftore³⁸.

Sipas Gramatikës së Gjuhës shqipe³⁹ këto mënyra të foljes mund të ndahen në tri grupe sipas kuptimeve modale themelore që shprehin.

Dëftorja dhe habitorja që shprehin kryesisht modalitetin vërtetësisë përbëjnë grupin e parë, po këtu duhet pasur parasysh se nëpërmjet habitores shprehet edhe ndjenja e habitës. Në grupin e dytë bëjnë pjesë lidhorja dhe kushtorja të cilat shprehin modalitetin e mundësisë, ndërsa grupi i tretë përbëhet prej dëshirores dhe urdhërores të cilat kryesisht shprehin modalitetin e dëshirës, në formë urimi a mallkimi apo në formë urdhri apo kërkese.

Mënyra në gjuhën greke quhen format e ndryshme që merr folja për të treguar predispozicionin shpirtëror të folësit⁴⁰. Kështu në gjuhën greke dallohen tri mënyra:

³³ Më hollësisht për to do të flasim në kapitullin për mënyrën dëshirore.

³⁴ Edhe në traditën e mëparshme gramatikore të shqipes pranoheshin si mënyra të foljes pjesorja, paskajorja dhe përcjellorja. Por gjuhësia e pasçlirimit ka mbajtur një qëndrim kritik ndaj këtij trajtimi, duke qenë se nëpërmjet formave të pashtjelluara të foljes nuk shprehet qëndrimi i folësit lidhur me veprimin e emërtuar nga folja, duke e paraqitur këtë si të vërtetë, të mundshëm, të dëshirueshëm etj. , Sh. Demiraj, *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën shqipe*, SF 3, 1977

³⁵ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995

³⁶ Sh. Demiraj, *Gramatika Historike e Gjuhës Shqipe*, 1986, 698

³⁷ O. Myderrizi, *Gramatika e re e shqipes*, Tiranë, 1944, K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (II), Tiranë 1961. Sh Demiraj në *Gramatikën Historike të Gjuhës Shqipe*, 1986, 699, 701, është i mendimit se mënyra lidhore – habitore nuk mund të merret si një mënyrë më vete.

³⁸ S. Frashëri dhe K. Kristoforidhi në gramatikat e tyre i trajtojnë format e habitores si forma të dëftores dhe të lidhore, ndërsa për sa i përket kushtores S. Frashëri dhe F. Agalliu nuk e pranojnë atë si mënyrë më vete.

³⁹ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995

dëftore, lidhore dhe urdhërore. Në disa gramatika të greqishtes së re konsiderohen mënyra edhe dëshirorja⁴¹ (*είθε να γράψει*) apo mënyra e mundësisë (*δυνητική*) (*θα έγραφα*), gjë që sipas Kleris – Babiniotis ndodh për arsye të paqartësisë së termit *mënyrë*. Sipas tyre⁴² ndërsa pranohet nga të gjithë se mënyra është shprehja morfologjike e modalitetit, është e paqartë se ç' kuptohet me termin shprehje morfologjike. Duke qenë se në gjuhët indoevropiane tradicionalisht mënyrat janë trajta të cilat dallohen nga mbaresat ata konsiderojnë se dy mënyrat të cilat dallohen qartësisht ndërmjet tyre janë dëftorja dhe urdhërorja, ndërsa për sa i përket lidhore, ajo dallohet nga tema në trajtat që formohen nga tema e aoristit. Në trajtat e tjera si edhe te dëshirorja e kushtorja dallimi nuk bëhet nëpërmjet mbaresave, por nëpërmjet pjesëzave që u paravendosen foljeve (*να, θα, ας*). Disa studiues mendojnë se këtu nuk bëhet fjalë për dallime morfologjike, por sintaksore.⁴³ Në gramatikën tradicionale të greqishtes së re trajtohen si mënyra pavetore dhe paskajorja me pjesoren⁴⁴.

1.2.3.2. Kategoria gramatikore e kohës

Sistemi foljor i shqipes së dokumentuar është mjafti pasur në forma kohore, nëpërmjet të cilave shprehen dallime kuptimore, jo vetëm me karakter kohor, por në disa raste edhe me karakter aspektor⁴⁵. Kategoria gramatikore e kohës shpreh lidhjen ndërmjet kohës kur kryhet veprimi që emërton folja dhe një çasti të caktuar, i cili merret si bazë në marrëdhëniet kohore. Ky çast në gjuhën e folur është çasti i ligjërimit, ndërsa për gjuhën e shkruar mund të jetë çasti kur shkruajmë, ose një çast tjetër i përfytyruar. Kështu kohët themelore të foljes janë tri: e tashmja, e shkuara dhe e ardhmja⁴⁶. Këto tri kohë themelore paraqesin nëndarje kohore. Jo të gjitha mënyrat e foljes kanë të njëjtin numër kohësh gramatikore. Kjo ndodh sepse “tipi i modalitetit të kësaj apo asaj mënyre kushtëzon edhe ekzistencën, edhe përdorimin e një numri më të madh, përkatësisht më të vogël formash kohore⁴⁷”. Kështu mënyra dëftore e shqipes, e cila, për sa i përket modalitetit është më pak e shenjuar⁴⁸ se mënyrat e tjera, është më e pasur në forma kohore. Dëftorja ka dhjetë forma kohore: e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera, e kryera e tejshkuar, e ardhmja, e ardhmja e përparme, e ardhmja e së shkuarës dhe e ardhmja e përparme e së shkuarës⁴⁹. Mënyra habitore ka katër forma kohore: kohën e tashme, të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën, mënyra lidhore ka kohën e tashme, të pakryerën të kryerën dhe më se të kryerën, mënyra kushtore ashtu si edhe ajo dëshirore paraqiten vetëm me dy forma kohore, të tashmen dhe të kryerën, ndërsa për mënyrën

⁴⁰ M. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005., 308

⁴¹ Dëshirorja e greqishtes së vjetër e cila u mënjanua gjatë evolucionit të gjuhës paraqitet me trajtë të veçantë foljore.

⁴² Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπιμιώτης, *Γραμματική της νέας ελληνικής*, 10^η έκδοση, 2004, 475

⁴³ Po aty

⁴⁴ M. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005., 308

⁴⁵ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1986, 708

⁴⁶ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995, 273

⁴⁷ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1986, 709

⁴⁸ Në “*Gramatika Historike e Gjuhës Shqipe*”, 1986, Sh. Demiraj është i mendimit se dëftorja nga pikëpamja e modalitetit karakterizohet negativisht.

⁴⁹ Në mënyrë analitike për secilën kohë të secilës mënyrë do të referohemi në kapitujt në vijim.

urdhërore nuk ekziston ndonjë kundërvënie kohore, ndaj dhe në format e saj nuk e ka kategorinë gramatikore të kohës⁵⁰.

Edhe në gjuhën greke për të dalluar përshkallëzimet kohore përdoren trajta të veçanta foljore, kohët gramatikore. Kohët gramatikore grupohen në : kohë të së tashmes, kohë të së shkuarës dhe kohë të së ardhmes, si edhe në gjuhën shqipe. Për gjuhën greke vetëm në mënyrën dëftore këto kohë shprehin momentin e kryerjes së veprimit. Kështu kohët e mënyrës dëftore janë e tashmja, e pakryera, aoristi, e kryera, më se e kryera, e ardhmja e thjeshtë, e ardhmja e vazhduar dhe e ardhmja e përparme. Ashtu si edhe në gjuhën shqipe trajta foljore në këto kohë mund të jetë sintetike si e tashmja, e pakryera dhe aoristi, ose analitike (perifrastike) si e kryera, më se e kryera, e kryera e tejshkuar dhe kohët e së ardhmes. Në gramatikën e gjuhës greke bëhet edhe një klasifikim tjetër i kohëve sipas aspektit⁵¹ ku kohët grupohen në tri kategori: Kohët e vazhduara të cilat tregojnë vazhdimësinë, kohëzgjatjen apo përsëritjen e veprimit: koha e tashme, koha e pakryer dhe e ardhmja e vazhduar, kohët e çastit ose përmbledhëse, të cilat e paraqesin veprimin në tërësinë e tij si të ketë ndodhur apo të ndodhë, ose konsiderojmë se ka ndodhur ose do të ndodhë një herë të vetme dhe këto kohë janë aoristi dhe e ardhmja e thjeshtë dhe kohët e kryera që e paraqesin veprimin si të përfunduar, të kryer: e kryera, më se e kryera dhe e ardhmja e përparme.

Mënyrat e tjera përveç dëftores nuk i kanë të gjitha kohët, por edhe kohët të cilat kanë nuk përcaktojnë çastin e kryerjes së veprimit, por aspektin, pra kohët e mënyrës lidhore dhe urdhërore kanë vetëm dallime aspektore midis tyre dhe emërtimet e tyre bëhen sipas temës trajtëformuese të këtyre kohëve. Kështu lidhëria ka tri kohë të tashmen, e cila formohet nga tema e së tashmes së dëftores dhe shpreh vazhdimësi, aoristin që formohet nga tema e foljes në aoristin e dëftores dhe është një kohë e çastit (përmbledhëse) dhe të kryerën. Urdhërorja ka vetëm dy kohë të tashmen dhe aoristin, edhe këto me ndryshime aspektore midis tyre. Për sa i përket kohës së kryerjes së veprimit që këto kohë tregojnë ajo varet nga situata ligjërimore në të cilat vendosen⁵².

Vëmë re gjuha shqipe paraqitet relativisht më e pasur në trajta mënyrore dhe kohore se sa gjuha greke. Kështu gjuha shqipe paraqet tri trajta mënyrore të cilat në gramatikën e gjuhës greke nuk i hasim, habitorja, dëshirorja dhe kushtorja, por trajtohen si modalitete, ndaj paraqet interes mënyra se si jepen këto trajtat mënyrore të shqipes për të cilat kemi trajta të veçanta foljore, të cilat nuk ekzistojnë në gjuhën greke, sidomos modaliteti që ato shprehin.

Një pasqyrë e plotë e trajtave kohore e mënyrore të shqipes e greqishtes jepet në tabelën 1.3.

⁵⁰ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1986

⁵¹ M. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005, 313

⁵² Hollësisht në lidhje me kuptimin kohor dhe mënyrën e formimit të secilës kohë do të bëhet fjalë në kapitujt përkatës.

Gjuha shqipe		Gjuha greke	
Dëftore	<ol style="list-style-type: none"> 1. e tashmja 2. e pakryera 3. e kryera e thjeshtë 4. e kryera 5. më se e kryera 6. e kryera e tejshkuar 7. e ardhmja 8. e ardhmja e përparme 9. e ardhmja e së shkuarës 10. e ardhmja e përparme e së shkuarës 	Dëftore	<ol style="list-style-type: none"> 1. e tashmja 2. e pakryera 3. aoristi 4. e kryera 5. më se e kryera 6. e kryera e tejshkuar 7. e ardhmja e thjeshtë 8. e ardhmja e vazhduar 9. e ardhmja e përparme
Habitore	<ol style="list-style-type: none"> 1. koha e tashme 2. koha e pakryer 3. koha e kryer 4. koha më se e kryer 	–	–
Lidhore	<ol style="list-style-type: none"> 1. koha e tashme 2. koha e pakryer 3. koha e kryer 4. koha më se e kryer 	Lidhore	<ol style="list-style-type: none"> 1. koha e tashme 2. aoristi 3. koha e kryer
Kushtore	<ol style="list-style-type: none"> 1. koha e tashme 2. koha e kryer 	–	–
Dëshirore	<ol style="list-style-type: none"> 1. koha e tashme 2. koha e kryer 	–	–
Urdhërore	– ⁵³	Urdhërore	<ol style="list-style-type: none"> 1. koha e tashme 2. aoristi

Tabela 1.3

⁵³ Në trajtat e mënyrës urdhërore nuk krijohet në gjuhën shqipe një kundërvënie kohore, pra nuk mund të flasim në këtë mënyrë për kategorinë gramatikore të kohës. Më hollësisht për këtë do të flasim në kapitullin përkatës.

1.2.4. Kategoria gramatikore e vetës

Kategorinë e vetës e kanë foljet si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën greke, por edhe në gjuhët e tjera indoevropiane.

Kjo kategori, e cila shpreh lidhjen midis folësit dhe kryefjalës dhe kushtëzohet nga veta e kryefjalës së fjalisë në gjuhën shqipe, shprehet nëpërmjet mbaresave⁵⁴ të cilat kanë ndryshuar, ashtu si edhe në gjuhën greke, gjatë evolimit historik të shqipes. Sipas Demirajt⁵⁵ nga studimet krahasimore të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe një pjesë e mirë e këtyre mbaresave është trashëguar nga një fazë e hershme indoevropiane dhe gjatë evolucionit historik të shqipes ato kanë pësuar reduktime apo shtime tingujsh të tjerë për arsye fonetike apo analogjike, por nga përbërja e tyre e hershme kanë mbetur elemente thelbësore që e bëjnë të qartë karakterin e tyre indoevropian.

Folja në gjuhën shqipe ka tri veta dhe shumica e foljeve përdoren në të tria vetat, por ka edhe disa folje të cilat përdoren vetëm në vetën e tretë siç janë foljet njëvetore dhe foljet pavetore.

Folje njëvetore janë ato folje të cilat:

- emërtojnë veprime karakteristike për kafshët si p.sh.: *hingëllin, kakaris* etj., folje të cilat edhe në gjuhën greke përdoren vetëm në vetën e tretë, përkatësisht *χλιμιντριζει, κακαρίζει*.

- folje që tregojnë dukuri atmosferike apo natyrore si *fryn (era), bie (shi, borë), gjelbëron (bari)*, etj., për dy foljet e para edhe në gjuhën greke foljet analoge *φυσάσει, βρέχει, χιονίζει*, përdoren po vetën në vetën e tretë.

- folje të tipit (*s'më*) *besohet, (më) bëhet, duket, (më) pëlqen, ndodh*, kur ndiqen nga një fjali e varur kryefjalore. Në gjuhën greke tri foljet e fundit përdoren në të njëjtën mënyrë si në shqip përkatësisht *φαίνεται, (μou) αρέσει, συμβαίνει*, ndërsa për sa i përket dy foljeve të para përdoren të njëjtat folje por në struktura të ndryshme sintaksore, përkatësisht *δεν το πιστεύω (nuk e besoj)* dhe *θέλω να κάνω (dua të bëj)*.

- 1) *S'na besohet*, - *tha njëri. –Ishte njeriu gjallë dhe s'është më. (Gj.U.V. 175)- Δεν μπορώ να το πιστέψω, είπε κάποιος ήταν ένας τόσο ζωντανός άνθρωπος και δεν υπάρχει πια. (Σ.Ν.Σ. 208)*
- 2) *Më duket se mbasdite do të kemi shi. (Gj.U.V. 173)- Μου φαίνεται πως το απόγευμα θα 'χουμε βροχή. (Σ.Ν.Σ. 205)*
- 3) *Më duket e vështirë, nëse eshtrat janë nisur. (Gj.U.V. 149)- Το θεωρώ δύσκολο, αφού τα λείψανα έχουν ήδη σταλεί. (Σ.Ν.Σ. 178)*
- 4) *Atyre u pëlqen të përsëritin se Shqipëria është një kështjellë në breg të Adriatikut, - tha prifti. (Gj.U.V. 151) – Στους Αλβανούς αρέσει να επαναλαμβάνουν πως η Αλβανία είναι ένα κάστρο στις ακτές της Αδριατικής. (Σ.Ν.Σ. 181)*
- 5) *Nuk të durohet, tha me vete gjenerali. (Gj.U.V. 152) – Δεν αντέχεις, σκέφτηκε ο στρατηγός. Σε περιμένουν. (Σ.Ν.Σ. 181)*

⁵⁴ Ka edhe folje të cilat në numrin njëjës marrin mbaresën zero, për mbaresat vetore të secilës kohë do të flasim në kapitujt përkatës.

⁵⁵ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1986,683

- 6) **Qëllonte** që edhe fshatarët vinin nganjëherë e pinin. (Gj.U.V. 165) – Καμιά φορά έρχονταν και οι χωρικοί να πινουν. (Σ.Ν.Σ. 196)
- 7) **Qëllonte** që e vështroja në mesnatë të ndriçuar nga drita e ftohtë dhe e bardhe dhe thosha me vete: Kjo urë do të na e hajë kokën me radhë të gjithëve. (Gj.U.V. 166) - **Όταν** την κοίταζα τα μεσάνυχτα φωτισμένη απ' το κρύο άσπρο φως, μονολογούσα: Αυτή η γέφυρα θα μας το φάει το κεφάλι όλων μια μέρα. (Σ.Ν.Σ. 197)

Siç duket edhe nga shembulli (1) në gjuhën greke folja *besoj* nuk mund të përdoret si folje njëvetore apo pavetore ndaj përcjellja e saj në greqisht, kur në shqip përdoret si e tillë bëhet nëpërmjet foljes *μπορώ* (*mund*) + foljen *πιστεύω* (*besoj*) në lidhore.

Folja *duket* e cila në shembujt (2) dhe (3) përdoret si folje njëvetore, në gjuhën greke jepet përkatësisht me foljet *φαίνεται* (*duket*) dhe *θεωρώ* (*konsideroj*), ku në rastin e parë folja *φαίνεται* konsiderohet në gjuhën greke si pavetore, ndërsa në rastin e dytë folja *θεωρώ* është në vetën e parë njëjës duke i paravendosur trajtën shkurtër të vetës së tretë *το (e): το θεωρώ δύσκολο – e konsideroj të vështirë*, pra kjo është tërësisht në gjykimin e përkthyesit, pasi kuptimi i foljes *duket* mund të jepet pa ndryshuar kuptimin e fjalisë me të dyja mënyrat.

Edhe folja *pëlqej*, shembulli (4), kur në gjuhën shqipe përdoret si njëvetore edhe në gjuhën greke përdoret si e tillë.

Kur folja *duroj*, shembulli (5), përdoret si folje njëvetore, në gjuhën greke përcillet me foljen *duroj* në vetën e trajtës së shkurtër të shqipes, pra struktura sintaksore *s'të durohet* jepet me strukturën *δεν αντέχεις* (*nuk duron*), pasi folja *αντέχω* nuk mund të përdoret në gjuhën greke si pavetore.

Në shembujt (6) dhe (7) kur folja *qëlloj* përdoret si njëvetore, gjatë përkthimit në greqisht shmanget transmetimi i saj nëpërmjet një foljeje të veçantë, ndërkohë që ajo mund të jepet në gjuhën greke nëpërmjet foljes *τυχαίνει*, e cila ka të njëjtin përdorim dhe kuptim me atë të foljes *qëlloj* në këtë rast.

Disa folje kalimtare përdoren në formën joveprore si njëvetore kur folësi nuk mund apo nuk di të përcaktojë atë që kryen veprimin e përcaktuar prej tyre si p.sh.: *lejoj, them, ndaloj, di*. Për sa u përket tri foljeve të para edhe në gjuhën greke haset një përdorim analog i tyre: *επιτρέπω – επιτρέπεται, λέω – λέγεται απαγορεύω – απαγορεύεται*, ndërsa folja *di*, siç duket edhe nga shembulli i mposhtëm nuk mund të përdoret si e tillë në gjuhën greke dhe jepet nëpërmjet foljes (*είμαι*) *jam* në vetën e tretë dhe mbiemrit *γνωστός* (*i njohur*), në gjininë asnjënjës, jepet d.m.th. me një shprehje foljore pavetore.

- 8) **Dihej** veç që kishin qenë prej gjëkund, që nga trevat ku në rast vdekjeje qanin vetëm gratë, gjer te bjeshkët veriore ku gjëmën bënin burrat..... (Gj.U.V. 157) – Δεν ήταν γνωστό τίποτε άλλο, παρά μόνο πως είχαν έρθει από παντού, από περιοχές που στους θανάτους κλαίνε μόνο οι άντρες.....(Σ.Ν.Σ. 188)

Foljet *jam, vij, shkoj, dal* etj. në shprehje si: *s'është keq, me vjen mirë, më doli nga mendja* etj.

- 9) Do të ishte mirë që mbrëmjeve të shkonit në opera. (Gj.U.V. 134)- Θα κάνατε καλά αν κάποιο βράδυ πηγαίνατε στην όπερα. (Σ.Ν.Σ. 160)

Foljet pavetore janë foljet të cilat:

- Emërtojnë dukuri atmosferike si: *vetëtin*, *bubullin*, *bën ftohtë*, *bën freskët* etj., folje të cilat kanë të njëjtin përdorim edhe në gjuhën greke.

- Foljet me vlerë modale *duhet* dhe *do*. Këto folje në gjuhën greke jepen nëpërmjet foljes pavetore *πρέπει*, siç duket edhe në shembujt (1), (2).

1) *Diku duhet të jetë këndeje rrotull.* (Gj.U.V. 178)- **Πρέπει** να είναι κάπου εδώ γύρω. (Σ.Ν.Σ. 210)

2) **Duhet** të marr qetësues. (Gj.U.V. 134)- **Πρέπει** να πάρω ηρεμιστικά. (Σ.Ν.Σ. 160)

- Folja *kam* në vetën e tretë njëjës, kur përdoret me kuptimin e foljeve *ndodhet* (*ndodhen*), *ekziston* (*ekzistojnë*).

- Disa folje jokalimtare në formë joveprorë të shoqëruara ose jo me një pjesëz mohimi, folje të cilat emërtojnë veprime në mënyrë të përgjithësuar dhe shprehin njëkohësisht ngjyrimin modal të mundësisë dhe ndonjëherë edhe atë të detyrimit p.sh.: *s' rrihet*, *s' shkohet*, *s' rrihet*, *s' flitet* etj. Këto folje nuk mund të përdoren në gjuhën greke si pavetore, ndaj gjatë përkthimit së tyre në greqisht, kur në shqip përdoren si të tilla, përdoret kryesisht lidhorja e foljes, shembulli (3), ose i paravendoset kësaj lidhoreje folja *θέλω* (*dua*), shembulli (4).

3) *Kam dëgjuar të flitet shumë për këtë gjë, por, të them të drejtën, ende nuk e marr vesh ç'është.* (Gj.U.V. 139) – Άκουσα να μιλούν πολύ γι' αυτήν, αλλά για να πω την αλήθεια, ακόμα δεν έχω καταλάβει περί τίνος πρόκειται. (Σ.Ν.Σ. 167)

4) **S'na vihej** në hotel. (Gj.U.V. 175)- Δε θέλαμε να πάμε σε ξενοδοχείο. (Σ.Ν.Σ. 207)

Edhe në gjuhën greke folja vendoset në tri veta, përveç urdhërores ku si edhe në shqip folja ka vetëm vetën e dytë, të cilat dallohen nga mbaresat vetore që i prapavendosen temës së foljes. Në gramatikën e Triantafilidhit⁵⁶ veta përkufizohet si trajta e foljes që tregon se në cilën vetë është kryefjala e saj. Foljet të cilat përdoren zakonisht në vetën e tetë njëjës duke mos pasur si kryefjalë një person apo një objekt quhen folje pavetore.

Folje të tilla janë:

- Folje që tregojnë dukuri natyrore: *βρέχει* (*bie shi*), *χιονίζει* (*bie borë*), *αστράφτει* (*vetëtin*), *βροντά* (*bubullin*), *βραδιάζει* (*bie nata*), *ξημερώνει* (*agon*), *σκοτεινιάζει* (*errësohet*), *φυσάει* (*fryn*) etj.

- Si folje pavetore mund të përdoren edhe folje të zakonshme të cilat përdoren për të treguar një dukuri të natyrës p.sh.: *κάνει ωραίο καιρό* (*bën kohë e mire*), *κάνει κρύο* (*bën ftohtë*).

⁵⁶ Μ. Τριανταφυλλίδης, *ver. e cit.*, 2005

- Konsiderohen në gjuhën greke folje pavetore edhe foljet: *πρέπει* (*duhet*), *πρόκειται* (*bëhet fjalë*), *συμφέρει* (*është me interes, leverdi*).

Përdoren si folje pavetore edhe disa folje të tjera të cilat marrin një kuptim të veçantë ose përdoren në shprehje të caktuara si: *φαίνεται* (*duket*), *τυχαίνει* (*ndodh*), *μπορεί* (*mund*), *θέλει* (*do*) etj.

Ndër foljet që përdoren si folje pavetore janë foljet *είμαι* (*jam*), *έχω* (*kam*), *κάνω* (*bëj*) dhe *περνώ* (*kaloj*). Ndërsa Babiniotis bën dallim midis foljeve që mund të përdoren vetëm në vetën e tretë dhe foljeve pavetore⁵⁷.

⁵⁷ Për më tepër shih: Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπινιώτης, *ver. e cit.*, 2004,602 -605

1.2.5. Çështja e aspektit

Në gjuhën shqipe aspekti i foljes nuk trajtohet si kategori e mirëfilltë gramatikore. Në gramatikën e gjuhës shqipe⁵⁸ ky term përdoret p.sh. për të treguar ndryshimin midis së kryerës së thjeshtë, të pakryerës dhe më se të kryerës i cili “ka më fort karakter aspektor”. Në të njëjtën gramatikë sqarohet se “Kategoria e aspektit mbështetet në kundërvënien veprim i kryer: veprim i pakryer, të shprehur me format gramatikore përkatëse në të gjithë paradigmen e sistemit foljor. Kategoria gramatikore e aspektit nuk është e zhvilluar në sistemin foljor të shqipes, i cili është i karakterizuar nga kategoria gramatikore e kohës. Por disa forma foljore të këtij sistemi dallohen ndërmjet tyre për nga ngjyrimet aspektore”. Në një fazë më të hershme të shqipes kanë ekzistuar forma të ndryshme aspektore, që shpreheshin me mbaresa të veçanta, të cilat kanë humbur duke e shndërruar në këtë mënyrë sistemin e dikurshëm aspektor në sistem kohor, por disa nga format foljore e kanë ruajtur karakterin e tyre aspektor, p.sh.: koha e tashme dhe e pakryer kanë karakter imperfektiv, kurse e kryera e thjeshtë ka karakter perfektiv⁵⁹.

Ndryshe nga gjuha shqipe, në gjuhën greke aspekti zë një vend mjaft të rëndësishëm. Në krye të herës kohët e foljes përdoren për të shprehur aspektin (llojin dhe mënyrën e kryerjes së veprimit të shprehur nga folja: i vazhduar, i çastit, i kryer) dhe jo momentin e kryerjes së veprimit (të tashmen, të shkuarën, të ardhmen)⁶⁰. Dallimi aspektor midis kohëve vazhdon edhe në greqishten e re. Mirambeli thekson se dallimi aspektor mbizotëron edhe mbi dallimin mënyror edhe mbi atë kohor⁶¹. Por studiuesit nuk përdorin një terminologji të unifikuar për të dhënë këtë kategori të foljes në gjuhën greke. Triantafilidhis⁶² përdor temin “*τρόπος*”, Babiniotis⁶³ termin “*ποιόν ενέργειας*”, ndërsa Mackridge⁶⁴ përveç termit “*τρόπος ενέργειας*” përdor edhe termin “*όψη του ρήματος*” që sipas të cilit i përgjigjet termit të rusishtes *vid*. Kundërvënia kryesore është aspekti perfektiv – imperfektiv⁶⁵, por ekziston edhe aspekti i kryer (perfekti), i cili karakterizon foljet në kohën e kryer, më se të kryer dhe në të ardhmen e përparme të mënyrës dëftore. Aspekti imperfektiv karakterizon foljen në të tashmen e të gjitha mënyrave, dëftore, lidhore dhe urdhërore, të pakryerën dhe të ardhmen e vazhduar të dëftores, ndërsa ai perfektiv foljen në aoristin e të gjitha mënyrave, dëftore, lidhore dhe urdhërore dhe në të ardhmen e thjeshtë të dëftores.

⁵⁸ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995

⁵⁹ K. Topalli, *vep. e cit.*, Tiranë, 2010, 58, 212.

⁶⁰ Ι Σταματάκου, *Ιστορική γραμματική της αρχαίας ελληνικής*, Αθήνα, 1968, 83

⁶¹ Mirambel, De l'emploi de l'aoriste en grec moderne, *Transactions of the Philological Society*, 1942, 28. Cituar sipas P. Mackridge, *Η νεοελληνική γλώσσα*, Εκδόσεις Πατάκη, 1990

⁶² Μ. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005, 312

⁶³ Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπιμιώτης, *vep. e cit.*, 2004, 435, 447.

⁶⁴ P. Mackridge, *vep. e cit.*, 1990, 169-170

⁶⁵ Edhe terminologjia që karakterizon llojin e aspektit në gjuhën greke nuk është tërësisht e unifikuar.

Përfundime

- ❖ Foljet si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë greke, gjatë përdorimit të tyre dalin me larmi formash gramatikore sipas një paradigme të caktuar. Sistemi foljor i të dyja gjuhëve ka evoluar nga ai i gjuhës indoevropiane duke ruajtur në disa raste karakteristika të tij, e në raste të tjera ka pasur një zhvillim të mëvetësishëm në secilën gjuhë. Disa tipare të përbashkëta të cilat rrjedhin nga burimi i përbashkët indoevropian janë:
 - Supletivizmi, i cili në sistemin foljor të gjuhës shqipe ai ka lënë gjurmë vetëm në disa folje shumë të vjetra, ndërsa e hasim në gjuhën greke, si atë antike edhe në greqishten e re.
 - Forma e aoristit sigmatik, e cila në gjuhën shqipe, përsëri ruhet vetëm në disa folje të vjetra, ndërsa në gjuhën greke ka zëvendësuar në mjaft raste aoristin josigmatik të greqishtes së vjetër.
- ❖ Si gjuha shqipe ashtu edhe gjuha greke kanë zgjedhim vepror dhe zgjedhim jovepror, të cilat formohen nëpërmjet mbaresash vetore – kohore dhe mjetesh të tjera si foljet ndihmëse *kam* e *jam*, dukuri që është e përbashkët për të dyja gjuhët.
- ❖ Foljet e gjuhës shqipe ndahen në tre zgjedhime sipas mbaresave vetore e ndryshimeve tingullore të temës së foljes, ndërsa foljet në gjuhën greke ndahen në dy zgjedhime, sipas mbaresave të foljeve në vetën e parë të së tashmes së dëftores veprorë e pësore.
- ❖ Foljet si në greqisht ashtu edhe në shqip ndahen në dy forma: forma veprorë dhe forma pësore. Në shumicën e rasteve kemi përputhje të formës së foljes në shqip dhe në greqisht, pra foljet të cilat janë në veprorë ose pësore në njëren gjuhë janë në të njëjtën formë edhe në gjuhën tjetër, por ka edhe raste mospërputhjeje ku folje të cilat në shqip janë në formën joveprorë në greqisht janë në veprorë, ose folje të cilat janë dhe përdoren vetëm në formën pësore në gjuhën greke, në shqip janë në formën veprorë.
- ❖ Në gjuhën shqipe mbështetur në llojet e ndryshme të lidhjeve midis veprimit të emërtuar nga folja dhe kryefjalës së fjalisë, si edhe në kundërvënien e formave përkatëse (veprorë - joveprorë) dallohen katër diateza: diateza veprorë, diateza pësore, diateza vetvetore dhe diateza mesore. Ndërsa në gjuhën greke kriteri që përdoret për ndarjen e foljeve në diateza nuk është as morfologjik dhe as sintaksor, por semantik, lidhet me kuptimin e foljes. Folja në gjuhën greke ka katër diateza: veprorë, pësore, mesore dhe asnjane. Përputhjet më të shumta për sa i përket kategorisë së diatezës të dyja gjuhët i kanë në diatezën veprorë e pësore, ndërsa për sa u përket dy diatezave të tjera hasim mjaft ndryshime dhe kjo për shkak të kriterëve të ndryshme që përdoren në të dyja gjuhët për grupimin e foljeve në diateza.

- ❖ Gjuha shqipe, në të cilën dallohen gjashtë mënyra të foljes: dëftorja, habitorja, lidhorja, kushtorja, dëshirorja dhe urdhëdhorja, shfaqet relativisht më e pasur në forma mënyrore se gjuha greke ku dallohen tri mënyra vetore: dëftore, lidhore dhe urdhërore dhe dy pavetore ku përfshihen pjesorja dhe paskajorja.
- ❖ Kategorinë e vetës e kanë foljet si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën greke, si edhe në gjuhët e tjera indoevropiane. Si në shqip ashtu edhe në greqisht kemi folje pavetore, ose njëvetore, por jo gjithmonë kemi përputhje midis tyre.
- ❖ Në gjuhën shqipe aspekti i foljes nuk trajtohet si kategori e mirëfilltë gramatikore, vetëm disa forma foljore sistemit foljor të shqipes dallohen ndërmjet tyre për nga ngjyrimet aspektore, në gjuhën greke aspekti zë një vend mjaft të rëndësishëm. Kundërvënia kryesore është aspekti perfektiv – imperfektiv, por ekziston edhe aspekti i kryer (perfekti).
- ❖ Sistemi foljor i gjuhës shqipe dhe asaj greke shfaqin mjaft ngjashmëri e dallime të cilat do të shqyrtohen në mënyrë analitike në kapitujt përkatës.

II. MJETET E NDËRTIMIT TË FORMAVE FOLJORE

Si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë greke për të formuar trajtat e ndryshme sintetike e analitike të foljes gjatë paradigms së tyre përdoren mjete të ndryshme gjuhësore, ku disa prej tyre kanë karakter arkaik e disa vazhdojnë të luajnë një rol veprues në sistemin foljor të secilës gjuhë. Shumë nga këto mjete gjuhësore, siç do të shohim edhe në vazhdim, janë të njëjta në të dyja gjuhët. Kështu për të ndërtuar format sintetike të shqipes dhe të greqishtes përdoren temat foljore, mbaresat, prapashtesat trajtëformuese dhe bashkëtingëlloret kundër hiatit, ndërsa për ndërtimin e formave analitike përdoren foljet ndihmëse *jam* dhe *kam* dhe pjesëzat trajtëformuese. Në gjuhën greke për ndërtimin e formave sintetike përdoret gjithashtu augmenti dhe dublikacioni.

2.1 Temat foljore

a. Në gjuhën shqipe shumica e foljeve i ndërtojnë të gjitha format gramatikore me një temë të vetme, temën me të cilën shfaqen në kohën e tashme dhe në të gjitha vetat e kohëve të të gjitha mënyrave. Në gramatikën⁶⁶ e gjuhës shqipe në këtë kategori foljesh përfshihen edhe foljet *punoj*, *rrëfej* të cilat në shumësin e së kryerës së thjeshtë dhe pjesores e zbërthejnë zanoren e theksuar të temës përkatësisht në *-ua* dhe *-ye*, si edhe foljet e tipit *shkruaj* e *thyej*, të cilat në njëjës in e së kryerës së thjeshtë e mbledhin togun e zanoreve *-ua-*, *-ye-* përkatësisht në *-o-* dhe *-e-*. Por ekziston edhe një numër jo i vogël foljesh të cilat gjatë paradigms së tyre paraqiten me dy tema, si foljet e tipit *mbaj*, *bëj*, apo me tri tema, si foljet e tipit *heq*, *mbjell*, ku njëra nga temat është e njëjtë për shumicën e vetave të kohës së tashme dhe për pjesoren, një temë e dytë e cila është e njëjtë për vetën e dytë shumës të së tashmes, për të pakryerën, për urdhëroren dhe për të gjitha format joveprore të foljes në të tashmen dhe të pakryerën dhe një temë e tretë për të kryerën e thjeshtë. Disa folje paraqiten edhe me katër tema të ndryshme si foljet *dal*, *vras*, *pëlcas*.

Këto tema të ndryshme formohen kryesisht nëpërmjet ndërrimeve fonetike si metafoia *-a-* : *-e-*, përkatësisht *-o-*: *-e-* në vetën e dytë e të tretë njëjës të së tashmes së dëftores, *dal* – *del*, *shoh* – *sheh*, ndërrimi *-s-*: *-t-*, *pres* – *pret*, apofonia *-a-*: *-o-*, përkatësisht *-e-/je-*: *-o-* në të kryerën e thjeshtë, *marr* – *mora*, *mbjell* – *mbolla*, ndërrimi *-e-/je-*: *-i-*, në vetën e dytë shumës së kohës së tashme, në të tashmen e joveprores dhe të pakryerën e veprores dhe joveprores, si edhe të kryerën e thjeshtë në disa raste, *heq* – *hiqni*, *mbjell* – *mbillni* etj. Ndërrime fonetike të temës ndodhin edhe nëpërmjet zberthimit të *-o-* së dhe *-e-* së përkatësisht në *-ua* dhe *-ye*, në shumësin e së kryerës së thjeshtë dhe pjesores, dhe anasjelltas në njëjës in e së kryerës së thjeshtë nëpërmjet mbledhjes së togut të zanoreve *-ua-*, *-ye-* përkatësisht në *-o-* dhe *-e-*, si p.sh.: foljet *punoj*, *rrëfej*, të cilat klasifikohen në grupin e foljeve të cilat i ndërtojnë të gjitha format gramatikore me një temë të vetme, temën me të cilën shfaqen në kohën e tashme⁶⁷.

⁶⁶ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, 277

⁶⁷ Po aty

Në gjuhën greke tri janë temat të cilat shërbejnë për të formuar trajtat që merr folja gjatë paradigmes së saj, tema e së tashmes aktive, tema e aoristit aktiv dhe tema e aoristit pasiv⁶⁸.

Tema e së tashmes veprare të dëftores, nëpërmjet së cilës formohen të gjitha kohët e vazhduara, me aspekt imperfektiv, të të gjitha mënyrave, pra e pakryera dhe e ardhmja e vazhduar e dëftores, e tashmja e lidhore, ose lidhëria e vazhduar, e tashmja e urdhërores, ose urdhërorja e vazhduar dhe pjesorja aktive p.sh.: *διαβάζ-ω, διάβαζ-α, θα διαβάζ-ω, να διαβάζ-ω, διάβαζ-ε, διαβάζ-οντας*. Sipas gramatikës së Triantafilidhit⁶⁹ temat foljore të së tashmes aktive kategorizohen në gjashtë kategori sipas tingullit fundor (karakterit) të tyre:

Kategoria e parë: përfshin foljet tema e të cilave ka si tingull fundor një zanore (*e, i, u*): *πλέ-ω, μηνύ-ω, ακού-ω*.

Kategoria e dytë: përfshin foljet tema e të cilave ka si tingull fundor një bashkëtingëllore buzore (*π-ρ, β-ν, φ- f*). Këtu përfshihen edhe foljet tema e të cilave mbaron me togjet e bashkëtingëlloreve *πτ-ρτ, φτ-φτ* si edhe togjet *εν-εν, εφ; αυ- αυ, εφ; βλέπ-ω, ανάβ-ω, γράφ-ω, πάυ-ω βασιλεύ-ω*

Kategoria e tretë: përfshin foljet tema e të cilave ka si tingull fundor një bashkëtingëllore grykore (*γ-γ, κ-κ, χ- χ*). Këtu përfshihen edhe foljet tema e të cilave mbaron me togjet e bashkëtingëlloreve *χν - χν, ng: ανοίγ-ω, πλέκ-ω, βρέχ-ω, δείχν-ω*.

Kategoria e katërt: përfshin foljet tema e të cilave ka si tingull fundor një bashkëtingëllore dentale (*θ, τ- t*) dhe ato siristike të zëshme apo të pazëshme (*ζ-ζ, σ-s*): *νιώθ-ω, θέτ-ω, πλήττ-ω, αλλάζ-ω, αρέσ-ω, εξελίσσ-ω*.

Kategoria e pestë: përfshin foljet tema e të cilave ka si tingull fundor një bashkëtingëllore hundore (*ν-n, μ-m*) dhe likuide (*λ-l, ρ-r*). Këtu përfshihen edhe foljet tema e të cilave mbaron me togjet e bashkëtingëlloreve *λν- λν, ρν-ρν: μέν-ω, τρέμ-ω, θέλ-ω, ζέρ-ω, ψέλν-ω, γέρν-ω*.

Në kategorinë e gjashtë përfshihen foljet e zgjedhimit të dytë, d.m.th. folje të cilat në vetën e parë të së tashmes së dëftores aktive theksohen në mbaresën – *ώ, αγαπώ, κατοικώ*.

Tema e aoristit vepror përdoret për të formuar trajtat foljore të kohëve të thjeshta të zgjedhimit vepror, pra të aspektit perfektiv, të të gjitha mënyrave, pra aoristin dhe të ardhmen e thjeshtë të dëftores, aoristin e lidhore ose lidhoren e thjeshtë, aoristin e urdhërores ose urdhëroren e thjeshtë, si edhe paskajoren aktive të greqishtes së re që përdoret për të formuar kohët analitike të zgjedhimit vepror, vetën e dytë njëjës të aoristit të urdhërores pasive, p.sh.: *διάβασ-α, θα διαβάσ-ω, να διαβάσ-ω, διάβασ-ε, διαβάσε-ει, διαβάσ-ου*.

Tema e aoristit aktiv mund të jetë sigmatike apo josigmatike. Aoristin sigmatik e formojnë foljet me karakter të temës një bashkëtingëllore buzore e cila, në kontakt me bashkëtingëlloresn *σ -s* të aoristit ndërrohet në *ps* (*λείπω – έλειψα, βάρω - έβαψα*), një bashkëtingëllore grykore e cila, në kontakt me bashkëtingëlloresn *σ -s* të aoristit, ndërrohet në *ks* (*πλέκω – έπλεξα, τρέχω - έτρεξα*), apo një bashkëtingëllore dentale ose

⁶⁸ Mackridge i emërton përkatësisht, tema e vazhduar, tema përmbledhëse aktive dhe tema përmbledhëse pasive, P. Mackridge, *vep. e cit.*, 1990, 251, 252

⁶⁹ M. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005

siristike të cilat, në kontakt me bashkëtingëlloresn σ -s të aoristit, ndërrohen në *s ose ks* (*θέτω – έθεσα, παίζω – έπαιξα, νομίζω - νόμισα*).

Foljet me tingull fundor të temës bashkëtingëllore hundore dhe likuide formojnë aoristin josigmatik, përveç disa foljeve me tingull fundor të temës *n* (*πλένω – έπλυνα, στέλλω – έστειλα, δένω - έδεσα*).

Foljet e zgjedhimit të dytë e formojnë aoristin sigmatik, por tingullit fundor *s* i paravendoset zanorja *i*, apo në disa raste *a*, ose *-e* (*τραγουδώ – τραγούδησα, γελώ – γέλασα, μπορώ – μπόρεσα*).

Tema e aoristit jovepror përdoret për të formuar trajtat foljore të kohëve të thjeshta të zgjedhimit jovepror të të gjitha mënyrave, pra aoristin dhe të ardhmen e thjeshtë të dëftores pasive, aoristin e lidhore ose lidhoren e thjeshtë të zgjedhimit jovepror, vetën e dytë shumës të aoristit të urdhërores pasive, si edhe paskajoren pasive të greqishtes së re që përdoret për të formuar kohët analitike të zgjedhimit jovepror, p.sh.: *διαβάστ-ηκα, θα διαβαστ-ώ, να διαβαστ-ώ, διαβαστ-είτε, διαβαστ-εί*.

Tema e aoristit pasiv formohet në rastin foljeve që formojnë aoristin sigmatik, nëse në temën e aoristit aktiv zëvendësojmë σ -në me $-\theta$ ose $-\sigma$ (*δένω - έδεσα – δέθηκα, ακούω – άκουσα - ακούστηκα*).

Kur tema e aoristit vepror mbaron më $-\psi$ (*ps*), në aoristin pasiv ajo shndërrohet në $-\varphi$ (*κρύβω- έκρυψα – κρύφτηκα*), ndërsa në rastin e foljeve tema e të cilave mbaron me togjet *ev-en, ef; av- an, ef*, tema e aoristit pasiv formohet duke i shtuar temës të së tashmes aktive një $-\tau$ (*μαγένω – μάγεψα – μαγεύτηκα*).

Kur tema e aoristit vepror mbaron më $-\zeta$ (*ks*), e cila në fakt është bashkimi i bashkëtingëllores fundore të temës (κ) *k* me (σ) *s*-në e aoristit sigmatik, në aoristin pasiv ajo shndërrohet në $-\chi\tau$ (*πλέκω – έπλεξα – πλέχτηκα*).

Kur tema e aoristit vepror të foljeve, tema e së cilave ka si tingull fundor një bashkëtingëllore dentale ose siristike, mbaron më $-\sigma$ apo $-\zeta$ (*ks*), në aoristin jovepror ato shndërrohen përkatësisht në $-\theta$ dhe $-\sigma$ (*πλάθω – έπλασα – πλάστηκα, λούζω – έλουσα – λούστηκα*).

Ndërsa për sa u përket foljeve që e formojnë aoristin vepror josigmatik, tema e aoristit jovepror formohet duke i shtuar temës së aoristit pasiv një $-\theta$ (*βάζω – έβαλα – βάλθηκα, φέρνω – έφερα - φέρθηκα*), ose duke e zëvendësuar karakterin e saj me $-\theta$ (*ζεσταίνω, ζέστανα – ζεστάθηκα, πλένω – έπλυνα – πλύθηκα, κρίνω – έκρινα - κρίθηκα*).

Në gjuhën greke, ashtu si edhe në gjuhën shqipe, këto tema foljore formohen kryesisht prej ndërrimeve fonetike, përveç temave supletive.

2.2. Mbaresat vetore

Një nga mjetet kryesore të formimit të trajtave foljore si të zgjedhimit vepror dhe atij jovepror janë mbaresat vetore. Disa nga mbaresat vetore të gjuhës shqipe janë trashëguar nga një fazë e hershme indoevropiane, ashtu si ka ndodhur edhe me gjuhë të tjera indoevropiane, por gjatë evolucionit të tyre kanë pësuar ndryshime të mëdha në krahasim me tipin e hershëm, ndërsa disa të tjera janë përfutur gjatë evolucionit historik të gjuhës shqipe, për të zëvendësuar ato mbaresa vetore që me kohë janë zhdukur fare ose janë bërë arkaike. Mbaresat vetore të shqipes janë të shumëkuptimshme, sepse përveç vetës dhe numrit shprehin edhe kategoritë gramatikore të kohës dhe diatezës e në ndonjë rast edhe të mënyrës⁷⁰. Në disa raste në gjuhën shqipe foljet marrin edhe mbaresën zero, e cila në kundërvënje me mbaresat vetore, kryen të njëjtin funksion me to. Shumica e mbaresave vetore të shqipes janë të gjalla, ato kanë ardhur duke u diferencuar gjithnjë e më shumë edhe sipas kohës duke e bërë edhe më të qartë dallimin midis kohëve sintetike.

Edhe në gjuhën greke mbaresat vetore shërbejnë për të shprehur njëkohësisht mënyrën, diatezën, kohën dhe numrin në të cilin ndodhet folja. Ekzistojnë d.m.th. mbaresa të ndryshme për sa i përket formës veprorë e joveprorë, kohëve e mënyrave të ndryshme. Mbaresat e urdhërores janë të veçanta, ndërsa për dëftoren dhe lidhoren hasen edhe mbaresa të njëjta e në ato raste dallimi bëhet nëpërmjet pjesëzave që i paravendosen foljes, ose në rastet kur to mungojnë nga struktura e temës foljore dhe mbaresa, apo nga përdorimi i saj në ligjërim. Në greqishten e vjetër mbaresat e dëftores e lidhores kanë qenë të ndryshme, por gjatë evolimit fillimisht pati një ndryshim drejtshkrimor ndërmjet tyre, por shqiptim të njëjtë, e në vazhdimësi ato janë njehsuar.

Për sa u përket kohëve analitike mbaresat vetore i marrin foljet ndihmëse ndërsa paskajorja e greqishtes së re mbetet e pandryshuar gjatë zgjedhimit.

Për mbaresat vetore të kohëve të secilës mënyrë në të dyja gjuhët do të bëhet fjalë në mënyrë analitike në kapitujt përkatës.

⁷⁰ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1986, 658, 678

2.3. Prapashtesat trajtëformuese (temëformuese)

Tema e disa foljeve gjatë paradigmës së tyre zgjerohet nëpërmjet prapashtesave të ndryshme të cilat janë një mjet tjetër i formimit të strukturave foljore. Sipas Demiraj⁷¹, prapashtesat temëformuese që ndeshen në shqipen e dokumentuar janë:

Prapashtesa *-sh-*, e cila është një prapashtesë e trashëguar që haset vetëm në vetën e parë njëjës të së kryerës së thjeshtë, ose aoristit sigmatik në disa folje të trashëguara si: *pa-sh-ë, qe-sh-ë, ra-sh-ë* etj.

Prapashtesat e trashëguara të pjesores *-në/-rë, -m-, -të*, të cilat trajtohen më hollësisht në kapitullin mbi pjesoren.

Prapashtesat *-t/-jt*, që janë përftuar gjatë evolucionit historik të shqipes dhe zgjerojnë temën e disa foljeve në të kryerën e thjeshtë dhe pjesore si: *di/ di-t-a/ di-t-ur, rua-j/ rua-jt-a/ rua-jt-ur, mbaj/ mbaj-t-a/ mbaj-t-ur*.

Prapashtesa *-fsh/-sh* e cila zgjeron temën e së tashmes së dëshirores dhe është përftuar nga evolimi historik i shqipes.

Prapashtesa *-as/-s* në temën e foljeve të kohës së tashme e të pakryerës e në disa raste edhe të kryerës së thjeshtë të foljeve si: *flas < fol+ as, bërtas < brit + as, thërras < thirr + as*, e cila në shumë raste pëson shndërrime tingullore.

Si prapashtesë temëformuese në rrafshin diakronik konsiderohet nga Demiraj⁷² edhe bashkëtingëllorja fundore e temës *-n*, në foljet e tipit *bën, hyn*.

Çështja e prapashtesave trajtëformuese në greqishten e re është një çështje e cila diskutohet ende nga studiuesit dhe nuk është arritur në një mendim të unifikuar nga studiuesit. Në analizën strukturore që Babiniotis⁷³ i bën foljes në greqishten e re dallon dy përbërës kryesorë: temën dhe mbaresën dhe duke vazhduar me tej analizën tema përbëhet prej bazës me ose pa prapashtesë e prapashtesë. Si prapashtesa temëformuese në greqishten e re ai konsideron:

Prapashtesën *-s-*, e cila përdoret për të formuar temën e foljeve të aoristit sigmatik, p.sh.: *ανιγ-ο – ανικ-s-a, αγαπα-ο – αγαπι-s-a*.

Prapashtesën *-θik-/tik*⁷⁴, e cila përdoret për të formuar temën e aoristit pasiv të foljeve p.sh. : *kriv-ο – krif-tik-a, αγαπα-ο – αγαπι –θik-a*.

Prapashtesën *-γ*⁷⁵, e cila përdoret për të formuar temën alternative të së pakryerës aktive të disa foljeve të zgjedhimit të dytë, si p.sh.: *αγαπ-ο – αγαπα-γ-a*, edhe të foljeve *ακούω, λέω, καίω, φταίω, κλαίω* etj.

⁷¹ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1986

⁷² Po aty

⁷³ Γ. Μπαμπινιώτης, *vep. e cit.*, 1972, 26-27

⁷⁴ Triantafillidhis në gramatikën e tij i konsideron këto prapashtesa si pjesë e mbaresës (Τριανταφυλλίδης Μ., *Νεοελληνική γραμματική της δημοτικής*, Θεσσαλονίκη, 2005, 361, 362), Mackridge e konsideron θ-në si pjesë të temës, ndërsa *-ik-* si shtesë ndërmjet temës e mbaresës (P. Mackridge, *Η νεοελληνική γλώσσα*, Εκδόσεις Πατάκη, 1990, 265) ndërsa Kleris e Babiniotis në gramatikën e tyre (Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπινιώτης, *Γραμματική της νέας ελληνικής*, 10^η έκδοση, 2004, 516- 517) parashtrojnë dy analiza strukturore të foljes ku në të parën i konsiderojnë këto prapashtesa si pjesë të temës së foljes duke dhënë një sistem unik mbaresash, ndërsa në të dytën e konsiderojnë θ-në si pjesë të temës, ndërsa *-ik-* pjesë të mbaresës.

Prapashtesa trajtëformuese mund të konsiderohen gjithashtu edhe prapashtesa *-ει*, e cila përdoret për të formuar trajtën e paskajores së greqishtes së re si atë të formës veprare dhe atë të formës jo veprare: *διαβάσ-ει*, *διαβαστ-ει*, *αγαπήσ-ει*, *αγαπηθ-εί*.

Për të formuar trajtën e pjesores aktive përdoret prapashtesa *-οντας/ώντας* përkatësisht për foljet e zgjedhimit të parë dhe të zgjedhimit të dytë: *μιλ-ώντας*, *γράφ-οντας*.

⁷⁵ Në foljet e tipit *αγαπο*, Mackridge (1990, 266) trajton si shtesë togun *-αγ-*, Kleris e Babibniotis (*vep. e cit.*, 2004, 516- 517) në dy analizat strukturore të foljes e paraqesin në të parën si pjesë të temës së foljes, ndërsa në të dytën e si pjesë të mbaresës, ndërsa për foljet e tipit *ακούω*, *λέω* trajtohet si pjesë e mbaresës.

2.4. Bashkëtingëlloret kundër hiatit

Në gjuhën shqipe, në forma të ndryshme të sistemit foljor midis temës foljore e cila mbaron në zanore dhe mbaresës vetore e cila nis përsëri me zanore shtohen disa tinguj bashkëtingëllore për të prishur hiatin e krijuar nga takimi i këtyre dy zanoreve të cilat nuk formojnë diftong.

Në shqipen e dokumentuar bashkëtingëlloret që përdoren si tinguj kundër hiatit janë *-v-*, *-h-*, dhe *-j-*⁷⁶.

Bashkëtingëlloret kundër hiatit *-v-* del vetëm në vetën e parë e të dytë njëjës të së kryerës së thjeshtë të foljeve me temë në zanore si *la-v-a*, *shkro-v-a*, *pre-v-a*, *fshi-v-a* etj. Kjo bashkëtingëllore nuk është e nevojshme në vetën e tretë njëjës ku zanorja e theksuar e temës formon me mbaresën vetore një diftong, *la-u*, *shkro-i*, si edhe në numrin shumës mbaresat vetore nisin me bashkëtingëllore. Bashkëtingëlloret kundër hiatit *-v-* haset në gjuhën shqipe edhe në sistemin *rasor p.sh. : male ~ male-v-e*

Bashkëtingëlloret kundër hiatit *-h-* del në kohën e tashme dhe të pakryerën e joveprores së foljeve me temë në zanore, te të cilat duhet të jetë shtuar në krye të herës si *la-h-em*, *di-h-em*, dhe nën ndikimin e këtyre foljeve u shtri edhe në foljet me temë në *-n-*, të cilat në krye të herës nuk e merrnin këtë tingull si *gëzon-em : gëzo-h-em*⁷⁷.

Bashkëtingëlloret kundër hiatit *-j-*, duke qenë se haset edhe në disa forma rasore (*kala ~ kala-j-a*, *rrufe ~ rrufe-j-a*), koniderohet si si tingulli më i përhapur kundër hiatit në strukturën morfologjike të shqipes⁷⁸. Kjo bashkëtingëllore del në vetën e tretë njëjës të kohës së tashme dhe në vetën e parë e të dytë njëjës të së të pakryerës së lidhores dhe në vetën e parë e të dytë njëjës të së pakryerës së dëftores së foljeve me temë në zanore si *di: di-j-a*, *të di-j-ë*, *të dija*. Bashkëtingëlloret *-j-* përdoret gjithashtu edhe për të zhdukur hiatin në mënyrën urdhërore të foljes kur shoqërohet me një trajtë të shkurër (*shuaje*, *lyeje*, *punoje*)⁷⁹.

Si bashkëtingëllore kundër hiatit në gjuhën greke shërben bashkëtingëlloret *-γ-*, e cila përdoret jo vetëm në sistemin foljor, por edhe në atë emëror. Kjo bashkëtingëllore vendoset ndërmjet temës dhe mbaresës te disa folje në vetën e parë të së tashmes së dëftores aktive si p.sh.: *τρώ(γ)ω*, *λέ(γ)ω*, në vetat e tjera nuk është i domosdoshëm përdorimi i saj, madje edhe në vetën e parë këto folje mund të përdoren pa të, përderisa mbaresat vetore fillojnë me zanore të ndryshme nga zanorja fundore e temës së foljes, ose fillojnë me bashkëtingëllore: *τρω-ς*, *τρώ-ει*, *λέ-ει*, *λέ-με*. Bashkëtingëlloret kundër hiatit *-γ-* përdoret gjithashtu edhe në të pakryerën e disa foljeve kur zanorja fundore e temës së folje është e njëjtë me mbaresën vetore p.sh.: *έτρωγα*, *έτρωγες*, *έτρωγε*, *τρώγαμε*, *τρώγατε*, *έτρωγαν*.

⁷⁶ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1986, 661

⁷⁷ Po aty, 662

⁷⁸ Po aty

⁷⁹ K. Topalli, *vep. e cit.*, 2010

2.5. Foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*

Foljet *kam* dhe *jam* në gjuhën shqipe përveç kuptimit të tyre të mëvetësishëm ku shprehin përkatësisht zotërimin, përkatësinë e diçkaje (folja *kam*) dhe një gjendje (folja *jam*), shërbejnë si folje ndihmëse për të formuar kohët analitike të foljes. Kështu duke iu paravendosur pjesores së foljes themelore, dhe e vendosur në kohë të ndryshme, formohen përkatësisht koha e kryer (*kam/jam mësuar*), më se e kryera (*kisha/isha mësuar*), e kryera e tejshkuar (*pata/qeshë mësuar*), e ardhmja e përparme (*do të kem mësuar*). Folja *kam* përdoret si folje ndihmëse edhe në rastet kur i paravendoset paskajores së tipit *për të mësuar* dhe formon në këtë rast në varësi të kohës, e tashme apo e pakryer, përkatësisht formën e së ardhmes (*kam për të mësuar*), apo të së ardhmes të së shkuarës (*kisha për të mësuar*). Folja *jam* kryen funksionin e foljes ndihmëse edhe në rastin kur ajo i paravendoset formës së pashtjelluar të tipit *duke mësuar* dhe formon në këtë mënyrë përkatësisht formën analitike të së tashmes (*jam duke mësuar*) apo të pakryerës (*isha duke mësuar*) së mënyrës dëftore në varësi të kohës në të cilën ajo vendoset. Kur përdoren si folje ndihmëse, foljet *kam* edhe *jam* e humbasin kuptimin leksikor dhe kthehen në fjalë shërbyese me funksion thjesht gramatikor⁸⁰. Duke qenë se në këto raste foljet *kam* dhe *jam* u paravendosen trajtave të pashtjelluara (pjesore, formë e pashtjelluar paskajore, formë e pashtjelluar përcjellore) ato bëhen bartëse të kuptimit gramatikor. Kështu format e tyre vetore shprehin kuptimin gramatikor të kohës, të diatezës, të formës, të vetës e të numrit.

Foljet *kam* dhe *jam* mund të përdoren gjithashtu edhe si folje modale kur ato ndiqen nga forma e pashtjelluar e tipit *për të mësuar*. Ndërsa folja *jam* mund të përdoret edhe si folje këpujore.

Foljet *kam* dhe *jam* si folje të mëvetësishme mund t'i formojnë të gjitha trajtat kohore si ato sintetike edhe ato analitike (*kam, kisha, pata, kam pasur, kisha pasur, pata pasur, do të kem pasur, do të kisha, do të kisha pasur*), në ndryshim nga gjuha greke ku këto dy folje formojnë vetëm të pakryerën e dëftores nga kohët e së shkuarës. Ndaj edhe në gjuhën greke e kryera e tejshkuar nuk mund të formohet si trajtë kohore.

Edhe në gjuhën greke si folje ndihmëse përdoren foljet *έχω* (*kam*) dhe *είμαι* (*jam*). Ato përdoren për të formuar kohët perifrastike. E kryera (*έχω πλύνει*), më se kryera (*είχα πλύνει*) dhe e ardhmja e përparme (*θα έχω πλύνει*) e zgjedhimit vepror formohen në gjuhën greke me foljen ndihmëse *έχω* (*kam*) përkatësisht në të tashmen, të pakryerën dhe të ardhmen dhe paskajoren aktive, por mund të formohen edhe nga folja ndihmëse *έχω* dhe njëjësi i pjesores pasive të së kryerës, e cila merr gjininë e kundrinorit përkatësisht *έχω πλυμένο, είχα πλυμένο, θα έχω πλυμένο*. Këto dy trajta siç do të shohim edhe më poshtë nuk janë tërësisht sinonimike ndërmjet tyre për sa i përket kuptimit.

Në zgjedhimin jovepror kohët perifrastike e kryera (*έχω πλυθεί*), më se kryera (*είχα πλυθεί*) dhe e ardhmja e përparme (*θα έχω πλυθεί*) formohen nëpërmjet foljes ndihmëse *έχω* (*kam*) përkatësisht në të tashmen, të pakryerën dhe të ardhmen dhe paskajoren pasive, por mund të formohet edhe nga folja ndihmëse *είμαι* dhe njëjësi i pjesores pasive të së kryerës, e cila merr gjininë e kryefjalës përkatësisht *είμαι πλυμένος, ήμουν πλυμένος*,

⁸⁰ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

θα είμαι πλυμένος. Edhe këto dy trajta siç do të trajtojmë edhe më poshtë nuk janë tërësisht sinonimike ndërmjet tyre për sa i përket kuptimit.

Këto dy folje si edhe në shqip përdoren edhe si folje të mëvetësishme, por ato nuk mund t'i formojnë trajtat kohore të të gjitha kohëve. Ato mund të formojnë të tashmen dhe të pakryerën (*έχω* - *είχα*, *είμαι* - *ήμουν*). Për të gjitha kohët e së shkuarës përdoret trajta e së pakryerës (*είχα*, *ήμουν*), madje edhe për ato analitike të së shkuarës. Formojnë gjithashtu vetëm një trajtë të së ardhmes (*θα έχω*, *θα είμαι*) e cila përdoret për të dyja aspektet, si për atë perfektiv edhe për atë imperfektiv. E njëjta gjë ndodh edhe për kohët e lidhores dhe urdhërores të cilat kanë ndërmjet tyre ndryshime vetëm aspekte, këto folje formojnë vetëm një trajtë: *να έχω*, *να είμαι*, *έχε*, *έχετε*. Edhe të kryerën e lidhores këto dy folje nuk mund ta formojnë, por mund të përdoren në të pakryerën e dëftores paraprirë nga pjesëzat *να*, *ας* të lidhores.

2.6. Pjesëzat trajtëformuese

Për të formuar trajtat analitike të foljes përdoren në gjuhën shqipe, siç do të shohim edhe në gjuhën greke, pjesëza të cilat në përgjithësi u paravendosen formave foljore⁸¹ dhe nëpërmjet gramatikalizimit të tyre formohen trajta të reja gramatikore të zgjedhimit foljor. Këto pjesëza për gjuhën shqipe janë:

Pjesëza *do*, e cila si edhe në greqisht ka origjinë foljore, nga folja *dua*, dhe përdoret për formimin e kohëve të së ardhmes, pra për të ardhmen, të ardhmen e përparme, të ardhmen e së shkuarës dhe të ardhmen e përparme të së shkuarës të mënyrës dëftore. Përdoret gjithashtu edhe për të formuar kohët e mënyrës kushtore.

Pjesëza *të*, e cila ka origjinë lidhëzore dhe përdoret si tregues i kohëve të mënyrës lidhore.

Pjesëza *u*, e cila ka origjinë përemërore dhe përdoret për të formuar disa nga trajtat foljore të diatezës joveprore.

Pjesëzat *për*, *me*, *pa* dhe *duke*, të cilat përdoren për formimin e trajtave të pashtjelluara të foljes, përkatësisht format e tipit *për të larë*, *me la*, *pa larë*, *duke larë* dhe *me të larë*.

Pjesëzat trajtëformuese që në gjuhën greke përdoren për të formuar trajta analitike foljore janë:

Pjesëza $\theta\alpha$ (*do*), e cila e ka prejardhjen nga folja $\theta\acute{\epsilon}\lambda\omega$ (*dua*), $\theta\acute{\epsilon}\lambda\omega\ \nu\alpha - \theta\epsilon\ \nu\alpha - \theta\alpha$, dhe përdoret për të formuar kohët e së ardhmes së dëftore, të ardhmen e thjeshtë, të ardhmen e vazhduar dhe të ardhmen e përparme. Kjo pjesëz u paravendoset në disa raste edhe foljeve në kohën e pakryer, aorist dhe më se të kryerën e dëftores për të shprehur kuptime të ndryshme modale. Sigurisht trajta e së ardhmes është një strukturë tashmë e gramatikalizuar, ndërsa përdorimi i pjesëzës $\theta\alpha$ me kohë të tjera është situacional në varësi të modalitetit që dëshiron të shprehë folësi.

Pjesëzat e lidhore $\nu\alpha$ (*të*), $\alpha\varsigma$ (*le të*). Pjesëza $\nu\alpha$ (*të*) si edhe në gjuhën shqipe ka origjinë lidhëzore dhe përdoret në greqishten e re për të formuar kohët e mënyrës lidhore. Edhe pjesëza $\nu\alpha$ mund t'u paravendoset foljeve në kohën e pakryer, aorist, më se të kryerën e dëftores për të shprehur kuptime të ndryshme modale.

⁸¹ Ka raste kur edhe prapavendosen, si p.sh. pjesëza *u* në rastet *hap-u*, *la-h-u*, Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1986, 667

2.7. Augmenti

Në gjuhën shqipe nuk njihet augmenti si mjet për ndërtimin e trajtave të ndryshme foljore. Ndërsa për gjuhën greke ky mjet është i trashëguar që nga greqishtja antike. Në greqishten e periudhës klasike pothuajse të gjitha foljet pësonin ndonjë ndryshim të tingullit të parë të temës në të gjitha kohët e së shkuarës, pra nëse tingulli i parë i temës ishte bashkëtingëllore i paravendosjes zanorja ε-, nëse tema fillonte me zanore, atëherë kjo zanore zgjatej në kohë⁸², d.m.th. bëhej η-, ose ω-: ζητώ - ἐζήτησα, ρίπτω - ἐρριπτον-ἔριψα - ἐρρίφειν, ἀγοράζω - ἠγόραζον, ἐλπίζω - ἠλπιζον.

Në greqishten e re situata paraqitet e ndryshme. Augmentin ε-, i cili quhet edhe augment rrokjor, në fillim të temës e marrin foljet që kanë si tingull fillestar të temës një bashkëtingëllore dhe janë dyrokëshe kur formojnë të pakryerën dhe aoristin e dëftores aktive. Këtu nuk përfshihen foljet e zgjedhimit të dytë, pavarësisht numrit të rrokjeve që kanë në tashmen e dëftores. Augmentin foljet edhe në këto kohë nuk e ruajnë gjatë gjithë paradigmes, e ruajnë vetëm në rastet kur ai është i theksuar. Sipas Kleris e Babiniotis roli i augmentit në greqishten e re është morfofonologjik, ndihmon në theksimin e foljeve⁸³. Kështu augmenti ruhet në tri vetat e njëjësit dhe vetën e tretë të shumës të se pakryerës dhe aoristit aktiv, ἐκλείσα, ἐκλείσεις, ἐκλείσει, ἐκλείσαν, ndërsa në vetën e parë e të dytë shumës ku mbaresat janë dyrokëshe dhe foljet kthehen në trirrokëshe nuk është e nevojshme që të paravendoset augmenti para tingullit fillestar të temës së foljes κλείσαμε, κλείσατε. Por ka raste kur edhe pse i patheksuar augmenti ruhet. Kjo ndodh kryesisht në mbetjet nga katharevusa ose në letërsi: Γιατί οι δυο μας ύπατοι κ'οι πραιτορες εβγήκαν/ σήμερα με τες κόκκινες, τες κεντημένες τόγες` (Κ, Περιμένοντας τους βαρβάρους), ...που άφοβα, κ'ελληνικά όλως διόλου/εγνώρισε πλήρη την ηδονή. (Κ., Οροφέρνης). Mund të ndodhë gjithashtu që disa folje të përdorin augmentin për të formuar të pakryerën, por aoristin e formojnë në mënyrë të parregullt, pa shtimin e augmentit si βρίσκω – ἐβρισκα – βρήκα, μπαίνω – ἐμπαινα – μπήκα.

Ka raste kur disa folje në vend të augmentit ε- marrin augmentin η- ose ει- si: θέλω – ἠθέλα, πίνω – ἠπια, ζέρω – ἠζερα, έχω – εἶχα.

Në rastet e foljeve të përbëra ku si gjymtyrë e parë përdoren ndajfoljet πολύ, καλά, κακά ose parafjalët e greqishtes së vjetër, ανά, από, διά, εκ, επί, κατά, μετά, προς, υπέρ augmenti i paravendoset gjymtyrës së dytë, pra temës së foljes sikur ajo të ishte një folje e thjeshtë: δεν τον πολυβλέπω – δεν τον πολυέβλεπα, διαθέτω – διέθεσα, εκβάλλω – εξέβαλα, εμπνέω – ενέπνευσα, etj. Ky quhet **augment i brendshëm**, sepse gjendet në trup të foljes. Por ka edhe folje të cilat formohen në këtë mënyrë por për të formuar të pakryerën dhe aoristin nuk përdorin augmentin: διαλέγω – διάλεγα – διάλεξα.

Disa folje të cilat fillojnë me zanore përdoren nën ndikimin e greqishtes së vjetër në të pakryerën apo aoristin duke e ndërruar zanoren fillestare me η- si: ἐλπίζω – ἠλπιζα, ἐξάγω – ἐξήγαγα, υπάρχω - υπήρχα. Ky quhet **augment kohor**, i trashëguar nga greqishtja antike, por që përdoret në disa folje kryesisht në ligjërimin formal apo publicistik dhe përdoret vetëm kur është i theksuar.

⁸² P. Mackridge, *vep. e cit.*, 1990, 277

⁸³ Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπιμιώτης, *vep. e cit.*, 2004, 526

2. 8. Dublikacioni

Dublikacioni përdorej në greqishten e lashtë për të formuar kohët e kryera (e kryera, më se e kryera dhe e ardhmja e përparme) të të gjitha mënyrave, përfshi këtu edhe pjesoren dhe paskajoren. Dublikacioni është përsëritja e bashkëtingëllores nistore të foljes duke i prapavendosur asaj një – ε, p.sh.: παιδεύω/- πε - παιῖδευ – κα / έ- πε - παιδεύ – κειν. Kjo ndodhte zakonisht tek foljet që fillonin me një bashkëtingëllore të thjeshtë, përveç ρ(r) dhe me dy bashkëtingëllore, nga të cilat e para qe e pazëshme dhe e dyta likuide apo hundore, p.sh.: πνέω / πέ – πνευ –κα. Në rastin e foljeve të tjera rolin e dublikacionit e luan augmenti. Dublikacioni përdorej edhe për formimin trajtave kohore të foljeve të përbëra me gjymtyrë të parë një parafjalë të greqishtes së vjetër. Në këtë rast përsëritej pas gjymtyrës së parë bashkëtingëlloerja nistore e foljes që përbënte gjymtyrën e dytë p.sh.: παρανομώ – παρα-νε-νόμηκα.

Në greqishten e re dublikacioni nuk është një mjet produktiv trajtëformues i sistemit foljor. Por përdoren në gjuhën greke mjaft trajta foljore të formuara prej dublikacionit, kryesisht pjesore të së kryerës pasive të cilat janë trashëguar nga greqishtja e vjetër. Pjesore të tilla si : *εγγεγραμμένος, διαδεδομένος, εγκεκριμένος, συνδεδεμένος, κεκλεισμένος*, përdoren kryesisht në ligjërimin libror, sidomos në atë publicistik e juridik.

Në gjuhën shqipe dublikacioni nuk përdoret për formimin e trajtave foljore.

Përfundime


- ❖ Për të ndërtuar format sintetike të shqipes dhe të greqishtes përdoren mjete gjuhësore si temat foljore, mbaresat, prapashtesat trajtëformuese dhe bashkëtingëlloret kundër hiatit, ndërsa për ndërtimin e formave analitike përdoren foljet ndihmëse *jam* dhe *kam* dhe pjesëzat trajtëformuese. Në gjuhën greke për ndërtimin e formave sintetike përdoret gjithashtu augmenti dhe dublikacioni.
- ❖ Në gjuhën shqipe shumica e foljeve i ndërtojnë të gjitha format gramatikore me një temë të vetme, temën me të cilën shfaqen në kohën e tashme dhe në të gjitha vetat e kohëve të të gjitha mënyrave. Por ekzistojnë mjaft folje të cilat gjatë paradigmes së tyre paraqiten me dy apo me tri tema. Disa folje paraqiten edhe me katër tema të ndryshme. Këto tema formohen kryesisht nëpërmjet ndërrimeve fonetike si metafoia, ndërrimi, apofonia.
- ❖ Në gjuhën greke tri janë temat të cilat shërbejnë për të formuar trajtat që merr folja gjatë paradigmes së saj, tema e së tashmes aktive, nëpërmjet së cilës formohen të gjitha kohët e vazhduara, me aspekt imperfektiv, të të gjitha mënyrave, tema e aoristit aktiv, e cila përdoret për të formuar trajtat foljore të kohëve të thjeshta të zgjedhimit vepror, pra të aspektit perfektiv, të të gjitha mënyrave dhe tema e aoristit pasiv, e cila përdoret për të formuar trajtat foljore të kohëve të thjeshta të zgjedhimit jovepror të të gjitha mënyrave.
- ❖ Mbaresat vetore si të shqipes ashtu edhe të greqishtes janë të shumëkuptimshme. Shumica e mbaresave vetore të shqipes janë të gjalla, ato kanë ardhur duke u diferencuar gjithnjë e më shumë edhe sipas kohës duke e bërë edhe më të qartë dallimin midis kohëve sintetike. Për sa u përket kohëve analitike mbaresat vetore i marrin foljet ndihmëse ndërsa pjesorja e shqipes dhe paskajorja e greqishtes së re mbeten të pandryshuara gjatë zgjedhimit.
- ❖ Prapashtesat temëformuese që ndeshen në shqipen e dokumentuar janë: prapashtesa *-sh-*, e cila haset vetëm në vetën e parë njëjës të së kryerës së thjeshtë, ose aoristit sigmatik në disa folje të trashëguara, prapashtesat e trashëguara të pjesores *-në/-rë*, *-m-*, *-të*, prapashtesat *-t/-jt*, që zgjerojnë temën e disa foljeve në të kryerën e thjeshtë dhe pjesore, prapashtesa *-fsh/-sh* e cila zgjeron temën e së tashmes së dëshirores dhe prapashtesa *-as/-s* në temën e foljeve të kohës së tashme e të pakryerës e në disa raste edhe të kryerës së thjeshtë të disa foljeve.
- ❖ Për çështjen e prapashtesave trajtëformuese në gjuhën greke ka diskutime të shumta. Disa prej këtyre prapashtesave janë: Prapashtesa *-s-*, e cila përdoret për të formuar temën e foljeve të aoristit sigmatik, të cilën në shqip e hasim *-sh-*, dhe është shumë më e rrallë në përdorim, prapashtesën *-θik/-tik*, e cila përdoret për të formuar temën e aoristit pasiv të foljeve, prapashtesën *-γ-*, e cila përdoret për të formuar temën alternative të së pakryerës aktive të disa foljeve të zgjedhimit të

- dytë. Prapashtesa *-ei* përdoret për të formuar paskajoren e greqishtes së re, ndërsa prapashtesa *-ovtas/óvtas* për të formuar pjesoren aktive të greqishtes së re.
- ❖ Në shqipen e dokumentuar bashkëtingëlloret që përdoren si tinguj kundër hiatit janë *-v-*, *-h-*, dhe *-j-*. Si bashkëtingëllore kundër hiatit në gjuhën greke shërben bashkëtingëllorja *-γ-*, e cila përdoret jo vetëm në sistemin foljor, por edhe në atë emëror. Kjo bashkëtingëllore vendoset ndërmjet temës dhe mbaresës të disa foljeve në vetën e parë të së tashmes së dëftores aktive por edhe në të pakryerën e disa foljeve kur zanorja fundore e temës së foljeve është e njëjtë me mbaresën vetore.
 - ❖ Foljet *kam* dhe *jam* si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën greke përveç kuptimit të tyre të mëvetësishëm ku shprehin përkatësisht zotërimin, përkatësinë e diçkaje (folja *kam*) dhe një gjendje (folja *jam*), shërbejnë si folje ndihmëse për të formuar kohët analitike të foljes. Foljet *kam* dhe *jam* si folje të mëvetësishme në gjuhën shqipe mund t'i formojnë të gjitha trajtat kohore si ato sintetike edhe ato analitike, në ndryshim nga gjuha greke ku këto dy folje mund të formojnë vetëm të tashmen dhe të pakryerën e dëftores, formojnë gjithashtu vetëm një trajtë të së ardhmes (*θα έχω, θα είμαι*) e cila përdoret për të dyja aspektet, si për atë perfektiv edhe për atë imperfektiv. Edhe për kohët e lidhore dhe urdhërores këto folje formojnë vetëm një trajtë: *va έχω, va είμαι, έχε, έχετε*.
 - ❖ Për të formuar trajtat analitike të foljes përdoren në gjuhën shqipe dhe në gjuhën greke, pjesëza të cilat në përgjithësi u paravendosen formave foljore dhe nëpërmjet gramatikalizimit të tyre formohen forma të reja gramatikore të zgjedhimit foljor. Nga këto pjesëza të njëjta si për gjuhën shqipe edhe për gjuhën greke janë: pjesëza *do-θα*, e cila në të dyja gjuhët ka origjinë foljore dhe përdoret për formimin e kohëve të së ardhmes, por në shqip edhe për të formuar kohët e mënyrës kushtore, pjesëza *të - va*, e cila ka origjinë lidhëzore dhe përdoret si tregues i kohëve të mënyrës lidhore në të dyja gjuhët. Në gjuhën shqipe kemi gjithashtu edhe pjesëzën *u*, e cila përdoret për të formuar disa nga trajtat foljore të diatezës joveprore dhe pjesëzat *për, me, pa* dhe *duke*, të cilat përdoren për formimin e trajtave të pashtjelluara të foljes, ndërsa në greqisht kemi dhe pjesëzën *ας (le të)*, e cila përdoret në greqishten e re për të formuar kohët e mënyrës lidhore.
 - ❖ Në gjuhën shqipe nuk njihet augmenti si mjet për ndërtimin e trajtave të ndryshme foljore. Ndërsa për gjuhën greke ky mjet është i trashëguar që nga greqishtja antike. Augmentin *ε-* në fillim të temës e marrin foljet që kanë si tingull fillestar të temës një bashkëtingëllore dhe janë dyrrokëshe kur formojnë të pakryerën dhe aoristin e dëftores aktive. Këtu nuk përfshihen foljet e zgjedhimit të dytë, pavarësisht numrit të rrokjeve që kanë në tashmen e dëftores. Në këtë rast augmenti quhet augment rrokjor. Foljet nuk e ruajnë augmentin gjatë gjithë paradigmes, e ruajnë vetëm në rastet kur ai është i theksuar. Ka raste kur disa folje në vend të augmentit *ε-* marrin augmentin *η-* ose *ει-*. Kur augmenti gjendet në trup të foljes quhet augment i brendshëm, kur ndërrohet zanorja fillestare me *η-*, augmenti quhet augment kohor, i trashëguar nga greqishtja antike.

III. MËNYRAT E FOLJES

3.1. Mënyra dëftore

Mënyra dëftore është mënyra më e pasur me trajta kohore si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë greke. Nëpërmjet kësaj mënyre në gjuhën shqipe folësi e paraqit si të vërtetë veprimin e emërtuar nga folja⁸⁴. Dëftorja, për sa i përket modalitetit karakterizohet negativisht sepse folësi nëpërmjet formave kohore të kësaj mënyre përgjithësisht pohon se një veprim po kryhet, është kryer apo do të kryhet, por nuk shpreh qëndrimin e tij në formën e një dëshire, dyshimi apo emocioni⁸⁵. Kjo mënyrë ka tri kohët themelore ku e shkuara dhe e ardhmja kanë disa nënndarje. Disa forma kohore, si e tashmja dhe e kryera e thjeshtë, janë trashëguar që nga kohët e lashta, ndërsa një pjesë tjetër e formave kohore, si e kryera, më se e kryera, e kryera e tejshkuar dhe të gjitha format e së ardhmes, janë krijuar gjatë zhvillimit historik të shqipes⁸⁶. Format kohore të mënyrës dëftore të shqipes janë:



Paraqitje grafike 3.1

Format kohore të mënyrës dëftore shprehin një kuptim të mirëfilltë kohor⁸⁷, pra shprehet koha e kryerjes së veprimit, por edhe mënyra e kryerjes së tij, pra në kohët e mënyrës dëftore kemi jo vetëm kundërvënien kohore por edhe aspekte si p.sh e kryera e thjeshtë me të pakryerën, ku momenti kohor i kryerjes së veprimit është e shkuara për të dyja kohët, por ajo që i dallon është aspekti i kryer (perfektiv) dhe ai i pakryer (imperfektiv). Ka disa forma kohore të mënyrës dëftore të cilat janë të njëjta për sa i përket strukturës me forma kohore të mënyrave të tjera, si p.sh të kushtores, por këto do të trajtohen më hollësisht në vazhdim.


⁸⁴ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

⁸⁶ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1976

⁸⁷ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

Edhe në gjuhën greke dëftorja është mënyra në të cilën të gjitha kohët e foljes shprehin diçka të vërtetë, ose sepse kështu është në të vërtetë, ose sipas mendimit të folësit⁸⁸. Ashtu si edhe në gjuhën shqipe ka forma foljore që u përgjigjen tri kohëve themelore, por siç do të vërejmë edhe më poshtë, sado që është mënyra më e pasur me forma foljore, në krahasim me gjuhën shqipe ka më pak të tilla. Kohët e dëftores janë sintetike dhe analitike për sa i përket strukturës së tyre. Në greqishten e lashtë, kohët e cilat sot janë analitike si p.sh. e ardhmja, e kryera, më se e kryera, kanë qenë sintetike. Kohët analitike janë produkt i evolimit të gjuhës. Në mënyrë skematike kohët e dëftores së greqishtes janë:



Paraqitje grafike 3.2

Siç vëmë re nga dy paraqitjet e mësipërme të kohëve të dëftores në të dyja gjuhët, në gjuhën shqipe dëftorja ka tri kohë, të cilat dëftorja e greqishtes nuk i ka si kohë⁸⁹ të dëftores: të kryerën e tejshkuar, të ardhmen e së shkuarës dhe të ardhmen e përparme të së shkuarës. Për sa i përket kohës së kryer në gjuhën greke ajo trajtohet si kohë e së tanishmes, por bën pjesë edhe në kohët e së shkuarës. Konsiderohet se folja në këtë kohë ndërlihd të shkuarën me të tanishmen, veprimi është kryer në të shkuarën dhe ekziston si i kryer në të tashmen⁹⁰, ndaj dhe konsiderohet se bën pjesë në të dyja këto kohë themelore.

⁸⁸ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *Νεοελληνική σύνταξις*, Τόμος Α, Εκδοτικός Οίκος Αδελφών Κυριακίδη, Θεσσαλονίκη 1991

⁸⁹ Siç do ta shohim edhe më poshtë, ekzistojnë si struktura foljore, por trajtohen si modalitete.


⁹⁰ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *vep. e cit.*, 1991

3.1.1. Kohët sintetike të mënyrës dëftore

Format kohore sintetike të mënyrës dëftore formohen duke i shtuar temës foljore (të së tashmes apo aoristit) mbaresat kohore apo mjete të tjera gramatikore (augment), me ndihmën e të cilave krijohet një strukturë foljore njëfjalëshe.

Format kohore sintetike të gjuhës shqipe janë: *koha e tashme*, *koha e pakryer* dhe *koha e kryer e thjeshtë*. Këto tri kohë që për sa i përket momentit të kryerjes së veprimit i referohen të tashmes dhe të shkuarës, ndërsa të gjitha format kohore të së ardhmes formohen në mënyrë analitike.

Edhe në gjuhën greke format kohore sintetike janë *koha e tashme*, *koha e pakryer* dhe aoristi. Janë vetëm këto tri forma kohore që vazhdojnë të jenë sintetike, kemi parasysh këtu që në greqishten e lashtë të gjitha format kohore ishin sintetike dhe dhënia e tyre në mënyrë analitike është rezultat i evolimit të gjuhës.



Paraqitje grafike 3.3

Skema e kohëve sintetike të mënyrës dëftore është e njëjtë për të dyja gjuhët. Si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë greke vëmë re se *koha e tashme* dhe vetëm dy prej kohëve të së shkuarës formohen në mënyrë sintetike, ndërsa asnjë nga kohët e së ardhmes nuk shprehet nëpërmjet formash kohore sintetike.

3.1.1.1. Koha e tashme

a. Folja në kohën e tashme në gjuhën shqipe tregon një veprim që kryhet në të tashmen dhe përfshin edhe çastin e ligjëritimit⁹¹. Siç do të shohim në vazhdim e tashmja mund të përdoret edhe me vlerën e së ardhmes apo së shkuarës. Forma foljore e vetës së parë të kohës së tashme është forma me të cilën ndeshim, si në gjuhën shqipe edhe në atë greke foljet *lemat* në fjalor.

lex/oj kal., ~óva, ~úar. 1. Shkoqit fjalët e lexuara në letër, a diku tjetër duke i shqiptuar me zë, ose duke i përshkuar me mend. *Lexoj letrën. Lexoj librin (gazetën, revistën). Lexoj bukur (rrjedhshëm, shpejt, ngadalë, keq). Lexoj fjalë për fjalë. Di të shkruajë e të lexojë*⁹².

διαβάζω ρ. αμετβ. κ. μετβ. {διάβασ-α, -τηκα, -μένος} ♦ (αμετβ.) **1.** μπορώ να αναγνώσω, ξέρω ανάγνωση: δεν πήγε σχολείο και δεν ζέρει να γράφει και να διαβάζει **2.** μελετώ (για το

⁹¹ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

⁹² Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980

σχολείο, το πανεπιστήμιο κ.λπ.): αν δεν διαβάζεις, πώς θα περάσεις την τάξη; || έχω πονοκέφαλο και δεν μπορώ να διαβάσω ♦ (μετβ.)⁹³

Trajta foljore e kohës së tashme përbëhet nga tema foljore, e cila është tema e kohës së tashme dhe tregon se folja në këtë kohë tregon një veprim që paraqitet në zhvillim e sipër në çastin e ligjërit, pra karakterizohet nga aspekti i pakryer (imperfektiv)⁹⁴, dhe mbaresa kohore.

Koha e tashme e dëftores së shqipes	
tema foljore	mbaresa
la-	-j/o

Tabela 3.1

Tema foljore e kohës së tashme nuk mbetet gjithmonë e pandryshueshme në të gjitha vetat. Foljet e zgjedhimit të parë, përveç foljes *blej* nuk e ndryshojnë temën foljore gjatë zgjedhimit. Për sa u përket foljeve të zgjedhimit të dytë, foljet e kasës së parë e ruajnë të pandryshuar temën foljore gjatë zgjedhimit, ndërsa te foljet e klasës së dytë hasim disa ndryshime tingullore në temë gjatë zgjedhimit: Në vetën e dytë dhe tretë njëjës: *-a- → -e- (dal/del)*, *-o- → -e- (njoh/njeh)*, *-s- → -t (vras/vret)*. Në vetën e dytë shumës: zanorja e theksuar e temës (ose togu *-je*) → *-i (njoh/njihni)*, *-k → -q (ndjek/ndiqni)*, në këtë rast kemi dy shndërrime tingullore të temës, edhe togun *-je* në *-i*, edhe *-k* në *-q*. Në vetën e dytë shumës kemi gjithashtu edhe shndërrimin *-g → -gj (djeg/digjini)*. Edhe te foljet e klasës së parë të zgjedhimit të tretë në vetën e dytë ndodh shndërrimi: zanore e togut të zanoreve të temës → *-i- (fle/flini)*⁹⁵.

Mbaresat vetore të foljeve në kohën e tashme mund t'i paraqesim si më poshtë:

Zgjedhimi i parë	-j	Zgjedhimi i dytë	o	Zgjedhimi i tretë	o
	-n		o		o
	-n		o		o
	-jmë		-im		-më/-m
	-ni		-ni		-ni
	-jnë		-in		-në/-n

Tabela 3.2

⁹³ Γ. Μπαμπιμιώτης, *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Αθήνα, 1998. (Përshkrimi i lemës nuk është dhënë i plotë, është dhënë vetëm një pjesë, e cila i shërben pohimit tonë).

⁹⁴ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

⁹⁵ Shndërrimet tingullore të temës së foljeve në kohën e tashme janë dhënë sipas *Gramatikës së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995

Folja në kohën e tashme, siç përmendëm edhe më sipër, shpreh një veprim që kryhet në një kohë që përfshin edhe çastin e ligjërimit. Koha e tashme e gjuhës shqipe në të shumtën e rasteve jepet me të tashmen e greqishtes:

- 1) *Ndërsa unë habitem si nuk pini ju. Madje habitem fort.* (Gj.U.V. 32) – *Εγώ πάλι εκπλήσσομαι μ'εσάς που δεν πίνεται. Εκπλήσσομαι πολύ.* (Σ.Ν.Σ. 39).
- 2) *Megjithatë çuditem sesi nuk filloni të pini tani.* (Gj.U.V. 32)- *Κι όμως, μένω κατάπληκτος που δεν αρχίσατε να πίνεται τώρα.* (Σ.Ν.Σ. 39)
- 3) *Por e ke kot, prej saj nuk shpëton dot kurrë.* (Gj.U.V. 248)- *Γελίεσαι όμως, δε γλυτώνεις από αυτήν ποτέ.* (Σ.Ν.Σ. 293).

Në shembullin (1) koha e tashme e gjuhës shqipe si në të shumtën e rasteve jepet me të tashmen e greqishtes.

Në shembullin (2) koha e tashme jepet me një shprehje foljore formuar nga folja *μένω* (*qëndroj*), e cila në këtë rast është e barazvlefshme me foljen *jam*, + mbiemrin që mbart kuptimin e foljes, pra shprehet me një folje supletive + përcaktorin kallëzuesor. Në gjuhën greke ekziston folja *çuditem* – *εκπλήσσομαι*, por është zgjedhja e përkthyeses që ta japë në mënyrë të tillë këtë trajtë kohore. Nëse do të bënim një përkthim të ndërsjelltë të kësaj shprehjeje nga greqishtja në shqip atëherë do të thoshim *jam i çuditur*, gjithsesi veprimi ndodh përsëri në të tashmen dhe përfshin edhe çastin e ligjërimit. Ndërsa për sa i përket foljes së dytë ajo është dhënë në gjuhën greke me të njëjtën folje në kohën e kryer të thjeshtë, pra *nuk filloni*, është transmetuar me formën *nuk filluat* (*δεν αρχίσατε*). Për ta dhënë në greqisht kuptimin e kësaj foljeje, do të mund të përdornim edhe një tjetër kohë të së shkuarës, kohën e kryer e cila lidh të shkuarën me të tashmen pra *habitem sesi nuk filloni* – *habitem se si nuk keni filluar* (*δεν έχετε αρχίσει ακόμα*), por edhe dhënia me aoristin e greqishtes nuk përbën rrezik për moskuptimin apo keqkuptimin e fjalisë, madje në gjuhën greke në situata të tilla ligjërimore përdoret më shpesh aoristi. Mund të përdoret në këtë rast edhe e tashmja e greqishtes, por ajo përdoret me shpesh kur nuk ndiqet nga një folje tjetër.

Në të tashmen e dëftores së shqipes, shembulli (3), ndryshe nga mënyrat e tjera, mohimi shprehet nëpërmjet pjesëzës mohuese *nuk*, siç ndodh edhe në gjuhën greke ku përdoret, sipas gramatikës së gjuhës greke, ndajfolja me kuptim mohues *δεν* (*nuk*).

E tashmja me pjesëzën po

Folja në kohën e tashme mund të përdoret edhe me pjesëzën aktualizuese *po*⁹⁶, në rastet kur veprimi vazhdon të kryhet edhe në çastin e ligjërimit. Në gjuhën greke nuk ekziston një pjesëz e tillë aktualizuese dhe për të treguar dhe në shumicën e rasteve kjo formë se së tashmes së shqipes jepet thjesht me të tashmen e greqishtes pa u shoqëruar nga ndonjë mjet tjetër gjuhësor, i cili të ketë kuptim aktualizues si në shembujt (1), (2), (3), (4):

- 1) *Kur e pa se të tjerët po e ndiqnin, frati tregoi takimin e tij me Nik Martini, fjalët që i tha: ku po shkon Nik Martini?* (Gj.U.V. 154) – *Όταν είδε πως οι άλλοι τον*

⁹⁶ Sipas K. Topallit, pjesëza *po*, përdoret me të tashmen dhe të pakryerën për të shprehur aspektin e vijimësisë së foljeve, K. Topalli, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010, 217

- ακολούθησαν, ο καλόγερος διηγήθηκε για τη συνάντησή του με τον Νικ Μαρτίνι και τα λόγια που του είπε: πού πας, Νικ Μαρτίνι; (Σ.Ν.Σ. 184)*
- 2) -**Po ju dëgjoj, tha gjenerali, kur iu duk se prifti po mëdyshej të vazhdonte.** (Gj.U.V. 36)- *Σας ακούω, είπε ο στρατηγός, όταν του φάνηκε πως ο ιερέας δίσταζε να συνεχίσει. (Σ.Ν.Σ. 43)*
- 3) - **Ju sonte po merrni telegrame tepër misterioze, koleg.** (Gj.U.V. 248) – *Απόψε, κύριε συνάδελφε, παίρνετε πολύ μυστηριώδη τηλεγραφήματα. (Σ.Ν.Σ. 292)*
- 4) - **Sa është ora? – pyeti gjenerali. – Po afron mesnata.** (Gj.U.V. 248)- *Τι ώρα είναι; ρώτησε ο στρατηγός. – Κοντεύουν μεσάνυχτα. (Σ.Ν.Σ. 292)*

Por ka raste si shembujt (5), (6) ku forma e së tashmes së shqipes e paraprirë nga pjesëza *po* jepet në greqisht me aoristin, pra shprehja *po pini pak si tepër* është dhënë me ekivalentin semasiologjik *ήπιατε λίγο παραπάνω (pitë pak si tepër)*. Në këtë rast përveç kohës ndryshon edhe aspekti i foljes, ndërsa në shqip folja është në aspektin imperfektiv, pra veprimi po vazhdon, në greqisht folja është në aspektin perfektiv, pra veprimi ka përfunduar në të shkuarën. Nëse do të duhej që fjalinë ta përkthenim nga greqishtja në shqip, atëherë do të thoshim: *Thashë vetëm se keni pirë pak si tepër*, pra do të përdornim të kryerën e cila në këtë rast do të ishte koha më e përshtatshme për të transmetuar kuptimin e kësaj shprehjeje në gjuhën shqipe. Në këtë rast të tashmen e shqipes nuk do të mund ta jepnim nëpërmjet të tashmes së greqishtes, për shkak se ndajfolja e sasisë që e shoqëron, e cila tregon sasinë e objektit mbi të cilin kalon veprimi i foljes dhe që në këtë rast nënkuptohet, nuk lejon që folja të jetë në të tashmen.

- 5) **Unë nuk thashë asgjë të tillë. Thashë vetëm se ju po pini pak si tepër.** (Gj.U.V. 32) – *Εγώ δεν είπα κάτι τέτοιο. Είπα μόνο πως ήπιατε λίγο παραπάνω. (Σ.Ν.Σ. 39)*
- 6) - **Ndoshta. Ç'po bëjnë këta? – tha gjenerali. – Ende s'po gjendet gjë.** (Gj.U.V. 23)- *Ίσως. Μα τι κάνουν αυτοί; είπε ο στρατηγός. Ακόμα δε βρέθηκε τίποτε. (Σ.Ν.Σ. 28)*

Në shembullin (7) ku e tashmja me pjesëzën aktualizuese *po* transmetohet në gjuhën greke me aoristin e shoqëruar me ndajfoljen kohore *ende*, pra shprehja *s'po fillon shiu* jepet me shprehje *s'ka zënë ende shiu*. Siç e vëmë re në gjuhën greke është përdorur një folje me kuptim sinonimik në këtë rast me foljen *filloj*, foljen *zë*. Në fakt edhe në gjuhën shqipe e përdorim shprehjen *zuri shiu*, por edhe në greqisht përveç foljes *filloj (αρχίζω)*, kur bëhet fjalë për shiun përdoret edhe folja *zë (πιάνω)*.

- 7) -**Sa mirë që s'po fillon shiu! - tha prifti.** (Gj.U.V. 20) – *Πάλι καλά, που δεν έπιασε ακόμα βροχή! είπε ο ιερέας. (Σ.Ν.Σ. 25)*

Ndërsa në shembullin (8) e tashmja e shqipes e paraprirë nga pjesëza *po* transmetohet nëpërmjet së ardhmes së thjeshtë të greqishtes, pra nëse e sillnim formën nga greqishtja në shqip do të ishte *nuk do të gjejmë asgjë (δε θα βρούμε τίποτα)*.

- 8) - **Nuk po gjejmë gjë, me sa duket, - tha gjenerali duke u munduar të fshihte nervozizmin.** (Gj.U.V. 23) – *Δε θα βρούμε τίποτα, μου φαίνεται, είπε ο στρατηγός προσπαθώντας να κρύψει τη νευρικότητά του. (Σ.Ν.Σ. 28)*

E tashmja e dëftores me vlerën kohëve të tjera

E tashmja e dëftores mund të përdoret edhe me vlerën e kohës së ardhme dhe përkthimi në këtë rast na ndihmon që ta vëmë në dukje duke qenë se folja në të tashmen e shqipes jepet me të ardhmen e thjeshtë të greqishtes, si në shembullin (9).

- 9) *Po të vdes, më thoshte gjithnjë, varrosmë thellë, se kam frikë mos më **zbulojnë** qentë, si atëherë në Tepelenë.* (Gj.U.V. 22) – *Αν πεθάνω, μου έλεγε πάντα, θάψε με βαθιά γιατί φοβάμαι πως **θα με βρουν** τα σκυλιά, όπως τότε στο Τεπελένι.* (Σ.Ν.Σ. 27).

E tashmja mund të përdoret gjithashtu edhe me vlerën e së shkuarës si në shembullin (10). Në këtë rast folja *mbaron* është dhënë në greqisht me emrin *τέλος* (*mbarim*, *përfundim*) pra shprehja *pasi mbaron lufta* është transmetuar *pas mbarimit të luftës*.

- 10) *S'ka dyfytërsi më të madhe se kërkimi i eshtrave pasi **mbaron** lufta.* (Gj.U.V. 24) – *Δεν υπάρχει μεγαλύτερη υποκρισία απ' την αναζήτηση των οστών **μετά το τέλος του πολέμου.*** (Σ.Ν.Σ. 29).

Koha e tashme në gjuhën shqipe është koha që përdoret për veprime që nuk lidhem me një kohë të caktuar, por kanë vlerë mbarëkohore si p.sh. proverbat: *Ujku qimen e ndërron*, por *zakonin s'e harron*.

b. Koha e tashme e dëftores së greqishtes ashtu si edhe në gjuhën shqipe tregon se veprimi që shpreh folja kryhet në të tashmen, apo po zhvillohet në momentin e ligjëritimit. Veprimi në të tashmen mund të jetë i vazhduar, ose të përsëritet. Struktura e foljes në kohën e tashme përbëhet nga tema foljore dhe mbaresa, ku tema foljore përveç kuptimit leksikor mbart edhe aspektin e foljes, i cili në kohën e tashme është i pakryer (imperpektiv), ndërsa mbaresa mbart kuptimin gramatikor vetor e kohor. Këto mbaresa paraqiten në skemën e mëposhtme:

Mbaresat e foljeve në të tashmen e dëftores së greqishtes		
Zgjedhimi i parë	Zgjedhimi i dytë	
	Klasa e parë	Klasa e dytë
-ω	-άω/-ώ	-ώ
-εις	-άς	-είς
-ει	-ά(ει)	-εί
-ουμε/-ομε	-άμε/-όμε	-ούμε
-ετε	-άτε	-είτε
-ουν(ε)	-ούν(ε)/-άν(ε)	-ούν(ε)

Tabela 3.3

Siç vëmë re mbaresa e së tashmes së dëftores për të gjitha foljet në formën veprorë është $-\omega(-\acute{\omega})$, Në greqishten e vjetër foljet kishin dhe mbaresa të tjera foljore si: $-\mu$ ($-mi$ ⁹⁷), $\acute{\delta}\acute{\iota}\delta\omega\mu$, por në periudhën postklasike të gjitha foljet me mbaresën $-\mu$, e transformojnë atë në $-\omega$: $\acute{\delta}\acute{\iota}\delta\omega$ ⁹⁸.

Duke qenë se folja në kohën e tashme të dëftores shpreh të njëjtin kuptim në të dyja gjuhët, në të shumtën e rasteve e tashmja e shqipes jepet nëpërmjet të tashme së greqishtes si në shembullin (1).

- 1) *Σήμερα βρέχει σιγά, απαλά, σμίγει ο ουρανός με τη γη με άπειρη τρυφεράδα. (B.Π. 101)- Bie shi i shtruar, i qetë. Toka bashkohet me qiellin me një pëlhurë të rrallë e të njomë. (Z. 89)*
- 2) *Σ'αυτές τις σκοτεινές κάμαρες, που περνώ/ μέρες βαρβές, επάνω κάτω τριγωνώ/ για νάβρω τα παράθυρα. (K. Τα παράθυρα) – Në këto dhoma të errëta, ku kaloj, / ditë të rënda, endem rretheqark / për të gjetur dritaret. (K, A.S) Në këto dhomëza të errëta, / ku ditë mërzie po kaloj, / sillem lart e poshtë të gjej dritaret. (K, L.Z)*
- 3) *- Έχω μια ψυχή υπάκουη και λεύτερη· χρόνια τώρα τη μαθαίνω να παίζει μαζί μου. (B.Π. 30)- Kam një shpirt të urtë e të lirë. Vite e vite luan e stërvitet me mua. (Z. 26)*

Shembulli (2) është dhënë i përkthyer nga dy përkthyes të ndryshëm: Siç e vëmë re folja e parë *περνώ (kaloj)*, e cila në greqisht nuk shoqërohet nga asnjë element gjuhësor aktualizues në shqip jepet nga njëri përkthyes thjesht me të tashmen duke i qëndruar besnik strukturës kohore të origjinalit, ndërsa nga përkthyesi i dytë jepet folja e shoqëruar me pjesëzën aktualizuese *po*. Në fakt duke qenë se në gjuhën greke nuk hasim ndonjë element gjuhësor, i cili të luajë rolin e pjesëzës *po* të shqipes dhe kuptimin aspektor imperfektiv e mbart tema e foljes në këtë kohë, atëherë është zgjedhja e përkthyesit (interpretit, transmetuesit të ligjërit nga njëra gjuhë në tjetrën) nëse dhe kur do ta përdorë këtë pjesëz të paravendosur te folja në kohën e tashme për të transmetuar të tashmen e greqishtes.

Në shembullin (3) që dy folje që ndjekin njëra tjetrën, njëra në të tashmen e dëftores dhe tjetra në të tashmen e lidhore përkthhen në shqip të dyja me të tashmen e dëftores duke ndryshuar kështu edhe struktura e periudhës, pra nga një fjali kryesore + një fjali të nënrenditur, kemi dy fjali të bashkërenditura. Sigurisht që këto kohë mund të jepeshin me analoget e shqipes, por në këtë rast ajo që e përcakton këtë është perceptimi gjuhësor i përkthyesit në lidhje me anën kuptimore të pjesës së ligjërit dhe jo përkatësia gramatikore, e cila intereson këtë punim.

Një nga përdorimet më të shpeshta të së tashmes së dëftores në gjuhën greke, është dhe përdorimi i saj në vend të aoristit apo të së pakryerës gjatë rrëfimit, e tashme kjo që emërtohet e tashmja historike. Edhe në gjuhën shqipe, siç e përmendëm edhe më sipër e tashmja mund të përdoret me kuptimin e kohëve të së shkuarës, ndaj siç do ta vërejmë

⁹⁷ Në gjuhën shqipe si mbeturina të zgjedhimit në $(-mi)$ pranohen foljet *jam, kam* e *thom* (Demiraj Sh., *Morfologjia historike e gjuhës shqipe II*, Tiranë 1976, 48)

⁹⁸N. Ανδριώτης, *vep. e cit.*, 1995, 48.

edhe më poshtë në shumicën e rasteve e tashmja historike e greqishtes transmetohet nëpërmjet së tashmes së shqipes, shembulli (4)

- 4) Τα ξημερώματα σηκώθηκα να πάρω τη γυναίκα μου να φύγουμε. Σκοτάδι ακόμα, δεν καλόβλεπα. **Πιάνω** ένα πόδι, το **τραβώ**, δεν ήταν της Νούσας· πιάνω άλλο, μήτε αυτό! **Πιάνω** άλλο, μήτε αυτό! **Πιάνω** άλλο, άλλο, και τέλος πάντων είδα κι έπαθα, **βρίσκω** το πόδι της Νούσας, το **τραβώ**, την **ξεμπλέκω** από τους δυο τρεις νταγλαράδες, που την είχαν πιτακωμένη την κακομοίρα, και την **ξυπνώ**. (B.Π. 98)
Në të gdhirë hapra sytë dhe u ngrita të merrja gruan time e të shkoja. Po s'kishte zbardhur ende e s'e dalloja dot. **Kap** një kofshë dhe e **tërheq**. S'ishte e Nusës. **Marr** një tjetër. As ajo. Një tjetër. As ajo. Një tjetër, një tjetër e, pasi pashë kijametin e zi, **gjej** këmbën e Nusës, e **heq** osh e **shthur** nja tre katër edepsëzë që e kishin vënë përposhtë, e **zgjoj**. (Z. 87)
- 5) «Που με πάς, μωρή;» της **κάνω**, μα αυτή με πήγαινε, με πήγαινε κι ύστερα **γυρίζει** και μου **κάνει**: «Κάτσε!» (B.Π. 108) – “Ku më çon, moj?” ia **bëj**, por ajo s'më linte. Pastaj m'u **kthye** e më **tha**: “Ulu!” (Z. 96)

Por ka edhe raste si në shembullin (5), ku e tashmja historike greqishtes përveç të tashmes së shqipes, jepet edhe me të kryerën e thjeshtë të saj si në rastin *γυρίζει (kthehet)→ u kthye, κάνει(bën)→ tha*, kjo tregon edhe më qartë funksionin e së tashmes në këtë rast, e cila siç e thamë përdoret në vend të së shkuarës. Në rastin e dytë përveç ndryshimit kohor ndërmjet foljeve kemi edhe një ndryshim kuptimor, por që në tërësinë e fjalisë kuptimi nuk ndryshon.

Si edhe në gjuhën shqipe e tashmja mund të përdoret në greqisht edhe me funksionin e së ardhmes. Nisur nga ky funksion i njëjtë i së tashmes së dëftores kjo kohë e greqishtes transmetohet nëpërmjet së tashmes së shqipes, shembulli (6). Kur e tashmja e greqishtes përdoret me kuptimin e së ardhmes, mund të jepet në gjuhën shqipe me të kryerën e thjeshtë, duke qenë se kjo kohë mund të marrë funksionin e së ardhmes, shembulli (7), ku folja *έρχομαι (po vij)*, jepet në shqip me të kryerën e thjeshtë *erdha*, e cila përdoret shpesh në gjuhën e folur me kuptimin e së ardhmes, *do të vij*. Mund të ndodhë që e tashmja e greqishtes të jepet me të kryerën e shqipes, shembulli (8) ku forma foljore *αγαπάς (do)*, jepet me formën e së kryerës *ke dashur*.

- 6) Με **παίρνεις** μαζί σου; (B.Π. 21) - Më **merr** me vete? (Z. 18)
- 7) - Λέγε, μωρή, το σκοπό, λέγε κι **έρχομαι!** φώναξε... (B.Π. 270)- Thoja moj, thoja dhe një herë se **erdha!**- i thirri tjetrës.... (Z. 245).
- 8) Φαρμάκι ο αργός αποχωρισμός από τους ανθρώπους που **αγαπάς**. (B.Π. 16) - Helm e shkuar helmit kjo ndarje e ngadaltë prej njerëzve që i **ke dashur**. (Z. 12)
- 9) «Που να πάω; συλλογίστηκα καλά **είμαι** εδώ.» (B.Π. 24) – Ku ta **gjej** më mirë. Thashë me vete. Mirë fare **qënkam** këtu. (Z. 20)
- 10) Αυτοί οι θαλασσινοί **ξέρουν** ο μυστικό. (B.Π. 26) - Këta detarët ia **ditkan** lezetin; (Z. 22)

E tashmja e dëftores së shqipes ka raste kur jepet edhe me të tashmen e habitores së shqipes. Duke qenë se mënyra habitore nuk ekziston në gjuhën greke, është zgjedhja e përkthyesit dhe modaliteti i foljes që diktojnë përdorimin e kësaj mënyre. Në shembujt

(9), (10) mund të ishte përdorur e tashmja e shqipes dhe do të kishim: *mirë jam këtu* apo *detarët ia dinë lezetin* (duke iu referuar përkthimit të përkthyesit, ne mund të jepnim edhe një variant tjetër: *e dinë sekretin*).

3.1.1.2. Koha e pakryer

a. Koha e pakryer e dëftores në gjuhën shqipe bën pjesë në kohët e së shkuarës dhe ka me të kryerën e thjeshtë dhe të kryerën dallime të cilat kanë më shumë karakter aspektor⁹⁹. Kuptimi themelor i saj është të tregojë një veprim në zhvillim e sipër në një çast të caktuar të së shkuarës¹⁰⁰. Format e së pakryerës kanë pësuar ndryshime morfologjike e fonetike si në temë ashtu edhe në mbaresa gjatë evolucionit të shqipes, edhe në periudhën parashkrimore edhe në atë shkrimore¹⁰¹.

Struktura foljore e kohës së pakryer në shqip formohet në përgjithësi, ashtu si edhe në gjuhën greke, nga tema foljore e kohës së tashme.

Koha e pakryer e dëftores së shqipes	
tema foljore e kohës së tashme	mbaresa
<i>la-</i>	<i>-ja</i>

Tabela 3.4

Por jo të gjitha foljet e formojnë të pakryerën nga tema foljore e së tashmes. Foljet të cilat pësojnë shndërrime tingullore në vetën e dytë shumës i ruajnë ato edhe në kohën e pakryer, në të gjitha format vetore p.sh.: *pjek-piqni* → *piqja*, *ngre – ngrini* → *ngrija*, *zë – zini* → *zija* etj. Për sa u përket foljeve *kam*, *jam* e *them*, ato në të pakryerën paraqesin si tema ashtu edhe mbaresa vetore të veçanta, përkatësisht, *kisha*, *isha* dhe *thosha*. Foljet e të tria zgjedhimeve, por edhe foljet e parregullta paraqesin në të pakryerën të njëjtat mbaresa vetore:

Mbaresat e foljeve në të pakryerën e dëftores së shqipes		
Zgjedhimi i parë	Zgjedhimi i dytë	Zgjedhimi i tretë
	<i>-ja</i>	
	<i>-je</i>	
	<i>-te (-nte)</i>	
	<i>-nim</i>	
	<i>-nit</i>	
	<i>-nin</i>	

Tabela 3.5

⁹⁹ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

¹⁰⁰ Po aty

¹⁰¹ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1976

Përveç kuptimit themelor e pakryera e shqipes përdoret edhe me kuptime të tjera si për të treguar një veprim të pacaktuar që përsëritet apo ka zgjatur për një kohë pak a shumë të gjatë në të shkuarën. Duke qenë se edhe në gjuhën greke (siç do ta shohim edhe në vazhdim) folja në kohën e pakryer ka pothuajse të njëjtat kuptime në shumicën e rasteve foljet në kohën e pakryer të shqipes jepen në gjuhën greke me po të njëjtën kohë, shembujt (1), (2).

- 1) Ajo *lagte fushën dhe brigjet dhe shkëlqente mbi asfaltin e zi të rrugës automobilistike.* (Gj.U.V. 13) – *Μούσκευε την πεδιάδα και τους λόφους και λαμποκοπούσε πάνω στη μαύρη άσφαλτο του αυτοκινητόδρομου.* (Σ.Ν.Σ. 15)
- 2) *Është e vërtetë se kjo pritje ndryshonte pak nga ajo pritja tjetër, kur ato shpresonin t'u ktheheshin gjallë bijtë e tyre, por, sidoqoftë, edhe të vdekurit priten.* (Gj.U.V. 17) – *Είναι αλήθεια πως αυτή η αναμονή διέφερε κάπως από την άλλη αναμονή, όταν δηλαδή αυτές έλπιζαν πως θα γύριζαν πίσω ζωντανά τα παιδιά τους, αλλά, όπως και να είναι, αυτές τα περιμένουν ακόμα και νεκρά.* (Σ.Ν.Σ. 20)
- 3) *U shmangeshin sidomos bisedave politike.* (Gj.U.V. 16) – *Ιδιαίτερα, απέφυγαν τις πολιτικές συζητήσεις.* (Σ.Ν.Σ. 19)
- 4) *Nga mënyra se si gërmonte dukej që ishte një punëtor me përvojë.* (Gj.U.V. 21) – *Απ' τον τρόπο που έσκαβε, έμοιαζε να είναι έμπειρος εργάτης.* (Σ.Ν.Σ. 25)
- 5) *Nga qelqet e makinës shihte kalimtarët e shumtë që shpejtonin në shi.* (Gj.U.V. 16) – *Μέσ' απ' τα τζάμια του αυτοκινήτου έβλεπε τους περισσότερους διαβάτες να προχωρούν βιαστικοί κάτω από τη βροχή.* (Σ.Ν.Σ. 19)

Në shembullin (3) foljet në të dyja gjuhët janë në të pakryerën, por folja në shqip është në formën joveprore, ndërsa në greqisht në formën veprore. Në fakt është kuptimi i foljes që e dikton këtë. Në gjuhën greke kjo folje për të shprehur kuptimin *shmang diçka*, apo *i shmangem diçkaje* përdoret vetëm në formën veprore *αποφεύγω*, mund të përdoret edhe në joveprore në rastin kur është në diatezën pësore, pra kryefjala pëson diçka p.sh.: *αυτό το εμπόδιο είναι αδύνατον να αποφευχθεί* - *kjo pengesë është e pamundur të shmanget.*

Në rastet kur e pakryera e foljes është në lidhje varësie me folje të tjera si në shembullin (4) ku e pakryera e foljes *jam, isha*, është kallëzuesi i një fjalie të nënrenditur dhe është në lidhje varësie me foljen *dukej*, e pakryera e shqipes mund të jepet me të tashmen e lidhore së greqishtes¹⁰², *να είναι*. Në këtë rast e pakryera nuk tregon as një veprim që përsëritet dhe as që vazhdon të kryhet në të shkuarën, por i bën një karakterizim kryefjalës pa vendosur caqe kohore, pa treguar se sa kohë vazhdon apo zgjat ai.

Me të tashmen e lidhore jepet e pakryera e dëftores së shqipes edhe në shembullin (5) ku përsëri folja *shpejtonin* është në marrëdhënie varësie me foljen e fjalisë kryesore *shihte*. Folja *shpejtonin* në këtë rast është zgjedhur të jepet me foljen *προχωρώ* (*përparoj, eci përpara*,) e cila në këtë rast luan rolin e një foljeje këpujore + mbiemrin *βιαστικοί*, i

¹⁰² Siç do të shqyrtojmë edhe në vazhdim, e tashmja e lidhore së greqishtes nuk ka kuptimin e së tanishmes, pra e së tashmes si kohë fizike, por si kohë gramatikore, pra kjo kohë formohet nga tema foljore e së tashmes.

cili mbart kuptimin e nxitimit, edhe pse në gjuhën greke ekziston folja me të njëjtin kuptim, *βιάζομαι*, dhe do të mund të përdorej në rastin konkret në të pakryerën e dëftores.

Për të treguar vazhdimësinë apo përsëritjen e veprimit në të shkuarën folja në të pakryerën mund të shoqërohet nga shprehje me kuptim ndajfoljor apo nga një fjali e nënrenditur kohore, gjë e cila ndodh edhe gjatë përcjelljes së tyre në gjuhën greke, shembujt (6), (7), (8), (9), (10).

- 6) *Nganjëherë ajo ulej kaq shumë sa që dukej sikur do të ngecej te kulmaku i tendës.* (Gj.U.V. 80) *Μερικές φορές κατέβαινε τόσο χαμηλά που έμοιαζε ν' ακουμπάει την κορυφή της σκηνής.* (Σ.Ν.Σ. 97)
- 7) *Herë pas here varrmihësit grumbulloheshin te fundaja, çka do të thoshte se ishte gjetur edhe një ushtar.* (Gj.U.V. 80) *Κάπου – κάπου οι εργάτες μαζεύονταν πολλοί μαζί πράγμα που σήμαινε πως είχε βρεθεί ένας ακόμη σκελετός.* (Σ.Ν.Σ. 97)
- 8) *Në rastet kur përmasat nuk përkonin me ato të listës atëherë pas kryqthi shtohet një pikëpyetje.* (Gj.U.V. 80) – *Στις περιπτώσεις που οι διαστάσεις δεν αντιστοιχούσαν μ' εκείνες του καταλόγου, μετά το σταυρό πρόσθετε κι ένα ερωτηματικό.* (Σ.Ν.Σ. 97)
- 9) *Çdo herë i kujtoheshin fytyra të ndryshme, të zymta në sallonin e pritjes....* (Gj.U.V. 81)– *Κάθε φορά του έρχονταν στο νου διάφορα πρόσωπα, απ' αυτά που περίμεναν στο σαλόνι του σπιτιού του....*(Σ.Ν.Σ. 99)
- 10) *Kur grupi i vogël vonohej sipër eshtrave, gjenerali ndiente një zbrazëtirë në lukth.* (Gj.U.V. 80) – *Όταν η μικρή ομάδα καθυστερούσε πάνω απ'τα οστά ο στρατηγός ένοιωθε ένα κενό στο στομάχι.* (Σ.Ν.Σ. 97)

Ashtu si edhe e tashmja e dëftores, e pakryera shoqërohet në mjaft raste nga pjesëza *po*, por duke qenë se e pakryera e ka më të qartë lokalizimin kohor, si kohë e së shkuarës, shoqërohet më rrallë me pjesëzën *po* se e tashmja¹⁰³. Gjatë përcjelljes së kësaj forme të së pakryerës në gjuhën greke nuk hasim asnjë element gjuhësor, i cili duke shoqëruar foljen të japë kuptimin e pjesëzës *po*, shembujt (11), (12), (13), (14).

- 11) *Po mblihdnin eshtrat e ushtarëve të ditës së parë të luftës.* (Gj.U.V. 150)– *Μάζευαν τα λείψανα των στρατιωτών που είχαν πέσει στη μάχη την πρώτη μέρα του πολέμου.* (Σ.Ν.Σ. 179)
- 12) *Mijëra nëna në vendin e tij po prisnin eshtrat e bijve të tyre.* (Gj.U.V. 14)– *Χιλιάδες μανάδες στον τόπο του περίμεναν τα λείψανα των παιδιών τους.* (Σ.Ν.Σ. 17)
- 13) *Dritëzat e kuqe e ngjyrë manushaqe po mënjanoheshin nga të dy anët.* (Gj.U.V. 15) – *Τα κοκκινοβιολετιά φώτα απομακρύνονταν κι απ' τις δύο πλευρές.* (Σ.Ν.Σ. 17)
- 14) *Pllaja të zymta po rrëshqisnin me shpejtësi poshtë mjegullës.* (Gj.U.V. 14) – *Μουντά οροπέδια που έτρεχαν με ταχύτητα κάτω από την ομίχλη.* (Σ.Ν.Σ. 16)
- 15) *Tani që për herë të parë po shihte tokën e huaj, ai provonte shumë më qartë atë frikë të turbullt që i shkaktonte prej disa muajsh ndjesia e pamundësisë, me të cilën ishte lidhur misioni i tij.* (Gj.U.V. 14) – *Και τώρα, που για πρώτη φορά*

¹⁰³ F. Agalliu, *Mbi pjesëzën po në gjuhën shqipe*, SF 2, 1982, f. 62

έβλεπε την ξένη γη, ένωθε πολύ καθαρά το θολό φόβο που του προκαλούσε εδώ και αρκετούς μήνες η αίσθηση του αδύνατου, με την οποία είχε συνδέσει την αποστολή του. (Σ.Ν.Σ. 16)

Ka raste kur kemi disa fjali brenda një periudhe, në lidhje bashkërenditëse apo nënrenditëse, te të cilat folja është në të pakryerën, por jo të gjitha ato shoqërohen nga pjesëza *po*. Mund të jetë vetëm fjalia e parë, si në shembullin (15) ose edhe ndonjë nga fjalitë e tjera:

Në gjuhën greke nuk ka asnjë ndryshim në përkthimin e të tria këtyre foljeve, ato që të tria jepen me të pakryerën e shqipes. Për sa i përket foljes së parë e cila në shqip shoqërohet prej pjesëzës *po*, në gjuhën greke nuk ka asnjë gjymtyrë apo element me kuptim kohor apo aspektor që të shprehë kuptimin dhe vlerën e pjesëzës *po* të shqipes.

b. E pakryera e dëftores¹⁰⁴ së greqishtes, si edhe në gjuhën shqipe tregon se veprimi kryhej në të shkuarën dhe ky veprim mund të kryhej vazhdimisht, apo në mënyrë të përsëritur¹⁰⁵. Struktura e foljes në këtë kohë përveç temës dhe mbaresës ka edhe një element tjetër, augmentin, i cili nuk përdoret për të formuar të pakryerën e çdo foljeje, por te foljet që fillojnë me bashkëtingëllore dhe në të pakryerën paraqiten me më pak se tri rrokje, p.sh.: *γράφω – έγγραφα*. Augmenti ruhet kur është i theksuar, por ka raste kur edhe pse nuk theksohet ai ruhet si në rastet kur bashkëtingëllorja fillestare e foljes është e njëjtë me atë fundore të fjalës paraardhëse p.sh: *τους εστρώναμε*, përdorim i cili haset më shpesh në ligjërimin e folur. Por kemi përdorim të së pakryerës me augment të patheksuar edhe në ligjërimin letrar: *...Μα απ’ το πολύ να σκέπτεται και να θυμάται/ ο γέρος εζαλίστηκε*. (Κ. Ένας γέρος). Augmenti në të shumtën e rasteve, ashtu si edhe te aoristi është *ε-*; *γράφω – έγγραφα*, *βρίσκω - έβρισκα*, por mund të jetë edhe *η-* *θέλω – ήθελα*, *ζέρω – ήξερα*, apo *ει-*: *έχω – είχα*. E pakryera e dëftores së greqishtes formohet nga tema foljore e kohës së tashme dhe karakterizohet nga aspekti foljor imperfektiv (i pakryer). Strukturën e foljes në këtë kohë në mënyrë skematike mund ta paraqesim si më poshtë:

E pakryera e dëftores së greqishtes		
Augmenti	Tema foljore e së tashmes	Mbaresa
<i>ε-, η-, -ει-, ο</i>	<i>γράφ-</i>	<i>-α</i>

Tabela 3.6

Mbaresat foljore të së pakryerës për foljet e zgjedhimit të parë janë të njëjta me ato të aoristit, pra nga ana strukturore këto dy kohë ndryshojnë vetëm nga tema, pra dallimi midis tyre është aspektor. Për foljet e zgjedhimit të dytë këtyre mbaresave u paravendoset formanti *-ουσ-*. Kjo mbaresë e së pakryerës, e cila në greqishten e vjetër karakterizohej

¹⁰⁴ Në gjuhën greke mënyra dëftore është e vetmja, në të cilën folja mund të vendoset në të pakryerën.

¹⁰⁵ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *vep. e cit.*, 1991

nga mbaresa të tjera, filloi të shfaqet në periudhën postklasike fillimisht në numrin shumës dhe më vonë për analogji u vendosën edhe në numrin njëjës¹⁰⁶. Mbaretat kohore vetore të së pakryerës së greqishtes janë:

Mbaretat e foljeve në të pakryerën e dëftores së greqishtes	
Zgjedhimi i parë	Zgjedhimi i dytë
	Klasa e parë
-α	-ουσα
-εις	-ουσες
-ε	-ουσε
-αμε	-ουσαμε
-ατε	-ουσατε
-αν(ε)	-ουσαν

Tabela 3.7

Kuptimet gramatikore të së pakryerës së shqipes e greqishtes në shumicën e situatave ligjërimore ku përdoret kjo kohë janë të njëjta ndaj dhe përcjellja e kësaj forme kohore nga greqishtja bëhet në gjuhën shqipe me të pakryerën e shqipes, si në shembullin (1). Vërejmë se folja e parë në të pakryerën e greqishtes, *αγαπιούμαστε*, është dhënë me më se të kryerën e shqipes, gjë që siç do të shohim edhe më poshtë përdoret në mjaft raste për të përkthyer të pakryerën e greqishtes në shqip.

Në shembullin (2) vëmë re se edhe pse në gjuhën greke nuk ka asnjë element gramatikor apo gjuhësor që të tregojë aktualizim të veprimit në të shkuarën, apo vazhdimësi të tij, është parapëlqyer nga përkthyesi që në gjuhën shqipe t'i paravendoset foljes në të pakryerën pjesëza *po*, e cila në këtë rast në gjuhën shqipe se veprimi është në proces kryerje në të shkuarën. Siç vumë re edhe më sipër edhe kur kemi përcjelljen e një foljeje në të pakryerën e shqipes të shoqëruar nga pjesëza *po*, në gjuhën greke, në këtë të fundit nuk kemi përdorimin e asnjë mjeti gramatikor apo leksikor, i cili të shoqërojë foljen e të shprehë kuptimin gramatikor të kësaj pjesëze.

- 1) Ποτέ, εμείς που τόσο αγαπιούμαστε, δεν είχαμε σταυρώσει έναν τρυφερό λόγο-παίζαμε και τσαγκρονιούμαστε σα θειριά. (B.II. 17)- Kurrë po kurrë ndonjëherë, ne që e kishim dashur njëri- tjetrin me kaq zjarr, s'kishim shkëmbyer një fjalë të brishtë. **Lozënim e gërvishteshim** si bisha. (Z. 13)
- 2) Πήρε να βρέχει τώρα δυνατά. Φτάναμε στο χωριό. (B.II. 106)- Shiu kishte shtruar mirë. **Po hynim** n ë fshat. (Z. 94)

¹⁰⁶ N. Ανδριώτης, *νερ. e cit.*, 1995, 50

- 3) *Καθόμουν σε μια γωνιά, κρύωνα, παράγγειλα και δεύτερο φασκόμηλο· νύσταζα· πάλευα με τον ύπνο, την κούραση και με την πρωινή θλίψη της μέρας. (B.Π. 16) – Isha mbledhur e bërë shuk në një kënd të kafenesë. Të ftohtit më kish hyrë në palcë. Më kish mundur gjumi, bëja çmos që t'i bëja ballë. Dhe sfilitjes. Dhe mërisë së ditës së re. (Z. 11)*
- 4) *Εγώ που τόσο αγαπούσα τη ζωή, πώς είχα μπλεχτεί, χρόνια τώρα, στα χαρτιά και στα μελάνια. (B.Π. 20)- Unë e kisha dashur kaq shumë jetën, por kisha ngecur keq mes letrave e bojërave! (Z. 16)*

Por hasen edhe raste kur e pakryera e greqishtes mund të jepet në gjuhën shqipe edhe me kohë të tjera dhe jo vetëm të mënyrës dëftore, shembulli (3). Folja *καθόμουν* (rrija) në gjuhën shqipe është dhënë me më se të kryerën e foljes *mbledhem*, *isha mbledhur*, që në fakt nuk ka kuptim sinonimik të plotë me foljen *rri*, por ajo që ne na intereson të vërejmë në këtë rast është analogjia kohore e dy foljeve dhe jo ngjyrimet semasiologjike të tyre. Të dyja këto forma kohore, si e pakryera dhe më se e kryera në shqip bëjnë pjesë në kohët e së shkuarës, por në gjuhën shqipe ne e përdorim foljen *rri* në shprehjen *rri mbledhur*, përkatësisht *rrija mbledhur* në të pakryerën, duket se forma e më se të kryerës, *isha mbledhur e bërë shuk*, mund të përdoret për të përkthyer në shqip të pakryerën e greqishtes *καθόμουν*. Analogjia kuptimore e foljes *κρύωνα* në shqip është një togfjalësh, i cili përmban foljen *kam*, *kam ftohtë*, por në vend të së pakryerës së foljes *κρύωνα* përkthyesi ka zgjedhur të përdorë më se të kryerën e foljes *hyj* në shprehjen: *më ka hyrë i ftohti në palcë*, pra e pakryera e greqishtes jepet përsëri me më se të kryerën në shqip. Edha folja *νύσταζα* është dhënë me më se të kryerën e shqipes, dhe kjo edhe për analogji të dy foljeve paraardhëse.

Edhe në shembullin (4) e pakryera e greqishtes jepet me më se të kryerën e shqipes: Në këtë rast e pakryera e foljes *αγαπώ* (*dua*), është preferuar të jepet me më se të kryerën e shqipes, *kisha dashur*, ka ndikuar këtu natyrisht fakti që është ndryshuar struktura e periudhës, ndërkohë që në gjuhën greke kemi një fjali të thjeshtë e një të nënrenditur, në gjuhën shqipe kemi dy fjali kryesore.

Koha e pakryer mund të përdoret edhe në shprehjet frazeologjike me vlerë mbarëkohore, p.sh.: shprehja *δάσκαλε που δίδασκες και νόμο δεν εκράτεις*, që do të kishte si analoge në shqip shprehjen: *bëj si them unë, por mos bej si bëj unë*, folja *δίδασκες* në këtë shprehje përdoret gjithmonë në të pakryerën. Por një mënyrë alternative me të cilën mund të jepet kjo shprehje dhe për rrjedhojë edhe koha e foljes është: *Εμπρός, λοιπόν, δάσκαλε που δίδασκες...Έλα!* (B.Π. 17) - *Marsh pra, o mësues që na dhënke mësimë.....O burra!* (Z. 13) Jepet pra në gjuhën shqipe e pakryera e foljes *διδάσκω* në greqisht me të tashmen e habitores *dhënke* (*mësime*), duke zgjedhur mënyrën habitore, e cila nuk ekziston në gjuhën greke si formë foljore, për të përcjellë edhe ngjyrimin stilistikor të shprehjes.

E pakryera e foljes *θέλω* (*dua*), mund të përdoret në gjuhën greke edhe me vlerën e së ardhmes si p.sh., në shprehjen *ό,τι ήθελε προκύψει* (*të dalë ku të dalë*) ku ajo ndiqet nga folja *προκύπτει* (*rezulton, del*).

3.1.1.2.1. E pakryera e greqishtes e shoqëruar me pjesëza

Kur e pakryera e greqishtes shoqërohet me pjesëza (*θα, να*) atëherë ajo përdoret për të shprehur zakonisht modalitete.

Θα + e pakryer

Funksioni më karakteristik i pjesëzës *θα* (*do të/do*) në gjuhën greke është formimi i kohëve të së ardhmes së mënyrës dëftore. Përveç këtij funksioni kur kjo pjesëz shoqërohet nga kohët e së shkuarës përdoret për të shprehur një sërë modalitetesh¹⁰⁷.

Kur pjesëza *θα* i paravendoset një foljeje në të pakryerën atëherë ajo mund të tregojë mundësi, ajo që quhet dëftore e mundësisë¹⁰⁸, shembulli (1). Vërejmë se në gjuhën shqipe kjo formë foljore e greqishtes është përcjellë nëpërmjet së ardhmes së përparme të së shkuarës së dëftores, formë e cila në këtë rast e përcjell më së miri kuptimin dhe modalitetin e foljes në gjuhën greke.

- 1) *Μονάχα ένας Σαιζπήρος, συλλογίστηκα, θα μπορούσε, στις πιο δημιουργικές στιγμές του, να βρει μιαν τόσο ωμή ρεαλιστική έκφραση.....(B.II. 111) Vetëm një Shekspir, - thashë me vete – do të kishte mundur të gjente një shprehje të tillë..... (Z. 99)*
- 2) *Ο μπάμπας σου, είπε σιγά, αγρίεψε πάλι να περνούσε από το χέρι του, θα την έκανε λουρίδες λουρίδες την κακομοίρα· (B.II. 109)- Xhaxhai yt – i tha ngadalë – u nxehe prapë. Ta kishte korbën në dorë do ta rrippte fije – fije. (Z. 97)*
- 3) *Μα θαρρώ πως μήτε αυτός το ‘ξερε, γιατί αν το ‘ξερε θα ‘ριχνε το αστροπελέκι να μας κάψει. (B.II. 98) – Por ma do mendja, as ai vetë s’e di, se, ta dinte, do të na vërtiste një rrufe kresë e do të na përvëlonte të tërëve. (Z. 87)*
- 4) *Οι στίχοι που θα διάλεγα πρωί πρωί θα ρύθμιζαν τη μέρα μου όλη. (B.II. 21)- Vargjet e zgjedhura këtij mëngjesi do të përcaktonin fatin e gjithë ditës që do të vinte. (Z. 17)*
- 5) *Θα’ταν μεσάνυχτα (B.II. 75) – Do të ketë qenë zemra e natës. (Z. 67)*

Duke qenë se gjuha greke nuk e ka mënyrën kushtore, kjo formë foljore përdoret në gjuhën greke në fjalitë e nënrenditura kushtore, e parë përsëri si modalitet dhe tregon se cilat janë mundësitë të ndodhe diçka në të shkuarën, nëse plotësoheshin kushtet (kushti), shembujt (2), (3). Vërejmë se në këtë rast kur bëhet fjalë për fjali kushtore, e pakryera e greqishtes kur i është paravendosur pjesëza *θα*, në gjuhën shqipe jepet me të tashmen e mënyrës kushtore.

Θα + e pakryera e dëftores përdoret edhe me kuptimin e së ardhmes të shkuarës, dhe nuk ka një kuptim të theksuar modal, pra thjesht vendoset veprimi pas një çasti të caktuar në të shkuarën, shembulli (4). Duke qenë se në gjuhën shqipe, ekziston forma kohore e cila e shpreh këtë kuptim kohor, është e ardhmja e së shkuarës, ajo përdoret për të përcjellë në shqip këtë përdorim të së pakryerës kur i paravendoset pjesëza *θα*. Vërejmë

¹⁰⁷ Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπιμιώτης, *ver. e cit.*, 2004

¹⁰⁸ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *ver. e cit.*, 1991

se folja e parë *θα διάλεγα* (*do të zgjidhja*), jepet në shqip me mbiemrin prejpjesor e *zgjedhura*, i cili tregon përfundimin e një veprimi. Përdorimi i tij nuk e humbet kuptimin e frazës sepse duke qenë se ndiqet nga një folje në të ardhmen e së shkuarës, tregon parakohësi, pra *do të zgjidhja vargjet të cilat më pas do të përcaktonin fatin e gjithë ditës*.

Në shembullin (5) folja *είμαι* (*jam*) në të pakryerën me pjesëzën *θα* tregon një hamendësi dhe vërejmë se në shqip ajo përcillet me të ardhmen e përparme të foljes *jam*, e cila nuk mund të formohet në gjuhën greke.

E pakryera e greqishtes, sidomos kur asaj i paravendoset pjesëza *θα*, përdoret edhe për të shprehur diçka me politesë p.sh.: *Θα ήθελα ένα ποτήρι νερό, σας παρακαλώ.* – *Do të doja një gotë ujë, ju lutem.* gjë që ndodh me të ardhmen e së shkuarës së shqipes kur e njëjta situatë ligjërimore përcillet nga gjuha greke në atë shqipe. Kaq i gjerë është përdorimi i kësaj forme *θα* + të pakryerën si mënyrë e shprehjes me politesë, sa që mund të thuhet se pjesëza *θα*, përveç se tregues i së ardhmes, është edhe tregues modaliteti, tregues i politesës, kur shoqërohet nga e pakryera¹⁰⁹.

Na (të)+ e pakryer

Kur e pakryera e greqishtes shoqërohet me pjesëzën *të*, atëherë e pakryera nuk përdoret me kuptim kohor por me kuptim modal¹¹⁰. Folja në të pakryerën shoqëruar me pjesëzën *να* (*të*) tregon një dëshirë apo urim për të ardhmen dhe shpesh shoqërohet edhe me pashirra si *αχ, ε* (*ah, eh*) etj., shembujt (1), (2). Forma foljore e cila i përgjigjet në shqip formës *να* + e pakryer, si nga ana strukturore, por siç vërejmë nga shembulli i mësipërm edhe nga ana semasiologjike është e pakryera e lidhore. Në mënyrën lidhore të greqishtes nuk ekziston koha e pakryer, si formë kohore, dhe struktura *να* + e pakryer trajtohet si modalitet dhe jo si trajtë kohore.

- 1) *Ε, και να 'χα τα νιάτα σου! (B.Π. 241) Eh, të kisha moshën e rininë tënde. (Z. 218)*
- 2) *Αχ, να μπορούσα να ζούσα λεύτερος, χωρίς να πιάνουμε, σαν τον πνιγμένο, από τα ζεστά, ζωντανά κορμιά σας! (B.Π. 312) – Ah, të mundja të jetoja i lirë, pa u kapur si i mbyturi pas trupit tuaj të valë. (Z. 284)*
- 3) *Ε, μωρέ, και να 'μouvα σαν τον Παυλή του Μουραντώνη, είκοσι χρονών! (B.Π. 109) – Eh, të qenkësha në moshën e Pavli Mavrandonit, njëzetvjeçar!(Z. 97)*

Në shembullin (3) trajta *να 'μouvα – të isha*, është zgjedhur të jepet me strukturën *να* (*të*) + të pakryerën e habitores së foljes *jam, qenkësha*. Kjo trajtë në gjuhën shqipe nuk përbën trajtë kohore të asnjë mënyre.

¹⁰⁹ Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπιμιώτης, *ver. e cit.*, 2004

¹¹⁰ По аты

3.1.1.3. Koha e kryer e thjeshtë (aoristi)

a. Folja në kohën e kryer të thjeshtë në gjuhën shqipe tregon një veprim të përfunduar në një çast të caktuar në të shkuarën¹¹¹. Ndryshimi i së kryerës së thjeshtë së shqipes me të pakryerën¹¹² dhe të kryerën¹¹³ ka më shumë karakter aspektor. Përveç këtij kuptimi e kryera e thjeshtë mund të përdoret edhe me kuptim mbarëkohor, apo me kuptimin e së ardhmes apo të së kryerës.

Për sa i përket strukturës morfematike të foljes në këtë kohë, vërejmë se shumica e foljeve ruajnë temën e kohës së tashme dhe mbaresat e së kryerës së thjeshtë, megjithëse kemi edhe folje ku ndeshim tema të zgjeruara, *di – dita*, tema të pazgjeruara, *pëlcas – plasa*, apo tema me shndërrime tingullore, *dal – dola*, *pjek – poqa*¹¹⁴. Përveç formimeve të reja, siç i quan Demiraj¹¹⁵, si *punoj – punova*, në të kryerën e thjeshtë përfshihen edhe forma të aoristit sigmatik: *dhashë, pashë*, si edhe forma të së kryerës së vjetër sintetike: *breddh – brodha*. Foljet që të kryerën e thjeshtë e formojnë me prapashtesa trajtëformuese *-sh-* të aoristit sigmatik, e cila është një zgjerim i prapashtesës *-s-*, në shqipen e dokumentuar janë shumë të pakta dhe kjo prapashtesë haset vetëm në vetën e parë¹¹⁶. Mbaresat vetore që marrin foljet në të kryerën e thjeshtë, në shumicën e foljeve janë: *-a, -e, -i/-u* për numrin njëjës, ku tek foljet, tema e të cilave mbaron me zanore, në vetën e parë e të dytë njëjës këtyre mbaresave u paravendoset një *-v-*, pra kemi mbaresat *-va, -ve*, dhe për numrin shumës: *-më/-m, -të/-t, -në/-n*, të cilat në foljet me temë në bashkëtingëllore janë: *-ëm, -ët, -ën*. Për të formuar të kryerën e thjeshtë të joveprores, i paravendosim trajtës së të kryerës së thjeshtë të veprores pjesëzën *u*.

Koha e kryer e thjeshtë e shqipes				
Tema foljore				Mbaresa
Tema e së tashmes	Temë e zgjeruar	Temë e pazgjeruar	Temë me ndryshime tingullore	Mbaresa
<i>hap - hap-</i>	<i>di – dit-</i>	<i>pëlcas – plas-</i>	<i>dal – dol- pjek – poq-</i>	<i>-a, -e, -i/-u</i> <i>-ëm, -ët, -ën; -më/-m, -të/-t, -në/-n.</i>

Tabela 3.8

¹¹¹ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

¹¹² Po aty

¹¹³ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, ë 2002

¹¹⁴ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

¹¹⁵ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

¹¹⁶ Po aty

Siç përmendëm edhe më sipër e kryera e thjeshtë përdoret në shumicën e rasteve për të treguar se një veprim ka përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës. Kjo ndodh edhe me aoristin e greqishtes, ndaj në shumicën e rasteve, koha me të cilën përcillet në greqisht koha e kryer e thjeshtë e shqipes është pikërisht aoristi i greqishtes si për formën veprorë edhe për atë joveprorë, shembujt (1), (2), (3), (4), (5).

- 1) Gjenerali **porositi raki**. *Prifti kërkoi kakao*. (Gj.U.V. 27)- *Ο στρατηγός παράγγειλε ένα ρακί. Ο ιερέας ζήτησε κακάο*. (Σ.Ν.Σ. 33)
- 2) *Qëkurse malet i lanë prapa dhe fluturuan mbi lugina e pastaj mbi fusha*, gjenerali e ndjeu veten më të lehtësuar. (Gj.U.V. 15) – *Απ’ όταν άφησαν πίσω τους τα βουνά και πετούσαν πάνω από κοιλάδες και ύστερα πάνω από πεδιάδες, ο στρατηγός ένιωσε να ζαλαφρώνει κάπως*. (Σ.Ν.Σ. 17)
- 3) Gjenerali e **vështroi** në sy i shqetësuar. (Gj.U.V. 21)- *Ο στρατηγός τον κοίταξε ανήσυχος*. (Σ.Ν.Σ. 26)
- 4) *Bisedimet midis dy qeverive kishin filluar që në pranverë, por marrëveshja përfundimtare u nënshkrua vetëm në fund të gushtit, në kohën e vranësirave të para*. (Gj.U.V. 13) – *Οι διαπραγματεύσεις ανάμεσα στις δύο κυβερνήσεις είχαν αρχίσει ήδη απ’ την άνοιξη, αλλά η οριστική συμφωνία υπογράφτηκε μόλις στα τέλη του Αυγούστου, την εποχή που εμφανίζονται οι πρώτες συννεφίες*. (Σ.Ν.Σ. 15)
- 5) *Që larg u dëgjua një vërshëllimë lokomotive*. (Gj.U.V. 15) – *Από μακριά ακούστηκε το σφύριγμα μιας αμαξοστοιχίας*. (Σ.Ν.Σ. 18)
- 6) *Iu kujtuan prapë ushtarët e kombeve të ndryshme, që kishin qenë në Shqipëri*. (Gj.U.V. 33) – *Θυμήθηκε ζανά τους στρατιώτες τόσων διαφορετικών κρατών, που είχαν έρθει στην Αλβανία*. (Σ.Ν.Σ. 41)

Në varësi të karakteristikave semantike të foljeve, edhe pse për të përkthyer kohën e kryer të thjeshtë të shqipes përdoret aoristi i greqishtes, përdoren folje të ndryshme në gjuhën greke, të cilat japin kuptimin e foljes, si në rastin e foljes *ndjeu* të shqipes, shembujt (7),(8).

Ka dhe raste kur foljet në kohën e kryer të thjeshtë të shqipes, jepen në shqip me folje në kohën e pakryer, shembujt (9), (10). Në shembullin (10), ku e kryera e thjeshtë e foljes *dua – desha*, në këtë rast është dhënë me të pakryerën e foljes *θέλω* në greqisht *ήθελα* dhe jo me aoristin *θέλησα*, shprehja *nuk deshi të kujtonte* jepet në greqisht me shprehjen *nuk donte të kujtonte*.

- 7) *Në hotel “Dajti” e ndjeu veten mirë*. (Gj.U.V. 16) – *Στο ξενοδοχείο «Νταίτι» ο στρατηγός συνήλθε*. (Σ.Ν.Σ. 19)
- 8) *Papritur e ndjeu veten fare vetëm*. (Gj.U.V. 29) – *Ξαφνικά αισθάνθηκε τελείως μόνος*. (Σ.Ν.Σ. 35)
- 9) *Por prifti nuk u tregua kureshtar*. (Gj.U.V. 16) – *Αλλά ο ιερέας δε φαινόταν περίεργος*. (Σ.Ν.Σ. 19)
- 10) *Nuk deshi të kujtonte “varret e vëllezërve”*. (Gj.U.V. 29) – *Δεν ήθελε να θυμάται «τους τάφους των αδελφών του»*. (Σ.Ν.Σ. 35)

Në rastin kur dy folje në të kryerën e thjeshtë ndjekin njëra tjetrën dhe lidhen ndërmjet tyre me një lidhëz bashkërenditëse, mund të ndodhë që e para të jepet me të

pakryerën e greqishtes, ndërsa e dyta me aoristin e greqishtes, pra analogen e së kryerës së thjeshtë të shqipes, shembulli (11). Në këtë rast e kryera e thjeshtë *u përplas*, jepet me të pakryerën *χτυπούσε (përplasej)*, ndërsa folja *ngritën* jepet me aoristin *σήκωσαν*.

Folja *ζέρω (di)* në greqisht nuk mund ta formojë aoristin dhe as kohët analitike të së shkuarës, ndaj dhe kur kjo folje në shqip është në të kryerën e thjeshtë, në greqisht jepet me të pakryerën *ήξερα (dija)*, që është e vetmja kohë e së shkuarës që mund të formohet, shembulli (12).

11) *Era e lagur iu përplas me forcë në fytyrë dhe ata ngritën qafëzat.* (Gj.U.V. 15) – *Ο υγρός αέρας τους χτυπούσε με δύναμη στο πρόσωπο και αυτοί σήκωσαν τους γιακάδες.* (Σ.Ν.Σ. 18)

12) *Ai do t' u çonte nënave eshtrat e bijve të tyre, që gjeneralët e paaftë nuk ditën t' i udhëhiqnin në luftë.* (Gj.U.V. 17) – *Θα 'στελνε, λοιπόν, στις μητέρες τα οστά των παιδιών τους, που οι ανίκανοι στρατηγοί δεν ήξεραν να καθοδηγούν στη μάχη.* (Σ.Ν.Σ. 20)

Ndodh që kur kemi dy a me shumë folje në të kryerën e thjeshtë në shqip, njëra prej tyre të jepet në greqisht me lidhoren e thjeshtë, apo aoristin e lidhores, shembulli (13). E kryera e thjeshtë e foljes *heq – hoqi* jepet me aoristin e lidhores së greqishtes e foljes *βγάζω* në vetën e tretë, (*βγάζει- va βγάλει*)- të *heqë*.

13) *Ai doli më pas nga gropa dhe pushoi ndanë saj për aq kohë sa shoku i tij hoqi me lopatë baltën e gërmuar.* (Gj.U.V. 20) – *Βγήκε ύστερα από λίγο απ' το λάκκο και στάθηκε δίπλα του μέχρι ο άλλος εργάτης να βγάλει με το φτυάρι το σκαμμένο χώμα.* (Σ.Ν.Σ. 24)

Vërejmë se një folje në të kryerën e thjeshtë mund të jepet edhe me më se të kryerën e greqishtes, shembulli (14).

E kryera e thjeshtë e shqipes përdoret ndonjëherë edhe me kuptimin e së ardhmes. E njëjta gjë siç do ta shohim edhe më poshtë ndodh edhe në gjuhën greke. Por pavarësisht kësaj jo gjithmonë ky përdorim i së kryerës së thjeshtë jepet në greqisht me aoristin. Në shembullin (15) e kryera e thjeshtë e shprehjes foljore *mora vesh*, jepet me aoristin e lidhores (lidhoren e thjeshtë) e foljes *καταλαβαίνω (kuptoj)*, ndërsa e kryera e thjeshtë e dy foljeve të tjera jepet po me aoristin e foljeve në greqisht.

14) *Specialisti shqiptar u përkul prapë te gropa dhe të tjerët u afruan.* (Gj.U.V. 23) – *Ο Αλβανός επιστάτης είχε σκύψει ξανά προς το λάκκο και οι άλλοι πλησίασαν κοντά του.* (Σ.Ν.Σ. 28)

15) *Të pui e zezë, po mora vesh gjë, të vara te kulmi i pullazit.* (Gj.U.V. 103) – *Καταστράφηκες, έτσι και καταλάβω κάτι, σε κρέμασα απ' την κορυφή της στέγης.*

b. Aoristi i dëftores së greqishtes është koha e cila tregon se veprimi i foljes ka ndodhur në të shkuarën. Ndryshimi i saj me të pakryerën, ashtu si edhe në gjuhën shqipe është aspektor, pra ndërsa e pakryera tregon një veprim i cili është në zhvillim apo

përsëritet në të shkuarën, aoristi e tregon veprimin të përfunduar, në tërësinë e tij¹¹⁷. Ndryshimi duket edhe te temat foljore të secilës kohë, ku koha e pakryer ka temën foljore të së tashmes, ndryshe nga aoristi. Veta e parë e foljes në aorist mund të mbarojë më – σα(-ψα,- ζα,-ευσα), ose -α, në rastin e parë aoristin e quajmë sigmatik, gjurmë të së cilit hasim edhe në gjuhën shqipe, dhe është më i shpeshtë¹¹⁸, ndërsa në rastin e dytë e quajmë aorist jo sigmatik. Element tjetër mjaft i rëndësishëm në formimin e aoristit të greqishtes është edhe augmenti, i cili mund të jetë ε- (γράφω - έγγραψα), η- (πίνω - ήπια), ει- (λέω - είπα), dhe gjendet në fillim (σπάω - έσπασα) apo në trup të foljes (ενδίδω - ενέδωσα). Siç e vëmë re edhe nga foljet e mësipërme augmenti është gjithmonë i theksuar, sepse vetëm atëherë ai mund të qëndrojë, qoftë në fillim apo të trup të foljes, në rast të kundërt ai bie. Foljet e rregullta në aoristin e greqishtes kanë gjithmonë theks tejfundor, ndaj të gjitha foljeve dyrrrokëshe gjatë formimit të aoristit u paravendoset augmenti. Strukturën e aoristit në greqisht mund ta paraqesim me skemën e mëposhtme:

Aoristi i dëftores së greqishtes		
Augmenti	Tema foljore e aoristit	Mbaresa
ε-, η-, -ει-, ο	διαβάσ-/γράφ-/τρέξ-/σφαλ-/	-α

Tabela 3.9

Mbaresat kohore të aoristit janë të njëjta me ato të kohës së pakryer, por ato u prapavendosen temave të ndryshme foljore, përkatësisht të aoristit dhe të së tashmes. Këto mbaresa janë të njëjta për të dyja zgjedhimet, madje edhe për foljet e parregullta të cilat mund të kenë ndryshme në temën foljore, por jo në mbaresa.

Mbaresat e foljeve në aoristin e dëftores së greqishtes
Zgjedhimi i parë/ Zgjedhimi i dytë
-α
-ες
-ε
-αμε
-ατε
-αν(ε)

Tabela 3.10

¹¹⁷ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *vep. e cit.*, 1991

¹¹⁸ Μ. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005

Siç pamë edhe për gjuhën shqipe, përveç kuptimit kryesor të aoristit, folja në këtë kohë gramatikore mund të shprehë edhe kuptime të tjera. Në shumicën e rasteve aoristi i greqishtes përdoret në rrëfime, ndaj dhe në këto raste quhet aoristi historik apo narrativ. Këto përdorime të aoristit të greqishtes jepen kryesisht me të kryerën e thjeshtë të gjuhës shqipe, shembulli (1).

- 1) *Μα έκλεψα, σκότωσα, είπα ψέματα, κοιμήθηκα μ' ένα σωρό γυναίκες. Πάτησα όλες τις εντολές. (B.Π. 241)- Po se vodha, vrava, gënjeva, fjeta me kushedi sa gra. I shkela të gjitha porositë. (Z. 218)*
- 2) *Η τζαμόπορτα άνοιξε· ένας κοντός, ταγαριασμένος λιμανιώτης μπήκε· ζεσκούφωτος, ζυπόλυτος, ολολάσπωτος. (B.Π. 15)- Porta prej xhami u hap. Një rrondokor nga të portit bëri këmbë, pa feste kresë, zbatharak, i përbaltur. (Z. 11)*
- 3) *Μερικοί γέλασαν, άλλοι κούνησαν το κεφάλι, βλαστήμησαν. (B.Π. 15) Ndoca ia dhanë gazit, të tjerë tundën kryet me blasfemi. (Z. 11)*

Në shembullin (2) folja *μπήκε* (*hyri, u fut*) është përcjellë në shqip me një shprehje foljore, *bëri këmbë*, e cila është në të kryerën e thjeshtë.

Siç vërejmë në shembullin (3) folja *γέλασαν* (*qeshën*) jepet përsëri me një shprehje frazeologjike foljore në të kryerën e thjeshtë, *ia dhanë gazit*, ndërsa folja në aorist *βλαστήμησαν* jepet me një emër, *blasfemi*.

Folja *κάνω* (*bëj*) në të kryerën e thjeshtë e ndjekur nga një folje në lidhore dhe shoqëruar nga një rrethanor kohe, i cili tregon një interval kohor (*μια μέρα -një ditë, δύο ώρες - dy orë, δύο εβδομάδες - dy javë etj.*) në gjuhën greke tregon se për atë interval kohor nuk ka ndodhur veprimi që shpreh folja. Kjo strukturë mund të jepet në shqip me të kryerën e thjeshtë të foljes duke i paravendosur një pjesëz mohuese (*nuk, s'*), shembulli (4).

- 4) *Πιάστηκε η αναπνοή μου. Τρεις μέρες έκαμα να βάλω μπουκιά στο στόμα μου. (B.Π. 23) – M'u mbajt fryma. Tri net e tri ditë s'vura gjë prej gjëje në gojë. (Z. 19)*

Aoristi përdoret në greqisht edhe në këngët popullore të cilat shumë herë kanë karakter narrativ, shembulli (5).

5) *Βγήκαν κλέφτες στα βουνά
για να κλέψουν άλογα!
Κι άλογα δε βρήκανε
και τη Νούσα πήρανε! (B.Π. 98)*

*Dolën kaçakët në male
Kuaq për të kapur-o
Por në male s'kishte kuaq
dhe rrëmbyen Nusën-o. (Z. 87)*

Përveç së kryerës së thjeshtë aoristi i greqishtes vërejmë se mund të jepet edhe me kohë të tjera të së shkuarës së shqipes, si p.sh. e kryera apo e kryera e tejshkuar, shembujt (6), (7)

- 6) *Τόσο πολύ την αγάπησες τη γυναίκα αυτή; ρώτησα ύστερα από λίγο. (B.Π. 99) -
Kaq shumë e ke dashur atë grua? – e pyeta pas pak. (Z. 88)*

- 7) **Ἐπεσα** κι εγώ με τα μούτρα στο λάκκο όπου **ἔπεσαν** κι οι μπροστινοί μου. (B.Π. 24)- **Rashë** edhe unë në po atë përrua ku **patën rënë** dhe të parët e mi. (Z. 21)
- 8) Αφεντικό, **εἶπε**, θα πεταχτώ στο χωριό να δω τι **ἔπαθε** η σκρόφα.... **Κάνε υπομονή. Δωσ' μου δυο κόκκινα αυγά να της κρατώ να σκουντρήσουμε· ἔφτασα!** (B.Π. 240) – Zotni, - **tha** – po çap një vrap deri të fshat të shoh ç'ka bërë vaki...Mos u mërzit. **Më jep dy vezë të kuqe një për mua e një për atë. S'vonoj.** (Z. 216)

Aoristi i greqishtes si edhe e kryera e thjeshtë e shqipes mund të përdoret edhe me kuptimin e së ardhmes, shembulli (8). Folja *ἔφτασα* (*arrita*) në këtë rast përdoret në të njëjtën mënyrë me atë që në gjuhën shqipe përdoret folja *vij* në të kryerën e thjeshtë, *erdha*, duke e përdorur atë në vend të së ardhmes, p. sh.: *Sa të mbaroj dhe erdha*. Në këtë rast është përdorur një folje tjetër, folja *vonoj* në të tashmen e shoqëruar me pjesëzën mohuese *s'* për të dhënë të njëjtin kuptim.

Aoristi në greqishtes përdoret edhe në fjalë të urta, proverba shumë herë në vend të së tashmes: *Πήγε για μαλλί και βγήκε κουρεμένος, Πέρσι **εκάηκε** το φαί και φέτος βγήκ' η τσίκνα, Πέρσι **ψόφησε**, φέτος **βρόμησε***, etj. Kur aoristi ka këtë përdorim quhet në greqisht aoristi gnomik.

3.1.1.3.1. Aoristi i greqishtes i shoqëruar me pjesëza

a. *Θα* (do të) + aoristin

Pjesëza *θα* kur përdoret e shoqëruar nga aoristi i një foljeje nuk shërben më si një tregues i një kohe të së ardhmes. Kjo strukturë foljore në greqisht trajtohet si modalitet¹¹⁹, tregon se folësi beson se ekziston një mundësi e madhe që të jetë e vërtetë ajo për të cilën po flet. Pra, kjo strukturë foljore që nuk përbën një kohë gramatikore më vete në gjuhën greke, shpreh mundësinë që ekziston që ajo për të cilën bëhet fjalë të ketë ndodhur vërtet. Një strukturë foljore analoge nuk haset në gjuhën shqipe, jo vetëm me pjesëzën *do të* dhe të kryerën e thjeshtë në mënyrën dëftore, por edhe as si trajtë kohore e ndonjë mënyre tjetër të foljes.

Ky formim foljor i gjuhës greke jepet zakonisht në gjuhën shqipe me të ardhmen e përparme të mënyrës dëftore, duke qenë se kjo kohë përdoret për të shprehur kryesisht veprime të mundshme të së shkuarës¹²⁰, shembujt (1), (2).

- 1) *Θα πέρασε από δω σίγουρα, είπε ο Γιαννακός, κι άναψε τη λαμπάδα....*(X.Ξ. 159)
- *Do të ketë kaluar patjetër këtej- tha Janakua, - ai e ka ndezur llambadhen.....*
(K.K.P. 170)
- 2) - *Θα μάθε, είπε ο Γιαννακός, πως του αφήκε κι αυτουνού κληρονομιά, πάει τώρα στο σπίτι του καπετάνιου να πάρει το γύψινο αγαλματάκι της βασίλισσας της Αγγλίας να το φάει.* (X.Ξ. 156) – *Do të ketë marrë vesh, - tha Janakua, - që i la edhe atij një trashëgim, nxiton për në shtëpinë e kapedanit për të marrë atë bust të vogël prej allçie të mbretëreshës së Anglisë që ta kallurit.* (K.K.P. 166)

Në shembullin (2) folja *μαθαίνω* (mësoj) e greqishtes është dhënë me shprehjen foljore *marr vesh* në gjuhën shqipe, e cila ka kuptim sinonimik me të, por koha në të cilën është vendosur është e ardhmja e përparme. Ndërsa gjatë përkthimit të dy vargjeve të Kavafit: *Έτσι σοφός που έγινες με τόση πείρα,/ ήδη θα το κατάλαβες οι Ιθάκες τι σημαίνουν. (Ιθάκη, Καβάφης)* vëmë re se aoristi *κατάλαβες* i foljes *καταλαβαίνω* (kuptoj), të cilit i është paravendosur pjesëza *θα*, nga dy përkthyes të ndryshëm është dhënë në njërin rast: *Me kaq përvojë, i mençur si je bërë./tash do ta kesh kuptuar ç'kuptim paskan Itakat.* (K, A.S) me të ardhmen e përparme të foljes *kuptoj*, *do ta kesh kuptuar*, e cila tregon edhe hamendësim dhe është më afër origjinalit, dhe në rastin tjetër *U bërë kaq i ditur, kaq me përvojë, sepse tashmë e kuptove se çfarë janë Itakat.* (K, L.Z) me të kryerën e thjeshtë të kësaj foljeje, *kuptove*.

b. *Να* (të) + aoristin

Siç thamë edhe për kohën e pakryer pjesëza *να* (të) kur i paravendoset aoristit nuk formon një kohë gramatikore, por përbën një modalitet. Folja në aorist, së cilës i është paravendosur pjesëza *να*, tregon habi apo supozim dhe shpesh mund të përforcohet nga

¹¹⁹ Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπιμιώτης, *verp. e cit.*, 2004

¹²⁰ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995

shprehje të tilla si: *άραγε (vallë), λες (a thua)*¹²¹ etj. : *Λες να έφτασε;* - *Thua të këtë arritur?* Në gjuhën shqipe nuk përdoret një strukturë analoge, pjesëza *të* nuk mund të ndiqet nga një folje në të kryerën e thjeshtë. Ky modalitet i shprehur nga pjesëza *να* + aoristin e greqishtes në gjuhën shqipe jepet nëpërmjet të kryerës së lidhores.

Por ka raste kur folja në aorist së cilës i është paravendosur pjesëza *να*, në gjuhën shqipe përcillet nëpërmjet më se të kryerës së lidhores, shembulli (1) :

- 1) *Αυτό ήταν! Σα να 'δωκα, λες, το σενιάλο που περίμεναν.* (B.Π. 98) – *Kjo ishte. Si të kisha dhënë sinjalin.* (Z. 87)
- 2) *Ένα πρωί, σηκώθηκα, πλύθηκα: σα να σηκώθηκε και πλύθηκε ο κόσμος κι έλαμψε κατακαίνουριος....*(B.Π. 277) – *Një ditë u ngrita herët, u lava dhe më dukej se gjithë bota **qe ngritur** e po lahej me mua.* (Z. 251)

Në shembullin (2) pjesëza *σα* është dhënë me shprehjen *më dukej se*, ndërsa aoristi *σηκώθηκε* është dhënë me të kryerën e tejshkuar të foljes *ngrihem, qe ngritur*.

3.1.2. Kohët analitike të mënyrës dëftore të gjuhës shqipe dhe të gjuhës greke

Trajtat analitike foljore të formës veprare të mënyrës dëftore në shumicën e rasteve kanë të njëjtën strukturë në të dyja gjuhët, përveç rasteve kur disa kohë të shqipes nuk ekzistojnë në sistemin foljor të greqishtes, ose e kundërta. Kohët analitike të formës veprare, përveç së ardhmes, në gjuhën greke formohen nëpërmjet foljes ndihmëse *kam + trajtën paskajore të formës veprare*¹²², me të cilën i mëshohet më shumë veprimit¹²³, ose me foljen ndihmëse *kam + kallëzoren e pjesores pësore të së kryerës* përdorimi i së cilës i mëshon më shumë përfundimit të veprimit¹²⁴. Struktura e parë është edhe ajo që ka përdorimin më të gjerë. Ndërsa në gjuhën shqipe kjo kohë formohet nëpërmjet foljes ndihmëse *kam + pjesoren*. Formimi i kohës së kryer (dhe më se të kryer) analitike ndërtohet nëpërmjet foljes *kam* dhe pjesores së shkuar të foljes themelore është një dukuri e përbashkët, jo vetëm për gjuhët jo-sllave të Ballkanit, por haset edhe në maqedonishten perëndimore¹²⁵. Në greqishten e vjetër si e kryera ashtu edhe më se e kryera ishin kohë sintetike që formoheshin përkatësisht me sufiksën *-κα* dhe *-κειν*. Për sa i përket faktit nëse kjo formë është rezultat i zhvillimit të brendshëm të këtyre gjuhëve, apo ndikim i gjuhës romane ballkanike studiuesit kanë arritur në përfundime të ndryshme. Kështu Havranek¹²⁶ mendon se këto forma janë përfutur nën ndikimin e gjuhës romane, mendim i cili është mbështetur edhe nga Çabej e më vonë është pranuar edhe nga Domi dhe Ajeti¹²⁷. Malecki¹²⁸ mendon se kemi të bëjmë me një dukuri ballkanike të përfutur nën ndikimin e substratit, ndërsa Demiraj kundërshton këto dy mendime duke pohuar se forma analitike e së kryerës në gjuhën shqipe është një zhvillim i brendshëm i pavarur i kësaj gjuhe¹²⁹. Për sa i përket formës joveprare kohët e përbëra në greqisht formohen me foljen ndihmëse *kam + trajtën paskajore të formës joveprare*, ose me foljen ndihmëse *jam + emëroren e pjesores pësore ose mesore të së kryerës*. Përdorimi i formës së dytë të së kryerës me foljen ndihmëse *jam* është më i kufizuar dhe në shqip do t'i korrespondonte formës *jam i mësuar* dhe jo *jam mësuar* (είμαι μαθημένος). Këto dy struktura nga ana semantologjike janë të barazvlefshme, por përkthimi në këtë rast na ndihmon të kuptojmë se këto dy struktura gramatikore nuk janë sinonimike. Në gjuhën shqipe kohët e përbëra të formës joveprare formohen me foljen ndihmëse *jam + pjesoren*. Disa kohë të mënyrës dëftore si e ardhmja e së shkuarës, e ardhmja e përparme e së shkuarës dhe e kryera e tejshtuar nuk hasen si kohë të dëftores në gjuhën greke. Mungesa e së kryerës së tejshtuar në greqisht mund të përlligjet me faktin se foljet *kam* (έχω) dhe *jam* (είμαι) nuk e formojnë kohën e kryer të thjeshtë dhe as kohët e përbëra. Për të gjitha kohët e së

¹²² Për trajtën paskajore të greqishtes së re, e cila luan rolin e pjesores së gjuhës shqipe në formimin e kohëve analitike do të flasim më poshtë.

¹²³ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *vep. e cit.*, 1991, 277

¹²⁴ Po aty

¹²⁵ Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Tiranë 2004, fq. 167

¹²⁶ Cituar sipas Shaban Demiraj, *vep. e cit.*, 2002, fq. 347

¹²⁷ Cituar sipas Shaban Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

¹²⁸ Po aty

¹²⁹ Po aty

shkuarës përdoret forma e së pakryerës *είχα* dhe *ήμουν*. Në tabelat 3.11 dhe 3.12 paraqitet analogjia e kohëve analitike të zgjedhimit vepror dhe jovepror për gjuhën greke dhe atë shqipe.

ZGJEDHIMI VEPROR	
GJUHA GREKE	GJUHA SHQIPE
e ardhme e vazhduar (<i>θα γράφω</i> ¹³⁰)	e ardhme (<i>do të shkruaj</i>)
e ardhme e thjeshtë (<i>θα γράψω</i>) - ¹³¹	
e ardhme e përparme (<i>θα έχω γράψει</i>)	e ardhme e së shkuarës (<i>do të shkruaja</i>)
- ¹³²	e ardhme e përparme (<i>do të kem shkruar</i>)
e kryer (<i>έχω γράψει</i>)	e ardhmja e përparme e së shkuarës (<i>do të kisha shkruar</i>)
më se e kryer (<i>είχα γράψει</i>)	e kryer (<i>kam shkruar</i>)
-	më se e kryer (<i>kisha shkruar</i>)
-	e kryer e tejshkuar (<i>pata shkruar</i>)

Tabela 3.11

ZGJEDHIMI JOVEPROR	
GJUHA GREKE	GJUHA SHQIPE
e ardhme e vazhduar (<i>θα γράφομαι</i>)	e ardhme (<i>do të shkruhem</i>)
e ardhme e thjeshtë (<i>θα γραφτώ</i>)	
-	e ardhme e së shkuarës (<i>do të shkruhesha</i>)
e ardhme e përparme (<i>θα έχω γραφτεί</i>)	e ardhme e përparme (<i>do të jem shkruar</i>)
-	e ardhmja e përparme e së shkuarës (<i>do të isha shkruar</i>)
e kryer (<i>έχω γραφτεί</i>)	e kryer (<i>jam shkruar</i>)
më se e kryer (<i>είχα γραφτεί</i>)	më se e kryer (<i>isha shkruar</i>)
-	e kryer e tejshkuar (<i>qeshë shkruar</i>)

Tabela 3.12

¹³⁰ Koha e ardhme e thjeshtë dhe e ardhmja e vazhduar e greqishtes ndryshojnë vetëm nga ana aspektore dhe jo nga momenti në të cilin kryhet veprimi.

¹³¹ Ekziston si formë, por trajtohet si modalitet në gramatikën e sotme greke, Holton, Mackridge, Ειρήνη Φιλίππική-Warburton fq.208, Κλαίρης, Μπαμπινιώτης fq.436, 441

¹³² Edhe kjo formë ekziston në gjuhën greke, por trajtohet edhe ajo si modalitet.

3.1.2.1 Koha e kryer

a. Gjuha shqipe, ashtu si edhe greqishtja, por edhe gjuhë të tjera indoevropiane në një fazë më të hershme e kanë shprehur kuptimin e së kryerës me anë formash sintetike¹³³, gjurmë të së cilave hasim në shqipen e dokumentuar si *breth – brodha, vjel – vola*¹³⁴. Nuk mund të përcaktohet me saktësi nëse forma analitike e së kryerës është shfaqur paralelisht me mënjanimin gradual të së kryerës sintetike (perfektit) apo pas përzjerjes së saj me aoristin.¹³⁵

Ekzistojnë pikëpamje të ndryshme gjithashtu për faktin nëse është shfaqur më parë e kryera analitike e formës veprorë, me foljen ndihmëse *kam*, apo ajo e formës joveprorë, me foljen ndihmëse *jam*. Nëse pranojmë pikëpamjen e Havranekut¹³⁶, i cili mbështetet edhe nga Çabej¹³⁷ sipas së cilës format analitike të së kryerës janë krijuar nën ndikimin e rumanishtes ballkanike, së pari është shfaqur e kryera analitike e formës joveprorë. Nëse pranojmë pikëpamjen e Demirajt¹³⁸, i cili në të kundërt mendon se shfaqja e së kryerës analitike përbën zhvillim të brendshëm të pavarur të shqipes, së pari është formuar e kryera analitike e formës veprorë. E kryera e shqipes formohet nga e tashmja e foljes ndihmëse *kam*¹³⁹ për formën veprorë, dhe *jam*¹⁴⁰ për formën joveprorë plus *pjesoren* e foljes. Struktura e sotme e së kryerës së dëftores së shqipes mund të jepet kështu:

E kryera e shqipes		
Folje ndihmëse	Pjesore	
<i>kam</i>	<i>jam</i>	morfemë leksikore + morfemë gramatikore
		temë foljore (e së tashmes ose së kryerës së thjeshtë) + sufiks (-r(e) -un(ë), -ur(ë) -ë-në-m-të- m-un- n-unë(-r(e), -un(ë), -ur(ë)-ë), -në, -m, -të, - m-un)
		<i>mbjell-ë / ndenj-ur</i>

Tabela 3.13

Rendi i dy përbërësve të kësaj kohe është i ngulitur dhe ndërmjet tyre nuk mund të ndërfiten elementë të tjerë. Por mund të ndodhë që në gjuhën e folur për arsye stilistikore të përmbysset ky rend dhe të kemi struktura të tipit: *dëgjuar e kam*, por mbeten në kuadrin

¹³³ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1976, 96

¹³⁴ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002, 337

¹³⁵ Po aty

¹³⁶ Po aty

¹³⁷ E. Çabej, Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe, SF 1942/2

¹³⁸ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002, 347

¹³⁹ Në gjuhën e folur të gegërishtes veriore hasen edhe forma të së kryerës aktive me foljen ndihmëse *jam* dhe folje jokalmtare që tregojnë lëvizje: *a dalë zani*. Për më tepër shih A. Dodi, *Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe*, SF 1, 1968, fq.59-61

¹⁴⁰ Ndonjëherë e kryera pësore siç vëren Dodi formohet edhe duke i paravendosur një u së kryerës aktive. Kjo formë haset në gegërisht, por edhe në dialektin e çamërishtes: *po ne s'kemi shumë që u kemi pjekur*. (Qemal Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e Çamërisë*, DSH 2, Tiranë 1974)

e ligjërimit gojor dhe nuk janë shumë të shpeshta. Këtë përmbysje e hasim edhe te Buzuku¹⁴¹ si p.sh.: *folë kam, marrë kanë*, ku përsëri këto përdorime kanë ngjyrim stilistik. Mundet gjithashtu që ndërmjet pjesores e foljes ndihmëse në të folmet popullore të ndërfitet edhe ndonjë element tjetër si p.sh.: *folë nu' m'ke*¹⁴².

E kryera analitike e formës veprorë të shqipes në gjuhën greke jepet në mjaft raste me analogen e saj, pra me të kryerën e greqishtes, e cila si do të shohim edhe më poshtë edhe ajo nga formë sintetike është kthyer në formë analitike, shembujt (1), (2).

- 1) *Është e vërtetë, ka kaluar shumë kohë.* (Gj.U.V. 21) – *Πράγματι, έχει περάσει πολύς καιρός* (Σ.Ν.Σ 26).
- 2) *Keni dëgjuar për hakmarrjen e tyre?* (Gj.U.V. 36) – *Έχετε ακούσει για τις βεντέτες τους;* (Σ.Ν.Σ 44)
- 3) *Edhe gjithë ata të vrarë e kanë dëgjuar këtë gjuhë fatale, mendoi.* (Gj.U.V. 33) – *Και όλοι οι σκοτωμένοι άκουσαν κάποτε αυτή τη μοιραία γλώσσα, σκέφτηκε.* (Σ.Ν.Σ 40)
- 4) *Unë kam qenë ushtar dhe kam luftuar atje dy vjet rresht.* (Gj.U.V. 40) – *Ήμουνα φαντάρος και πολέμησα εκεί για δύο συνεχόμενα χρόνια.* (Σ.Ν.Σ 49)

Në disa raste e kryera e shqipes jepet me aoristin e greqishtes duke përforcuar mendimin se në një periudhë të caktuar, përpara shfaqjes të së kryerës analitike, aoristi me të kryerën sintetike (perfektin) janë përzier, shembujt (3), (4).

Në rastin kur në gjuhën shqipe përdoret e kryera e foljes *jam* në gjuhën greke përdoret e kryera e një foljeje me kuptim të përafërt me të në situatën konkrete, pra në vend të formës *keni qenë* përdoret forma *keni ardhur herë tjetër*, shembulli (5).

Mund të përdoret gjithashtu, për të dhënë këtë strukturë të shqipes, e pakryera e foljes *jam* (*είμαι – ήμουν*) pra *kam qenë – ήμουν* (*isha*), shembujt (6), (7).

- 5) *Nuk ju besohet, sepse nuk keni qenë ndonjëherë këtu.* (Gj.U.V. 22) – *Δεν μπορείτε να το πιστέψετε, γιατί δεν έχετε ξανάρθει ποτέ εδώ.* (Σ.Ν.Σ. 26)
- 6) *Asnjëherë nuk e gjente dot nëse kishte qenë më mirë apo më keq për të.* (Gj.U.V. 151) – *Ποτέ δεν κατάλαβε αν έτσι ήταν καλύτερα ή χειρότερα γι' αυτόν.* (Σ.Ν.Σ. 180)
- 7) *Gropat e përbashkëta kishin qenë tmerrri i gjeneralit.* (Gj.U.V. 180) – *Οι ενωμένοι λάκκοι ήταν ο τρόμος του στρατηγού.* (Σ.Ν.Σ. 212)

Formë analoge nuk ka gjuha greke edhe për strukturën *kam pasur*¹⁴³, duke qenë se në greqishten e re folja *kam* (*έχω*) nuk mund ta formojë paskajoren e greqishtes së sotme, e cila luan rolin e pjesores së shqipes në formimin e kohëve analitike. Në këtë rast kjo formë analitike kohore jepet me të pakryerën e foljes *kam*, ose *jam*, *kam pasur-είχα* (*kisha*), *ήμουν* (*isha*), shembujt (8), (9).

¹⁴¹ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

¹⁴² A. Dodi *Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe*, SF 1, 1968, fq.60

¹⁴³ Duke qenë se forma paskajore e greqishtes së sotme formohet nga tema e aoristit, edhe folje të tjera të cilat nuk mund ta formojnë aoristin, nuk mund të formojnë edhe kohët e kryera si p.sh.: foljet *ξέρω* (*di*), *ανήκω* (*përkas*), *χρωστώ* (*i detyrohem, kam borxh*), pra ne nuk mund ta formojnë në gjuhën greke formën *kam ditur*, por përdoret për të gjitha rastet e pakryera e foljes *ήξερα*.

- 8) *Shqiptarët gjithmonë kanë pasur dëshirë të të vrasin ose të vriten. (Gj.U.V. 36)- Οι Αλβανοί είχαν πάντα την επιθυμία να σκοτώνουν ή να σκοτώνονται. (Σ.Ν.Σ. 44)*
9) *Mos vallë e ke pasur mikun tënd? Me siguri e ke pasur mik, përderisa e kërkon ashtu. (Gj.U.V. 206) - Μήπως ήταν τίποτε φίλος σου; Σίγουρα ήταν φίλος σου για να τον ψάχνεις έτσι. (Σ.Ν.Σ. 243)*

Ndërsa e kryera e formës joveprore jepet ose me të kryerën e greqishtes e cila siç e theksuam edhe më sipër nuk formohet me foljen ndihmëse *jam*, por me foljen ndihmëse *kam*, shembulli (10). Në disa raste të tjera e kryera e joveprores jepet me aoristin e greqishtes. Pra siç e vërejmë ky transmetim i kohës së kryer nuk ndryshon shumë, pavarësisht nëse ajo është aktive apo pasive, shembujt (11), (12).

- 10) *Të duket sikur këtu s'është bërë luftë kurrë, - tha ai, -por vetëm kanë kullotur këto lopë të qeta ngjyrë kafe. (Gj.U.V. 21) – Φαίνεται σαν να μην έχει γίνει ποτέ πόλεμος εδώ, είπε, είναι σαν να βοσκούσαν πάντα αυτές οι ήσυχες καφετιές αγελάδες. (Σ.Ν.Σ. 26)*
11) *Asgjë s'merret vesh. Janë ngatërruar numrat e kuotave(Gj.U.V. 26). - Δεν μπορείς να καταλάβεις τίποτε. Μπερδεύτηκαν οι αριθμοί των υψωμάτων. (Σ.Ν.Σ. 31)*
12) *Jemi therur me njëri – tjetrin egërsisht, - vazhdoi gjenerali. (Gj.U.V. 35) - Αλληλοσφαχτήκαμε άγρια, συνέχισε ο στρατηγός. (Σ.Ν.Σ. 43)*

Ka raste kur kjo strukturë kohore jepet në gjuhën greke edhe me ndonjë formë tjetër kohore, si p.sh. koha e pakryer joveprore, shembulli (13). Por hasen edhe raste kur e kryera e shqipës jepet me strukturën: folja ndihmëse *jam* + *pjesoren pasive* të foljes, që është një strukturë alternative e së kryerës pasive të greqishtes, shembulli (14). Nëse do të bënim të kundërtën, do të jepnim këtë strukturë të greqishtes në shqip, për t'i qëndruar besnikë kësaj forme foljore do të thoshim *ishte i varrosur*, pra folje + mbiemër prejpjesor. Sigurisht që kuptimi, ashtu si edhe forma e këtyre dy strukturave: *ishte i varrosur* dhe *ishte varrosur* nuk është sinonimike, por në raste si ky i mësipërmi mund të zëvendësojnë njëra tjetrën, pa tjetërsuar nuancën kuptimore të shprehjes.

- 13) *Ata janë vrrarë me njëri tjetrin kur nuk kanë pasur me kë të luftojnë. (Gj.U.V. 36) – Σκοτώνονταν μεταξύ τους όταν δεν είχαν κανέναν άλλον να πολεμήσουν. (Σ.Ν.Σ. 44)*
14) *Kuvendi i fretërve, ku ishte varrosur ushtari i vetmuar, ndodhej në një kodrinë, atje ku rruga bigëzohej. (Gj.U.V. 152)- Το μοναστήρι, όπου ήταν θαμμένος ολομόναχος ο στρατιώτης, βρισκόταν πάνω σ'ένα λόφο, εκεί που χώριζε ο δρόμος. (Σ.Ν.Σ. 182)*

Në gjuhën e folur dhe rrallë edhe në gjuhën e shkruar ndeshen edhe forma të mbipërbëra të së kryerës si: *kam pasë larë*. Kjo formë së kryerës ka kuptim të ngjashëm me të së kryerës, por përdoret zakonisht për veprime të një të shkuare të largët¹⁴⁴.

¹⁴⁴ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

b. Koha e kryer e gjuhës së sotme greke ashtu si edhe ajo e gjuhës shqipe formohet nëpërmjet foljes ndihmëse *kam* (*έχω*), si për formën veprorë edhe për atë joveprorë. Ajo që ndryshon nga njëra formë te tjetra është forma paskajore¹⁴⁵ e foljes në greqishten e re, e cila luan rolin e pjesores së shqipes për sa i përket formimit të kohëve analitike dhe ka dy forma: formën aktive dhe atë pasive. Forma aktive formohet nga tema foljore e aoristit aktiv + sufiksin *-ει*, ndërsa forma pasive nga tema foljore e aoristit pasiv + sufiksin *-ει*.

E kryera e dëftores së greqishtes		
Folje ndihmëse	Formë paskajore e greqishtes së re	
<i>kam</i> (<i>έχω</i>)	morfemë leksikore + morfemë gramatikore	morfemë leksikore + morfemë gramatikore
	tema e aoristit aktiv	tema e aoristit pasiv
	+ -ει	+ -ει
	<i>διαβάσ-ει</i>	<i>διαβαστ-ει</i>

Tabela 3.14

Ekziston edhe një formë tjetër alternative e së kryerës ku në vend të trajtës paskajore përdoret kallëzorja e njëjësit të gjinisë asnjane të pjesores pasive të greqishtes së re. Siç e kemi përmendur edhe më sipër këto dy forma *έχω διαβάσει* (*kam lexuar*) – *έχω διαβασμένο* (*kam të lexuar*) nuk janë tërësisht të barazvlefshme. Me strukturën e parë theksohet veprimi, ndërsa me të dytën theksohet rezultati i veprimit¹⁴⁶. Për sa i përket formës joveprorë forma alternative e shprehjes të së kryerës është: *jam + pjesore pasive në emërORE*, gjinia dhe numri i së cilës përputhet me atë të kryefjalës.

Në greqishten e vjetër, ashtu si shumica e kohëve, e kryera shprehej në formë sintetike dhe përveç mbaresave në fillim të temës foljore ndodhte një dyzim i bashkëtingëllores fillestare të temës shoqëruar me zanoren *ε*: *λύω – λέλυκα*. Gjatë periudhës helenistike struktura *jam + pjesoren pësore të së kryerës* zëvendëson të kryerën sintetike¹⁴⁷. Struktura *kam + paskajore* haset që në periudhën helenistike, por është e barazvlefshme me të ardhmen dhe është mjaft e përdorur në tekstet kësaj periudhe që reflektojnë gjuhën e folur të kohës¹⁴⁸.

Ndryshe nga gjuha shqipe, në strukturën e kohës më se të kryer të greqishtes ndërmjet foljes ndihmëse dhe paskajores së greqishtes së re të foljes mund të ndërfiten elementë të tjerë gjuhësorë: *Είχαν πια φτάσει στο μαντρί, μπήκαν κανένας*. (X.Ξ. 158)

¹⁴⁵ Ky term përdoret si i tillë në gramatikën e gjuhës së re greke, por duke qenë se funksioni i kësaj gjymtyre nuk i përgjigjet asaj të paskajores shumë gjuhëtarë të huaj kanë përdorur terma të tjerë për ta përkufizuar si p.sh. Mackridge (1990:191) përdor termin *formant i perfektit* (*perfect formant*), Hesse(1980:13) përdor temin *pjesore e aoristit* (*aorist participle*).

¹⁴⁶ P. Mackridge, *vep. e cit.*, 1990, 192

¹⁴⁷ R. Browning, *vep. e cit.*, 1991, 51

¹⁴⁸ Po aty

Ndajfolja *πια* (*tashmë*) në këtë rast është futur ndërmjet foljes ndihmëse *είχαν* (*kishin*) dhe paskajores së greqishtes së re, ndërsa në gjuhën shqipe këtë strukturë do ta jepnim: *kishin arritur tashmë*, ose *tashmë kishin arritur* duke ia paravendosur ose prapavendosur ndajfoljen strukturës foljore të më se të kryerës. Por mund të zgjidhet edhe një mënyrë alternative për ta përcjellë: *Tani **ishin** mu përpara vathës, hynë brenda dhe s'gjetën njeri*. (K.K.P. 169)

E kryera e dëftores së gjuhës greke si në formën veprorë dhe atë joveprorë mund të jepet në gjuhën shqipe me analogen e saj, pra të kryerën, shembujt (1), (2).

- 1) *Έρχεται στο νου μου ένα ινδιάνικο ανάγλυφο, από σκούρα γκρίζα πέτρα: ο άντρας έχει ρίξει τα μπράτσα του γύρω από τη γυναίκα και σμίγει μαζί της με τόση απαλάδα κι εγκαρτέρηση, που θαρρείς, έτσι που ο καιρός έχει αγγείψει και φάει σχεδόν τα κορμιά, πως βλέπεις δυο έντομα που έσμιζαν κι άρχισε η ψιλή βροχή.....*(B.Π. 101) – *Më bëhet në sy një reliev indian në një gurrë murrash: një burrë i ka **hedhur** krahët një gruaje dhe të dy bashkohen me njëri tjetrin kaq thjeshtë e kaq përjetësisht saqë të duket se koha u ka **brejtur** dhe **ngrënë** trupin e tyre.* (Z. 89)
- 2) *Ο κ. Βενιάμης, σχολιάζοντας τις δηλώσεις της κυρίας Κατσέλη στο Λονδίνο.....υπογράμμισε ότι «ουδέποτε έχει γίνει τέτοια συζήτηση».* (Το Βήμα 27/11/2009) – *Z. Veniamis, duke komentuar deklaratat e zonjës Kaceli..... nënvizoi se “kurrë nuk është bërë një diskutim i tillë”.*

Në rastet kur e kryera e greqishtes shfaqet me formën saj alternative në gjuhën shqipe mund të jepet me të kryerën ose me foljen *kam* + mbiemër prejprjesor, shembujt (3), (4).

- 3) *....Πολλοί πιστεύουν στην Παράδεισο κι έχουν δεμένο το γάιδαρό τους· εγώ δεν έχω γάιδαρο, είμαι λεύτερος και δε φοβάμαι την Κόλαση....* (B.Π. 155) - *Shumë i besojnë parajsës dhe e **kanë lidhur** gomarin, unë s'kam gomar, jam i lirë e si trembem Ferrit.* (Z. 138)
- 4) *Ο πανικός που θα κυριεύει το ζο που βόσκει ανέγνοιο, και μονομιάς, χωρίς να δει τίποτα, ψυχανεμίζεται ολόγυρά του πως είναι **μπλοκαρισμένο** και δε γλυτώνει.* (B.Π. 101) – *Paniku që mbërtheu një gjallesë, e cila kullot e qetë dhe në çast, pa parë kënd, nuhat përreth se **qenka e bllokuar**.* (Z. 89)

Siç do të shohim edhe në vazhdim gjuha greke nuk e ka mënyrën habitore, përkthyesi duke u nisur nga ana kuptimore e fjalisë, në shembullin (4) e ka vendosur foljen *jam* në habitore.

3.1.2.2. Koha më se e kryer

a. Në gjuhën shqipe kjo kohë formohet prej së pakryerës së foljes ndihmëse *kam*, *kisha* + pjesore. Fillimisht është shfaqur e kryera analitike dhe më pas më se e kryera si formë relative e së shkuarës së tipit *kam larë*¹⁴⁹. Është e vështirë të thuhet me siguri nëse ka ekzistuar apo jo një formë sintetike për më se të kryerën, ashtu si te latinishtja apo te greqishtja e vjetër, por ajo që mund të themi është që nëse për të kryerën kemi ende në gjuhën shqipe gjurmë të së kryerës sintetike, gjurmë të një më se të kryere sintetike nuk janë ndeshur.¹⁵⁰

Skema e strukturës së kësaj kohe nuk paraqet siç thamë edhe më sipër ndryshime të mëdha nga e kryera:

Më se e kryera e shqipes			
Folje ndihmëse		Pjesore	
<i>kisha</i>	<i>isha</i>	morfemë leksikore + morfemë gramatikore	
		temë foljore (<i>e së tashmes ose së kryerës së thjeshtë</i>) + sufiks (<i>-r(e) -un(ë), -ur(ë) -ë-në-m-të- m-un- n-unë(-r(e), -un(ë), -ur(ë)-ë), -në, -m, -të, - m-un)</i>)	
		<i>mbjell-ë / ndenj-ur</i>	

Tabela 3.15

Ashtu si edhe e kryera edhe më se e kryera ka edhe një formë të dytë që formohet duke i pararendosur pjesores formën e më se të kryerës së foljes *kam*: *kisha pasë larë*. Kjo formë ndeshet më shumë në të folmet e Shqipërisë Veriore, ndërsa në shqipen letrare haset me rrallë. Në shumicën e rasteve koha më se e kryer e shqipes jepet me më se të kryerën e greqishtes, shembujt (1), (2).

- 1) *Vetëm njerëzit që kishin dalë t'i prisnin, po vinin grumbull drejt aeroplanit.* (Gj.U.V. 15) – *Μόνο αυτοί που είχαν βγει να τους περιμένουν, έρχονταν ομαδικά προς το μέρος του αεροπλάνου.* (Σ.Ν.Σ. 17)
- 2) *Ai donte t'i fliste priftit, sepse heshitja e kishte mërziur, por nuk dinte ç't'i thoshte.* (Gj.U.V. 16) - *Ήθελε να μιλήσει στον ιερέα, γιατί η σιωπή τον είχε στεναχωρήσει, αλλά δεν ήξερε τι να του πει.* (Σ.Ν.Σ. 19)

Në disa raste më se e kryera e shqipes jepet gjithashtu në greqisht me forma të tjera kohore të së shkuarës si p.sh. me aoristin apo të pakryerën, shembujt (3), (4).

¹⁴⁹ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

¹⁵⁰ Po aty

- 3) *Gjenerali i kishite ngulur sytë grumbullit të plisave që sa vinte rritej në këmbët e punëtorit*(Gj.U.V. 19).- *Ο στρατηγός κάρφωσε το βλέμμα στο σωρό από σβώλους που όσο πήγαινε και μεγάλωνε στα πόδια του εργάτη.* (Σ.Ν.Σ. 23)
- 4) *Për një kohë të gjatë, nga dritarëza e aeroplanit, kishite vështruar pamjen kërcënuese të maleve.* (Gj.U.V. 13) - *Για αρκετό διάστημα, απ'το παραθυράκι του αεροπλάνου παρατηρούσε την απειλητική θέα των βουνών.* (Σ.Ν.Σ. 16)

Ka raste kur më se e kryera jepet me foljen *mund + lidhoren e foljes*, ndërsa në rastin kur foljet *kam* dhe *jam* në gjuhën shqipe janë në më se të kryerën, të cilën në greqisht këto folje nuk mund ta formojnë, jepen ose me të pakryerën e këtyre foljeve ose me më se të kryerën e një foljeje me kuptim të përafërt me to, shembujt (5), (6).

- 5) *Nuk e kishin kuptuar asnjëherë arsyen e këmbënguljes së vendasve, gjersa kishin qenë të detyruar të lëshonin pe.* (Gj.U.V. 30)- *Δεν μπορούσαν να καταλάβουν καθόλου το λόγο της άρνησης των ντόπιων που κανονικά ήταν υποχρεωμένοι να τους αφήσουν.* (Σ.Ν.Σ. 37)
- 6) *Vërtet, t'i ketë pëlqyer prifti asaj apo..... Në qoftë se vërtet midis tyre kishite pasur ndonjë gjë.....*(Gj.U.V. 33)- *Αλήθεια να της άρεσε της χήρας ο ιερέας ήΣε περίπτωση που πράγματι είχε συμβεί κάτι μεταξύ τους.....* (Σ.Ν.Σ. 40)

Më se e kryera e joveprores së shqipes jepet ose me më se të kryerën e greqishtes, por me foljen ndihmëse *kisha*, ose me foljen *jam në të pakryerën + një mbiemër prejpsesor*, ose thjesht me të pakryerën, shembujt (7), (8).

- 7) *Të tjerët ishin afruar rrotull tij.* (Gj.U.V. 22) *Οι άλλοι είχαν πλησιάσει γύρω – γύρω.* (Σ.Ν.Σ. 26)
- 8) *Sepse atje pranë me këmbë të varura në një hulli me ujë, ishte shtrirë përmbys shoku im më i ngushtë.* (Gj.U.V. 22) *Γιατί εκεί κοντά ήταν πεσμένος μπρούμυτα, με τα πόδια κρεμασμένα σ'ένα αυλάκι, ο καλύτερός μου φίλος.* (Σ.Ν.Σ. 27)

b. Më se e kryera e greqishtes

Ashtu si e kryera, edhe më se e kryera e greqishtes fillimisht ka qenë kohë sintetike. Struktura *kisha + paskajoren e aoristit* haset për herë të parë me kuptimin e më se të kryerës në tekste të periudhës së mesjetës.¹⁵¹ Kjo strukturë kristalizohet përfundimisht në shekullin e shtatëmbëdhjetë, dhe ndryshe nga supozimi se në gjuhën shqipe më se e kryera formohet sipas gjedhes të së kryerës, në gjuhën greke e kryera analitike (të dyja variantet e saj) formohen sipas modelit të më se të kryerës¹⁵². Skematikisht më se të kryerën e greqishtes do ta paraqisnim:

¹⁵¹ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

¹⁵² R. Browning, *vep. e cit.*, 1991

Më se e kryera e greqishtes		
Folje ndihmëse	Formë paskajore e greqishtes së re	
kisha (είχα)	morfemë leksikore + morfemë gramatikore	morfemë leksikore + morfemë gramatikore
	tema e aoristit aktiv + -ει	tema e aoristit pasiv + -ει
	διαβάσ-ει	διαβαστ-ει

Tabela 3.16

Ashtu si e kryera edhe më se e kryera e greqishtes formohet edhe në një mënyrë alternative, e cila nuk është aq e përdorur sa forma parësore. Për formën veprorë kjo strukturë alternative është e *pakryera e foljes kam* (είχα)+ *pjesoren pasive të së kryerës* (είχα διαβασμένο), ndërsa për formën joveprorë: e *pakryera e foljes jam* (ήμουν) + *pjesoren pasive të së kryerës* (ήμουν διαβασμένος)

Më se e kryera e greqishtes në të shumtën e rasteve përcillet në gjuhën shqipe nëpërmjet më se të kryerës së shqipes duke qenë se si struktura ashtu edhe kuptimi i tyre janë analogë, shembulli (1). Ka raste kur më se kryera e greqishtes jepet me të kryerën e tejskuar të shqipes, formë foljore e cila nuk mund të formohet në gjuhën greke pasi siç e kemi përmendur foljet *kam* dhe *jam* nuk e formojnë aoristin dhe asnjë kohë analitike, shembulli (2). Ndonëse zakonisht e kryera është koha e cila mund të përdoret në vend të aoristit (të kryerës së thjeshtë) ka raste kur edhe më se e kryera e greqishtes mund të jepet me të kryerën e thjeshtë të shqipes, shembulli (3).

- 1)**Είχε κοιμηθεί** στο κατάστρωμα, και τα γκριζα κατσαρά μαλλιά του έσταζαν δροσούλα. Όλες οι βαθιές ζάρες στα μάγουλά του, στο πιγούνι και στο λαιμό φωτίστηκαν ως το βυθό, τώρα που **είχε πέσει** πάνω τους ο ήλιος. (B.Π. 31)- **Kishte fjetur** në bash dhe flokët e tij të bardha krela-krela kishin vënë vesë. Brazdat e faqeve, të mjekrës, të qafës u praruan nga dielli që u **kishte rënë**. (Z. 27)
- 2) Να ξαναζήσω πάλι το θυμό που με **είχε κυριέψει** τότε, όχι το θυμό, την ντροπή, όταν μ'έκραζε ο φίλος μου «χαρτοπόντικα». (B.Π. 20)- Doja si e si të jetoja edhe një herë zemëratën që më **pat sunduar** asokohe; jo zemëratën, por turpin tek më thirrte "mi letrash" (Z. 16).
- 3) Έστησα το αντί- μιλούσε για τα τελώνια που **είχαν πιάσει** κι άγλειφαν, μέσα στη φουρτούνα, τα κατάρτια του караβιού του. (B.Π. 21) Ngrita veshët: fliste për ca lugetër që ia kishin behur befaz në anije e **zunë** të lëpinin direktë ndërsa stuhia shfrynte e shfrynte. (Z. 17)
- 4) **Είχα πολύ χαρεί** στο γιαλό τούτον, η ζωή με το Ζορμπά **είχε πλατόνει** την καρδιά μου και μερικά του λόγια **είχαν γαληνέψει** το νου μου, δίνοντας απλότατη λύση σε πολύπλοκες μέσα μου έννοιες. (B.Π. 297)- **Kisha gëzuar shumë** këtij bregdeti. Jeta me Zorban, më **kish zgjeruar** mushkëritë, ca fjalë të tij më **kishin qëruar** mendjen duke u dhënë përgjigje të thjeshta problemeve fort të ndërlikuara. (Z. 270)

- 5) Το φεγγάρι δεν **είχε** ακόμα **βγει**, το μοναστήρι ήταν κατάμαυρο, σαν την κόλαση.
(B.Π. 181) – Hëna s'kishte **dalë** ende, manastiri nxinte si ferr. (Z. 254)

Struktura e kohëve analitike është mjaft kompakte dhe zakonisht nuk pranon gjymtyrë të tjera brenda saj, ka raste kur në gjuhën greke ndërfitet ndajfolja *shumë* (πολύ), shembulli (4), ku në gjuhën shqipe kjo ndajfolje vendoset pas strukturës foljore. Mund të ndërfitet në këtë strukturë edhe ndajfolja *ακόμα*, shembulli (5). Edhe në këtë rast në gjuhën shqipe ndajfolja *ende* i prapavendoset foljes në më se të kryerën.

Në rastin e më se të kryerës pasive përkthimi i saj nga gjuha greke në atë shqipe realizohet si edhe te më se e kryera aktive nëpërmjet analoges së saj, shembulli (6). Por ka raste kur mund të realizohet edhe nëpërmjet të kryerës së tejshkuar joveprore të shqipes duke ndryshuar gjithashtu edhe formën, shembujt (7), (8).

- 6) Το βουναλάκι του λιγνίτη **ήταν** **πλανταγμένο** στην καταχνιά. (B.Π. 106)-
Rrafshulëta e linjtit **ishte** **kredhur** në muzg. (Z. 94)
- 7) Έκανε όζω κρύο και τα τζάμια **είχαν** **παχιστεί** από τις ανάσες. (B.Π. 15)- Athimë,
xhamat **qenë** **veshur** me avull nga fryma e afshët e klientëve. (Z. 10)
- 8) Μπήκε που λέτε η θάλασσα στο καράβι, μουσκεύτηκαν τα κάρβουνα που **ήμουν**
φορτωμένος. (B.Π. 21) – Që ta ngas muhabetin , deti vërshoi nëpër anije, u njom
qymyri që **pata** **ngarkuar**, u rëndua. (Z. 17)
- 9) **Ήμουν** **ξαπλωμένος** στο κρεβάτι στο ίδιο ξενοδοχείο που είχαμε τότε μείνει.
(B.Π. 311)- **Rrija** **shtrirë** në krevat në po atë hotel që kishim bujtur dikur të tre.
(Z. 283)

Ndeshen edhe raste kur gjatë përkthimit të më se të kryerës nga greqishtja në shqip, folja ndihmëse *kisha* e shqipes të zëvendësohet nga e pakryera e një foljeje me kuptim sinonimik me të, shembulli (9), ku shprehja *ήμουν ξαπλωμένος* (*isha i shtrirë*) jepet me shprehjen *rrija shtrirë* në të pakryerën.

3.1.2.3. Koha e kryer e tejskUAR

E kryera e tejskUAR në gjuhën shqipe formohet nga e kryera e thjeshtë e foljes kam/jam *pata/qeshë* + *pjesoren*. Nëse do ta paraqisnim këtë kohë në mënyrë skematike, atëherë ajo do të ishte jo shumë e ndryshme nga kohët e tjera analitike, përveç foljes ndihmëse e cila gjendet në të kryerën e thjeshtë.

E kryera e tejskUAR e shqipes			
Folje ndihmëse		Pjesore	
pata	qeshë	morfemë leksikore + morfemë gramatikore	
		temë foljore (e së tashmes ose së kryerës së thjeshtë) + sufiks (-r(e) -un(ë), -ur(ë) -ë-në-m-të- m-un- n-unë(-r(e), -un(ë), -ur(ë)-ë), -në, -m, -të, - m-un)	
		mbjell-ë / ndenj-ur	

Tabela 3.17

Për sa i përket kuptimit kjo kohë është sinonime me më se të kryerën, por më se e kryera përdoret shumë më dendur¹⁵³. Fatmir Agalliu¹⁵⁴ thotë se këto dy kohë mund të vështrohen edhe si dy variante të një trajte kohore të vetme. Sipas Kostallarit¹⁵⁵ nga kohët e shkuara të dëftores, sot në gjuhën letrare përdoren realisht vetëm e pakryera (*punoja*), e kryera e thjeshtë (*punova*), e kryera (*kam punuar*) dhe e kryera e plotë (*kisha punuar*), e mjaft rrallë e kryera e tejskUAR (*pata punuar*), ndërsa *pata pasë punuar* dhe *kisha pasë punuar* pothuajse nuk përdoren fare. Por pavarësisht përdorimit të kufizuar paraqet interes të shohim se si përcillet kjo kohë në gjuhën greke për faktin se e kryera e tejskUAR nuk ekziston si kohë gramatikore foljore në greqisht. Kur lind nevoja për ta dhënë këtë kohë të shqipes në greqisht, atëherë mund të përdoret më se e kryera, shembulli (1).

- 1) *Pra, edhe kjo mbrëmje, ndonëse një mbrëmje me dasmë, do të kishte shkUAR si çdo mbrëmje tjetër, sikur gjenerali t'i kishte menduar të gjitha këto dhe pastaj të dëgjonte ç'rrëfente prifti rreth kolonelit Z., si kishte shkUAR në klub dhe qe ulur në tryezë me ca fshatarë, ç'i kishin treguar vendësit për zhdukjen e koloneli, dhe se si ai dyshonte për gjithçka. (Gj.U.V. 195) – Έτσι λοιπόν κι αυτή η βραδιά, αν και βραδιά γάμου, θα περνούσε όπως κι όλες οι άλλες, αν ο αρχηγός αφού είχε κάνει αυτές τις σκέψεις δεν άκουγε τον ιερέα να διηγείται για το συνταγματάρχη Ζ.: πως είχε πάει στη λέσχη και είχε καθίσει μαζί με μερικούς χωριάτες, πως του είχανε πει*

¹⁵³ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

¹⁵⁴ F. Agalliu, Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore, SF 2, 1968

¹⁵⁵ A. Kostallari, Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare, SF 2, 1982

για την εξαφάνιση του συνταγματάρχη, και πως ο ίδιος αμφέβαλλε για όλα αυτά.
(Σ.Ν.Σ. 230)

E kryera e tejshtuar e shqipes në greqisht mund të jepet edhe me kohë sintetike të së shkuarës së greqishtes, me aoristin ose të pakryerën, shembujt (2), (3).

2) *Pastaj të zbriturit kishin vështruar me shpërfillje kryqëzorët që nxinin me topat gjigandë të drejtuar nga bregu, aeroplanët që fluturonin ultas, barkat e zbarkimit, dhe fill pas kësaj, pa e bërë të gjatë, kishin rënë në përprjekje, ashtu siç e lypnin doket, dhe **qenë vrarë** njëri pas tjetrit kush më përpara, kush më pas.* (Gj.U.V. 157) - *Μετά κοίταζαν αδιάφορα τα καταδρομικά που ξεχώριζαν με τα γιγάντια κανόνια τους στραμμένα στην ακτή, τα αεροπλάνα που πετούσαν χαμηλά, τα αποβατικά σκάφη. Και χωρίς να αργοπορούν ρίχτηκαν στη μάχη, όπως υπαγόρευαν τα ήθη τους, και **σκοτώθηκαν** ο ένας μετά τον άλλο, ποιος πριν, ποιος μετά.* (Σ.Ν.Σ. 187)

3) *Dy nga varrmihësit pinin cigare, i treti thithte llullën, kurse më i riu **qe mbështetur** mbi bishtin e veglës dhe shikonte me një vështrim të menduar.* (Gj.U.V. 19) - *Δύο απ'τους νεκροθάφτες κάπνιζαν τσιγάρο, ο τρίτος ρούφαγε τον καπνό απ'το τσιμπούκι του, ενώ ο νεότερος **στηριζόταν** στο στείλιάρι του φτυαριού και κοίταζε σκεπτικός.* (Σ.Ν.Σ. 23)

Ka raste kur e kryera e tejshtuar e mënyrës joveprore të shqipes në greqisht jepet me foljen ndihmëse *jam në të pakryerën (ήμουν) + pjesoren pasive*, pra një formë alternative të më se të kryerës, shembulli (4).

4) *Ndërsa në një pllakë guri **qenë gdhendur** fjalët: “Këta ushtarë të huaj ranë heroikisht krahas partizanëve shqiptarë në përprjekje me forcat e Batalionit Blu më 17 mars 1943”. (Gj.U.V. 50) - Ενώ σε μια πέτρινη πλάκα **ήταν σκαλισμένες** οι λέξεις: «Εδώ ζένοι στρατιώτες έπεσαν ηρωικά στο πλευρό των αλβανών ανταρτών σε συμπλοκή με τις δυνάμεις του Τάγματος των Μελανοχιτώνων στις 17 Μάρτη 1943».*(Σ.Ν.Σ. 61)

3.1.2.4. Koha e ardhme

Struktura e së ardhmes, e sidomos mënyra e formimit të saj është një nga fenomenet që ka ngjallur interesin e mjaft gjuhëtarëve, të cilët janë përpjekur që ta analizojnë. Fillimisht duhet thënë se koha e ardhme si në shqip ashtu edhe në greqisht është një formë foljore që shërben për të shprehur qartë kuptimin kohor të së ardhmes.

Në gjuhën shqipe kuptimi kohor i së ardhmes shprehet nëpërmjet dy tipave formash analitike: Tipi i parë formohet nga pjesëza foljore *do* dhe nga e tashmja e lidhore e pajisur ose jo me pjesëzën *të*¹⁵⁶. Tipi i dytë, i cili përdoret shumë më pak se i pari, formohet nga folja *kam* + *paskajoren* (e tipit *me lexu* dhe *për të lexuar*) dhe *kam* + *tashmen e lidhore*. Ndërtimi *kam* + *paskajore* haset që te autorët e vjetër Buzuku, Bogdani e Budi, madje përdoren në një masë relativisht të madhe që në librin e parë shqip¹⁵⁷, ndërsa ndërtimet perifrastike të së ardhmes *kam* + *lidhore*, strukturë e cila siç do ta shohim edhe më poshtë përdoret edhe në gjuhën greke, hasen më shumë në të folmet e arbëreshëve të Italisë dhe në ndonjë të folme të Shqipërisë jugore¹⁵⁸. Tipi me pjesëzën e ngurosur “*do*”, sipas Demirajt¹⁵⁹, në krye të herës do të jetë përdorur me kuptimin modal të dëshirueshmërisë, ndërsa ai me foljen ndihmëse “*kam*” do të jetë përdorur në fillim me kuptimin modal të domosdoshmërisë. Me kalimin e kohës, madje qysh në periudhën parashkrimore të shqipes, të dy këta tipa të së ardhmes i kishin humbur dalëngadalë ngjyrimet modale shoqëruese, duke u përdorur kështu si forma thjesht kohore të së ardhmes.

Për sa i përket tipit të parë, i cili është edhe më i përdorshëm, pjesëza *do* për nga origjina, sipas shumë gjuhëtarëve është forma e vetës së tretë njëjës së foljes *dua*¹⁶⁰. Tipi i kohës së ardhme të formuar me ndihmën e foljes “*dua*”, e cila zakonisht është e gramatikalizuar dhe ndiqet nga folja themelore kryesisht në formën e kohës së tashme të mënyrës lidhore haset pothuajse në të gjitha gjuhët ballkanike: P.sh. shqip *do të bëj*, greqisht *θα κάνω*, rumanisht *o să fac*, bullgarisht *shte pravja*, maqedonisht *qe pravam*¹⁶¹. Disa gjuhëtarë me në krye Sandfildin¹⁶² duke u mbështetur në vjetërsinë e këtij tipi të së ardhmes në greqishte mbrojnë mendimin se tipi i së ardhmes së formuar me anë të foljes ndihmëse “*dua*” në gjuhët ballkanike është zhvilluar nën ndikimin e greqishtes, ndërsa Wiegand-i¹⁶³ e kërkon burimin e këtij tipi të së ardhmes në këto gjuhë tek e ashtuquajtura trako-shqipe. Për tezën e Sandfeldit ka pasur kritika ose rezerva, kurse teza e Wiegand-it në përgjithësi nuk është mbështetur. Demiraj¹⁶⁴ është i mendimit se të dy tipat e së ardhmes janë zhvillime të brendshme të gjuhës shqipe.

¹⁵⁶ Sh. Demiraj, *Rreth formimit të së ardhmes në gjuhën shqipe*, SF 3, 1970

¹⁵⁷ S. Mansaku, *Ndërtimet me foljen ndihmëse kam + paskajore te autorët e vjetër*, SF 2, 1980

¹⁵⁸ Po aty

¹⁵⁹ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2004

¹⁶⁰ Demiraj nuk përjashton mundësinë që do të jetë forma e vetës së dytë njëjës, Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, SF 3, 1970

¹⁶¹ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2004

¹⁶² Po aty

¹⁶³ Po aty

¹⁶⁴ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

E ardhmja e shqipes			
Pjesëz	Formë foljore e së tashmes së lidhore		
<i>do</i>	<i>të</i>	temë folore e së tashmes së dëftores	mbaresat e së tashmes së lidhore
<i>do</i>	<i>të</i>	<i>lexo -j/-sh/-jë/-jmë/-ni/-jnë</i>	

Tabela 3.18

Vitet e fundit pjesëza *të* tenton të mos përdoret në këtë strukturë të së ardhmes së shqipes dhe këtë e vërejmë përveç gjuhës së folur edhe në shtypin e shkruar, mjafton të citojmë disa tituj artikujsh: **Do ndërtojmë 8 shkolla të reja në Afganistan** (Gazeta “Shekulli”, 12/8/2009), **Do rishikojmë hartën e vlerës së tokës** (Gazeta “Shekulli”, 15/10/2009), **Do vdes bashkë me djalin invalid, brenda shtëpisë**, (Gazeta Shekulli, 4/02/2007), **Provime me zgjedhje, edhe për ata që do studiojnë jashtë**, (Gazeta “Shekulli”, 24 /3/ 2007), **Taksat, ja sa do paguajmë në 2008** (Gazeta “Shekulli”, 16 /10/2007 2007 apo edhe pjesë të tyre: **Të liruarit do hetohen në Prokurorinë e Tiranës për 9 vjedhjet e grupit, ndërsa kërkohen disa të tjerë të dyshuar**. (Gazeta “Shekulli” 14/12/2009), duke e sjellë këtë strukturë akoma më afër asaj të greqishtes ku është zhdukur pjesëza e lidhore *va* dhe e ardhmja formohet nga pjesëza *θα*, e cila vjen nga folja *θέλω (dua)*, dhe folja themelore.

E ardhmja e gjuhës shqipe jepet me të ardhmen e greqishtes, por pika ku haset vështirësia është nëse do të përdoret në greqisht e ardhmja e thjeshtë (e momentit) apo e ardhmja e vazhduar. Në shumicën e rasteve foljet në të ardhmen, si në formën veprare edhe në joveprare, jepen në greqisht me të ardhmen e thjeshtë, shembujt (1), (2), (3), por edhe me të ardhmen e vazhduar, shembulli (4). Në rastet kur folja shoqërohet nga rrethana kohe që tregojnë vazhdimësi apo përsëritje të veprimit atëherë në greqisht përdoret e ardhmja e vazhduar.

- 1) *Këta të pestë do të nxjerrin nga varri një ushtri të tërë.* (Gj.U.V. 20) - *Αυτοί οι πέντε άνθρωποι θα ξεθάψουν έναν ολόκληρο στρατό.* (Σ.Ν.Σ. 24)
- 2) *Pastaj kini parasysh se kooperativistët do të paguhen rregullisht.* (Gj.U.V. 52) - *Κι έπειτα έχετε υπ' όψη σας πως οι εργάτες θα πληρωθούν κανονικά.* (Σ.Ν.Σ. 64)
- 3) – *Dhe ja, ta zemë se do të na i kërkojnë.* (Gj.U.V. 24) – *Αλλά, εντάξει, ας υποθέσουμε πως θα τα ψάξουν.* (Σ.Ν.Σ. 29)
- 4) *Dhe do të jetë përherë ashtu, si ajo bujtina në anë të udhës.* (Gj.U.V. 183) - *Και θα είναι πάντα έτσι, σαν τα φτηνά ξενοδοχεία στην άκρη του δρόμου.* (Σ.Ν.Σ. 215)

Siç përmendëm edhe më sipër një nga format e së ardhmes është edhe ajo e formuar nga folja *kam* + formën paskajore dhe në këtë rast në gjuhën greke jepet nëpërmjet formës *kam* + *lidhore*, shembulli (5).

5) *Keni për të parë edhe më. (Gj.U.V. 233) – Έχετε να δείτε πολλά ακόμη. (Σ.Ν.Σ. 274)*

Në gjuhën e lashtë greke koha e ardhme formohej në mënyrë sintetike. Mbaresat e kohës së ardhme të formës veprorë e mesore ishin të njëjta me ato të së tashmes vetëm se temës së foljes i shtohej bashkëtingëllojta σ : ($\lambda\acute{o}-\omega$) $\lambda\acute{o}-\sigma-\omega$, ($\lambda\acute{o}-\omicron\mu\alpha\iota$) $\lambda\acute{o}-\sigma-\omicron\mu\alpha\iota$, $\lambda\epsilon\lambda\acute{o}-\sigma-\omicron\mu\alpha\iota$ e cila quhej *karakter kohor*, ndërsa mënyra joveprorë formohej duke i shtuar rrokjen $\theta\eta$ e më pas bashkëtingëlloren σ përpara mbaresës: ($\lambda\acute{o}-\omicron\mu\alpha\iota$ - $\lambda\nu-\theta\eta-\sigma-\omicron\mu\alpha\iota$).

Në greqishten e re e ardhmja formohet nga pjesëza $\theta\alpha$ + *folja në lidhore*. Fillimet e formimit të saj kjo formë foljore i ka në periudhën helenistike ku përdorej struktura $\theta\acute{\epsilon}\lambda\omega$ + *paskajore* përdorej si barazvlerëse e së ardhmes edhe pse fillimisht i jepte foljes ngjyrimin kuptimor të dëshirueshmërisë, në kundërvënje me atë të domosdoshmërisë¹⁶⁵. Kjo strukturë zëvendësohet me vonë me formën $\theta\acute{\epsilon}\lambda\omega$ *va* + *lidhore*, formë analitike e cila u transformua më tej. Në vend të foljes volitive $\theta\acute{\epsilon}\lambda\omega$ me kalimin e kohës përdoret trajta e shkurtuar e saj $\theta\epsilon$, e në vazhdim bashkohet me pjesëzën *va*, $\theta\epsilon$ *va*¹⁶⁶, duke arritur kështu në tipin përfundimtar $\theta\alpha$, produkt i gramatikalizimit të foljes $\theta\acute{\epsilon}\lambda\omega$ dhe pjesëzës së lidhores *va*, p.sh. $\theta\alpha$ *γράφω* /*γράφω* - “do të shkruaj”. Edhe në gjuhën greke përdoret struktura kam + lidhore si barazvlerës i së ardhmes, strukturë që është evolim i strukturës $\acute{\epsilon}\chi\omega$ (*kam*) + *paskajore*, e cila në periudhën helenistike është një formë foljore mjaft e përdorur për shprehjen e së ardhmes, përdorimi i së cilës mënjanohet gradualisht në mesjetë me mbizotërimin e tipit të ri të së ardhmes $\theta\alpha$ + *lidhore*.

Ajo që përbën ndryshim nga greqishtja te shqipja është fakti se në gjuhën greke kemi dy të ardhme, me ndryshime aspektore midis tyre, të ardhmen e vazhduar ku folja ka temën e kohës së tashme dhe tregon vazhdimësi veprimi $\theta\alpha$ *διαβάζω*, dhe të ardhmen e thjeshtë ku folja ka temën e aoristit dhe veprimi kryhet në një çast të vetëm $\theta\alpha$ *διαβάσω* - *do të lexoj*. Në mënyrë skematike strukturën e së ardhmes së greqishtes mund ta paraqesim si më poshtë:

E ardhmja e vazhduar e greqishtes			E ardhmja e thjeshtë e greqishtes		
Pjesëz	Formë foljore		Pjesëz	Formë foljore	
$\theta\alpha$	tema foljore e kohës së tashme	mbaresa të kohës së tashme	$\theta\alpha$	tema foljore e aoristit aktiv/pasiv	mbaresa të aoristit të lidhores
$\theta\alpha$	<i>διαβάζ-</i>	<i>-ω/-μαι</i>	$\theta\alpha$	<i>διαβάσ-/διαβαστ-</i>	<i>-ω</i>

Tabela 3.19

Tabela 3.20

E ardhmja e greqishtes si e thjeshta ashtu edhe e vazhduara nuk paraqesin ndonjë vështirësi për t’u përcjellë në gjuhën shqipe, pasi që të dyja jepen me të ardhmen e shqipes pavarësisht aspektit, shembulli (5).

¹⁶⁵ R. Browning, *vep. e cit.*, 1991, 52

¹⁶⁶ Haset për herë të parë në shekullin e 12-të forma $\theta\epsilon\nu\acute{\nu}\alpha$, R. Browning, *vep. e cit.*, 1991, 109

- 6) **Θα ‘ρθεις μαζί μου.** Έχω λιγνίτη στην Κρήτη, **θα επιστατείς** τους εργάτες. Το βράδυ **θα ξαπλώνουμε** οι δυο μας στην αμμουδιά – γυναίκα, παιδιά, σκυλιά δεν έχω – **θα τρώμε και θα πίνουμε** μαζί. (B.Π. 26)- **Do të vish me mua.** Kam një minierë linjiti në Kretë. **Do të mbikëqyrësh** punëtorët. Netëve **do të shtrihemi** ranishtes –grua, të pjellë e të mbjellë nuk kemi-**do të hamë e do të pimë** së toku. Pastaj **do t’i biesh** sandurit. (Z. 22)

3.1.2.5. Koha e ardhme e përparme

a. Në gjuhën shqipe e ardhmja e përparme formohet me strukturën *do të + folje ndihmëse + pjesore*. Por në të folmet popullore mund të ndeshet edhe pa pjesëzën *të* ashtu si edhe format tjera të së ardhmes.

E ardhmja e përparme e shqipes		
E ardhmja e foljes <i>kam</i>		Pjesore
Pjesëza	Folje ndihmëse në të tashmen e lidhore	Pjesore
<i>do</i>	<i>të kem/të jem</i>	<i>mësuar</i>

Tabela 3.21

Edhe pse kjo kohë për nga emërtimi bën pjesë në kohët e së ardhmes, ajo përdoret shumë rrallë në kuptimin e së ardhmes së përparme, përdoret më shumë për të shprehur veprime të mundshme të së shkuarës¹⁶⁷. Kjo kohë përveç analoges së saj mund të përkthehet nga shqipja në greqisht edhe me strukturën *do të (θα) + të pakryerën* ose *do të (θα) +jam(είμαι)+pjesore pasive*, shembujt (1), (2), (3).

- 1) **Do ta ketë marrë** ujët, - *tha gjenerali.* (Gj.U.V. 224)- **Θα το παρέσυρε** το νερό, *είπε ο στρατηγός.*(Σ.Ν.Σ. 263)
- 2) **Do të jetë shëruar**, - *tha dikush.* (Gj.U.V. 173) – **Θα ‘γινε καλά,** *είπε κάποιος.* (Σ.Ν.Σ. 207)
- 3) **Me siguri do ta kenë prerë** përmbi bërryl, *mendoi.* (Gj.U.V. 60) - **Σίγουρα θα είναι κομμένο** στον αγκώνα, *σκέφτηκε.* (Σ.Ν.Σ. 74)

b. Në greqishten e re e ardhmja e përparme ndërtohet nëpërmjet pjesëzës *θα* dhe kohës së kryer të foljes themelore p.sh.: *θα έχω διαβάσει* - “do të kem lexuar”.

¹⁶⁷ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

E ardhmja e përparme e greqishtes	
Pjesëza	E kryera aktive/pasive e greqishtes së re
<i>θα</i>	<i>έχω γράψει/γραφτεί</i>

Tabela 3.22

Kjo kohë në greqishten e re tregon se veprimi do të jetë kryer në të ardhmen, d.m.th. do të jetë i përfunduar në një çast të së ardhmes që ka në mendje folësi¹⁶⁸. Këtë kohë do të mund ta quanim sipas Tzartanos¹⁶⁹ si e kryera e së ardhmes. Ndërsa Babinjoti¹⁷⁰ pohon se e ardhmja e përparme tregon një veprim të kryer para një veprimi tjetër, d.m.th. vendos një ngjarje përpara një ngjarjeje tjetër në të ardhmen. E ardhmja e përparme e greqishtes transmetohet në gjuhën shqipe përmes kohës analoge me të, pra të ardhmes së përparme, shembujt (1), (2).

- 1) *Ένα πράγμα ήθελα να σε ρωτήσω· θα ‘χεις ξεφυλλίσει ένα μπαούλο φυλλάδες. (B.Π. 33) – Desha veç një gjë të të pyes. Do të kesh kënduar një baule qitapësh... (Z. 29)*
- 2) *..Θα ‘χεις στύψει δυο τρεις χιλιάδες οκάδες χαρτί· τι ζουμί έβγαλες; (B.Π. 275)- Do të kesh shtrydhur dy- tri mijë okë letër. Na thuaj, pra, ç’lëng nxore? (Z. 249)*

3.1.2.6. Koha e ardhme e së shkuarës

E ardhmja e së shkuarës në gjuhën shqipe formohet duke u pararendosur formave vetore të kohës së pakryer të mënyrës lidhore të foljes pjesëzën *do*¹⁷¹. Përveç kësaj forme, e cila është parësore, mund të ndeshet edhe një formë tjetër, struktura e së cilës përbëhet nga e pakryera e foljes ndihmëse *kam + formën e pashjtelluar të tipit për të larë*. Strukturën parësore të saj në mënyrë skematike do të mund ta paraqisnim si më poshtë:

E ardhmja e së shkuarës e shqipes			
Pjesëz	Formë foljore e së pakryerë së lidhore		
do	të	temë folore e së tashmes së dëftores	mbaresat e së pakryerës së lidhore
<i>do</i>	<i>të</i>	<i>lexoja/lexohesha</i>	

Tabela 3.23

¹⁶⁸ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *ver. e cit.*, 1991

¹⁶⁹ Po aty

¹⁷⁰ Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπιμιώτης, *ver. e cit.*, 2004

¹⁷¹ Po aty

E ardhmja e së shkuarës në gjuhën greke nuk ekziston si kohë më vete, megjithatë haset struktura e saj *do të (θα) + të pakryerën dëftores së foljes*, e cila trajtohet si modalitet¹⁷². Ndaj dhe e ardhmja e së shkuarës së shqipes jepet pikërisht me këtë formë të greqishtes, shembujt (1), (2).

- 1) *Po ndiqnin me vëmendje hapjen e varrit të parë për të mësuar rregullat që do të ndiqeshin gjatë gërmimit. (Gj.U.V. 19) – Παρακολουθούσαν με προσοχή το άνοιγμα του πρώτου τάφου για να μάθουν τους κανόνες και την τακτική που θ'ακολουθούσαν στο σκάψιμο. (Σ.Ν.Σ. 23)*
- 2) *Kur mbarova, e sheshova si munda tokën dhe sipër nuk i vura asnjë shenjë, asnjë gur, sepse ai trembej nga çdo shenjë, ngaqë i dukej se do ta gjenin e do ta nxirrnin prapë nga dheu. (Gj.U.V. 23) – Όταν τελείωσα, ίσιωσα όσο μπορούσα περισσότερο το χώμα χωρίς να βάλω από πάνω κανένα διακριτικό, γιατί ο φίλος μου φοβόταν οποιοδήποτε σημάδι: του φαινόταν πως θα τον έβρισκαν και θα τον ζέθαβαν. (Σ.Ν.Σ. 27)*

3.1.2.7. Koha e ardhme e përparme e së shkuarës

a. E ardhmja e përparme e së shkuarës formohet me *të ardhmen e së shkuarës së foljes ndihmëse kam+pjesore*. Kjo formë foljore rrallë përdoret për të shprehur një veprim që mund të jetë kryer para një çasti të së shkuarës, por përdoret disi më shumë si një e shkuar e tipit *do të kem larë* për të shprehur një veprim të mundshëm të së shkuarës¹⁷³.

E ardhmja e përparme e së shkuarës së shqipes		
E ardhmja e së shkuarës së foljes <i>kam</i>		Pjesore
Pjesëza	Folje ndihmëse në të pakryerën e lidhore	Pjesore
<i>do</i>	<i>të kisha/të isha</i>	<i>mësuar</i>

Tabela 3.24

Transmetimi në greqisht i kësaj kohe është bërë duke përdorur *θα + më se të kryerën* ose *θα +të pakryerën*, shembujt (1), (2).

- 1) *Ndërkaq zdrukthëtarë të panjohur do t'i kishin mbaruar ato mijëra arka të vogla, sipas përmasave të caktuara në marrëveshje. (Gj.U.V. 189)- Στο μεταξύ άγνωστοι μαραγκοί θα είχαν πια τελειώσει τα χιλιάδες μικρά φέρετρα, σύμφωνα με τις*

¹⁷² Holton, Mackridge, Ειρήνη Φιλιππάκη-Warburton fq.208, Κλαίρης, Μπαμπινιώτης fq.436, 441

¹⁷³ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

διαστάσεις που είχαν καθοριστεί στη διάρκεια των διαπραγματεύσεων. (Σ.Ν.Σ. 223)

- 2) *Pra, edhe kjo mbrëmje, ndonëse një mbrëmje me dasmë, do të kishte shkuar si çdo mbrëmje tjetër, sikur gjenerali t'i kishte menduar të gjitha këto dhe pastaj të dëgjonte ç'rrëfente prifti rreth kolonelit Z., si kishte shkuar në klub dhe që ulur në tryezë me ca fshatarë, ç'i kishin treguar vendësit për zhdukjen e koloneli, dhe se si ai dyshonte për gjithçka. (Gj.U.V. 195) – Έτσι λοιπόν κι αυτή η βραδιά, αν και βραδιά γάμου, θα περνούσε όπως κι όλες οι άλλες, αν ο αρχηγός αφού είχε κάνει αυτές τις σκέψεις δεν άκουγε τον ιερέα να διηγείται για το συνταγματάρχη Ζ.: πως είχε πάει στη λέσχη και είχε καθίσει μαζί με μερικούς χωριάτες, πως του είχανε πει για την εξαφάνιση του συνταγματάρχη, και πως ο ίδιος αμφέβαλλε για όλα αυτά. (Σ.Ν.Σ. 230).*

Në gjuhën greke e ardhmja e përparme e së shkuarës nuk konsiderohet si formë kohore e dëftores, por ama mund të formohet si strukturë nëpërmjet pjesëzës *θα + më se të kryerën*, dhe trajtohet si modalitet. Kjo strukturë foljore përdoret për të treguar mundësinë dhe ndryshe nga modalitetet e tjera mohoren e formon me pjesëzën *δεν (nuk)*. Modaliteti në këtë rast lidhet me gjykimin e folësit për sa i përket faktit nëse ekziston ose jo mundësia për t'u realizuar diçka dhe sa është e mundur të realizohet¹⁷⁴. Kjo strukturë mund të përdoret gjithashtu edhe në rolin e kushtores, të cilën do ta shqyrtojmë në vazhdim.

¹⁷⁴ Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπιμιώτης, *ver. e cit.*, 2004, 484

Përfundime

- ❖ Mënyra dëftore si për gjuhën shqipe ashtu edhe për atë greke është mënyra më e pasur në forma kohore. Në gjuhën shqipe kjo mënyrë ka dhjetë trajta kohore ndërsa në gjuhën greke tetë. Kohët gramatikore që i hasim në të dyja gjuhët janë: e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë (aotisti), e kryera, më se e kryera, e ardhmja, e ardhmja e përparme.
- ❖ Në gjuhën greke nuk haset si kohë gramatikore, koha e ardhme e së shkuarës, formim i cili trajtohet si modalitet, si edhe e kryera e tejshkuar, e cila nuk mund të formohet sepse foljet ndihmëse *kam* e *jam* nuk mund të vendosen në aorist(të kryerën e thjeshtë).
- ❖ Në gjuhën greke, ndryshe nga gjuha shqipe, hasim dy forma të së ardhmes, të ardhmen e thjeshtë dhe të ardhmen e vazhduar, me ndryshime aspektore ndërmjet tyre, të cilat i përgjigjen të dyja së ardhmes së shqipes.
- ❖ Koha e tashme ka pothuajse të njëjtat përdorime në të dyja gjuhët, si në shqip ashtu edhe në greqisht, ajo karakterizohet nga aspekti i pakryer (imperfektiv) dhe tema e saj përdoret në gjuhën greke për të formuar kohët që karakterizohen nga aspekti i pakryer. Për të transmetuar foljet që janë në këtë kohë nga njëra gjuhë të tjetrën, përdoret në shumicën e rasteve e tashmja. Por në varësi të kuptimeve semantike e ngjytimeve kohore që mund të ketë folja në secilën gjuhë mund të përdoret përkatësisht edhe forma të tjera kohore si p.sh.: e ardhmja, aoristi, e kryera etj. Folja në kohën e tashme të shqipes mund të përdoret edhe me pjesëzën *po*, ndërsa në gjuhën greke nuk ekziston një pjesëz e tillë aktualizuese dhe në shumicën e rasteve kjo formë se së tashmes së shqipes jepet thjesht me të tashmen e greqishtes e pashoqëruar nga ndonjë mjet tjetër gjuhësor, i cili të ketë kuptim aktualizues, por hasim edhe raste kur shprehet me aoristin e shoqëruar me ndajfoljen kohore *ende*.
- ❖ Koha e pakryer e dëftores në gjuhën shqipe si edhe në gjuhën greke bën pjesë në kohët e së shkuarës dhe ka me të kryerën e thjeshtë dhe të kryerën dallime të cilat kanë më shumë karakter aspektor. Koha e pakryer në gjuhën greke formohet nga tema e kohës së tashme të foljes, ndërsa në gjuhën shqipe jo të gjitha foljet e formojnë të pakryerën nga tema foljore e së tashmes, foljet të cilat pësojnë shndërrime tingullore në vetën e dytë shumës i ruajnë ato edhe në kohën e pakryer, në të gjitha format vetore. Në gjuhën greke struktura e foljes në këtë kohë përveç temës dhe mbaresës ka edhe një element tjetër, augmentin, i cili nuk përdoret për të formuar të pakryerën e çdo foljeje, por te foljet që fillojnë me bashkëtingëllore dhe në të pakryerën paraqiten me më pak se tri rrokje. Zakonisht për të transmetuar foljet në këtë kohë nga shqipja në greqisht dhe anasjelltas, përdoret e pakryera, por mund të përdoret edhe e tashmja e lidhore së greqishtes apo më se e kryera e shqipes. Kur e pakryera e greqishtes shoqërohet me pjesëza ($\theta\alpha$, $\nu\alpha$) atëherë ajo përdoret për të shprehur zakonisht modalitete. Vërejmë se në

- gjuhën shqipe kjo formë foljore e greqishtes përkthehet nëpërmjet të ardhmes së përparme të së shkuarës së dëftores. Kur bëhet fjalë për fjali kushtore, e pakryera e greqishtes kur i është paravendosur pjesëza $\theta\alpha$, në gjuhën shqipe jepet me të tashmen e mënyrës kushtore. $\theta\alpha$ + e pakryera e dëftores përdoret edhe me kuptimin e së ardhmes të shkuarës. Kur e pakryera e greqishtes shoqërohet me pjesëzën $t\epsilon$, atëherë e pakryera nuk përdoret me kuptim kohor por me kuptim modal. Forma foljore e cila i përgjigjet në shqip formës $\nu\alpha$ + e pakryer, si nga ana strukturore edhe nga ana semasiologjike është e pakryera e lidhore.
- ❖ Folja në kohën e kryer të thjeshtë (aoristi) si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën greke tregon një veprim të përfunduar në një çast të caktuar në të shkuarën. Në varësi të temës, aoristi në gjuhën greke ndahet në sigmatik dhe në jo-sigmatik. Gjurmë të aoristit jo sigmatik hasim edhe te disa folje të gjuhës shqipe. E kryera e thjeshtë, përkatësisht aoristi mund të përdoret edhe me kuptim mbarëkohor, apo me kuptimin e së ardhmes apo të së kryerës. Foljet në këtë kohë përkthehen nga shqipja në greqisht dhe anasjelltas zakonisht nëpërmjet kohës së kryer të thjeshtë (aoristit), por hasim edhe raste kur për përkthimin e tyre nga një gjuhë në tjetrën përdoren edhe kohë të tjera si: e pakryera e greqishtes, lidhorja e thjeshtë, apo aoristi i lidhore së greqishtes, e kryera apo e kryera e tejshkuar e shqipes etj. Pjesëza $\theta\alpha$ e shoqëruar nga aoristi i një foljeje në greqisht trajtohet si modalitet. Një strukturë foljore analoge nuk haset në gjuhën shqipe. Ky formim foljor i gjuhës greke jepet zakonisht në gjuhën shqipe me të ardhmen e përparme të mënyrës dëftore. Folja në aorist, së cilës i është paravendosur pjesëza $\nu\alpha$, tregon habi apo supozim. Në gjuhën shqipe nuk përdoret një strukturë analoge, dhe për transmetuar këtë strukturë të greqishtes përdoret e kryera e lidhore, ose më se e kryera e lidhore.
 - ❖ Kohët analitike të formës veprare, përveç së ardhmes, në gjuhën greke formohen nëpërmjet foljes ndihmëse *kam* + *trajtën paskajore të formës veprare*, ose me foljen ndihmëse *kam* + *kallëzoren e pjesores pësore të së kryerës*. Struktura e parë është edhe ajo që ka përdorimin më të gjerë. Ndërsa në gjuhën shqipe kjo kohë formohet nëpërmjet foljes ndihmëse *kam* + *pjesoren*. Formimi i kohës së kryer (dhe më se të kryer) analitike ndërtohet nëpërmjet foljes *kam* dhe pjesores së shkuar të foljes themelore është një dukuri e përbashkët, jo vetëm për gjuhët joslave të Ballkanit. Për sa i përket formës joveprare kohët e përbëra në greqisht formohen me foljen ndihmëse *kam* + *trajtën paskajore të formës joveprare*, ose me foljen ndihmëse *jam* + *emëroren e pjesores pësore ose mesore të së kryerës*. Në gjuhën shqipe kohët e përbëra të formës joveprare formohen me foljen ndihmëse *jam* + *pjesoren*. Disa kohë të mënyrës dëftore si e ardhmja e së shkuarës, e ardhmja e përparme e së shkuarës dhe e kryera e tejshkuar nuk hasen si kohë të dëftores në gjuhën greke.
 - ❖ Gjuha shqipe, ashtu si edhe greqishtja, por edhe gjuhë të tjera indoevropiane në një fazë më të hershme e kanë shprehur kuptimin e së kryerës me anë formash sintetike. E kryera e shqipes formohet nga e tashmja e foljes ndihmëse *kam*, për formën veprare, dhe *jam*, për formën joveprare plus *pjesoren* e foljes, ndërsa në

gjuhën greke forma aktive formohet folja *kam* + *paskajore*. Forma tjetër alternative e së kryerës formohet nëpërmjet foljes *kam* dhe kallëzores së njëjësit të pjesores pasive të gjinisë asnjane të greqishtes së re. Këto dy forma nuk janë semantologjikisht të barazvlefshme. Rendi i dy përbërësve të kësaj kohe në gjuhën shqipe është i ngulitur dhe ndërmjet tyre nuk mund të ndërfiten elementë të tjerë, ndërsa në strukturën e kohës më se të kryer të greqishtes ndërmjet foljes ndihmëse dhe paskajores së greqishtes së re të foljes mund të ndërfiten elementë të tjerë gjuhësorë. E kryera analitike e formës veprorë të shqipes në gjuhën greke jepet në mjaft raste me analogen e saj, pra me të kryerën e greqishtes, por mund të jepet gjithashtu me aoristin e greqishtes. Në rastin kur në gjuhën shqipe përdoret e kryera e foljes *jam* në gjuhën greke përdoret e kryera e një foljeje me kuptim të përafërt me të në situatën konkrete, mund të përdoret gjithashtu, për të dhënë këtë strukturë të shqipes, e pakryera e foljes *jam* (*είμαι – ήμουν*) pra *kam qenë – ήμουν* (*isha*).

- ❖ Në gjuhën shqipe më se e kryera formohet prej së pakryerës së foljes ndihmëse *kam*, *kisha* + pjesore. Për shqipen është e vështirë të thuhet me siguri nëse ka ekzistuar apo jo një formë sintetike për më se të kryerën, ndërsa për gjuhën greke ashtu si e kryera, edhe më se e kryera fillimisht ka qenë kohë sintetike. Struktura *kisha* + *paskajoren e aoristit* haset për herë të parë me kuptimin e më se të kryerës në tekste të periudhës së mesjetës në gjuhën greke dhe u formua sipas modelit të më se të kryerës. Më se e kryera e greqishtes formohet edhe në një mënyrë alternative, e cila në formën veprorë formohet nga e pakryera e foljes *kam* (*είχα*) + pjesoren pasive të së kryerës (*είχα διαβασμένο*), ndërsa për formën joveprorë: e pakryera e foljes *jam* (*ήμουν*) + pjesoren pasive të së kryerës (*ήμουν διαβασμένος*). Në shumicën e rasteve koha më se e kryer e shqipes jepet me më se të kryerën e greqishtes. Në disa raste më se e kryera e shqipes jepet gjithashtu në greqisht me forma të tjera kohore të së shkuarës si p.sh. me aoristin apo të pakryerën, por ka raste kur jepet me foljen *mund* + *lidhoren e foljes*, ndërsa në rastin kur foljet *kam* dhe *jam* në gjuhën shqipe janë në më se të kryerën, të cilën në greqisht këto folje nuk mund ta formojnë, jepen ose me të pakryerën e këtyre foljeve ose me më se të kryerën e një foljeje me kuptim të përafërt me to. Më se e kryera e greqishtes në të shumtën e rasteve përcillet në gjuhën shqipe nëpërmjet më se të kryerës së shqipes. Ka raste kur më se kryera e greqishtes jepet me të kryerën e tejskuar të shqipes, ose me të kryerën e thjeshtë të shqipes.
- ❖ E kryera e tejskuar në gjuhën shqipe formohet nga e kryera e thjeshtë e foljes *kam/jam* *pata/qeshë* + pjesoren. Kjo trajtë kohore nuk ekziston në gjuhën greke., ndaj kur lind nevoja për ta dhënë këtë kohë të shqipes në greqisht, atëherë mund të përdoret më se e kryera, ose kohë sintetike të së shkuarës së greqishtes si aoristi apo e pakryera. Ka raste kur e kryera e tejskuar e mënyrës joveprorë të shqipes në greqisht jepet me foljen ndihmëse *jam* në të pakryerën (*ήμουν*) + pjesoren pasive, pra një formë alternative të më se të kryerës.
- ❖ Në gjuhën shqipe kuptimi kohor i së ardhmes shprehet nëpërmjet dy tipave formash analitike: Tipi i parë formohet nga pjesëza foljore *do* dhe nga e tashmja

e lidhore e pajisur ose jo me pjesëzën të. Tipi i dytë, i cili përdoret shumë më pak se i pari, formohet nga folja *kam* + *paskajoren* (e tipit *me lexu* dhe *për të lexuar*) dhe *kam* + *të tashmen e lidhore*. Në gjuhën e lashtë greke koha e ardhme formohet në mënyrë sintetike. Në greqishten e re si edhe në shqip e ardhmja formohet nga pjesëza *θα* + folja në lidhore. Edhe në gjuhën greke përdoret struktura *kam* + lidhore si barasvlerës i së ardhmes, strukturë që është evolim i strukturës *έχω* (*kam*) + *paskajore*. Për sa i përket tipit të parë, tipi i kohës së ardhme të formuar me ndihmën e foljes “*dua*”, e cila zakonisht është e gramatikalizuar dhe ndiqet nga folja themelore kryesisht në formën e kohës së tashme të mënyrës lidhore haset pothuajse në të gjitha gjuhët ballkanike. Ajo që përbën ndryshim nga greqishtja të shqipja është fakti se në gjuhën greke kemi dy të ardhme, me ndryshime aspekte midis tyre, të ardhmen e vazhduar ku folja ka temën e kohës së tashme dhe tregon vazhdimësi veprimi *θα διαβάζω*, dhe të ardhmen e thjeshtë ku folja ka temën e aoristit dhe veprimi kryhet në një çast të vetëm *θα διαβάσω* - *do të lexoj*. Në shumicën e rasteve foljet në të ardhmen e shqipes, si në formën veprorë edhe në joveprorë, jepen në greqisht me të ardhmen e thjeshtë, po edhe me të ardhmen e vazhduar. Në rastet kur folja shoqërohet nga rrethana kohe që tregojnë vazhdimësi apo përsëritje të veprimit atëherë në greqisht përdoret e ardhmja e vazhduar. E ardhmja e greqishtes si e thjeshta ashtu edhe e vazhduara nuk paraqesin ndonjë vështirësi për t'u përcjellë në gjuhën shqipe, pasi që të dyja jepen me të ardhmen e shqipes pavarësisht aspektit.

- ❖ Në gjuhën shqipe e ardhmja e përparme formohet me strukturën *do të* + *folje ndihmëse* + *pjesore*. Në greqishten e re e ardhmja e përparme ndërtohet nëpërmjet pjesëzës *θα* dhe kohës së kryer të foljes themelore dhe tregon se veprimi do të jetë kryer në të ardhmen, d.m.th. do të jetë i përfunduar në një çast të së ardhmes që ka në mendje folësi. Kjo kohë përveç analoges së saj mund të përcillet nga shqipja në greqisht edhe me strukturën *do të* (*θα*) + *të pakryerën* ose *do të* (*θα*) + *jam* (*είμαι*) + *pjesore pasive*, ndërsa e ardhmja e përparme e greqishtes transmetohet në gjuhën shqipe përmes kohës analoge me të, pra të ardhmes së përparme.
- ❖ E ardhmja e së shkuarës në gjuhën shqipe formohet duke u pararendosur formave vetore të kohës së pakryer të mënyrës lidhore të foljes pjesëzën *do*. Përveç kësaj forme, e cila është parësore, mund të ndeshet edhe një formë tjetër, struktura e së cilës përbëhet nga e pakryera e foljes ndihmëse *kam* + *formën e pashtjelluar* të tipit *për të larë*. E ardhmja e së shkuarës në gjuhën greke nuk ekziston si kohë më vete, megjithatë haset struktura e saj *do të* (*θα*) + *të pakryerën dëftores së foljes*, e cila trajtohet si modalitet. Ndaj dhe e ardhmja e së shkuarës së shqipes jepet pikërisht me këtë formë të greqishtes.
- ❖ E ardhmja e përparme e së shkuarës formohet me *të ardhmen e së shkuarës së foljes ndihmëse kam+pjesore*. Kjo formë foljore rrallë përdoret për të shprehur një veprim që mund të jetë kryer para një çasti të së shkuarës, por përdoret disi më shumë si një e shkuar e tipit *do të kem larë* për të shprehur një veprim të mundshëm të së shkuarës. Në gjuhën greke e ardhmja e përparme e së shkuarës

nuk konsiderohet si formë kohore e dëftores, por ama mund të formohet si strukturë nëpërmjet pjesëzës $\theta\alpha + më\ se\ të\ kryerën$, dhe trajtohet si modalitet. Kjo strukturë foljore përdoret për të treguar mundësinë dhe mund të përdoret gjithashtu edhe në rolin e kushtores. Transmetimi në greqisht i kësaj kohe është bërë duke përdorur strukturat $\theta\alpha + më\ se\ të\ kryerën$ ose $\theta\alpha + të\ pakryerën$.

3.2. Mënyra lidhore

a. Mënyra lidhore në gjuhën shqipe shpreh kryesisht modalitetin e mundësisë, por ka raste kur ajo mund të shprehë edhe modalitetin e dëshirës apo të detyrimit¹⁷⁵. Kjo është një nga mënyrat e trashëguara e cila ka pësuar ndryshime të rëndësishme gjatë evolucionit të gjuhëve indoevropiane, në disa prej të cilave ajo është përzier me mënyrën dëshirore¹⁷⁶. Sipas Brugmann-it¹⁷⁷ dallohen tre kuptime të lidhore: kuptimi volitiv ose voluntativ, kuptimi deliberativ dhe kuptimi prospektiv. Demiraj¹⁷⁸ është i mendimit se kuptimi në zanafillë i mënyrës lidhore duket të ketë qenë ai volitiv a voluntativ, ndërsa kuptimet e tjera modale të kësaj mënyre si edhe përdorimi i saj me kuptimin e mënyrave dëshirore e urdhërore duhet të jenë diakronikisht dytësore. Në shqipen e dokumentuar lidhorja përdoret më shumë në fjali të nënrenditura, por edhe në fjali kryesore, kryesisht format e së tashmes së lidhore¹⁷⁹ dhe ky përdorim, po sipas Demirajt, ka marrë shkas edhe nga mënjanimi i paskajores në gjuhët ballkanike. Edhe foljet *mund* e *duhet* në shqip shoqërohen nga lidhorja, madje Mansaku¹⁸⁰ e vëren këtë që te Buzuku, ku sipas tij, kur folja *mund* përdoret si folje modale, ajo shoqërohet nga lidhorja në 136 raste, përkundrejt 38 rasteve kur shoqërohet me paskajore, nga 226 rastet ku folja *mund* del si folje modale. Të gjitha format kohore të mënyrës lidhore të gjuhës shqipe kanë të paravendosur pjesëzën *të*¹⁸¹, ashtu si edhe ato të greqishtes pjesëzën *va*. Mënyra lidhore e gjuhës shqipe ka dy kohë: *të tashmen* dhe *të shkuarën*, ku e shkuara ka tri nënndarje, *të pakryerën*, *të kryerën* dhe *më se të kryerën*¹⁸².

Kohët e lidhore së shqipes	E tashmja	• <i>Koha e tashme</i>
	E shkuara	<ul style="list-style-type: none"> • <i>Koha e pakryer</i> • <i>Koha e kryer</i> • <i>Koha më se e kryer</i>

Paraqitje grafike 3.4

¹⁷⁵ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

¹⁷⁶ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

¹⁷⁷ Brugmann K. – Delbrück B., Grundriss der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen, cituar sipas Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

¹⁷⁸ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

¹⁷⁹ Po aty

¹⁸⁰ S.Mansaku, *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet*, SF, 1979/3

¹⁸¹ Pjesëza *të*, sipas Sh.Demirajt, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë 2002, 372, ka qenë burimisht një lidhës nënrenditëse që shërbente për të lidhur një fjali të nënrenditur, ku folja ishte në mënyrën lidhore dhe me kalimin e kohës u bë pjesë e pandashme e formave foljore të lidhore.

¹⁸² Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

b. Në gjuhën greke, mënyra lidhore është mënyra e cila e paraqet veprimin e foljes si diçka që duam ose presim që të ndodhë¹⁸³. Mënyra lidhore është një nga mënyrat e foljes, e cila ka evoluar që nga greqishtja e lashtë, ku folja në këtë paraqiste veprimin si diçka të dëshirueshme apo të pritshme¹⁸⁴. Folja në mënyrën lidhore mund të përdoret me ose pa pjesëzat *να (të)*, *ας (le të)* (pa këto pjesëza përdoret lidhorja e thjeshtë ose aoristi i lidhores)¹⁸⁵. Treguesi i lidhores së greqishtes së re *να*, kishte fillimisht formën *ίνα* dhe kishte funksionin e një lidhëze nënrenditëse dhe në periudhën e koinesë e hasim të shoqëruar me lidhoren e greqishtes së vjetër. Në vazhdim ndryshon mënyra e shqiptimit dhe vendi i theksit dhe bëhet *ινά*, duke arritur në greqishten e re në formën *να*, i cili është treguesi i lidhores¹⁸⁶. Në rastet kur lidhorja nuk shoqërohet me këto pjesëza prihet nga ndajfolja *ίσως (ndoshta)*, apo nga lidhëza ose pjesë të tjera të ligjëratës që kanë funksionin e tyre: *άμα, μόλις, μήπως, πριν, όποτε, αφού, όποιος, όπου, ό,τι, ωστόσο*. Por ka raste kur folja në lidhore përdoret vetëm pa iu paravendosur asnjë nga elementët e mësipërm gramatikorë si p.sh: **Έρθεις δεν έρθεις, εμείς θα πάμε**. - *Vjen apo nuk vjen ti, ne do të shkojmë*. Edhe në gjuhën shqipe ndeshen forma të lidhores pa pjesëzën *të* te Buzuku e te Matrënga¹⁸⁷.

Gjuhëtarë si Anrdhrioti¹⁸⁸, kanë vënë në dyshim ekzistencën lidhore si mënyrë më vete duke qenë se në shumicën e tyre tipologjia e formave kohore është e njëjtë si për dëftoren ashtu edhe për lidhoren, por Tzartanos¹⁸⁹ i përgjigjet me dy shkrime të tij Andriotit duke mbrojtur idenë se në greqishten e re ekziston si mënyrë më vete lidhorja. Sipas Mackridge termat “dëftore” e “lidhore” nuk përdoren për të treguar kategori morfologjike, sepse nuk ekzistojnë ndërmjet tyre ndryshime në paradigmën e foljes, por ato dallohen vetëm nga ana sintaksore në bazë të mjedisit leksikor në të cilin gjenden. Ndryshimi i vetëm nga ana morfologjike që dallon dëftoren dhe lidhoren si mënyra më vete është pamundësia për t’u përdorur në dëftore e formës që tradicionalisht është emërtuar aoristi i lidhores¹⁹⁰. Për sa u përket kohëve të mënyrës lidhore të gjuhës greke, emërtimi i tyre nuk shpreh momentin kohor në të cilin kryhet veprimi, por shprehin zakonisht aspektin, pra nëse veprimi që shpreh folja është në aspektin e pakryer (imprefektiv) dhe tregon vazhdimësi, apo në aspektin e kryer. Kohët gramatikore të mënyrës lidhore janë: e tashmja ose lidhorja e vazhduar, aoristi, ose lidhorja e thjeshtë dhe e kryera. E tashmja dhe aoristi i lidhores, ndryshe nga shqipja kanë vetëm dallime aspektore midis tyre. Për sa i përket momentit kohor që i përgjigjet kryerjes së veprimit, ai del zakonisht nga situata ligjërimore në të cilën përdoren këto kohë¹⁹¹. Kohët e lidhores për gjuhën greke mund ti paraqesim si më poshtë:

¹⁸³ M. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005,

¹⁸⁴ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *Γραμματική της αρχαίας ελληνικής γλώσσας*, Αθήνα, 1967

¹⁸⁵ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *vep. e cit.*, 1991

¹⁸⁶ R. Browning, *vep. e cit.*, 1991, 63

¹⁸⁷ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002

¹⁸⁸ Ν.Π. Ανδριώτης, *Υπάρχει υποτακτική στη νέα ελληνική*; NE 15, 445 – 50, 1934

¹⁸⁹ Α. Τζάρτζανος, *Δεν υπάρχει υποτακτική στη νέα ελληνική*; NE 12, 826-7, 1932, *Κι όμως υπάρχει!* NE 15, 515-516 (Απάντηση στον Ανδριώτη 1934)


¹⁹⁰ P. Mackridge, *vep. e cit.*, 1990, 172-3

¹⁹¹ M. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005

Kohët lidhore së greqishtes	Koha e tashme	• <i>(Lidhorja e vazhduar)</i>
	Aoristi	• <i>(Lidhorja e thjeshtë)</i>
	Koha e kryer	

Paraqitje grafike 3.5

Vërejmë se në gjuhën greke mënyra lidhore ka vetëm tri kohë, ndërsa lidhorja e shqipes ka katër, nga të cilat janë të përbashkëta vetëm e tashmja dhe e kryera, greqishtja nuk ka të pakryerën dhe më se të kryerën e lidhore, ndërsa shqipja nuk ka aoristin (të kryerën e thjeshtë).



Paraqitje grafike 3.6

Vërejmë gjithashtu se të gjitha kohët e lidhore si në shqip ashtu edhe në greqisht karakterizohen (pavarësisht përjashtimeve) nga paravendosja e pjesëzës *të* për shqipen, e përkatësisht *va* për greqishten. Për sa i përket analogjisë nga ana kuptimore e këtyre kohëve do ta shohim në vazhdim kur të shqyrtojmë strukturën dhe përdorimin e secilës kohë në të dyja gjuhët.

3.2.1. Koha e tashme

3.2.1.1. Koha e tashme e lidhore në gjuhën shqipe

Koha e tashme e lidhore në gjuhën shqipe tregon një veprim kryerjen e së cilit folësi e paraqet si të mundshme apo të detyrueshme¹⁹². Sipas Demirajt¹⁹³ e “tashmja” është e vetmja “kohë” e mirëfilltë e lidhore së shqipes, e cila ka pësuar ndryshime të rëndësishme si në temën ashtu edhe në mbaresat e saj vetore. Tema foljore e kohës së tashme të lidhore për të gjitha foljet, përveç foljeve *kam* dhe *jam*, është e njëjtë me temën e së tashmes së dëftores. Foljet të cilat në paradigmen e kohës së tashme të dëftores paraqesin ndërrime tingullore, nuk i mbartin ato edhe në të tashmen e lidhore p.sh.: *(unë) shoh, (ti, ai) sheh – (unë) të shoh, (ti) të shohësh, (ai) të shohë*. Por ato folje të cilat pësojnë ndryshime tingullore në vetën e dytë shumës të së tashmes së dëftores e ruajnë këtë ndërrim në temën e tyre edhe në vetën e dytë shumës të së tashmes së lidhore: *(unë) pjek, (ju) piqni – (unë) të pjek, (ju) të piqni*. Mbaresat e së tashmes së lidhore, përveç vetës së dytë e të tretë njëjës, janë të njëjta me ato të kohës së tashme të dëftores¹⁹⁴. Mbaresat e vetës së dytë dhe vetës së tretë njëjës të së tashmes së lidhore janë: *-(ë)sh, -ë/-jë*.

Koha e tashme e lidhore së shqipes		
Pjesëz	Tema foljore e së tashmes së dëftores	Mbaresa
<i>të</i>	<i>la-/dal/di</i>	<i>-j/ø/ø</i> <i>-(ë)sh</i> <i>-ë/-jë,</i> <i>-jmë, -im, -më/-m</i> <i>-ni</i> <i>-jnë, -in, -në/-n</i>

Tabela 3.25

Folja në kohën e tashme të lidhore në shqip mund të përdoret si në fjali të varura ashtu edhe në fjali të pavarura ose kryesore. Në rastet kur e tashmja e lidhore përdoret në fjali të nënrenditura ajo shpreh kryesisht modalitetin e mundësisë, i cili mund të përforcohet duke i paravendosur asaj, foljen me vlerë modale *mund*¹⁹⁵, shembulli (1). Edhe në gjuhën greke, në këtë rast foljes në të tashmen e lidhore, e tashme e cila në këtë rast është e përligjur me faktin se folja *είμαι (jam)* mund të formojë aoristin e lidhore, i paravendoset folja *μπορεί (mund)*. Në shembullin (2) folja *mund*, nuk luan rolin e një

¹⁹² Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

¹⁹³ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002, 372

¹⁹⁴ Përjashtim përbëjnë foljet *kam, jam* dhe *them*.

¹⁹⁵ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

foljeje me vlerë modale, madje është edhe ajo në mënyrën lidhore. Edhe në këtë rast e tashmja e lidhore tregon modalitetin e mundësisë. Në gjuhën greke lidhëria e foljes *mund*, jepet në shembullin konkret po me lidhoren e së tashmes, por duke i paravendosur treguesin *av* dhe jo pjesëzën *va* (*të*) si në gjuhën shqipe, ndërsa folja në lidhore, *të nxirrni*, jepet në greqisht me aoristin e lidhore së foljes *ξεθάβω*, *va ξεθάψετε*. Kjo folje, kuptimi i së cilës është *zhvarros*, është përdorur në këtë rast për të dhënë shprehjen *nxjerr nga toka*. Vëmë re gjithashtu se në të dyja gjuhët struktura e lidhore nuk është hermetike, ajo mund të lejojë që ndërmjet pjesëzës *të – va* dhe foljes të vendoset një trajtë e shkurtër. Trajta e shkurtër *e*, në këtë rast në gjuhën shqipe është shkruar me pjesëzën *të*, duke formuar treguesin *ta*, ndërsa në gjuhën greke, trajta e shkurtër *τον*, thjesht i është paravendosur foljes *ξεθάψετε* duke pasuar pjesëzën *va*.

- 1) *Mendoni se edhe skeletet e tjera mund të jenë të infektuara?* (Gj.U.V. 172) – *Νομίζεται πως μπορεί **va** είναι μολυσμένοι κι άλλοι σκελετοί.* (Σ.Ν.Σ. 204)
- 2) *Varrin e tij nuk e di asnjëri, dhe prandaj unë erdha te ju, që, kur t'ju bjerë rruga nga ato anë, të mundni ta nxirrni nga toka edhe atë bashkë me të tjerët.* (Gj.U.V. 41) – *Τον τάφο του δεν τον ξέρει κανείς και γι' αυτό ήρθα σε σας. Όταν **θα βρεθείτε** σ' εκείνα τα μέρη, **αν μπορείτε, va τον ξεθάψετε** και αυτόν μαζί με τους άλλους.* (Σ.Ν.Σ. 50)
- 3) *Atëherë, përpara se të ikim, duhet t'u japim një përgjigje.* (Gj.U.V. 210) - *Τότε, πριν φύγουμε, πρέπει **va** τους **δώσουμε** μια απάντηση.* (Σ.Ν.Σ. 248)
- 4) *Po gërmojmë në dy vende të tjera anash. Diku duhet të jetë këndeje rrotull.* (Gj.U.V. 178)- *Θα σκάψουμε σε δύο μέρη ακόμη, από την κάθε πλευρά. Πρέπει **va** είναι κάπου εδώ γύρω.* (Σ.Ν.Σ. 210)

Foljes në lidhoren e së tashmes mund t'i paravendoset edhe folja me vlerë modale *duhet* e atëherë folja në të tashmen e lidhore shpreh diçka të detyrueshme, apo të domosdoshme, shembulli (3). Në gjuhën greke kjo formë jepet me foljen pavetore *πρέπει* plus lidhoren e thjeshtë. Në shembullin (4) paravendosja e foljes modale *duhet* nuk tregon domosdoshmëri se sa modalitetin e mundësisë.

Foljet në lidhoren e së tashmes kur përdoren në fjali të varura, mund të prihen nga lidhëza nënrenditëse, por mund të përdoren edhe pa lidhëza. Në shembullin (5) folja në të tashmen e lidhore prihet nga lidhëza nënrenditëse qëllimore *që*. Në gjuhën greke kjo folje transmetohet me aoristin e lidhore, por e prirë nga një lidhëz nënrenditëse qëllimore, lidhëza *για*. Në rastin kur kemi disa fjali të varura të lidhura në mënyrë bashkërenditëse ndërmjet tyre, atëherë ndodh që lidhëza nënrenditëse t'i paravendoset vetëm foljes së parë në lidhore. Në shembullin (6) lidhëza nënrenditëse *që*, i paravendoset vetëm foljes së fjalisë së parë të nënrenditur, *të sulesh*, ndërsa *të djegësh*, *të pjekësh* e *të vrasësh* lidhen me njëra tjetrën nëpërmjet lidhëzës bashkërenditëse *dhe*. Në gjuhën greke të gjitha foljet në tashmen e lidhore janë përcjellë nëpërmjet të ardhmes së thjeshtë, e cila formohet nga e njëjta temë si edhe aoristi i lidhore së greqishtes. Në fakt në shqip në këtë rast i referohemi një veprimi që pritët të ndodhë në të ardhmen, por kjo është shprehur nëpërmjet së tashmes së lidhore. Për sa i përket strukturës së periudhës, edhe në gjuhën greke ndodh e njëjta gjë, fjalia e parë e nënrenditur lidhet me lidhëzën nënrenditëse *που*, ndërsa foljet e tjera lidhen me njëra - tjetrën me lidhëzën bashkërenditëse *και*. Siç vumë re edhe më sipër, ndërmjet pjesëzës *të* dhe foljes mund

vendoset trajta e shkurtër, dhe në këtë rast edhe në gjuhën shqipe trajta e shkurtër *na* nuk bashkohet me pjesëzën *të*, por ndërfitet në strukturën e foljes në lidhore.

- 5) *Si një shpend krenar e i vetmuar ti do të fluturosh mbi ato male tragjike, që të shkëpusësh nga grykat dhe kthetrat e tyre djemtë tanë të mjerë. (Gj.U.V. 15) – Σαν περήφανο και μοναχικό πουλί πάνω απ’ αυτά τα τραγικά βουνά, για να ξεχωρίσεις απ’ τις χαράδρες και τα γαμψά τους νύχια τα κακότυχα παιδιά μας. (Σ.Ν.Σ. 17)*
- 6) *Ti mendon se do të vijë dita që të sulesh në anët tona me ushtri dhe të na djegësh e të na pjekësh e të na vrasësh siç bënë shokët e tu. (Gj.U.V. 206).- Σκέφτεσαι πως θα ‘ρθει μια μέρα που θα ριχτείς στα μέρη μας με το στρατό σου και θα μας κάμεις και θα μας ψήσεις και θα μας σκοτώσεις όπως έκαναν κι οι σύντροφοί σου. (Σ.Ν.Σ. 243).*

Në fjalitë e varura kundrinore folja përdoret detyrimisht në të tashmen e lidhore kur folja e fjalisë drejtuese shpreh vullnet, dëshirë apo qëndrimin e një njeriu¹⁹⁶, shembulli (7). Edhe në greqisht e tashmja e lidhore *të bëj*, në këtë rast jepet me të tashmen e lidhore *na κάνω*. Ndërsa në shembullin (8) e tashmja lidhore së foljes jepet me aoristin e lidhore. Përkthyesja ka zgjedhur gjithashtu që folja të vendoset në vetën e parë shumës, në vend të vetës së parë të numrit njëjës, ku folja ndodhet në gjuhën shqipe, por kjo nuk lidhet me mënyrën lidhore ku gjendet folja.

- 7) *Ç’ më këshilloni të bëj? (Gj.U.V. 32) – Τι με συμβουλεύεται δηλαδή εσείς να κάνω; (Σ.Ν.Σ. 39)*
- 8) *Një mendje më thotë t’i lë për verën e vitit që vjen. (Gj.U.V. 83) – Μερικές φορές σκέφτομαι να το αφήσουμε για το καλοκαίρι της επόμενης χρονιάς. (Σ.Ν.Σ. 101)*

E tashmja e lidhore së foljes në fjalinë e varur, mund të ndiqet nga fjali të pavarura, ku folja është në lidhore, shembulli (9). Në gjuhën greke folja në të tashmen e lidhore, *të fle*, jepet me aoristin e lidhore, *να κοιμηθώ*, ndërsa folja *të jem*, jepet me të tashmen e lidhore së greqishtes *να είμαι*. Në rastet kur folja në gjuhën shqipe ndodhet në një fjali të varur, ose të pavarur, e njëjta gjë në këtë rast ndodh edhe në gjuhën greke. Kur folja e fjalisë kryesore është folja *filloj* në të tashmen e dëftores në gjuhën greke, kjo folje mund të vendoset në aoristin e dëftores, ndërsa folja në lidhore të jetë në të tashmen, shembulli (10).

- 9) *Dua të fle, mendoj. Të fle. Të fle. Të jem i heshtur si kamioni që është përjashta. (Gj.U.V. 218) – Θέλω να κοιμηθώ, σκέφτηκα. Να κοιμηθώ. Να κοιμηθώ. Να είμαι ήσυχος σαν το φορτηγό που είναι έξω. (Σ.Ν.Σ. 257)*
- 10) *Megjithatë çuditë sesa nuk filloni të pini. (Gj.U.V. 32) – Κι όμως μένω κατάπληκτος που δεν αρχίσατε να πίνετε τώρα. (Σ.Ν.Σ. 39)*

Foljet në të tashmen e lidhore përdoren, siç përmendëm edhe më sipër, përveç fjalive të varura edhe në fjali të pavarura, ose kryesore. Kur këto fjali janë fjali pyetëse të

¹⁹⁶ Po aty

drejta, shprehet nëpërmjet këtyre foljeve modaliteti i mundësisë, shembulli (11). Në këtë rast fjalia pyetëse nis me ndajfoljen pyetëse *ku*, dhe me të njëjtën ndajfolje, *πού*, përcillet edhe në gjuhën greke. Po ashtu e tashmja e lidhore *të çon*, përcillet në greqisht me të tashmen e lidhore *να οδηγεί*, madje në gjuhën greke modaliteti i mundësisë përforcohet nëpërmjet përdorimit të ndajfoljes *τάχα* (*vallë*, në këtë rast).

- 11) *Ku të çon kjo rrugë fushe?* (Gj.U.V. 26)- *Πού να οδηγεί τάχα αυτός ο αγροτικός δρόμος;* (Σ.Ν.Σ.)
- 12) – *Ç' të jetë?* – pyeti gjenerali. (Gj.U.V. 171) – *Τι να είναι;* ρώτησε ο στρατηγός. (Σ.Ν.Σ. 203)
- 13) – *Ç' të ketë vallë?* – pyeti ai. (Gj.U.V. 171) – *Τι να έχει άραγε;* ρώτησε. (Σ.Ν.Σ. 203)31)
- 14) *Përse të shqetësoheni?* – tha prifti. (Gj.U.V. 21) – *Γιατί ανησυχείτε;* είπε ο ιερέας. (Σ.Ν.Σ. 26)

Në shembujt (12), (13) fjalia fillon me përemrin pyetës *ç'*, dhe me të njëjtin përemër pyetës (*τι*) jepen edhe në greqisht, dhe foljet në lidhoren e së tashmes *të jetë*, e *të ketë* jepen përkatësisht me të tashmen e lidhore së këtyre foljeve në gjuhën greke *να είναι*, *να έχει*. Por mund të ndodhë, si në shembullin (14), që e tashmja lidhore së shqipes *të shqetësoheni*, jepet me të tashmen e dëftores së greqishtes *ανησυχείτε*.

Në rastet kur fjalitë kryesore nuk janë pyetëse, atëherë folja në të tashmen e lidhore mund të shprehë nxitje, si në shembujt (15), (16). Në këtë rast e tashmja e lidhore së shqipes jepet me aoristin e lidhore së greqishtes. E njëjta gjë ndodh edhe në shembullin (17).

- 15) *U ngatërruam, tha,- hymë në shteg të verbër. – Të shohim edhe një herë hartat.* (Gj.U.V. 26) – *Χάσαμε τον προσανατολισμό, είπε, μπήκαμε σε αδιέξοδο μονοπάτι. – Να ξαναδούμε το χάρτη.* (Σ.Ν.Σ. 31)
- 16) *Pa ta provojmë njëherë nga e djathta.* (Gj.U.V. 26) – *Ας δοκιμάσουμε μια φορά ακόμα κι απ' τα δεξιά.* (Σ.Ν.Σ. 31)
- 17) – *Të ikim,* – tha papritur. – *Të ikim menjëherë.* (Gj.U.V. 210)– *Πάμε να φύγουμε, είπε ξαφνικά. Να φύγουμε αμέσως.* (Σ.Ν.Σ. 249)

3.2.1.1.1 E tashmja e lidhore me vlerën e mënyrave të tjera

E tashmja e lidhore së shqipes mund të përdoret edhe me vlerën e mënyrës urdhërore, shembulli (1). Në këtë rast edhe në gjuhën greke kjo lidhore ka vlerën e mënyrës urdhërore, vetëm se nuk përdoret e tashmja e lidhore së greqishtes, por aoristi i saj. Ndërsa në shembullin (2) e tashmja e lidhore së shqipes me vlerën e mënyrës urdhërore, jepet po me të tashmen e lidhore së greqishtes dhe me po të njëjtën vlerë, atë të urdhërores. Kjo vlerë e urdhërores jepet jo vetëm me pohoren po edhe me mohoren e së tashmes së lidhore, shembulli (3). Në shqip ashtu si edhe në greqisht, mohorja formohet me pjesëzën mohuese *mos* (*μη*).

- 1) *Të lutem për diçka,* – tha ajo, – *të marrësh vesh si e qysh u vra, kush iu gjend te koka kur dha shpirt, kush i dha ujë dhe ç'porosi la.* (Gj.U.V. 44) – *Θα σε*

- παρακαλέσω για κάτι, είπε.... Na μάθεις πώς σκοτώθηκε, ποιος ήταν κοντά του όταν ξεψύχησε, ποιος του 'δωσε λίγο νερό και ποιες ήταν οι τελευταίες του επιθυμίες. (Σ.Ν.Σ. 53)*
- 2) *Vetëm të mbani rregull, ndryshe do t'ju prapësoj. (Gj.U.V. 112) – Μόνο να κρατάτε τη σειρά, διαφορετικά θα σας γυρίσω πίσω. (Σ.Ν.Σ. 135)*
- 3) *Të jini krenar. Të mos e ulni kokën para tyre. (Gj.U.V. 45) – Να είστε περήφανος. Να μην σκύψετε το κεφάλι μπροστά τους. (Σ.Ν.Σ. 54)*

Vëmë re se lidhorja përdoret me vlerën e urdhërores edhe për vetat për të cilat mënyra urdhërore nuk ka forma të veçanta, vetën e tretë apo vetën e parë. Në shembujt (4),(5), e tashmja e lidhores së shqipes, jepet me aoristin e lidhores së greqishtes, ndërsa në shembullin (6) folja të bëjmë, jepet me të tashmen e lidhores së greqishtes *να κάνουμε*. Folja *κάνω* nuk mund ta formojë aoristin e dëftores dhe si e tillë nuk mund të formojë as kohët që formohen nga tema e aoristit, siç është aoristi i lidhores.

- 4) *I thoni atij që të mos i përziejë këta me të tjerët, biro, - tha plaka. (Gj.U.V. 50) - Πείτε σ'αυτόν, μωρέ παιδί μου, να μην τους ανακατέψει με του άλλους. (Σ.Ν.Σ. 62)*
- 5) *Gjashtë të tjerët të vijnë me mua, - tha. (Gj.U.V. 112) – Οι άλλοι έξι να 'ρθουν μαζί μου, είπε. (Σ.Ν.Σ. 136)*
- 6) *O burra, ta bëjmë hi! – thirri ai dhe u sul i pari. (Gj.U.V. 109) – Άντρες, εμπρός να τον κάνουμε στάχτη! φώναζε αυτός και όρμησε πρώτος. (Σ.Ν.Σ. 131)*

E tashmja e mënyrës lidhore mund të përdoret gjithashtu edhe me vlerën e dëshirores, madje për gjuhën greke e cila nuk ka forma të veçanta foljore për mënyrën dëshirore, mënyra lidhore është mënyra kryesore me këtë vlerë, shembujt (7), (8).

- 7) *Të mbërrini shëndoshë e mirë në atdhe! (Gj.U.V. 246) – Με το καλό να γυρίσετε υγιής στην πατρίδα σας! (Σ.Ν.Σ. 290)*
- 8) *-Udha e mbarë! - i tha plaku specialistit. Të veni me shëndet. (Gj.U.V. 101) – Καλό δρόμο! Του είπε ο μυλωνάς. Να 'στε καλά. (Σ.Ν.Σ. 123)*
- 9) *-Veç mos bëjë mot i keq! (Gj.U.V. 28) – Αρκεί να μην έχει κακό καιρό. (Σ.Ν.Σ. 34)*
- 10) *Shët, se mos dëgjojnë. (Gj.U.V. 210) – Σουτ, μη μας ακούσουν. (Σ.Ν.Σ. 247)*

E tashmja e lidhores së shqipes mund të haset gjithashtu edhe pa treguesin të, zakonisht në rastet kur folja është në mohore, pra i paravendoset pjesëza mohuese *mos*, shembulli (9). Edhe në gjuhën greke në këtë rast folja është në të tashmen e lidhores, por foljes i paravendoset treguesi i lidhores *να*, dhe pjesëza mohore ndodhet midis këtij treguesi dhe foljes, pra në gjuhën greke siç do të vërejmë edhe më poshtë struktura e foljes në lidhore nuk është e ngurtësuar, por lejon që në të të ndërfiten edhe elementë të tjerë. Të njëjtën gjë vërejmë edhe në shembullin (10), veçse në gjuhën greke e tashmja e lidhores së shqipes jepet me aoristin e lidhores së greqishtes.

3.2.1.2 E tashmja e lidhore së greqishtes

Siç e përmendëm edhe më sipër, për lidhoren e greqishtes kohët gramatikore nuk shprehin një moment të caktuar kohor, por shprehin modalitete dhe aspektin e foljes¹⁹⁷. Në rastin e së tashmes së lidhore, folja ka të njëjtën formë me të tashmen e dëftores dhe gjatë përdorimit në ligjërim i paravendoset zakonisht pjesëza *να*, ose pjesëza të tjera siç do të shohim në vazhdim. Strukturën e foljes në të tashmen e lidhore mund ta paraqesim si më poshtë:

Koha e tashme e lidhore së greqishtes (lidhorja e vazhduar)		
Pjesëz	Tema foljore e së tashmes së dëftores	Mbaresa e së tashmes së dëftores
<i>να/ο</i>	<i>διβάζ-/αγαπ-/κατοικ-</i>	<i>-ω/-ώ/-ώ</i>
		<i>-εις/-άζ/-είς</i>
		<i>-ει/-ά/-άει/-ει</i>
		<i>-ουμε/-άμε</i>
		<i>-ετε/-άτε/-είτε</i>
		<i>-ουν/-άνε</i>

Tabela 3.26

E tashmja e lidhore apo lidhorja e vazhduar siç shprehet ndryshe karakterizohet nga aspekti imperfektiv, pra tregon vazhdimësi të veprimit. Sipas Bakker-it, i cili studioi konceptin e përkatësisë kohore, aspekti i vazhduar i një foljeje në lidhore në një fjali të nënrenditur tregon se veprimi i foljes përkon nga ana kohore me veprimin e foljes së fjalisë kryesore, pra të dyja veprimet kryhen njëkohësisht, gjë që nuk ndodh kur aspekti i foljes është perfektiv¹⁹⁸. Kështu foljet *filloj*, *vazhdoj*, *mbaroj* ndiqen nga lidhorja e vazhduar, sepse fillimi, vazhdimi, apo përfundimi i një veprimi konsiderohet se përkon me çastin kohor, qoftë edhe minimalisht, me veprimin e foljes e cila ndjek foljen kryesore¹⁹⁹, shembulli (1). Në këtë rast folja *ἀρχισε* (*filloi*) është në të kryerën e thjeshtë të dëftores dhe si në gjuhën greke ashtu edhe në shqip folja e cila e ndjek ndodhet në të tashmen e lidhore. Për gjuhën greke në çfarëdo kohe që të ndodhet folja *αρχίζω* (*filloj*) kur folja që e pason është në lidhore, atëherë ajo vendoset gjithmonë në të tashmen e lidhore. Kjo gjë nuk ndodh në gjuhën shqipe, por në varësi të kohës në të cilën ndodhet folja *filloj*, vendoset edhe folja në lidhore e cila e pason. Pra ndërsa në greqisht kemi: *αρχίζω να τρώω*, *ἀρχισα να τρώω*, *θα αρχίσω να τρώω*, *έχω αρχίσει να τρώω*, *είχα αρχίσει να τρώω*, ndërsa folja *αρχίζω* (*filloj*) gjendet përkatësisht në kohën e tashme, aorist, të ardhmen, të kryerën, më se të kryerën, folja (*të ha*) në të gjitha rastet ndodhet në të tashmen e lidhore. Në gjuhën shqipe do të thoshim: *filloj të ha*, *filloja të haja*, *fillova të haja*, *do të filloj të ha*, *kam filluar të ha*, *kisha filluar të haja*, *do të filloja të haja*, *do të*

¹⁹⁷ Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπιμιώτης, *vep. e cit.*, 2004, 454

¹⁹⁸ W.F.Bakker, *The aspectual differences between the present and aorist subjunctives in Modern Greek*, *Ελληνικά* 23, 78 – 108, 1970

¹⁹⁹ P. Mackridge, *vep. e cit.*, 1990, 180

kem filluar të ha. Vërejmë se kur folja *filloj* ndodhet në të tashmen, të ardhmen, të kryerën dhe të ardhmen e përparme folja që vijon është në të tashmen e lidhore, ndërsa kur folja *filloj* ndodhet në kohet e tjera të dëftores, folja që vijon është në të pakryerën e lidhore. Në shembullin (1) vërejmë se gjatë përkthimit në gjuhën shqipe folja *filloj* ndodhet në të kryerën e thjeshtë, ndërsa folja që e pason në të tashmen e lidhore. Ndërsa në shembullin (2) folja *αρχίζω* në gjuhën greke ndodhet në aoristin e dëftores dhe është përcjellë në shqip me të kryerën e thjeshtë të dëftores *fillova*, ndërsa e tashmja e lidhore të greqishtes *να ξεμολογιέται*, është përcjellë me të pakryerën e lidhore së shqipes *t'i rrëfente*. Në shembullin (3) përkthyesi ka zgjedhur që të mos e përkthejë fare foljen *άρχισα* (*fillova*) dhe të përcjellë të tashmen e lidhore së foljes *κατεβαίνω* me të kryerën e thjeshtë të dëftores së foljes *zbres*, *zbrita*, ndërkohë që në gjuhën shqipe mund të përdoret forma *fillova të zbrisja*, që do të ishte analogja e *άρχισα να κατεβαίνω*.

- 1) Πείνασε ο Γιαννακός, έβγαλε από το ταγάρι του ένα μεγάλο κομμάτι ψωμί, μια φούχτα ελιές κι ένα κρεμμύδι κι άρχισε να τρώει, ευτυχισμένος. (X.Ε. 59)- *Janakon e mori uria, nxori nga trasta një copë të madhe buke, një grusht ullinj me një kokërr qepë dhe filloi të hajë me shije.* (K.K.P. 58)
- 2) Κι άρχισε βιαστικά με κομμένη ανάσα να του ξεμολογιέται γιατί ήρθε στη Σαρακήνα, τι συμφωνία είχε κάμει με το γερο-Λαδά και για τις τρείς λίρες που πήρε καπάρο(X.Ε. 95)- *Dhe filloi t'i rrëfente me nxitim, me një frymë për ç'ka erdhi në Saraqinë, se ç'marrëveshje kishte bërë me plakun Lladha si dhe për tri lirat që pat marrë si kapar.....* (K.K.P. 99)
- 3) Πήρα άλλο δρόμο, άρχισα να κατεβαίνω κατά το περιγιάλι. (B.Π. 178)- *Ktheva në një rrugë tjetër, zbrita teposhtë bregut të detit.* (Z. 160)

E tashmja e lidhore së greqishtes jepet në gjuhën shqipe edhe me të pakryerën e lidhore së shqipes, trajtë kohore kjo që siç do ta shohim edhe më poshtë nuk ekziston në gjuhën greke. Në shembullin (4) foljet *να τρώει*, *ν'αφομοιώνει*, *να δένει*, të cilat plotësojnë foljen e fjalisë kryesore e cila gjendet në të pakryerën e dëftores jepen në shqip përkatësisht e foljet *të rritej*, *hante*, *përvetësonte*, *shtinte*, të cilat janë në lidhje bashkërenditëse asindetike ndërmjet tyre. Në shembullin (5) e tashmja e lidhore *να ρχεται*, ose lidhorja e vazhduar jepet në gjuhën shqipe me të pakryerën e dëftores *vinte*, e cila gjithashtu karakterizohet nga aspekti imperfektiv. Hasim edhe raste kur e tashmja e lidhore së greqishtes, që është një formë foljore e eptueshme jepet në gjuhën shqipe me një formë të pashtjelluar si në shembullin (6) me përcjellore. Në këtë rast folja në të tashmen e lidhore *να του ζεσταίνει* jepet me përcjelloren *për t'i ngrohur*, ndërkohë që përkthyesi ka zgjedhur që të mos e përdorë në versionin shqip të tashmen e lidhore *να κατεβαίνει*. Me të pakryerën e dëftores jepet e tashmja e lidhore së greqishtes edhe në shembullin (7).

- 4) Το ένιωθα ακατάπαυστα μέσα μου να τρώει, ν'αφομοιώνει, να δένει. (B.Π. 20) - *E ndjeja natë e ditë brenda meje të rritej, hante, përvetësonte ç'ka kish ngrënë, shtinte lastarë.* (Z. 16)
- 5) Είδα εγώ απ' αλάργα το Λενιό να ρχεται, ανάθεμά το· (X.Ε. 110) - *Që për së largu dallova Lenjoin që vinte, ta kish marrë dreqi;* (K.K.P. 115)

- 6) *Ἦπιε το ρούμι ρουφιά ρουφιά· το κρατούσε πολλήν ώρα στο στόμα του να το χαρεί, κι έπειτα το άφηνε αγάλια **να κατεβαίνει** και **να του ζεσταίνει** τα σωθικά. (B.Π. 22)- E rrëkëlleu rumin gllënjka – gllënjka. Çdo gllënjkë e shkonte nëpër gojë një copë të gjatë here për t'ia ndjerë më shumë lezetin e pastaj e lëshonte me gurgullimë, lehtë – lehtë nëpër grykë **për t'i ngrohur** mushkëritë. (Z. 18).*
- 7) *Μα αυτός έπεσε απάνω μου και δώστου **να με φιλάει** και να κλαίει σα μωρό παιδί. (B.Π. 35)- Por ai m'u lëshua i tëri përsipër dhe s'i pushonte gulçi. Më **puthte** si fëmijë. (Z. 30)*
- 8) *Αυτό θα πει ελευθερία, συλλογιζόμουν. **Να 'χεις** ένα πάθος, **να μαζεύεις** χρυσές λίρες, και ζαφνικά **να νικάς** το πάθος και **να σκορπάς** όλο το έχει σου στον αέρα. (B.Π. 35) – Kësaj i them liri! Thoshja me mendje. **Të kesh** një pasion, **të kesh bërë** verdhushka me okë dhe vjen befaz një ditë e ti e **mund** pasionin: merr gjënë e katandinë dhe e **flak** poshtë e përprjetë. (Z. 31)*

Foljet *να 'χεις*, *να μαζεύεις*, *να νικάς*, *να σκορπάς* në shembullin (8) janë në të tashmen e lidhore dhe lidhen ndërmjet tyre në mënyrë bashkërenditëse, ndërsa në gjuhën shqipe e para jepet me të tashmen e lidhore *të kesh*, e dyta me të kryerën e lidhore *të kesh bërë* dhe dy të tjerat me të tashmen e dëftores *mund* dhe *flak*. Kjo është një zgjedhje përkthyesit pasi të katërta këto folje mund të jepen në shqip me të tashmen e lidhore: *Kësaj i thonë liri, mendoja. Të kesh* një pasion, *të grumbullosh* verdhushka dhe papritur të *mundësh* pasionin e *të hedhësh* në erë gjithë pasurinë tënde.

3.2.1.2.2 Lidhëria e greqishtes me vlerën e mënyrave të tjera

Lidhëria e vazhduar, si edhe ajo thjeshtë mund të përdoren në vlerën e mënyrave të tjera foljore si p.sh. urdhërores apo dëshirores. Për sa i përket urdhërores e tashmja e lidhore përdoret në vend të se tashmes së urdhërores, e cila karakterizohet gjithashtu nga aspekti imperfektiv. Siç vëmë re në shembullin (1) lidhëria e vazhduar e greqishtes jepet me urdhëroren e shqipës. Edhe në rastin e përkthimit të vargut të Kavafit: *Τα μεγαλεία **να φοβάσαι**, ω ψυχή. (K., Μάρτιαι ειδοί)* të dy përkthyesit kanë zgjedhur urdhëroren *ruhu* dhe *ruaju* për përcjellë të tashmen e lidhore së greqishtes *να φοβάσαι: Ο **shpirt**, ruhu nga madhështitë. (K.,L.Z) – Prej madhështive ruaju, o shpirt. (K., A.S)* Lidhëria mund të përdoret me vlerën e urdhërores edhe në rastet kur kjo mënyrë nuk mund të formojë forma gramatikore të posaçme, si në rastin e vetës së parë dhe vetës së tretë. Në këto raste lidhëria e greqishtes jepet me lidhoren e shqipës duke qenë se edhe në shqip urdhërorja nuk ka forma të veçanta për këto dy veta, shembulli (2).

- 1) *Να με **συμπαθάτε**, είπε· θα πάω σπίτι. (B.Π. 110) – Më **falni** – tha. – Po shkoj në shtëpi. (Z. 98)*
- 2) *Να' χει το νου της, **να μην ξεμυτίσει** στο χωριό, ακούς; (B.Π. 175)- E t'i **vërë gishtin kokës**: të këtë mendjen mos **të dalë** në fshat gjer të kalojë kjo valë e të harrohet gjëma. (Z. 157)*

Lidhëria e shqipës mund të përdoret edhe me vlerën e mënyrës dëshirore. Duke qenë se gjuha greke nuk ka një formë të veçantë foljore për këtë mënyrë të shqipës, të cilën greqishtja e vjetër e ka pasur, përdor lidhoren për të dhënë kuptimin e saj, shembujt (3),

(4) ku lidhja e vazhduar e foljeve *va χεις, ας είναι*, në gjuhën shqipe jepet përkatësisht me të tashmen e dëshirores së këtyre foljeve *paç* dhe *qoftë*. Në rastet kur në gjuhën greke kemi të bëjmë me shprehje në mënyrën lidhore të cilat shprehin modalitetin e dëshirës përkthyesi ka zgjedhur dëshiroren e shqipes për ta përcjellë atë në shqip, shembujt (5), (6), (7), (8).

- 3) *Να χεις την ευκή μου, Αλέξη, μου λέγε, βάρδα από γυναίκες. (B.Π. 142)- Paç uratën, mor Aleks, - më thoshte i ndjeri – mos ua var grave! (Z. 127)*
- 4) *Μα ας είναι καλά το σαντούρι. (B.Π. 24) – Po qoftë me jetë një ky sandur. (Z. 21).*
- 5) *Αυτό που σου λέω εγώ, ο Θεός να την έχει καλά! (B.Π. 109) – Këtë që po të them unë, Zoti e ruajt! (Z. 97)*
- 6) *Να ‘ναι καλά, να της πεις...(B.Π. 174)-Të mira pastë! Kështu i thuaj! (Z. 157)*
- 7) *Ε, η Παναγία να σου δίνει καλά κέρδητα. (B.Π. 180) - E Shën Mëria ta shpërbleftë. (Z. 162)*
- 8) *Δεν πειράζει, μουρμούρισα ας είναι.....(B.Π. 19) – S’ka gajle, - thashë nëpër buzë, - kështu qoftë.... (Z. 15)*

Pjesëza mohuese që përdoret në lidhoren e greqishtes është pjesëza *μην (mos)*, shembulli (9).

- 9) *Μάχουμουν να μη βλέπω, να μην ακούω, και να κρατήσω ακόμα τ’ όραμα που χάνουνταν. (B.Π. 20) - Bëja ç’ish e mundur të mos e shikoja, të mos u vija veshin fjalëve që këmbeshin e thuheshin hedhurazi dhe të përmbaja ende atë vegim që zhdukej e zhdukej. (Z. 16)*

3.2.2. Aoristi i lidhore së gjuhës greke

Emërtimi aorist i kësaj forme kohore nuk ka të bëjë me momentin e kryerjes së veprimit, pra nuk është një formë kohore që tregon se veprimi kryhet në të shkuarën, por se trajta e foljes në këtë kohë formohet nga tema e aoristit. Mbaresat që merr, janë mbaresat e kohës së tashme të dëftores. Kjo formë e lidhore përdoret pothuajse gjithmonë duke i paravendosur një apo më shumë tregues të lidhjes me nënrenditje (që në anglisht janë të njohur si subjunctive markers apo mood formants²⁰⁰) të cilët janë lidhëza kohore që tregojnë parakohësi, si edhe disa lidhëza të tjera²⁰¹. Por mund të hasen edhe raste në të cilat të mos paravendosen këta tregues si në rastin e disa strukturave sintaksore të përbëra nga çifte fjalish me kuptim të kundërt ku shprehet indiferentizmi për atë ç'ka do të ndodhë. Të dyja këto fjali lidhen ndërmjet tyre me lidhje bashkërenditëse kundërshtore ku njëra është pohore e tjetra mohore dhe të dyja bashkë lidhen në mënyrë të nënrenditur kushtore me një fjali të tretë²⁰²: *Ἐρθεις δεν ἔρθεις εμεις θα πάμε.* – Vjen apo nuk vjen ti ne do të shkojmë.

Në mënyrë skematike strukturën e aoristit të lidhore mund ta paraqesim si më poshtë:

Aoristi i lidhore së greqishtes (lidhorja e thjeshtë)		
Pjesëz	Tema foljore e aoristit të dëftores	Mbaresa e së tashmes së dëftores
να/ο	διαβάσ-/αγαπήσ- /κατοικήσ-	-ω
		-εις
		-ει
		-ουμε
		-ετε
		-ουν

Tabela 3.27

Në të shumtën e rasteve aoristi i lidhore së greqishtes përdoret në fjali të nënrenditura, por në rastin e fjalive pyetëse dhe në disa raste të tjera, të cilat do t'i shqyrtojmë në vazhdim mund të përdoret edhe në fjali të pavarura. Duke qenë se në shqip nuk e hasim aoristin e lidhore si formë gramatikore më vete le të shohim se si kjo strukturë e greqishtes jepet në shqip. Ajo mund të jepet me të tashmen e lidhore së shqipes, shembulli (1). Edhe në rastet e lidhore voluntative aoristi i saj jepet me të tashmen e lidhore së shqipes, shembulli (2). Në këtë rast strukturës së foljes në greqisht i ndërfiten dy trajta të shkurtra ndërsa në gjuhën shqipe njëjta trajtë e shkurtër i

²⁰⁰ Barri i quan këta tregues syntactic converters, *Aoristic present, "subjunctive" and converters in Modern Greek*, 1981

²⁰¹ P. Mackridge, *vep. e cit.*, 1990, 384

²⁰² Αχιλλ. Τζάρτζανος, *vep. e cit.*, 1991, 300

paravendoset strukturës së foljes, ndërsa tjetra bashkohet me treguesin e lidhores të. Edhe në shembullin (3) aoristi i lidhores së greqishtes jepet me të tashmen e lidhores së shqipes

- 1) *Να το σκάσουμε έτσι και να την αφήσουμε ολομόναχη, είπα, δεν είναι ντροπή;* (B.Π. 142)- *S'është turp t'ia mbathim kështu hajdutçe ta lëmë fillikate?* (Z. 126)
- 2) *Πόσες φορές να σου το πω;* (B.Π. 99) – *Sa herë të ta them?* (Z. 88)
- 3) *-Να σου πω μιαν ιδέα, αφεντικό, είπε, μα να μη θυμώσεις.* (B.Π. 106) – *Po të them diçka, zotni! Po mos u nxe...* (Z. 94)
- 4) *Ο σκληρός λόγος αυτός του φίλου μου κουφοδρομούσε μέσα μου, κι από τότε γύρευα αφορμή να παρατήσω τα χαρτιά και να ριχτώ στη στην πράξη.* (B.Π. 20) – *Kjo fjalë e sertë e mikut tim bënte shteg e hynte drejt e në shpirtin tim e unë që në kryeherë kërkoja seber të lija mënjane letrat e të hidhesha në aksione konkrete.* (Z. 16)
- 5) *Έκαμα να καμουφλάρω κι εγώ μ' ένα σκληρό λόγο την ταραχή μου, μα ντράπηκα.* (B.Π. 18) – *Bëra të kamufloja dhe unë tronditjen përmes një fjale të sertë, por u bëra me turp.* (Z. 13)
- 6) *Έκαμα να γυρίσω το κεφάλι να δω το φίλο μου στερνή φορά, μα κρατήθηκα.* (B.Π. 19) – *Bëra të ktheja kryet për herë të fundit, por e mbajta veten.* (Z. 15)

Në rastin kur lidhorja përdoret në fjali të nënrenditura përkthimi i aoristit të greqishtes, kur folja e fjalisë kryesore është në një nga kohët e së shkuarës bëhet me të pakryerën e lidhores së shqipes, shembujt (4), (5). Në shembullin (6) folja *να γυρίσω* jepet me të pakryerën e lidhores të *ktheja*, ndërsa folja *να δω* është parë e arsyeshme nga përkthyesi që të shmanget, ndërkohë që mund të ishte dhënë po me të pakryerën e lidhores të *shikoja mikun tim për herë të fundit*.

Ka edhe raste kur aoristi i lidhores së greqishtes jepet me përcjelloren e shqipes, siç do të shohim edhe më poshtë trajta e pashtjelluar përcjellore nuk ekziston në gjuhën greke dhe për ta përcjellë atë në gjuhën greke në të shumtën e rasteve përdoret lidhorja e greqishtes, shembulli (7). Edhe folja *να κρύψει* në shembullin (8) përcillet me përcjelloren *për të fshehur*, por në këtë rast në greqisht foljes i paravendoset edhe lidhëza qëllimore *για*. Për të përcjellë trajtën foljore *να κοιμηθούν* në shembullin (9) është përdorur shprehja *shkonin për gjumë*, edhe pse mund të jepet edhe me të pakryerën e lidhores duke i paravendosur lidhëzën *që: që të flinin*, ose me përcjelloren *për të fjetur*. Lidhorja përdoret edhe gjatë rrëfimit, lidhore e cila quhet lidhore narrative dhe në shqip përcillet me dëftore, me të tashmen e dëftores në shembullin (10).

- 7) *Είχα κατέβει στο λιμάνι να πάρω το βαπόρι για την Κρήτη.*(B.Π. 15)- *Kisha rënë në liman për të udhëtuar me traget për në Kretë.* (Z. 10)
- 8) *Γεια σου, χαρτοπόντικα! Είπε περγελαχτά, για να κρύψει τη συγκίνησή του.* (B.Π. 17) – *Shëndet, o mi letrash! – tha me të tallur, për të fshehur mallëngjimin.* (Z. 13)
- 9) *Οι γλώσσες, οι σκορπιοί, τα σελάχια, γυρνούσαν από τις νυχτερινές επιδρομές τους να κοιμηθούν.* (B.Π. 15) – *Gjuhcat, akrepi dhe kandili i detit ktheheshin nga gjahu i natës e shkonin për gjumë.* (Z. 11)

- 10) *Ἴσως, ἔλεγα, **να κουραστώ** περπατώντας και **ν' αλαφρώσω** από την ανοιζιάτικη θλίψη. (B.Π. 176) – Ndoshta, mendoja me vete, **lodhem** duke ecur, nga ky trishtim pranveror. (Z. 158)*

Edhe aoristi i lidhores ashtu si edhe e tashmja e saj mund të përdoren me vlerën e urdhërores dhe dëshirores. Lidhorja siç vërejtëm edhe më sipër mund të përdoret me vlerën e urdhërores për vetat, për të cilat urdhërorja nuk ka forma të veçanta gramatikore. Në shembullin (11) lidhorja *να πας* është përdorur me vlerën e urdhërores dhe në shqip gjithashtu është përcjellë me të tashmen e lidhores *të shkosh*, e cila përdoret edhe ajo me vlerën e urdhërores *shko*. Ndërsa në shembullin (12) lidhorja e vetës së tretë *να γίνει* ka vlerën e urdhërores *të bëhet*. Përkthyesi ka zgjedhur që në shqip ta përcjellë me veten e parë shumës të së tashmes së lidhores *të bëjmë*, por përsëri me vlerën e urdhërores, përderisa për këtë vetë nuk ka formë të veçantë gramatikore në mënyrën urdhërore.

- 11) *Να πας, της λέω, γιαγιάκα μου, **να πας**. (Z. 162) – **Të shkosh**, si jo, **të shkosh**, moj gjyshe! (Z. 145)*
12) *Τα λεφτά τελειώνουν Ζόρμπα, 'ο,τι είναι να γίνει, **να γίνει** γρήγορα. (B.Π. 147)- Po na mbarojnë parat, Zorba! **Të bëjmë** ç'kemi për të bërë pa humbur kohë. (Z. 130)*

Në rastet kur lidhorja përdoret me vlerën e dëshirores, si për të shprehur urime ashtu edhe mallkime, në shqip mund të jepet më së miri me të tashmen e dëshirores, shembujt (13), (14).

- 13) *Ου **να χαθεί** ο ξετσιπότος! (B.Π. 25) – Uf, **t'u mbylltë**, mor i praudhë! (Z. 22)*
14) *- **Να χαθεί**, η παλιοβρώμα! μουρμούρισε ο Ζορμπάς κι έφτυσε χάμω....(B.Π. 142)- Eh, iu **shoftë** gjaku! Dosë e dosëve! – mërmëriti Zorba duke pështyrë përtoke. (Z. 126)*
15) *Ο Θεός **ν' αγιάσει** τα κόκαλα του παππού μου, είπε. (B.Π. 142) – Zoti i **ndritë** eshtrat tim gjyshi! – tha. (Z. 127)*
16) *Κι ο Θεός **να βάλει** και σε μας τους άντρες γνώση! (B.Π. 100) – Zoti na **dhëntë** pesë pare mend dhe ne burrave. (Z. 89)*

3.2.2.1. Lidhorja e greqishtes me parafjalë

Gjatë përdorimit të lidhores mund të ndodhë që ajo të përdoret edhe e paraprirë nga një parafjalë, parafjalët *χωρίς, δίχως* (*pa*). Në këto raste lidhorja është pjesë e fjalisë së nënrenditur. Në gjuhën shqipe, duke qenë se një përdorim i tillë është i pa mundur kjo strukturë jepet në përmjet formës së pashtjelluar mohore.

- 1) *Ο φίλος μου, χωρίς να περιμένει απάντηση, σηκώθηκε. (B.Π. 17) – Miku im, pa pritur përgjigje, u ngrit befás. (Z. 13)*
- 2) *Ωσπου τα μάξεψα όλα στην ποδιά μου / δίχως να βηματίσω προχωρούσα. (E., Μαρία Νεφέλη) – Gjersa mblodha gjithçka në prehrin tim/ pa hedhur asnjë hap përparoja.*

3.2.2.2. Lidhorja e greqishtes me nyje

Në gjuhën greke nyja shquese e gjinisë asnjane *το* mund të emërzojë pothuajse çdo element të gjuhës, në mënyrë që ai të funksionojë si emër apo togfjalësh emëror, të luajë domethënë rolin e kryefjalës, kundrinorit apo përcaktorit kallëzuesor²⁰³. Edhe lidhorja mund të përdoret me një shquese *το* duke kryer kështu në fjali funksionin e një emri. Në shembullin (1) folja *να ζεις*, jo vetëm që përdoret me nyje por kjo nyje është në rasën gjinore, pra në këtë rast kjo folje luan rolin e një emri në gjinore. Në gjuhën shqipe kjo strukturë mund të jepet me emrin prejfoljor asnjane *të jetuarit* i cili mbart në vetvete edhe veprimin që shpreh folja *να ζεις* (*të jetosh*).

- 1) *Εδώ – μέσα στα πρώιμα ψιθυρίσματα των πόθων, ένιωσες για πρώτη φορά την οδυνηρή ευτυχία του να ζεις! (E. Η συναυλία των γυακίνθων) – Këtu – mes pëshpërimave të hershme të pasioneve/ ndjeve për të parën herë lumturinë e dhimbshme të të jetuarit. (E., Koncerti i zymbylave)*
- 2) *... Μα απ'το πολύ να σκέπτεται και να θυμάται/ ο γέρος εζαλίσθηκε (K., Ένας γέρος) - ...Duke menduar e duke kujtuar shumë/ plaku u trullos. (L.Z.) ...Por si mendoi e u mallua shumë/ plaku u trand. (A.S.)*

Foljet *να σκέπτεται* dhe *να θυμάται* të shoqëruara nga parafjala *το* në këtë rast nga dy përkthyes të ndryshëm janë dhënë po me trajta foljore, përkatësisht me trajtën e pashtjelluar përcjellore dhe me folje në të kryerën e thjeshtë të dëftores. Sigurisht këtu kemi të bëjmë me përkthimin e poezisë dhe përzgjedhja e trajtave të fjalëve varet edhe nga faktorë të tjerë, por këto dy folje edhe në këtë rast mund të jepeshin me emrat prejfoljorë asnjane *të menduarit* e *të kujtuarit*: *Nga të menduarit e të kujtuarit e shumë...* Ndoshta kjo nuk do të tingëllonte shumë poetike, por e vëmë në dukje thjesht për të treguar funksionin emëror të këtyre foljeve në këtë rast.

²⁰³ Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπιμιώτης, *ver. e cit.*, 2004, 137

3.2.2.3. Lidhorja e greqishtes pa pjesëzën *να*, ose e paraprirë nga tregues të tjerë

Sic e përmendëm edhe më sipër lidhorja e greqishtes mund të përdoret edhe pa pjesëzën *να* (*të*). Dhe kjo ndodh jo vetëm në rastin kur kemi përsëritjen e së njëjtës folje e cila kur përsëritet bëhet mohuese duke i paravendosur pjesëzën *δεν* (*nuk*): *έρθει δεν έρθει εμείς θα πάμε* – *vjen apo nuk vjen, ne do të shkojmë*, por edhe në rastet që do të shqyrtojmë në vazhdim.

Një tjetër pjesëz e cila i paravendoset foljes në lidhore dhe konsiderohet edhe si tregues i mënyrës lidhore është pjesëza *ας* (*le të*). Në këto raste kjo formë e lidhores mund të përcillet po nëpërmjet lidhores së shqipes, shembulli (1). Por mund të jepet edhe nëpërmjet të tashmes së dëftores, shembulli (2), e cila në këtë rast ka vlerën e urdhërores ashtu si edhe lidhorja e greqishtes. Në shembullin (3) përkthyesi ka zgjedhur që të mos e transmetojë fare foljen në lidhore *ας τ'αφήσουμε*, por mendojmë se nuk do të ndikonte në stilin dhe kuptimin e frazës, përkundrazi do të ishte më afër origjinalit nëse do të thoshim: - *Le t'i lëmë këto, shkofshin në djall!* duke e përcjellë këtë lidhore të greqishtes me lidhoren e shqipes.

- 1) *Ας πάμε λοιπόν στον πρωτόλυκο, να μην έχουμε μεπελάδες.* (X.Ε.61) – **Le të vemi, atëherë, tek ujku i parë, që të mos kemi telashe.** (K.K.P. 60)
- 2) *Ας καθίσουμε στα χοχλάδια: έχω κάτι να σε ρωτήσω.* (B.Π. 274)- **Rrimë një copë herë në ranishte. Dua të të pyes diçka.** (Z. 248)
- 3) *Ας τ'αφήσουμε αυτά να παν στο διάβολο.* (B.Π. 34) – *Shkofshin në djall! – ia bëri.* (Z. 30)

Në rastet kur lidhorja përdoret pa pjesëzat *να*, *ας* ajo paraprihet nga një lidhëz nënrenditëse (kushtore, vendore, kohore) apo një përemër lidhor. Kësaj lidhoreje mund t'i paraprijë lidhëza *αν* (*nëse*), shembulli (4). Në këtë rast lidhëza kushtore jepet në shqip me lidhëzën kushtore *po qe se*, ndërsa folja jepet me të ardhmen e dëftores, gjithsesi edhe kjo lidhore e greqishtes ka kuptimin e së ardhmes së këtë rast. Ndërsa në shembullin (5) përkthyesi ka përzgjedhur në mënyrë mjaft të goditur dëshiroren e shqipes për ta përcjellë këtë formë të lidhores.

- 4) *Δως' μου το χέρι σου· αν ένας απ' τους δυο μας βρεθεί σε κίνδυνο θανάτου....*(B.Π. 19) – **Qepalla! Po qe se njëri prej nesh do të ndodhet në rrezik...** (Z. 14)
- 5) *Όταν παίζω, μου μιλούν και δεν ακούω· κι αν ακούσω, δεν μπορώ να μιλήσω.* (B.Π. 24) – **Po më foli kush, s'e dëgjoj. Dhe në e dëgjofsha, s'i bëj dot zë.** (Z. 20)

Në përkthimin e vargjeve të Kavafit ...*αν τύχει και πλησιάσει από τον όγλο/ κανένας Αρτεμίδωρος, που φέρνει γράμμα, ...*(K., *Μάρτιαι ειδοί*) hasim dy mënyra alternative të përcjelljes në shqip të frazës ...*αν τύχει και πλησιάσει*, e para nëpërmjet shprehjes *se mos afrohet* ku shmanget përkthimi fjalë për fjalë i foljes në lidhore: -... *nga turma shiko se mos afrohet/ndonjë Artemidoros aty/ me letër në dorë....*(L.Z.) dhe e dyta ku lidhorja *αν τύχει* është dhënë me të tashmen e dëftores *qëllon* duke i paravendosur lidhëzën kushtore nëse: - *..nëse qëllon të afrohet që nga turma/ ndonjë Artemidor, që sjell një kartë..*(A.S.)

Në shembullin (6) lidhorja *βρω* paraprihet përkatësisht nga lidhëza vendore *όπου* dhe përemri lidhor *ό,τι*. Në të dyja rastet në shqip ajo jepet nëpërmjet të tashmes së lidhore. Aoristi i lidhore *βρω*, në shembullin (7) që paraprihet po nga përemri lidhor *ό,τι*, në këtë rast përcillet në shqip me të tashmen e lidhore *të dalë*. Ndërsa në shembullin (8) folja në lidhore *βρει* jepet në shqip me të tashmen e dëftores gjen që në fakt në këtë rast ka kuptimin e së ardhmes. Edhe në greqisht kjo lidhore quhet lidhore e së ardhmes.

- 6) *Ευπνώ το πρωί, τρώγω ένα κομμάτι ψωμί. Κι ύστερα χαμαλίκι, όπου βρω, ό, τι βρω. (B.Π. 111) Zgjothem në mëngjes e, ha një çapë bukë, pastaj hamallëqe. Ç 'të gjej e ku të gjej. (Z. 99)*
- 7) *Όταν τα συλλογίζομαι, μου 'ρχεται να σπάσω ό,τι μπροστά μου βρω, μιαν καρέκλα ή μια λάμπα ή το κεφάλι μου στον τοίχο. (B.Π. 34) – Kur i sjell ndër mend, më vjen të kap karrigen a llampën, a kokën time a ç 'të më dalë përpara a ta përndjek për muri. (Z. 30)*
- 8) *... Η χήρα, η Σουρμελίνα έχασε την προβατίνα της όποιος τη βρει, πέντε οκάδες κρασί βρετίκια. (B.Π. 109) – Vejusha Surmelinë humbi delen e kush e gjen i jep pesë okë verë. (Z. 97)*

Lidhorja përdoret pa pjesëzën *va* edhe kur i paravendoset një lidhëz vendore: *Όπου το μάτι μου γυρίσω, όπου κι αν δω/ερείπια μαύρα της ζωής μου βλέπω εδώ. (K., Πόλις) – Kudo që hedh sytë, kudo që shikoj/gërmadhë jetëzeza ime gjithandej fanitet. (L.Z.) – Sytë ngado t'i rrotulloj, ngado të hedh vështrimin,/ kam për të parë jetën time mes zisë dhe shkretimit (A.S.)* Lidhorja *γυρίσω* në këtë rast është dhënë në shqip një herë me të tashmen e dëftores dhe në rastin tjetër me të tashmen e lidhore.

Sic e sipërpërmendëm janë kryesisht lidhëzat kohore të cilat i paravendosen lidhore duke mënjanuar përdorimin e treguesit të lidhore *va*. Gjatë përkthimit të vargjeve në shembullin (9) të dy përkthyesit e kanë përcjellë lidhoren *ανοίξει* po me lidhore, por me të tashmen e saj, gjë që ndodh edhe në shembujt (10), (11).

- 9) *Όταν ανοίξει ένα παράθυρο θάναι παρηγοριά. (K, Τα παράθυρα) – Ngushëllim do të jetë kur të hapet një dritare. (L.Z.) Kur të çelë një dritare, do të kem ngushëllim. (A.S.)*
- 10) *Σα βγεις στον πηγαιμό για την Ιθάκη, / να εύχεται να 'ναι μακρύς ο δρόμος, (K., Ιθάκη) – Sapo të marrësh udhën për Itakë,/ uro që udhëtimi të jetë i gjatë,..(L.Z.) – Pasi të dalësh rrugës për Itakë, / urim për ty të qoftë e gjatë udha (A. S.)*
- 11) *Πριν γίνεις γεύση μοναζιάς τυλίγεις τα θυμάρια θύμησης. (E. Η συναυλία των γυακίνθων)- Para se të bëhesh shije e vetmisë mbështjell trumzat në kujtime.*
- 12) *Τι νόμους πια θα κάνουν οι Συγκλητικοί;/ Οι βάρβαροι σαν έλθουν θα νομοθετήσουν.(K., Περιμένοντας τους Βαρβάρους) - E ç'ligje do të bëjnë më senatorët?/ Barbarët sapo të vijjnë ligjet i bëjnë vetë. (L.Z.) – Ç'ligje të hartojnë senatorët? Barbarët do të vijjnë e do t'i thurin. (A. S.)*
- 13) *Μπορεί, άμα πεθάνει ένας άνθρωπος, να ζαναγεννηθεί; Πώτση. (B.Π. 118) – Po a mund të bëjë vaki të ringjallet rob i pas vdekjes? (Z. 105)*

Në shembullin (12) janë zgjedhur dy mënyra për të përcjellë aoristin e lidhore *έλθουν*, nëpërmjet të tashmes së lidhore *të vijnë* dhe nëpërmjet së ardhmes *do të vijnë*.

Përkthimi në këtë rast nëpërmjet së tashmes së lidhore është më pranë trajtës në greqisht, duke qenë se jepet edhe lidhëza kohore (në këtë rast) *σαν* (*sapo*). Në shembullin (13) aoristi i lidhore së greqishtes jepet me një emër të cilit i është paravendosur parafjala *pas*. Por mund të ishte përcjellë kjo formë foljore edhe me të kryerën e lidhore: *pasi të ketë vdekur*.

3.2.3. E pakryera e lidhore

E pakryera si kohë e lidhore ekziston vetëm në gjuhën shqipe. Foljet në kohën e pakryer të mënyrës lidhore dalin me të njëjtat mbaresa vetore si në të pakryerën e dëftores, prej së cilës ajo dallohet vetëm nga prania e pjesëzës *të*²⁰⁴. Pjesëza *të* si pjesë përbërëse e formave foljore të lidhore, si dukuri është shfaqur fillimisht në format e kohës së tashme të lidhore, e më vonë për analogji është shtrirë edhe në format e tjera kohore të kësaj mënyre²⁰⁵.

Koha e pakryer e lidhore së shqipes		
Pjesëz	Tema foljore e së tashmes së dëftores *	Mbaresa e së pakryerës së dëftores
<i>të</i>	<i>la-/dil-/di-</i>	<i>-ja</i> <i>-je</i> <i>-te (-nte)</i> <i>-nim</i> <i>-nit</i> <i>-nin</i>

Tabela 3.28

Kuptimi themelor i së pakryerës së lidhore është të tregojë një veprim të mundshëm të së shkuarës, pra është më shumë një e tashme e lidhore në të shkuarën përdorimi i së cilës është i kushtëzuar vetëm nga koha e foljes drejtuese²⁰⁶. Në fjalitë e nënrenditura e pakryera e lidhore përdoret pas formash kohore, të cilat nuk kanë të bëjnë me çastin e ligjëritimit, kështu ajo përdoret pas kohës së pakryer, së kryerës së thjeshtë, më se të kryerës dhe të kryerës së tejshkuar.

Kur folja e fjalisë kryesore është në të pakryerën e dëftores, siç vërejmë edhe në shembujt (1), (2), (3) në gjuhën shqipe folja në lidhore gjendet në të pakryerën, ndërsa në gjuhën greke ajo jepet me aoristin ose me lidhoren e thjeshtë, e cila në këtë rast nuk ka kuptimin kohor të së shkuarës:

1) *Ai donte të çlodhej.* (Gj.U.V. 29) – *Ἦθελε να ξεκουραστεί.* (Σ.Ν.Σ. 35)

²⁰⁴ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, 294

* Përveç foljeve që pësojnë ndryshime tingullore të temës.

²⁰⁵ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002, 372

²⁰⁶ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, 324

- 2) Ai donte **t'i fliste** priftit, sepse heshtja e kishte mërzhitur, por nuk dinte **ç't'i thoshte**. (Gj.U.V. 16) – *ἠθελε να μιλήσει στον ιερέα, γιατί η σιωπή τον είχε στεναχωρήσει, αλλά δεν ήξερε τι να του πει.* (Gj.U.V. 19)
- 3) Dy prej tyre ndezën prapë nga një cigare, i treti thithte ende llullën kurse tjetri, më i riu, **vazhdonte të qëndronte mbështetur mbi bishtin e mohësës dhe dukej që e kishte mendjen gjetkë**. (Gj.U.V. 20) - *Ο άλλος, ο νεότερος, στηριζόταν στο στείλιάρι του φτωαριού και έμοιαζε σαν να είχε αλλού το μυαλό του.* (Σ.Ν.Σ. 24)

Në shembullin (2) vëmë re gjithashtu se, si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën greke strukturës së lidhore i ndërfitet një trajtë e shkurtër, përkatësisht *i dhe tou*.

Në shembullin (3) folja në të pakryerën e lidhore pason foljen *vazhdonte*, ndërsa në gjuhën greke e gjithë shprehja *vazhdonte të qëndronte mbështetur* është dhënë me të pakryerën e dëftores së foljes *στηρίζομαι (mbështetem)*, *στηριζόταν (mbështetej)*. Vetë shprehja foljore *qëndronte mbështetur* nuk mund të jepet me të njëjtën strukturë në gjuhën greke, por nëse do të donim t'i qëndronim sa më besnikë origjinalit do të kishim mundur të thoshim: *συνέχιζε να στηρίζεται (vazhdonte të mbështetej)*, ku folja *στηρίζεται* në këtë rast është në të tashmen e lidhore.

Në shembujt e mëposhtëm folja e fjalisë kryesore gjendet në të kryerën e thjeshtë dhe në gjuhën greke jepet me aoristin e dëftores. Por le të vërejmë përkthimin e foljes në të pakryerën e lidhore së shqipes në greqisht:

- 4) Gjenerali dha **të kuptonte** se ai ishte kryesori, ndonëse prifti fliste më pak. (Gj.U.V. 16) – *Ο στρατηγός τους έδωσε να καταλάβουν πως αυτός ήταν επικεφαλής, ενώ ο ιερέας μιλούσε ακόμα λιγότερο.* (Σ.Ν.Σ. 19)
- 5) Ndërsa kamerieri i përgatiste kafën, burri i imët nxori nga çanta një fletore të trashë dhe **nisi të shkruante**. (Gj.U.V. 31) - *Ενώ το γκαρσόνι ετοίμαζε τον καφέ του, ο άντρας έβγαλε από την τσάντα ένα χοντρό τετράδιο κι άρχισε να γράφει.* (Σ.Ν.Σ. 38)
- 6) Ajo gota e vogël e konjakut **nisi t'ia dëbonte** përherë e më shumë pamjen e irnosur e kërcënuese të maleve, që edhe tani në tryezë e shqetësonte herë pas here. (Gj.U.V. 18) – *Το μικρό ποτήρι με το κονιάκ άρχισε να διώχνει όλο και περισσότερο τη σκυθρωπή και απειλητική θέα των βουνών, που και τώρα στο τραπέζι τον έκανε κάπου – κάπου να ανησυχεί.* (Σ.Ν.Σ. 21)
- 7) Gërmuesi **filloi të nxirrte** eshtrat jashtë me lopatë. (Gj.U.V. 24) – *Ο σκαφτιάς άρχισε να βγάξει έξω τα οστά με το φτυάρι.* (Σ.Ν.Σ. 29)
- 8) **Nisi të tregonte** sesi e vjehrra donte që me çdo kusht të porosiste priftin, nga ana e saj për të birin, se si ajo mundi **ta gjente** më në fund pas adresës dhe vjehrra u qetësua dhe..... (Gj.U.V. 87) *Άρχισε να του λέει πως η πεθερά της ήθελε με κάθε τρόπο να βρει τον συγκεκριμένο ιερέα, για το γιο της, πως αυτή μπόρεσε τελικά να τον βρει, έχοντας τη διεύθυνσή του, πως η πεθερά της ησύχασε και πως* (Σ.Ν.Σ. 106)

Në shembullin (4) e pakryera *të kuptonte* jepet me aoristin e lidhore së greqishtes, i cili tregon se folja ndodhet në aspektin perfektiv.

Në rastet (5), (6), (7), (8) foljet drejtuese në të kryerën e thjeshtë janë folje që tregojnë fillim veprimi, folja pasuese në shqip ndodhet në të pakryerën e lidhore, ndërsa

në gjuhën greke në të tashmen e lidhores, pasi foljet që pasojnë foljet që tregojnë fillim apo vazhdim veprimi, janë të aspektit imperfektiv, para ndodhen gjithmonë në lidhoren e vazhduar.

E pakryera e lidhores përdoret gjithashtu edhe kur folja e fjalisë kryesore është në më se të kryerën:

- 9) *Para se të nisej, kishte mësuar midis të tjerash edhe diçka tjetër për klimën e Shqipërisë. (Gj.U.V. 13) – Προτού ξεκινήσει, είχε μελετήσει, ανάμεσα στ' άλλα, και κάποια πράγματα για το κλίμα της Αλβανίας. (Σ.Ν.Σ. 15)*
- 10) *Ai kishte marrë detyrën ta ngrinte nga balta këtë ushtri. (Gj.U.V. 14) – Κι αυτός είχε αναλάβει την υποχρέωση να σηκώσει το στρατό από τη λάσπη. (Σ.Ν.Σ. 16)*
- 11) *Vetëm njerëzit që kishin dalë t'i prisnin, po vinin grumbull drejt aeroplanit. (Gj.U.V. 15) - Μόνο αυτοί που είχαν βγει να τους περιμένουν, έρχονταν ομαδικά προς το μέρος του αεροπλάνου. (Σ.Ν.Σ. 17)*

Në të tria rastet (9), (10), (11) foljet në më se të kryerën e shqipes jepen në greqisht po me më se të kryerën, ndërsa e pakryera e lidhores jepet me lidhoren e thjeshtë të greqishtes. Në rastin e tretë folja *περιμένω* ka të njëjtën trajtë si për lidhoren e thjeshtë, ashtu edhe për atë të vazhduar, përcaktimi i aspektit të saj bëhet duke pasur parasysh situatën e ligjëritimit.

E pakryera e lidhores mund të shërbejë edhe si folje e fjalisë kryesore, shembujt (12), (13) :

- 12) *Të niseshin prapë të dy me priftin, shtegtarë të zyrtë, kodër më kodër e zgrip më zgrip, për t'i vënë prapë skeletet një për një aty prej nga i kishin nxjerrë. (Gj.U.V. 188) – Να ξεκινούσαν, λέει, ζανά, οι δυο τους, αυτός και ο ιερέας, θλιβεροί ταξιδιώτες, από λόφο σε λόφο και από γκρεμό σε γκρεμό, για να βάλουν πίσω έναν προς ένα τους σκελετούς εκεί απ' όπου τους είχαν βγάλει. (Σ.Ν.Σ. 222)*
- 13) *Të kthente ndoshta një pjesë të ushtrisë. Ose krejt ushtrinë e gjetur. Ose...ose...të linte veten peng, që ushtria të lejohej..... (Gj.U.V. 192) – Να ξαναβάλει στη θέση του ένα μέρος του στρατού. Ή και όλους όσους είχε βρει. Ή....ή....να έμεινε όμηρος, αν ο στρατός το επέτρεπε. (Σ.Ν.Σ. 226)*

Kjo e pakryer e lidhores në këtë rast në gjuhën greke përkthehet nëpërmjet së pakryerës së dëftores paraprirë nga pjesëza *να*, strukturë e cila në gjuhën greke nuk i përket ndonjë kohe gramatikore.

Në rastet kur në fjali të pavarura apo kryesore e pakryera e lidhores paraprhet nga foljet me vlerë modale *mund* dhe *duhet* atëherë ajo përdoret me modalitetin e mundësisë përkatësisht të detyrimit. Në shembullin (14) folja *mund* e cila gjendet në trajtën e saj të ngurtësuar në gjuhën greke jepet me të pakryerën e fojes *mundem*, nga e cila ne kuptojmë edhe momentin kohor për të cilin bëhet fjalë, ndërsa e pakryera e lidhores së shqipes jepet me lidhoren e thjeshtë të greqishtes.

Në shembullin (15) folja *mund* përdoret përsëri në trajtën e saj të ngurtësuar, por në këtë rast në gjuhën greke jepet nga e pakryera e dëftores e foljes *μπορώ* (*mundem*) në vetën e tretë shumës prirë nga pjesëza *θα*, ndërsa për sa i përket së pakryerës së lidhores të *ishin* ajo jepet me lidhoren e vazhduar të foljes *είμαι* (*jam*), e cila nuk mund ta formojë

lidhoren e thjeshtë. Në shembullin (16) e pakryera e foljes modale *duhet*, jepet me të pakryerën e foljes pavetore *πρέπει*, ndërsa e pakryera e lidhores të vinim jepet me lidhoren e thjeshtë *να ρθουμε*.

- 14) *Por nga fytyrat e tyre s' mund të kuptojë gjë.* (Gj.U.V. 20) – *Απ' τα πρόσωπά τους δεν μπορούσε να καταλάβει τίποτε.* (Σ.Ν.Σ. 24)
15) *Pasojat mund të ishin të rapritura.* (Gj.U.V. 14) *Οι συνέπειές της θα μπορούσαν να είναι απρόβλεπτες.* (Σ.Ν.Σ. 16)
16) *Nuk duhej të vinim këtu.* (Gj.U.V. 209) – *Δεν έπρεπε να ρθουμε εδώ.* (Σ.Ν.Σ. 246)

Kur përdoret në fjali të nënrenditura kushtore, kuptimi kohor i së pakryerës së lidhores është i pacaktuar. Në këtë rast ajo përdoret më shumë me kuptimin e së tashmes të së shkuarës për të shprehur një kusht të së ardhmes, që sipas folësit nuk ka, ose ka pak mundësi për të ndodhur²⁰⁷:

- 17) *Por, edhe sikur në librin që kishte lexuar të shkruhej se vjeshta ishte e thatë, atij nuk do t'i dukej ky shi i rapritur.* (Gj.U.V. 13) – *Αλλά, ακόμα κι αν στο βιβλίο που είχε διαβάσει έγραφε πως στην Αλβανία το φθινόπωρο είναι συνήθως ξερό, αυτή η βροχή δε θα τον ζάφνιαζε.* (Σ.Ν.Σ. 15)
18) *Mos ki frikë, u hodh një tjetër, - edhe sikur të dinin shqip, nuk do të kuptonin asgjë nga brenga e saj.* (Gj.U.V. 210) – *Μη φοβάσαι, πετάχτηκε ένας άλλος, ακόμα κι αν ήξεραν αλβανικά, δε θα καταλάβαιναν τίποτα για τον καημό αυτηνής.* (Σ.Ν.Σ. 247)

Si në shembullin (17) dhe në (18) për të dhënë të pakryerën e lidhores me këtë funksion në greqisht përdoret e pakryera e dëftores prirë nga lidhëza kushtore.

Forma e saktë e së pakryerës së lidhores së foljes *jam* është *të isha*, por shpesh në vend të kësaj forme mund të hasim edhe formën joletrare, e cila sipas Gramatikës së gjuhës shqipe²⁰⁸ duhet mënjeluar, *të qe*, shembulli (19):

- 19) *S'e besoj. Të qe ashtu, do ta thoshte kënga.* (Gj.U.V. 92) – *Δεν πιστεύω. Αν ήταν γι' αυτόν θα το έκλεγε το τραγούδι.* (Σ.Ν.Σ. 112)

Kjo formë në gjuhën greke jepet me të pakryerën *ήταν* e foljes *είμαι* (*jam*), sidoqoftë kjo folje siç e kemi përmendur nuk mund ta formojë aoristin dhe si rrjedhojë edhe trajtat e tjera foljore që kanë temën e tij.

E pakryera e lidhores, si të gjitha kohët e saj për të formuar trajtën mohore merr pjesëzën mohuese *mos*, shembulli (20):

- 20) *Së paku të mos bënte ftohtë.* (Gj.U.V. 89) – *Τουλάχιστον να μην έκανε τόσο κρύο.* (Σ.Ν.Σ. 108)

²⁰⁷ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, 325

²⁰⁸ По аты

Edhe në gjuhën greke në këtë rast trajta mohore formohet nëpërmjet ndajfoljes mohuese *μην* (*mos*), edhe pse folja me të cilën përkthehet e pakryera e lidhore së shqipes ndodhet në të pakryerën e dëftores së greqishtes.

3.2.4. E kryera e lidhore

a. Koha e kryer e lidhore së shqipes ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të lidhore të së tashmes së foljes ndihmëse *kam*:




Tabela 3.29

Kuptimi i kohës së kryer të lidhore është të tregojë një veprim , që mund të jetë kryer para çastit të ligjërit, me të cilin nuk i ka të këputura lidhjet²⁰⁹. E kryera e lidhore mund të përdoret duke i paravendosur foljet modale *mund* dhe *duhet*. Në rastin e parë folja shpreh modalitetin e mundësisë dhe në rastin e dytë atë të detyrimit ose të mundësisë.

- 1) *Midis tyre duhet të ketë ndodhur diçka.* (Gj.U.V. 28) - *Μεταξύ τους φαίνεται πως κάτι έχει συμβεί.* (Σ.Ν.Σ. 34)
- 2) *Shpërthimi duhet të ketë qenë i frikshëm, mendoj ai.* (Gj.U.V. 166) – *Η έκρηξη πρέπει να ήταν τρομερή, σκέφτηκα.* (Σ.Ν.Σ. 198)

Në shembullin (1) e kryera e lidhore së shqipes jepet me të kryerën e dëftores së greqishtes. Modaliteti i mundësisë në këtë rast jepet nëpërmjet foljes *φαίνεται* (*duket, duket se diçka ka ndodhur*), që përkthyesja ka zgjedhur të përdorë në vend të foljes modale në shqip *duhet*.

Në shembullin (2) e kryera e lidhore është përcjellë në gjuhën greke me të pakryerën e foljes *είμαι* (*jam*) të prirë nga pjesëza *να*.

E kryera e lidhore veç fjalive të nënrenditura kryefjalore e kundrinore, fjalive të nënrenditura kohore, vendore, kushtore e lejore, përdoret edhe në fjali të pavarura pyetëse:

²⁰⁹ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

3) *Pastaj papritur tha me vete: ç' të ketë bërë vallë me gruan e ve të kolonelit?* (Gj.U.V. 28) - *Αμέσως μετά, ζαφνικά, σκέφτηκε: τι να έχει κάνει άραγε με τη χήρα του συνταγματάρχη;* (Σ.Ν.Σ. 34)

4) *Ç' të ketë pasur vallë midis tyre!* (Gj.U.V. 28) – *Τι να είχε συμβεί άραγε μεταξύ τους;* (Σ.Ν.Σ. 34)

Në rastin (3) e kryera e lidhores së shqipes është dhënë po me të kryerën e lidhores së greqishtes, ndërsa në rastin (4) është dhënë me më se të kryerën e dëftores së foljes *συμβαίνει* (ndodh) e prirë nga pjesëza *να*. Përzgjedhja e një foljeje tjetër mund të lidhet edhe me faktin se folja (*έχω*) *kam* nuk mund t'i formojë kohët analitike të së shkuarës.

b. E kryera e lidhores së greqishtes formohet nga lidhorja e foljes ndihmëse *έχω* (*kam*) dhe forma paskajore e greqishtes së re, e cila formohet nga tema e aoristit aktiv kur folja vendoset në mënyrën veprorë dhe nga tema e aoristit pasiv kur folja vendoset në formën joveprorë, ashtu si edhe gjatë formimit të kohëve analitike të mënyrës dëftore.

E kryera e lidhores së greqishtes			
Folje ndihmëse në të tashmen e lidhores		Formë paskajore e greqishtes së re	
Pjesëza <i>να</i>	Folje ndihmëse në të tashmen e dëftores	tema e aoristit aktiv + <i>-ει</i>	tema e aoristit pasiv + <i>-ει</i>
<i>να έχω</i>		<i>διαβάσ-ει</i>	<i>διαβαστ-ει</i>

Tabela 3.30

Foljet në të gjitha kohët e lidhores në përgjithësi i referohen të ardhmes (së afërt apo pak më të largët) kur ato përdoren në fjali të pavarura²¹⁰. Ndërsa kur foljet përdoren në fjali të nënrenditura, atëherë kohët e lidhores mund t'i referohen të tashmes, të shkuarës apo së ardhmes, në varësi të kohës së foljes së fjalisë kryesore.²¹¹ Pra momenti kohor të cilit i referohet folja në lidhore nuk lidhet me kohën gramatikore të foljes, por me kohën e foljes së fjalisë kryesore.

1) *Κι όταν είμαστε μόνες μας, τον βρίζει πατόκορφα και αυτόν και το σόι του, χωρίς να της έχει δώσει ο καημένος την παραμικρή αφορμή.* (T. T. Σ.,12) - *Dhe kur jemi bashkë e shan mbarë e prapë, atë dhe fisin e tij, pa i dhënë i shkreti as më të voglin shkak.* (K.T.)

2) *Να 'ταν ένα παιδάκι, έλεγα, με τα πρωτοχρονιάτικα παιχνιδάκια στο χέρι ή ένας γέρος κοτσονάτος, με άσπρο φαρδομάνικο πουκάμισο, που να 'χει τελέψει ακέραιο το χρέος του στη γης!* (B.Π. 118) – *Doja të ishte një fëmijë me lodrat e Vitit të Ri në duar a një plak kokorosh, me këmishë të bardhë mëngëçjerrë, që ta kishte kryer me nder detyrën e tij mbi dhe.* (Z. 119)

²¹⁰ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *vep. e cit.*, 2002, 347

²¹¹ Po aty

Në shembullin (1) e kryera e lidhore së greqishtes paraprihet nga parafjala *χωρίς* (*pa*) dhe në gjuhën shqipe jepet me formën e pashtjelluar *pa dhënë*. Në shembullin (2) e kryera e lidhore së greqishtes jepet në shqip me më se të kryerën e lidhore së shqipes.

3.2.5. Më se e kryera e lidhore së shqipes

Siç e përmendëm edhe më sipër më se e kryera e lidhore është një formë kohore të cilën e hasim vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa në gjuhën greke kjo trajtë nuk përbën kohë gramatikore. Më se e kryera e lidhore së shqipes formohet me foljen ndihmëse *kam* në të pakryerën e lidhore dhe pjesoren e foljes.

Më se e kryera e lidhore së shqipes			
Folje ndihmëse në të pakryerën e lidhore		Pjesore	
Pjesëza të	folje ndihmëse në të pakryerën e dëftores	morfemë leksikore + morfemë gramatikore	
të kisha	të isha	temë foljore (e së tashmes ose së kryerës së thjeshtë) + sufiks (-r(e) -un(ë), -ur(ë) -ë-në-m-të- m-un- n-unë(-r(e), -un(ë), -ur(ë)-ë), -në, -m, -të, - m-un)	
		mbjell-ë / ndenj-ur	

Tabela 3. 31

Kuptimi themelor i më se të kryerës së mënyrës lidhore është të tregojë një veprim që mund të jetë kryer para një çasti të caktuar të së shkuarës²¹². Kjo kohë mund të shoqërohet nga foljet me vlerë modale *mund* dhe *duhet*, shembulli (1). Në gjuhën greke në këtë rast folja vendoset në më se të kryerën e dëftores duke i paravendosur pjesëzën *va*, dhe folja *duhet* vendoset në të pakryerën. Më se e kryera e lidhore përdoret në fjali të nënrenditura kushtore, të cilat ndërtohen me lidhëzat nënrenditëse *po*, *sikur*, shembujt (2) dhe (3). Duke qenë se në greqisht nuk ekziston koha analoge e lidhore, kjo kohë përkthehet në këto raste nga shqipja me anë të më se të kryerës së dëftores të greqishtes. Më se e kryera e lidhore mund të përdoret edhe në fjali të nënrenditura mënyrore, shembulli (4), dhe në këtë rast në gjuhën greke ajo mund të përcillet nëpërmjet të pakryerës së dëftores paraprirë nga pjesëza *va*.

- 1) *Duhet ta kishit sjellë më përpara, na tha njëri prej tyre.* (Gj.U.V. 175)- *Έπρεπε να τον είχατε φέρει* *νωρίτερα, μας είπε ένας απ' αυτούς.* (Σ.Ν.Σ. 207)
- 2) *Po të kishite vdekur në mëngjes do ishte tani në varrezat e Vasilikojt.* (Ç. M. 80)- *Αν είχε ξεψυχήσει το πρωί, τώρα θα ήταν στο νεκροταφείο του Βασιλικού.* (I.T. 73)
- 3) *Kjo natë e fundit do të kishite shkuar si të gjitha të tjerat dhe asgjë të veçantë s' do të kishite për t'u mbajtur mend, sikur gjenerali të kishite thithur edhe atë mbrëmje*

²¹² Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, 326

- erën e veçantë të këtyre fshatrave shqiptare, një erë e lehtë, gati e pakapshme, por që ai tani do ta njihnte midis gjithë të tjerave. (Gj.U.V. 194) – Την τελευταία νύχτα θα την περνούσαν σαν όλες τις άλλες και δε θα τους άφηνε καμία ιδιαίτερη ανάμνηση, αν ο στρατηγός είχε περιοριστεί να ρουφήξει και εκείνο το βράδυ τη χαρακτηριστική μυρωδιά των αλβανικών χωριών, μια λεπτή μυρωδιά, ακατάληπτη, αλλά που τώρα πια την αναγνώριζε ανάμεσα σ'όλες τις άλλες. (Σ.Ν.Σ. 229)*
- 4) *Befas, si të ishën zgjuar nga gjumi njerëzit u kujtuan se kjo Madama, që shumëkush e dinte franceze ose kanadeze (isha i bindur se edhe në këtë rast njerëzit bënin sikur besonin ashtu), pra kjo Madama s'qenkësh tjetërkush veçse Makbule Shtinua, nga lagjja Hazmurat. (Ç. M. 69)- Ξαφνικά, σαν να βγαίνουν από λήθαργο, οι άνθρωποι θυμήθηκαν πως η Μαντάμ, που οι περισσότεροι περνούσαν για γαλλίδα ή канаδέζα (είχα πεισθεί πως και στην περίπτωση της, παρίσταναν ότι τάχα το πίστευαν), αυτή η Μαντάμ λοιπόν δεν ήταν άλλη από τη Μακμπούλε Στίνο από τη συνοικία Χαζμουράτ. (I.T.65)*
- 5) *Ah, sikur të kisha qenë në trupat e xhenierëve që të kisha me vete një lopatë dhe të gërmoja shpejt, shpejt, shpejt. (Gj.U.V. 22) – Μακάρι να είχα υπηρετήσει στο Μηχανικό για να 'χα τώρα ένα φτυάρι και να 'σκαβα γρήγορα, γρήγορα, γρήγορα. (Σ.Ν.Σ. 27)*
- 6) *Së raku t'i kishin fshirë baltën, mendoj me nervozizëm. (Gj.U.V. 27) – Αν τουλάχιστον το είχαν καθαρίσει από τη λάσπη..., σκέφτηκε νευριασμένος. (Σ.Ν.Σ. 33)*

Më se e kryera e lidhores së shqipes mund të përdoret edhe në fjali të pavarura, shembujt (5), (6), ku shprehet zakonisht një dëshirë e porealizueshme. Vërejmë se në gjuhën greke në të dyja rastet kjo formë kohore me këtë përdorim jepet nëpërmjet më se të kryerës së dëftores, paraprirë përkatësisht nga pjesëzat *va* dhe *av*.

3.2.6. Forma “kam + lidhore”

Në gjuhën shqipe, forma “kam + e tashmja e lidhore” është një nga format që përdoret për të shprehur kuptimin e së ardhmes dhe ndeshet kryesisht në të folmet e arbëreshëve të Italisë.²¹³ Kjo formë e së ardhmes e sidomos tipi *kam të vete* është e rëndomtë në veprën e Matrëngës (1592)²¹⁴. Në shumicën e rasteve në veprën e tij kjo strukturë përdoret si *futurum necessitatis: kemi të anastisemi (= ringjallemi)*²¹⁵. Sipas Sandfeldit, edhe në kolonitë greke të Italisë jugore ndeshet trajta e së ardhmes e tipit *ékho na grapso “kam të shkruaj”*, ashtu si tek arbëreshët e Italisë²¹⁶. Kjo trajtë perifrastike me vlerën modale të një *futurum necessitatis* gjendet që në librin e parë të shkruar në arbërishten e Italisë, në veprën e Lekë Matrëngës të vitit 1952²¹⁷. Ndërsa sipas Rohlf's-it, të cituar nga Shaban Demiraj në të folmet greke të Italisë jugore përdoret edhe togfjalëshi i tipit *é'нна pame (= ékho nà pame)* në kuptimin “*duhet të shkojmë*”²¹⁸. E ardhmja e shprehur me strukturën “kam + e tashmja e lidhore” haset gjithashtu edhe në ndonjë të folme të Shqipërisë jugore²¹⁹. Është e gjallë, sipas Totonit, në Piqeras e Nivicë e në ndonjë rast edhe në Borsh kjo trajtë e vjetër e së ardhmes dhe ka zakonisht kuptimin e një të ardhmeje të domosdoshmërisë: *kam të dërgoj një pako në Vlorë*²²⁰. E ardhmja e shprehur me këtë sintagmë takohet edhe në të folmen e Çamërisë²²¹. Ndonjë gjurmë e kësaj strukture haset në ndonjë rast edhe tek arbëreshët e Greqisë²²². Ndërsa te autorët e vjetër të Veriut ky ndërtim perifrastik i së ardhmes nuk takohet fare²²³.

Formimet e së ardhmes ndërtuar me anë të foljes ndihmëse *kam* në gjuhën shqipe kanë qenë fillimisht të ardhme të domosdosë, por nuanca e detyrimit është zbehur dhe në shumicën e rasteve është zhdukur. Por kjo formë e ka ruajtur në ndonjë rast nuancën e domosdosë kryesisht tek arbëreshët e Italisë.²²⁴ Madje me kalimin e viteve është zbehur edhe vetë përdorimi i kësaj forme, por përdoret gjithmonë e më dendur forma *kam për të bërë*.

Edhe në gjuhën greke sintagma foljore “kam + lidhore” përdoret me kuptimin e së ardhmes, por në gramatikën e gjuhës së re greke si formë e së ardhmes jepet forma *θα διαβάσω – do të lexoj*²²⁵. Ajo përdoret gjithashtu edhe me një sërë kuptimesh të tjera të cilat do t'i shtjellojmë në vazhdim. Në periudhën helenistike për të shprehur të ardhmen përdorej mjaft shpesh struktura *kam + paskajoren*, dhe kjo duket në tekstet e ndryshme të

²¹³ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1976, 103.

²¹⁴ Sh. Demiraj, *po aty*. 108.

²¹⁵ M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, dispensë, 1966, (cituar sipas Gj. Shkurtaç, *Vështrim mbi trajtat foljore të mënyrës dëftore të të folmeve arbëreshe*, SF 2, 1975

²¹⁶ Kristian Sandfeld, *Lingusitike balkanique*, 1930, 184 (cituar sipas Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Tiranë, 2004, 119).

²¹⁷ S. Mansaku, *Tipologjia e së ardhmes së tipit kam të shkoj në kontekstin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, Albanohellenica 4, 2011

²¹⁸ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2004, 119.

²¹⁹ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1976.

²²⁰ M. Totonit, *E folmja e Bregdetit të poshtëm*, SF 1, 1964, 154

²²¹ Q. Haxhihasani, *Vështrim mbi të folmen e Çamërisë, Dialektologjia shqiptare I*, Tiranë, 1971, 183

²²² Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, SF 3, 1970

²²³ S. Mansaku, *Ndërtimet me foljen kam + paskajore te autorët e vjetër*, SF 2, 1980

²²⁴ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1976, 108.

²²⁵ Μανόλης Τριανταφυλλίδης, *Νεοελληνική γραμματική της δημοτικής*, Θεσσαλονίκη, 2005

asaj periudhe. Në raste të rralla hasej edhe forma *kisha + paskajoren*, e cila përdorej si shprehje e mundësisë ose kushtit²²⁶. Ky tip i së ardhmes dëshmohet edhe në greqishten bizantine²²⁷. Po në kushtet kur sot në greqishten e re paskajorja është zhdukur dhe vendin e saj në formimet e ndryshme e ka marrë lidhorja, kjo strukturë përdoret në formën *kam + lidhore*.

Tipi i së ardhmes me ndihmësen *kam* ka një përhapje relativisht të gjerë edhe në gjuhët sllave të Ballkanit si bullgarishtja, maqedonishtja, si edhe rumanishtja, por nuk është i panjohur edhe për serbokroatishten dhe sllovenishten²²⁸.

Si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë greke gjatë përdorimit të saj në ligjërime këtu strukturë e hasim: a) në formën *kam + folje në lidhore*, b) në formën e një strukture të lirë brenda së cilës mund të vendoset një gjymtyrë tjetër (zakonisht një emër), c) në formën e një strukture të ngurtësuar.

a) Forma *kam + folje në lidhore*. Folja *kam* në këtë ndërtim në gjuhën greke mund të luajë rolin e një foljeje volitive, p.sh.: *Έχω να σου πω κάτι*. Në gjuhën shqipe kjo formë jepet me foljen *kam + formën paskajore*. ***Kam për të të thënë diçka***. Mund të tregojë gjithashtu edhe domosdoshmëri, funksion që, siç e përmendëm edhe më sipër, kishte fillimisht edhe në gjuhën shqipe, p. sh.: *Βιώνουμε μια περίοδο κρίσης οικονομικής και έχουμε να αντιμετωπίσουμε πολλά προβλήματα*. Në gjuhën shqipe këtë formë mund ta përkthejmë ose me foljen pavetore *duhet + folje në lidhore* ose me foljen *kam + formën paskajore*. *Ne po përjetojmë një periudhë krize ekonomike dhe duhet të përballlemi (kemi për t'u përballur) me shumë probleme*. Folja *kam* përdoret edhe si folje pavetore në shprehjen “*δεν έχει*”, e cila ndiqet nga një folje në lidhore, në kuptimin e pamundësisë që të ndodhë diçka²²⁹. Në gjuhën shqipe lidhorja e greqishtes edhe në këtë rast jepet me formën paskajore, p. sh.: *Δεν έχει να πάθεις τίποτε*. – ***Nuk ke për të pësuar asgjë***.

b) Forma *kam + folje në lidhore*, si një strukturë e lirë brenda së cilës mund të vendoset një gjymtyrë tjetër. Kur ndërmjet foljes *kam* dhe lidhores futet një emër atëherë edhe në gjuhën shqipe folja *kam* pas emrit ndiqet nga një folje në lidhore, p. sh. : *Έχει τη δύναμη να συνεχίσει το δύσκολο έργο που άρχισε*. – ***Ka forcën të vazhdojë veprën e vështirë që filloi***. Folja *kam* mund të mbartë në një strukturë të tillë edhe kuptimin e detyrimit, p.sh.: *Δεν έχει να δώσει λόγο σε κανέναν*. Edhe në këtë rast është forma paskajore ajo që në shqip i përngjet lidhores së greqishtes. ***Nuk ka për t'i dhënë llogari askujt***. Kur folja *kam* ndiqet nga një emër me kuptim kohor dhe më pas nga lidhorja shprehja tregon se ka kaluar një periudhë kohore, që veprimi nuk është kryer²³⁰, p.sh.: *Δύο μήνες είχαν να ακούσουν τη φωνή του*. – ***Kishin dy muaj pa i dëgjuar zërin***. *Έχω πολλά χρόνια να τη δω*. – ***Kam shumë vite pa e parë***. Ajo që vërejmë është se në gjuhën greke nuk ka brenda fjalisë asnjë element gjuhësor i cili të tregojë mohim, gjë në gjuhën shqipe shprehet me pjesëzën mohuese *pa*.

c) Forma *kam + folje në lidhore* në formën e një strukture të ngurtësuar. Janë disa ndërtime si p.sh.: *kam të bëj – έχω να κάνω* të cilat përdoren kështu në të gjitha situatat ligjërimore, vetëm se folja *kam* e formon paradigmen e vet. Kjo strukturë si në gjuhën greke dhe në atë shqipe merr kuptime të ndryshme. Së pari kuptimi *kam lidhje me si*

²²⁶ R.Browning, *vep. e cit.*, 1972.

²²⁷ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2004, 119.

²²⁸ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1976, 109.

²²⁹ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *vep. e cit.*, 2002

²³⁰ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *po aty*.

p.sh.: *Η συγγραφέας υπογραμμίζει πως το 1989 και η συνέχειά του έχει να κάνει με θεσμούς και διαδικασίες, αλλά και με ανθρώπινα βιώματα.* - *Autori vë në dukje se viti 1989 dhe vazhdimi i tij ka të bëjë me institucione dhe procedura, por edhe me eksperiencë njerëzore.* Kuptimi i dytë në gjuhën shqipe është *kam marrëdhënie farefisnore me dikë*, kuptim të cilin kjo shprehje në gjuhën greke nuk e ka. Përveç se jemi miq të mirë kemi edhe të bëjmë me njëri tjetrin. - *Εκτός του ότι είμαστε φίλοι και συγγενεύουμε μεταξύ μας.* Ndërsa në rastin: *Αν κάποιος τον πειράζει θα έχει να κάνει μαζί μου.* Nëse dikush e ngacmon *do të ketë të bëjë me mua*, kjo shprehje merr kuptimin *përballëm me dikë*. Një shprehje tjetër në gjuhën greke të cilën e hasim si strukturë të ngurtësuar të përbërë prej foljes *kam* dhe një foljeje në lidhore është edhe: *δεν έχω να φοβηθώ τίποτα.* p.sh.: *Αν βρισκόμαστε στην κατάσταση που πρέπει, δεν έχουμε να φοβηθούμε κάτι»,* *είπε χαρακτηριστικά χθες ο διεθνής αμυντικός της Μπολόνια.* - *Νέσε gjendemi në situatën e duhur, "nuk kemi asgjë për të pasur frikë", tha dje mbrojtësi i skuadrës së Bolonjës.*

Folja *kam* përveç kohës së tashme mund të përdoret edhe në kohën e pakryer e ndjekur nga lidhorja: *διότι πράγματα πολλά έξω να κάμω είχαν*²³¹. Si L. Zyka (*se shumë kisha për të bërë përjashta*) ashtu edhe A. Spiro (*se jashtë plot gjëra kisha për të bërë*) gjatë përkthimit përsëritin ndërtimin original, duke barazuar njëvlefshmërinë formale me atë dinamike. Ndërsa I. Kadare, e cili e përkthen nga një gjuhë e tretë (*kaq punë më presin jashtë muresh, atje*) nuk përdor asnjë prej këtyre formave, as lidhoren dhe as paskajoren.

²³¹ Καβάφης, Τα τείχη

Përfundime

- ❖ Mënyra lidhore në gjuhën shqipe shpreh kryesisht modalitetin e mundësisë, por ka raste kur ajo mund të shprehë edhe modalitetin e dëshirës apo të detyrimit. Të gjitha format kohore të mënyrës lidhore të gjuhës shqipe kanë të paravendosur pjesëzën *të*, ashtu si edhe ato të greqishtes pjesëzën *va* (*ας*), por në greqisht ka edhe raste kur folja në lidhore përdoret vetëm pa iu paravendosur kjo pjesëz. Mënyra lidhore e gjuhës shqipe ka dy kohë: *të tashmen* dhe *të shkuarën*, ku e shkuara ka tri nënndarje, *të pakryerën*, *të kryerën* dhe *më se të kryerën*. Kohët gramatikore të mënyrës lidhore të greqishtes janë: *e tashmja* ose lidhorja e vazhduar, *aoristi*, ose lidhorja e thjeshtë dhe *e kryera*. E tashmja dhe aoristi i lidhores, ndryshe nga shqipja kanë vetëm dallime aspekte midis tyre. Gjatë përdorimit lidhorja e greqishtes mund të paraprihet nga një parafjalë, parafjalët *χωρίς, δίχως* (*pa*). Në këto raste lidhorja është pjesë e fjalisë së nënrenditur. Në gjuhën shqipe, duke qenë se një përdorim i tillë është i pa mundur kjo strukturë jepet në përmjet formës së pashtjelluar mohore. Lidhorja e greqishtes mund të përdoret gjithashtu e paraprirë nga nyja shquese e gjinisë asnjane *to* duke kryer kështu në fjali funksionin e një emri, gjë që nuk e hasim në gjuhën shqipe.
- ❖ Koha e tashme e lidhores në gjuhën shqipe tregon një veprim kryerjen e së cilit folësi e paraqet si të mundshme apo të detyrueshme. Tema foljore e kohës së tashme të lidhores për të gjitha foljet, përveç foljeve *kam* dhe *jam*, është e njëjtë me temën e së tashmes së dëftores, ndërsa në gjuhën greke, folja ka të njëjtën formë me të tashmen e dëftores dhe gjatë përdorimit në ligjërim i paravendoset zakonisht pjesëza *va*, ose pjesëza të tjera. Folja në kohën e tashme të lidhores në shqip mund të përdoret si në fjali të varura ashtu edhe në fjali të pavarura ose kryesore. E tashmja e lidhores së shqipes mund të përdoret edhe me vlerën e mënyrës urdhërore, me vlerën e dëshirores, gjë e cila vlen edhe për të tashmen dhe aoristin e lidhores së greqishtes. E tashmja e lidhores apo lidhorja e vazhduar siç shprehet ndryshe karakterizohet nga aspekti imperfektiv. E tashmja e lidhores së greqishtes jepet në gjuhën shqipe edhe me të pakryerën e lidhores së shqipes, trajtë kohore kjo që nuk ekziston në gjuhën greke, lidhorja e vazhduar mund të jepet në gjuhën shqipe gjithashtu me të pakryerën e dëftores ose me një formë të pashtjelluar përcjellore.
- ❖ Aoristi i lidhores së greqishtes, kohë që nuk haset në gjuhën shqipe, nuk ka të bëjë me momentin e kryerjes së veprimit. Kjo formë e lidhores përdoret pothuajse gjithmonë duke i paravendosur një apo më shumë tregues të lidhjes me nënrenditje, por mund të hasen edhe raste në të cilat nuk paravendosen këta tregues si në rastin e disa strukturave sintaksore të përbëra nga çifte fjalish me kuptim të kundërt ku shprehet indiferentizmi për atë ç'ka do të ndodhë. Në shqip aoristi i lidhores mund të jepet me të tashmen e lidhores së shqipes, me të pakryerën e lidhores së shqipes, me përcjelloren e shqipes apo me të tashmen e dëftores.

- ❖ E pakryera si kohë e lidhore ekziston vetëm në gjuhën shqipe. Foljet në kohën e pakryer të mënyrës lidhore dalin me të njëjtat mbaresa vetore si në të pakryerën e dëftores, prej së cilës ajo dallohet vetëm nga prania e pjesëzës *të*. Kur folja e fjalisë kryesore është në të pakryerën e lidhore, ajo përkthehet në gjuhën greke me aoristin e lidhore. E pakryera e lidhore mund të shërbejë edhe si folje e fjalisë kryesore. Në këtë rast në gjuhën greke ajo jepet nëpërmjet së pakryerës së dëftores paraprirë nga pjesëza *va*. Kur përdoret në fjali të nënrenditura kushtore, kuptimi kohor i së pakryerës së lidhore është i pacaktuar. Në këtë rast ajo përdoret më shumë me kuptimin e së tashmes të së shkuarës për të shprehur një kusht të së ardhmes, që, sipas folësit nuk ka, ose ka pak mundësi për të ndodhur. Për të përkthyer të pakryerën e lidhore me këtë funksion në greqisht përdoret e pakryera e dëftores prirë nga lidhëza kushtore. E pakryera e lidhore, si të gjitha kohët e saj për të formuar trajtën mohore merr pjesëzën mohuese *mos*, edhe në gjuhën greke në këtë rast trajta mohore formohet nëpërmjet ndajfoljes mohuese *μην (mos)*, edhe pse folja me të cilën përcillet e pakryera e lidhore së shqipes ndodhet në të pakryerën e dëftores së greqishtes.
- ❖ Koha kryer e lidhore së shqipes ndërtohet duke i paravendosur pjesores së foljes format vetore të lidhore të së tashmes së foljes ndihmëse *kam*. E kryera e lidhore së greqishtes formohet nga lidhorja e foljes ndihmëse *έχω (kam)* dhe forma paskajore e greqishtes së re. E kryera e lidhore së shqipes mund të jepet me të kryerën e dëftores së greqishtes, me të pakryerën e foljes *είμαι (jam)* të prirë nga pjesëza *va*, ose me të kryerën e lidhore së greqishtes.
- ❖ Më se e kryera e lidhore është një formë kohore të cilën e hasim vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa në gjuhën greke struktura e saj nuk përbën kohë gramatikore. Më se e kryera e lidhore së shqipes formohet me foljen ndihmëse *kam* në të pakryerën e lidhore dhe pjesoren e foljes. Duke qenë se në greqisht nuk ekziston koha analoge e lidhore, kjo kohë përkthehet në këto raste nga shqipja me anë të më se të kryerës së dëftores të greqishtes, nëpërmjet të pakryerës së dëftores paraprirë nga pjesëza *va*, apo nëpërmjet më se të kryerës së dëftores, paraprirë përkatësisht nga pjesëzat *va* dhe *av*.
- ❖ Ndërtimi *kam + lidhore*, në gjuhën greke ka një përdorim mjaft të gjerë ndërsa përdorimi i tij në gjuhën shqipe si formë e së ardhmes është zbehur. Me këtë kuptim në vend të saj përdoret forma *kam + formën paskajore*, e cila ka gjithashtu edhe kuptimin e domosdoshmërisë apo sigurisë sipas rastit. Këtë strukturë në të dyja gjuhët mund ta hasim a) në formën *kam + folje në lidhore*, në formën e një strukture të lirë, brenda së cilës mund të vendoset një gjymtyrë tjetër dhe b) në formën e një strukture të ngurtësuar. Mund të themi se në të dyja gjuhët kemi të bëjmë me një sintagmë e cila po shkon drejt gramatikalizimit duke qenë se elementët e saj e kanë humbur pavarësinë kuptimore në një masë të madhe apo të vogël.

3.3. Mënyra urdhërore

3.3.1. Urdhërorja e shqipes

Mënyra urdhërore përdoret për të shprehur modalitetin e dëshirës në formë urdhri, kërkese, këshille, porosie, lutjeje, grishjeje, lejimi etj²³². Fillimisht me vlerën e urdhërores janë përdorur format e së tashmes së dëftores të shqiptuara me intonacion urdhri dhe më vonë janë krijuar forma të posaçme gramatikore për këtë mënyrë, forma të cilat nuk e krijojnë të plotë paradigmen²³³. Me vlerën e mënyrës urdhërore përdoren edhe trajtat e lidhores, jo vetëm për vetat të cilat nuk mund të formohen në urdhërore, veta e parë dhe veta e tretë, por edhe për vetat për të cilat urdhërorja ka trajtat e veta foljore²³⁴. Këtë përdorim e hasim në mbarë shqipen dhe e ndeshim relativisht dendur që tek autorët e vjetër, ndaj duhet të jetë i hershëm²³⁵. Shpesh përdorimi i lidhores me vlerën e urdhërores paraprihet nga pjesëza *le*. Me vlerën e urdhërores mund të përdoret në disa raste në gjuhën shqipe edhe e ardhmja e dëftores. Në trajtat e mënyrës urdhërore nuk krijohet në gjuhën shqipe një kundërvënie kohore, pra nuk mund të flasim në këtë mënyrë për kategorinë gramatikore të kohës, por këto trajta i referohen kryesisht të ardhmes. Në gjuhën greke, siç do të vërejmë edhe më poshtë, mënyra urdhërore ka dy kohë të tashmen dhe aoristin, por me ndryshime aspektore ndërmjet tyre dhe jo ndryshime në lidhje me momentin e veprimit²³⁶.

Mënyra urdhërore e shqipes, si edhe ajo e greqishtes së re, ka forma gramatikore vetëm për vetën e dytë njëjës dhe shumës. Për sa i përket mënyrës së formimit të trajtave foljore të numrit shumës, në zgjedhimin vepror ato kanë të njëjtën formë si veta e dytë shumës e së tashmes së dëftores, p.sh.: (*ju*) *mësoni* – *mësoni* (*ju*), forma të cilat dallohen nga intonacioni i fjalisë në të cilën përdoren. Ndërsa për sa u përket trajtave të numrit njëjës, një pjesë e tyre kanë të njëjtën formë me vetën e dytë njëjës të së tashmes së dëftores si p.sh. foljet që i përkasin foljet e klasës së parë të zgjedhimit të dytë (*hap* - *hap*), foljet e zgjedhimit të tretë (*pi* - *pi*) dhe foljet e parregullta supletive (*ha* – *ha*, *rri* - *rri*).

Foljet e tjera të cilat e formojnë vetën e dytë njëjës të urdhërores ndryshe nga e tashmja e dëftores, sipas Gramatikës²³⁷ së gjuhës shqipe mund të ndahen në katër grupe:

Foljet e zgjedhimit të parë të cilat dalin me temë më *-o-*, *-e-* dhe *-i-*, në vetën e dytë njëjës të urdhërores nuk marrin mbaresë, p.sh.: *mëso*, *rrëfe*, *fshi*, përveç foljeve *brej*, *gjej* dhe *blej* të cilat e formojnë vetën e dytë njëjës të urdhërores përkatësisht *brej*, *gjej* dhe *bli*.

²³² Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

²³³ Sh.Demiraj, *vep. e cit.*, 1986

²³⁴ Për këtë bëhet fjalë në mënyrë të hollësishme në kapitullin lidhur me mënyrën lidhore.

²³⁵ Sh.Demiraj, *vep. e cit.*, 1986

²³⁶ Edhe në latinisht, sipas Jaspersen – it, ka dy kohë në urdhërore, të cilat i referohen të dyja së ardhmes, duke qenë se e ashtuquajtura urdhërore e tashme i referohet ose së ardhmes së menjëhershme, ose një kohe të pacaktuar në të ardhmen, ndërsa e ashtuquajtura urdhërore e ardhme përdoret kryesisht në lidhje me një kohë të shënuar posaçërisht. (Sh.Demiraj, *vep. e cit.*, 1986)

²³⁷ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995

Të gjitha foljet e tjera të zgjedhimit të parë, përveç atyre të grupit të mësipërm dhe foljes *hyj*, në vetën e dytë njëjës të urdhërores marrin mbaresën *-j*, p.sh.: *mbaj, thyej, bëj*. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe foljet e parregullta *thuj* dhe *duaj*.

Në grupin e tretë bëjnë pjesë foljet e klasës së dytë të zgjedhimit të dytë cilat në vetën e dytë njëjës të urdhërores e ndërrojnë zanoren *-e* ose togun *-je-* në *-i-*, p.sh.: *hiq, mbill*. Foljet *pjek, përpkjek, ndjek* dhe *djeg* ndërrojnë edhe *-k-* në *-q-* dhe *-g-* në *-gj-*, *piq, digj*. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe foljet e zgjedhimit të tretë *fle, ngre* si edhe foljet e parregullta *jam, kam, shoh, vdes*. Përjashtim bën folja *marr*, e cila e formon vetën e dytë njëjës të urdhërores si vetën e dytë njëjës të së tashmes së dëftores. Përjashtim përbëjnë gjithashtu edhe foljet e nënklasës së tretë të klasës së dytë të zgjedhimit të dytë *vras, ngas, gërhas* e *pres* të cilat përbëjnë një grupim më vete dhe në vetën e dytë njëjës të urdhërores dalin zakonisht me temë të pazgjeruar si në të kryerën e thjeshtë: (*mos*) e *vra, nga, gërnga, pre* por ndeshen edhe në trajtën *vrit, ngit, gërgit, prit*.

Foljet e zgjedhimit të tretë *vë, zë, përzë, shpie*, folja e zgjedhimit të parë *hyj* dhe foljet e parregullta *bie* dhe *lë* në vetën e dytë njëjës të urdhërores e zgjerojnë temën me *-r-*.

Ka raste kur veta e dytë njëjës e urdhërores ndiqet nga një trajtë e shkurtër, e cila i bashkëngjitet formës së urdhërores, shembulli (1). Kur kjo formë mbaron me zanore dhe trajta e shkurtër është zanore, për lehtësi shqiptimi shtohet tingulli kundër hiatit *-j-*, shembulli (2). E njëjta gjë ndodh edhe në rastin kur trajta foljore është në vetën e dytë shumës dhe trajta e shkurtër vendoset midis temës dhe mbaresës së vetës së dytë shumës së urdhërores, shembulli (3). Në gjuhën greke, në ndryshim nga shqipja trajtat e shkurtra asnjëherë nuk i bashkëngjiten foljeve në urdhërore, por i pasojnë gjithmonë ato siç duket edhe në përkthimin e shembujve të sipërpërmendur.

- 1) **Tregona**, *vëlla, si ndodhi*. (Gj.U.V. 174) – **Πες μας, αδερφέ, πώς έγινε**. (Σ.Ν.Σ. 207)
- 2) **Bëju** nga një kafe, nuk e sheh si janë dërrmuar? – *i thirri dikush shitësit*. (Gj.U.V. 174)- **Καν' τους έναν καφέ, δε βλέπεις πως είναι ράκη; φώναζε κάποιος στον καφετζή**. (Σ.Ν.Σ. 206)
- 3) **Mbulojeni** përsëri, - *tha prifti. S'ke ç'i bën*. (Gj.U.V. 179) – **Ξαναθάψτε τον, είτε ο ιερέας. Τι άλλο να γίνει**. (Σ.Ν.Σ. 211)

Format e zgjedhimit jovepror të mënyrës urdhërore të foljeve formohen duke u prapavendosur pjesëzën *u* formave gjegjëse të formës veprorë për vetën e dytë njëjës të urdhërores, shembulli (4), ndërsa për vetën e dytë shumës duke e vendosur pjesëzën *u* ndërmjet temës dhe mbaresës vetore të vetës së dytë shumës.

- 4) **Ngrehu**, *themelues i shtetit, thirra me vete. Ndize llullën e luftës*. (Ç.M. 75) – **Σήκω όρθιος, ιδρυτή του κράτους, φώναζα μέσα μου. Άναψε τη φωτιά του πολέμου**. (I.T. 69)

Mohimi në urdhërore në gjuhën shqipe, kryhet nëpërmjet pjesëzës mohuese *mos*, në ndryshim nga dëftorja ku përdoret pjesëza mohuese *nuk*, shembujt (5), (6), (7), dukuri kjo që ndodh edhe në gjuhën greke siç do ta shqyrtojmë edhe në vazhdim. Në këto raste trajta

e shkurtër si edhe pjesëza e joveprores *u* i paravendosen foljes, shembujt (6), (7). E njëjta gjë, siç vërejmë edhe nga përkthimi, ndodh edhe në gjuhën greke.

- 5) *Dhe tani që është vrarë, duke gërmuar tokën, unë thosha me vete: **mos ki frikë, gropën po ta bëj të thellë, shumë të thellë.** (Gj.U.V. 23)- *Και τώρα που ήταν σκοτωμένος, ενώ έσκαβα, μονολογούσα: **μη φοβάσαι, θα σου φτιάξω ένα λάκκο βαθύ, πολύ βαθύ.** (Σ.Ν.Σ. 27)**
- 6) ***Mos më fyeni – tha prifti. Edhe unë jam patriot.** (Gj.U.V. 32) – **Μην με προσβάλλετε, είπε ο ιερέας. Είμαι κι εγώ πατριώτης.** (Σ.Ν.Σ. 39)*
- 7) *-Ja medaljoni, - tha dhe ia tregoi gjeneralit duke e mbajtur me një pincë. – **Mos e prekni, - ju lutem.** (Gj.U.V. 24) – *Ένα μενταγιόν, είπε και το ‘δειξε στο στρατηγό, κρατώντας το με μια λαβίδα. **Μην το αγγίζετε, σας παρακαλώ.** (Σ.Ν.Σ. 29)**

Siç përmendëm edhe më sipër kuptimi i urdhërores është të shprehë dëshirën e folësit në formë urdhri, shembujt (8), (9), (10), nxitjeje, shembujt (11), (12), këshille, shembujt (13), (14), lutjeje shembulli (15).

- 8) *Dezinfektantin, - thirri specialisti, **sillni** dizinfektantin. (Gj.U.V. 24) – *Το απολυμαντικό, φώναζε ο επιστάτης, **φέρτε** το απολυμαντικό. (Σ.Ν.Σ. 29)**
- 9) *U bë gati t'i thoshte shoferit: **ndal, ku po na çon, ti po na kthen përsëri në male?** (Gj.U.V. 191) – *Ετοιμαζόταν να πει στον οδηγό: **σταμάτα, πού μας πας, μας ξαναγυρίζεις στα βουνά;** (Σ.Ν.Σ. 225)**
- 10) ***Paketojini** eshtrat, - u tha specialisti punëtorëve. (Gj.U.V. 25) – **Να πακετάρετε** τα οστά, *είπε ο επιστάτης στους εργάτες. (Σ.Ν.Σ. 30)**

Në shembullin (8) urdhërorja e vetës së dytë shumë *sillni* jepet po me urdhëroren e thjeshtë, ose aoristin e greqishtes *φέρτε* dhe shpreh të njëjtin kuptim modal si edhe folja në gjuhën shqipe. Në shembullin (9) urdhërorja e shqipes *ndal*, e cila në këtë rast përdoret pa zanoren –*o* të temës, jepet me urdhëroren e vazhduar, ose të tashmen e urdhërores së greqishtes *σταμάτα*. Ndërsa vërejmë se në shembullin (10) urdhërorja e shqipes *paketojini* është dhënë nëpërmjet lidhore së greqishtes *να πακετάρετε*, e cila në këtë rast ka kuptimin e urdhërores. Trajta e shkurtër *i* e cila ndodhet në trup të foljes në gjuhën greke nuk është dhënë fare. Dhënia e trajtës së shkurtër e cila në këtë rast ndodhet në fund të foljes në shqip është shmangur edhe në shembullin (11) ku urdhërorja e shqipes *shtyje* jepet me aoristin e urdhërores së greqishtes *σπρώξε*. Një strukturë e tillë ekziston në gjuhën greke, *σπρώξε τον αυτό το διάλογο*, por përkthyesja në këtë rast ka zgjedhur të mos e përdorë. Në shembullin (12) urdhërorja e shqipes *fol* jepet me të tashmen e urdhërores së greqishtes *μίλα*.

- 11) ***Shtyje** dreqin, - tha fshataraku tjetër, duke shtyrë rrotën. (Gj.U.V. 55) – **Σπρώξε** λίγο κι εσύ αυτό το διάλογο, *είπε ο άλλος σπρώχνοντας τη ρόδα. (Σ.Ν.Σ. 67)**
- 12) ***Fol**, Gjolekë, si e ndien veten, e pyetëm disa herë, por ai nuk e hapi gojën, vetëm na vështronte sikur të thoshte: **keq, vëlla, keq.** (Gj.U.V. 175) – **Μίλα**, Γκιουλέκα, *πώς νιώθεις, τον ρωτήσαμε μερικές φορές, αλλά αυτός δεν άνοιγε το στόμα του, μόνο μας κοίταζε σα να ‘λεγε: άσχημα, αδερφέ, άσχημα. (Σ.Ν.Σ. 207)**

- 13) *Dëgjomë mua ti, - tha plak, e di mirë unë këtë punë, nga ata është. (Gj.U.V. 230) – Άκουσέ μ' εμένα, είπε ο γέρος, ξέρω καλύτερα εγώ, απ' αυτούς είναι. (Σ.Ν.Σ. 270)*
- 14) *Shihmëni tani ç'do t'ju punoj. (Ç.M. 80) – Θα δείτε τώρα τι θα σας φτιάξω! (I.T. 74)*
- 15) *Mjaft më jeni qepur si një dado. Lermëni të qetë, dreqi e mori. (Gj.U.V. 206) – Αρκετά μου κάνετε τη νταντά. Αφήστε με ήσυχο, που να πάρει ο διάολος. (Σ.Ν.Σ. 242)*

Në shembullin (13) urdhërorja e vetës së dytë njëjës së cilës i është bashkëngjitur edhe trajta e shkurtër *më*, *dëgjomë*, jepet me aoristin e urdhërores së greqishtes *άκουσε* së cilës i prapavendoset trajta e shkurtër *με*, e cila në këtë rast ka humbur zanoren fundore sepse ndiqet një fjalë që fillon me zanoren *ε*. Urdhërorja në shembullin (14) jepet në greqisht me të ardhmen e thjeshtë të dëftores, *θα δείτε* duke shmangur kështu edhe dhënien e trajtës së shkurtër *më* e cila ndodhet në trup të foljes. Në këtë rast mund të ishte përdorur edhe urdhërorja *κοιτάζτε*, por është zgjedhur nga përkthyesi trajta foljore e së ardhmes për ta përkthyer urdhëroren, e cila mund të përdoret edhe në shqip me vlerën e urdhërores. Në shembullin (15) urdhërorja *lermëni* jepet në greqisht me aoristin e urdhërores *αφήστε* pasuar nga trajta e shkurtër *με*.

3.3.2. Urdhërorja e greqishtes

Edhe në gjuhën greke urdhërorja është mënyra e cila përdoret për të shprehur me anë të foljes një thirrje e cila mund të jetë në formën e një urdhri dëshire apo urimi²³⁸. Por si edhe në shqip me vlerën e urdhërores mund të përdoret edhe lidhorja e në disa raste edhe veta e parë shumës e së tashmes së dëftores²³⁹, p.sh.: *ας πάμε* (*le të shkojmë*), *να φύγουμε* (*të ikim*), *πάμε* (*shkojmë*), *φύγουμε* (*ikim*). Në greqishten e re ashtu si edhe në gjuhën shqipe urdhërorja ka trajta të veçanta vetëm për vetën e dytë njëjës dhe shumës²⁴⁰. Ka gjithashtu trajta të veçanta kohore për të tashmen dhe aoristin. Dallimet ndërmjet këtyre kohëve janë aspekte dhe aspak kohore, e tashmja shpreh aspektin e pakryer, ndërsa aoristi aspektin perfektiv. Emërtimi i tyre tradicional vjen nga temat kohore të cilat përdoren për formimin e këtyre kohëve, përkatësisht tema e së tashmes dhe tema e aoristit. Kleris e Babiniotis²⁴¹ madje e quajnë urdhëroren si një mënyrë “jo kohore”, sepse veprimi të cilit i referohet folja në këtë mënyrë akoma nuk është kryer dhe është i vendosur në të ardhmen. Përveç këtyre dy kohëve Triantafilidhis²⁴² thotë se foljet rrallë

²³⁸ M. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005, 308

²³⁹ Triantafilidhis këto i trajton si forma sintetike të vetës së parë shumës së urdhërores aktive. (M. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005, 315)

²⁴⁰ Në greqishten e vjetër urdhërorja kishte trajta të veçanta edhe për vetën e tretë njëjës dhe shumës (I. Σταματάκου, *Ιστορική γραμματική της αρχαίας ελληνικής*, Αθήνα, 1968, 246), trajta të cilat nuk ekzistojnë në greqishten e re dhe për të shprehur veprimin në urdhërore në këtë vetë përdoren trajtat e lidhore. Njëra prej këtyre trajtave ë greqishtes së vjetër përdoret edhe në greqishten e re si pasthirmë, është forma *ζήτω*, veta e tretë e urdhërores aktive të foljes *ζω*.

²⁴¹ Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπινιώτης, *vep. e cit.*, 2004, 420

²⁴² M. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005, 314

mund të formojnë edhe trajta të së kryerës si p.sh.: *έχε γραμμένο* (ki të shkruar), formuar nga e tashmja urdhërores së foljes *έχω* (kam) dhe pjesores pasive të foljes.

3.3.2.1. E tashmja e urdhërores ose urdhërorja e vazhduar

Siç e përmendëm edhe më sipër e tashmja e urdhërores karakterizohet nga aspekti imperfektiv, por për mënyrën urdhërore kjo kundërvënie nuk është gjithmonë shumë e qartë²⁴³. Shpesh hasim raste kur e tashmja përdoret në vend të aoristit, pra jo për të treguar një veprim që kryhet në vazhdimësi apo përsëritet. E tashmja e urdhërores veprare formohet nga tema e së tashmes me mbaresat *-ε/-ετε*, përkatësisht për vetën e dytë njëjës dhe shumës të foljeve të zgjedhimit të parë dhe *-α/-ατε*, për foljet e zgjedhimit të dytë. E tashmja e urdhërores joveprare rrallë formohet me trajta të veçanta sintetike, haset vetëm te disa folje p.sh.: *γίνου, κάθου* etj., ndërsa për foljet tjera formohet nëpërmjet të tashmes së lidhore.

E tashmja e urdhërores aktive			
Tema foljore e së tashmes		Mbaresa	
<i>διαβάξ-</i>	<i>αγαπ-</i>	<i>-ε/-ετε</i>	<i>-α/-ατε</i>
<i>διάβαξε/διβάξετε</i>		<i>αγάπα/αγαπάτε</i>	

Tabela 3.32

E tashmja e urdhërores si edhe aoristi përdoren për të shprehur një urdhër, shembujt (1, 2), lëshim, shembujt (3, 4), nxitje, shembulli (5), urim, shembulli (6), etj. Për të përkthyer në gjuhën shqipe të tashmen e urdhërores zakonisht përdoret urdhërorja, shembujt (1-5). Por mund të përdoret edhe ndonjë mënyrë tjetër si në shembullin (6), ku është përdorur dëshirorja *παρ* për të dhënë urdhëroren *έχε* të foljes *έχω* (kam). Pra vërejmë që për të përkthyer të njëjtën formë foljore, të tashmen e urdhërores së foljes *έχω* (kam), në gjuhën shqipe janë përdorur dy mënyra të ndryshme, urdhërorja *ki*, shembulli (5) dhe dëshirorja *παρ*, (shembulli 6), e cila nuk formon trajta të veçanta foljore në greqishten e re.

- 1) *Πήγαινε εσύ μπροστά, τον πρόσταξε` έχουμε δικιά μας κουβέντα.* (B.Π. 112) – *Ec përpara se kemi tjetër muhabet!* (Z. 100)
- 2) *Μωρέ καλόγερε, μίλα μη σε πνίξω!* (B.Π. 215) – *Fol, fol, mor kallogjer. Se të mora frymën.* (Z. 194)
- 3) *Το φαί μου ψήθηκε, άρμεξα τα πρόβατά μου, μανταλωμένο το κλουβί μου, αναμμένη η φωτιά μου` και συ, βρέχε όσο θες, ουρανέ μου!* (B.Π. 30) – *Gjella m'u*

²⁴³ Χρ. Κλαίρης - Γ. Μπαμπινιώτης, *ver. e cit.*, 2004

- bë, dhentë i mola, bunin e mbylla, zjarrit i shtiva dru. Ndaj, po deshe, bjer o shi nga qiejt. (Z. 26)*
- 4) *Ο, τι θες λέγε' η γυναίκα είναι κάτι άλλο, αφεντικό, κάτι άλλο, όχι άνθρωπος. (B.Π. 100) – Thuaj ç'të duash, zotni, po gruaja është tjetër gjë, tjetër gjë, s'është njeri. (Z. 89)*
- 5) *...Κάμε το λοιπόν υπομονή, έχε εμπιστοσύνη σε μένα. (B.Π. 161) – Bëj pra durim e ki besim te lala. (Z. 144)*
- 6) *Έχε την ευκή μου! μου κάνει. (B.Π. 244) – Paç uratën! – më tha. (Z. 220)*

Ndryshe nga dëftorja urdhërorja për të formuar formën mohore përdor pjesëzën mohuese *μην (mos)*, shembulli (7) siç ndodh edhe në gjuhën shqipe.

- 7) *Μην τρέμεις, μωρέ καλόγερε, δε σου 'δωκε διαταγή ο αρχάγγελος; (B.Π. 218)- Mos u dridh o kallogjer! A s'të dha urdhër vetë kryengjëlli? (Z. 197)*

3.3.2. 2. Aoristi i urdhërores ose urdhërorja e thjeshtë

Aoristi i urdhërores ose urdhërorja e thjeshtë karakterizohet nga aspekti perfektiv. Sipas Mackridge²⁴⁴ urdhërorja për sa i përket aspektit të foljes sillet zakonisht ashtu si dëftorja dhe lidhorja, por ka edhe faktorë të tjerë që kushtëzojnë përdorimin e njërës apo tjetrit aspekt si *konkretizimi* i një veprimi, ekziston sipas tij tendenca të përdoret aspekti perfektiv (aoristi i urdhërores) kur bëhet fjalë për veprime më të konkretizuara e më pak të përgjithshme, *politesa*, sepse përdorimi i aspektit perfektiv jep përshtypjen se folësi shprehet me më shumë politesë se sa kur përdor aspektin imperfektiv dhe *kufizimimet morfologjike* pasi ka folje të cilat nuk mund ta formojnë fare urdhëroren, apo të formojnë vetëm njërën apo tjetrën trajtë të saj. Aoristi i urdhërores aktive formohet nga tema e aoristit aktiv me mbaresat *-ε/-τε*, përkatësisht për vetën e dytë njëjës dhe shumës të foljeve të të dyja zgjedhimeve. Ndërsa aoristi i urdhërores pasive për vetën e dytë njëjës formohet nga tema e aoristit aktiv plus mbaresën *-ου*, për vetën e dytë shumës formohet nga tema e aoristit pasiv duke i prapavendosur mbaresën *-είτε*. Në mënyrë skematike formimi i këtyre trajtave foljore mund të paraqitet si më poshtë:

Aoristi i urdhërores aktive			Aoristi i urdhërores pasive		
Tema foljore e aoristit		Mbaresa	Tema foljore e aoristit aktiv/pasiv		Mbaresa
διάβασ-	αγάπησ-	-ε/-τε	αγαπήσ-	αγαπηθ-	-ου/-είτε
διάβασε/ διβάστε		αγάπησε/ αγαπήστε	αγαπήσου		αγαπηθείτε

Tabela 3.33

Tabela 3.34

²⁴⁴ P. Mackridge, *vep. e cit.*, 1990, 198 - 200

Përveç foljeve që e formojnë aoristin e urdhërores me mbaresat e mësipërme, ka edhe folje të cilat e formojnë atë në mënyrë të çrregullt, p.sh. folja *πίνω*, aoristi i së cilës është *πιες*, shembulli (1). Po kështu edhe folja *έρχομαι* e cila mund të formojë vetëm aoristin e urdhërores *έλα*, *έλάτε* shembujt (2), (3). Vëmë re se në shqip urdhërorja e kësaj foljeje jepet një herë me foljen *çap*, shembulli (2) dhe një herë me urdhëroren *hajde*, shembulli (3), ndërkohë që në shqip ekziston edhe urdhërorja e foljes *vij*, *eja*. Edhe folja *λέω* (*them*) e formon aoristin e urdhërores në mënyrë të çrregullt *πιες*, shembulli (4). Në shqip ajo është përkthyer me urdhëroren e foljes *kallëztoj*, *kallëzo*.

- 1) **Φάε, πιες και τράβα να κοιμηθείς, σου λέω!** (B.Π. 112) - **Ha, pi e drejt e në krenat, po të them.** (Z. 100)
- 2) **'Ελα μαζί μου εκεί πέρα στον Καύκασο, χιλιάδες από τη ράτσα μας κιντνεύουν' έλα να τους σώσουμε.** (B.Π. 17) – **Çap me mua atje në Kaukaz, mijëra e mijëra nga raca jonë janë në rrezik. O burra t'i shpëtojme.** (Z. 12)
- 3) **'Ελα εδώ καφετζή' ένα ρούμι!** (B.Π. 22) – **Pa hajde, kafexhi, një rum!** (Z. 18)
- 4) **Ε, σε πήε πέντε κι ένα, καπετάν λεμονή, πες την αλήθεια!** (B.Π. 25) – **Eh, të shkoi shurra brekëve, kapedan Lemonis, kallëzo të drejtën.** (Z. 21)

Në disa raste mbaresa e vetës së dytë të aoristit të urdhërores aktive –ε, bie kur fjala që vijon fillon me τ, si rasti i foljes *αφήνω* (*lë*), e cila e formon aoristin e urdhërores edhe në mënyrë të çrregullt *άσε*, *άστε*, përveç mënyrës së rregullt *άφησε*, *αφήστε*, shembulli (5). Në gjuhën shqipe kjo urdhërore është dhënë me trajtën *lëre*, ku foljes në urdhërore i është prapavendosur trajta e shkurtër *e*, ndërkohë që edhe në greqisht folja në urdhërore pasohet nga një trajtë e shkurtër. E njëjta gjë ndodh edhe në shembujt (6), (7) ku trajtat e shkurtra u bashkëngjiten në shqip foljeve në urdhërore, ndërsa në greqisht këto folje ose ndiqen nga trajtat e shkurtra, shembulli (6), ose nga një kundrinor, shembulli (7).

- 5) **Ας' τηνε στο διάολο, το καλό που σου θέλω!** (B.Π. 112) – **Lëre në dreq, të mori e mira!** (Z. 100)
- 6) **Άκου αφεντικό, πάρε ένα μαντύλι, δέσε κόμπο δυο τρεις λίρες, μα χρυσές, όχι χαρτιά, αυτά δε θαμπώνουν το μάτι, πέψε τις με το Μιμηθό στη χήρα, παράγγειλέ του τι θα πει.....**(B.Π. 113) – **Dëgjo, zotni, merr një shami, lidhe nyje, fut dy tri lira, po lira floriri jo letre se ato të errin sytë, dërgoja vejushës me Mimithonë dhe porosite mirë që t'i thotë....** (Z. 101)
- 7) **Λύσε τον κόμπο. Λύσε τον κόμπο..... ικέτευε η Σειρήνα.** (B.Π. 221)– **Zgjidhe, zgjidhe!** - përgjërrohej Sirena. (Z. 199)

Për të dhënë aoristin e urdhërores *φέρε* të foljes *φέρνω* (*sjell*) është përzgjedhur në shqip urdhërorja *hjer* e foljes *bie*, dhe jo ajo e foljes *sjell*, *sill*, shembulli (8).

- 8) **Καφετζή, φώναζε, φέρε να κεράσεις τα παιδιά!** (B.Π. 26) – **Kafexhi, - thirri, - hjer për të qerasur çunat!** (Z. 22)
- 9) **Σηκωθείτε για τον όρθο, αδελφοί!** (B.Π. 214) – **Çohuni, vëllezër, ra kambana e mëngjesit!** (Z. 193)
- 10) **Μη γυρίσεις! πρόσταζα από μέσα μου' φτάνει!** (B.Π. 19) – **Mos e kthe kokën urdhërove veten, mjaft më!** (Z. 15)

Edhe aoristi pasiv i urdhërores së greqishtes jepet nëpërmjet urdhërores joveprore të shqipes, shembulli (9). Siç përmendëm më sipër për të tashmen e urdhërores edhe aoristi e formon formën mohuese nëpërmjet pjesëzës mohuese *μην* (*mos*), e cila i paravendoset foljes në vetën përkatëse të lidhores, shembulli (10).

Përfundime

- ❖ Mënyra urdhërore si në gjuhën shqipe edhe në atë greke përdoret për të shprehur modalitetin e dëshirës në formë urdhri, kërkese, këshille, porosie, lutjeje, grishjeje, lejimi etj. Me vlerën e mënyrës urdhërore përdoren edhe trajtat e lidhore, jo vetëm për vetat të cilat nuk mund të formohen në urdhërore, veta e parë dhe veta e tretë, por edhe për vetat për të cilat urdhërorja ka trajtat e veta foljore. Me vlerën e urdhërores mund të përdoret në disa raste në gjuhën shqipe edhe e ardhmja e dëftores, ndërsa në gjuhën greke veta e parë shumës e së tashmes së dëftores.
- ❖ Në trajtat e mënyrës urdhërore nuk krijohet në gjuhën shqipe një kundërvënie kohore, pra nuk mund të flasim në këtë mënyrë për kategorinë gramatikore të kohës, por këto trajta i referohen kryesisht të ardhmes. Në gjuhën greke, mënyra urdhërore ka dy kohë të tashmen dhe aoristin, por me ndryshime aspektore ndërmjet tyre dhe jo ndryshime në lidhje me momentin e veprimit.
- ❖ Mënyra urdhërore e shqipes, si edhe ajo e greqishtes së re, ka forma gramatikore vetëm për vetën e dytë njëjës dhe shumës.
- ❖ Kur veta e dytë njëjës e urdhërores ndiqet nga një trajtë e shkurtër, e cila i bashkëngjitet formës së urdhërores, ose kur trajta foljore është në vetën e dytë shumës, trajta e shkurtër vendoset midis temës dhe mbaresës së vetës së dytë shumës së urdhërores. Në gjuhën greke, në ndryshim nga shqipja trajtat e shkurtra asnjëherë nuk u bashkëngjiten foljeve në urdhërore, dhe as vendosen në trup të tyre.
- ❖ Mohimi në urdhërore në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën greke kryhet nëpërmjet pjesëzës mohuese *mos* (*μην*), në ndryshim nga dëftorja ku përdoret pjesëza mohuese *nuk* (*δεν*).
- ❖ Urdhërorja e shqipes jepet në greqisht zakonisht nga urdhërorja e greqishtes, e tashmja ose aoristi, por mund të ndodhë që të jepet edhe nga ndonjë mënyrë tjetër si p.sh. lidhorja apo e ardhmja e dëftores.
- ❖ Urdhërorja e greqishtes përkthehet zakonisht në shqip me urdhëroren, ose ndonjë mënyrë tjetër si dëshirorja e shqipes e cila nuk ekziston në greqishten e re.

3.4. Mënyra habitore

Mënyra habitore e shqipes ka qenë objekt diskutimesh ndërmjet gjuhëtarëve, për sa u përket mjaft çështjeve që lidhen me të: së pari ekzistenca e saj si mënyrë më vete apo ekzistenca e trajtave kohore habitore, mënyra e formimit të trajtave të habitores, mosha e trajtave të habitores dhe pikëtakimet midis habitores së shqipes dhe mënyrës së ritregimit në bullgarisht e rumanisht.

Në gramatikën²⁴⁵ e gjuhës shqipe habitortja trajtohet si mënyrë më vete, e cila së bashku me mënyrën dëftore shpreh modalitetin e vërtetësisë, por me habitoren folësi shpreh edhe ndjenjën e habitës. Por format e habitores përdoren relativisht dendur edhe për të shprehur një qëndrim ironizues, mosmiratues, kundërshtues të folësit²⁴⁶. I pari që i ka shqyrtuar trajtat kohore të habitores ka qenë Dozoni, i cili i emërton ato si “kohë të përbëra admirative”, por nuk e trajton mënyrën habitore si mënyrë më vete. Edhe Kristoforidhi²⁴⁷ në gramatikën e tij nuk bën fjalë për mënyrë habitore, por për kohë të cilat ai i quan “*απροσδόκητοι χρόνοι*” të papritura dhe i përfshin ato në mënyrën dëftore, lidhore dhe volitive. Ai rendit një sërë kohësh, përveç kohëve që pranohen nga gramatika e gjuhës shqipe si forma kohore të habitores, disa nga të cilat si *të paskam pasë, të paskam pasë pasë, do të paskam pasë, do të paskam pasë pasë* nuk hasen asgjëkund²⁴⁸. Sami Frashëri²⁴⁹ flet gjithashtu për “*mote të papandehurë*” dhe i përfshin ato në mënyrën dëftore e lidhore. E. Lafe është gjithashtu i mendimit se “zgjidhja më e mirë do të ishte të flisnim për trajta habitore të disa kohëve të mënyrës dëftore, lidhore dhe eventualisht kushtore dhe jo për mënyra habitore e lidhore - habitore”²⁵⁰. K. Cipoja²⁵¹ në gramatikën e tij e pranon mënyrën habitore (admirativin) si mënyrë më vete dhe trajton dy trajta kohore të saj, prezentin (*paskam, pikan*) dhe perfektin (*paskan mbushur, qënkën zënë*). Cipoja bën fjalë gjithashtu edhe për “një mënyrë të re, që nuk figuron akoma në gramatikët”, mënyrën habitore – lidhore²⁵², e cila ka dy kohë, imperfektin, dhe citon këtu vargjet e N. Frashërit : *të qënkështa si ti djalë...../ të paskështa vrapn’ e veriut*, dhe aoristin e dytë ose i kryeri i tejshkuar (*të paskështa qënë*) siç e emërton ai. Për të ashtuquajturën mënyrë lidhore – habitore²⁵³ bën fjalë edhe Sh. Demiraj²⁵⁴, i cili e trajton gjithashtu mënyrën habitore si mënyrë më vete. Për mënyrën habitore në gramatikat e shqipes në gjuhë të huaj mbizotëron termi admirativ, ndërsa që pas Kongresit të Lushnjës në gramatikat e shqipes në shqip është përdorur termi mënyrë habitore²⁵⁵.

²⁴⁵ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, 273

²⁴⁶ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, Tiranë 1986, 905

²⁴⁷ Χριστοφορίδη, *Γραμματική της Αλβανικής Γλώσσας*, 1882

²⁴⁸ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, Tiranë 1986, 906

²⁴⁹ S. Frashëri, *Shkronjëtorë e gjuhës shqip*, Bukuresht, 1886, 127

²⁵⁰ E. Lafe, *Mbi habitoren dhe disa trajta të saj*, SF 2, 1975, 151

²⁵¹ K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, 118-119

²⁵² Sipas K. Topallit “Format e të ashtuquajturës habitore – lidhore (të paskështa – të paskështa pasur) nuk formojnë mënyrë të veçantë, pasi ato kanë shtrirje të kufizuar dialektore dhe kuptimisht nuk ndryshojnë nga format e së pakryerës e më se të kryerës”. K. Topalli, *vep. e cit.*, 2010

²⁵³ Edhe në *Gramatikën e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995, 273, 294, 327, përmendet mënyra lidhore – habitore, pa u trajtuar si mënyrë më vete, por kur bëhet fjalë për të kryerën dhe të më se të kryerën e lidhores, dhe është vënë në dukje se për nga modaliteti ajo anon nga lidhorja.

²⁵⁴ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1961, 231

²⁵⁵ Sh. Demiraj, *Habitortja dhe mosha e saj*, SF 3, 1971, 32

Haborja e shqipes për nga tipi i ndërtimit është e veçantë dhe nuk haset në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane²⁵⁶. Trajtat e habitores janë formuar nga pjesorja shkurtuar dhe folja ndihmëse *kam*. Ky argumentim të cilin e ka dhënë për herë të parë Dozoni dhe është mbështetur edhe nga shumica e gjuhëtarëve²⁵⁷, nuk është pranuar nga Jokli sipas të cilit haborja është formuar nga përngjitja e së ardhmes së përmbysur, mendim i cili sipas Demirajt rezultoi i pambështetur²⁵⁸. Ndërtimet e lira sintaksore të tipit pjesore + *kam* sipas E. Likës, që sollën habitoren e sotme kanë qenë të njohura te autorët e vjetër, por janë të njohura edhe sot. Për një kohë, derisa u arrit gramatikalizimi përkatës i njëjti ndërtim sintaksor u lidh me dy përmbajtje gjuhësore, një që theksonte veprimin për një kohë të shkuar dhe një tjetër që të njëjtin veprim vetëm sa e paraqet si të papritur, ku e para nuk u përdor dhe nuk u zhvillua më tej, sepse e përfaqësoi ndërtimi *kam* punuar, ndërsa e dyta u zhvillua më tej edhe gramatikisht²⁵⁹. Format e tjera kohore të habitores (e pakryera, e kryera, më se e kryera, e kryera e mbipërbërë, më se e kryera e mbipërbërë, e ardhmja, e ardhmja e së shkuarës) janë ndërtuar nën ndikimin analogjik të formave kohore gjegjëse të mënyrës dëftore²⁶⁰.

Për sa i përket moshës së trajtave të habitores duket se ato janë krijuar gjatë një procesi të gjatë dhe e kanë zanafillën sipas Demirajt²⁶¹ para botimit të veprës së Buzukut.

Pavarësisht se për nga struktura format e habitores së shqipes janë unike e nuk hasen në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane, për nga funksioni i tyre ato kanë disa pikëtakime me mënyrën e ritregimit në bullgarisht e maqedonisht. Asenova vëren se afëria formale midis mënyrës habitore të shqipes dhe mënyrës ritreguese të bullgarishtes bazohet në lidhjet e dukshme me format e perfektit²⁶². Por sipas Demirajt e tashmja dhe e pakryera e habitores së shqipes janë forma të përngjitura dhe të gjitha format e kësaj mënyre në zanafillë janë përdorur kryesisht për të shprehur habinë e folësit në çastin e ligjërimit të tij për diçka të papritur, ndërsa mënyra e ritregimit në bullgarisht e maqedonisht del me forma analitike, që nuk kanë arritur të përngjiten dhe edhe historikisht kuptimi modal i habitores tek format e kësaj mënyre është dytësor²⁶³. Friedman shqyrton në kontekstin ballkanik edhe të ashtuquajturën mënyrë prezumtive të rumanishtes dhe habitoren e shqipes²⁶⁴. Ato sipas tij përcaktohen me të njëjtat kuptime (d.m.th. habi. dyshim, ritregim, etj.), por konstaton se megjithëse që të dyja kategoritë janë përcaktuar në të njëjtën mënyrë, nuk bashkëngjasin në përdorimet e veta, por formojnë një kontinuum, në të cilin shqipja është në një anë dhe rumanishtja në tjetrën²⁶⁵.

²⁵⁶ Sh.Demiraj, *vep. e cit.*, Tiranë 1986, 906

²⁵⁷ Për një prezantim më të hollësishëm lidhur me formimin e habitores dhe gjuhëtarëve që mbështesin këtë mendim shih Sh. Demiraj, *Haborja dhe moshë e saj*, SF 3, 1971, 33

²⁵⁸ Sh.Demiraj, *vep. e cit.*, SF 3, 1971, 33 - 34

²⁵⁹ E. Likaj, *Format analitike në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1997, 149

²⁶⁰ Sh.Demiraj, *vep. e cit.*, Tiranë 1986, 913

²⁶¹ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, SF 3, 1971, 147

²⁶² P. Asenova, *Haborja e shqipes dhe mënyra e ritregimit e bullgarishtes*, Seminari i XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 1996, 567

²⁶³ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1994, 170

²⁶⁴ V. Friedman flet edhe për paralele e ndikime ndërmjet habitores në gjuhën shqipe dhe gjuhën arumune. Për më tepër shih, *Mënyra habitore në gjuhën shqipe dhe gjuhën arumune - paralele dhe ndikime*, Seminari i XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 1995

²⁶⁵ V. Friedman, *Haborja e shqipes dhe "prezuntivul" e rumanishtes*, Seminari i XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 1996, 582.

Edhe pse siç vumë re edhe më sipër në gramatika të ndryshme të shqipes hasen mjaft trajta kohore të mënyrës habitore, disa nga të cilat madje nuk ndeshen në ligjërim, apo ndeshen shumë pak, sipas gramatikës së Akademisë²⁶⁶, mënyra habitore ka dy kohë kryesore, të tashmen dhe të shkuarën, ku e shkuara ka tri nënndarje, të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën. Mund të hasen gjithashtu edhe forma të mbipërbëra të së kryerës (*paskam pasë larë*) dhe të së ardhmes (*do të lakam*).

3.4.1. Koha e tashme

Trajta e kohës e tashme e habitores siç u përmend edhe më sipër formohet nga prapavendosja e së tashmes së foljes *kam* te pjesorja e shkurtuar e foljes, pra kemi të bëjmë me një formë sintetike të formuar nga përngjitja e përmbysur e dy elementëve të kohës së kryer, vetëm se pjesorja paraqitet e shkurtuar dhe folja *kam* në vetën e tretë shumës e humbet zanoren fundore *-ë*. Për të ndërtuar formën joveprore këtyre trajtave u paravendoset pjesëza *u*.

E tashmja e habitores së shqipes	
Pjesore e shkurtuar	Folje ndihmëse
<i>mbjell-ë / ndenj-ur</i>	<i>kam</i>
<i>mbjellkam, ndenjkam /-ke, -ka, -kemi, -keni, -kan</i>	

Tabela 3. 35

E tashmja është një nga kohët me përdorim më të shpeshtë të habitores. Ajo mund të shprehë habinë, dyshimin, apo mospajtimin e folësit për një veprim të caktuar që vazhdon të kryhet në çastin e ligjërimin, që përsëritet herë pas here apo ka vlerë mbarëkohore. Foljet në të tashmen e habitores përdoren kryesisht në fjali të pavarura dhe kryesore shembujt (2), (3), (5), (6), (7) por mund të ndeshet edhe në fjali të nënrenditura, shembujt (1), (4).

Në gjuhën greke nuk ekziston mënyra habitore si mënyrë më vete dhe as ka trajta analoge me ato të habitore së shqipes, ndaj paraqet interes mënyra e përkthimit të këtyre trajtave të habitores së shqipes në greqisht.

- 1) *Ah, ashtu? – ia bëri ajo, pa e ndërprerë krehjen. – Meqë e ditke, pa ma thuaj. (Ç. M. 16) – Α, vai; έκανε αυτή χωρίς να διακόψει το χτένισμα. Λοιπόν μια και το ζέρεις, πες το μου κι εμένα. (I. T. 20)*
- 2) *E ku më ndenjka mua mendja, sipas teje? – Ku të ndenjka? Po ajo dihet. Te italishtja, te amore mio! (Ç. M. 63) – Κι εγώ τι έχω, κατά τη γνώμη σου; - Τι; Μα είναι γνωστό. Τα ιταλικά, τα amore mio! (I. T. 60)*

²⁶⁶ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, 293, 319

- 3) *Ja, pra, këta **qenkan** shqiptarët! – tha gjenerali sikur të vazhdonte një bisedë të lënë përgjysmë. (Gj.U.V. 31) – Na, λοιπόν, αυτοί είναι οι Αλβανοί! Είπε ο στρατηγός σαν να συνέχιζε μια μισοτελειωμένη συζήτηση. (Σ.Ν.Σ. 38)*
- 4) *Kjo do të thotë se unë **qenkam** një copë lavire që përgjoj vëllanë kur lahet? (Ç. M. 17) - Αυτό πάει να πει πως **είμαι** μια πουτάνα που κατασκοπεύει τον αδελφό της όταν πλένεται. (I. T. 20)*
- 5) *Ashtu **qenkam** unë për ty, një tyryfyle? (Ç. M. 38) – Αυτό λοιπόν **είμαι** για σένα, μια ηλίθια;*
- 6) ***Dashke** vëmendje për ndenjzat e tua, kurse për të tjerët bëhesh shurdh. (Gj.U.V. 245) – **Ενδιαφέρεσαι** μόνο για τις δικές σου υποθέσεις, ενώ για τους άλλους παριστάνεις τον κουφό. (Σ.Ν.Σ. 288)*
- 7) *Ju flisni shpesh për grekët dhe trojanët. Përse nuk **u dashka** të flasim për njëzet vjet më parë. (Gj.U.V. 54) – Μιλάτε συχνά όμως για του Έλληνες και τους Τρώες. Γιατί δε σας **αρέσει** να μιλήσουμε και για ό, τι έγινε πριν από είκοσι μόλις χρόνια. (Σ.Ν.Σ. 66)*

Nga shembujt e mësipërm, ku përkthimi është bërë nga dy përkthyes të ndryshëm, folës natyrorë të greqishtes vërejmë se në të gjitha rastet e tashmja e habitores së shqipes është dhënë me të tashmen e dëftores së greqishtes, madje nuk shoqërohet nga ndonjë mjet tjetër gjuhësor, i cili të tregojë modalitetin e habitores së shqipes.

Në shembullin (2) për të përkthyer shprehjen *ku më ndenjka mendja*, është përdorur pyetja *ti έχω (çfarë kam)*, ndërsa kur përdoret habitoreja për herë të dytë (*Ku të ndenjka?*), e cila në këtë rast ka edhe një ton ironizues, në greqisht është shmangur tërësisht dhe e gjithë fjalia jepet thjesht me pyetjen *Ti; (Çfarë?)*.

Në shembullin (6) për të përkthyer foljen *dashke* përdoret folja *ενδιαφέρεσαι (interesohe)*, e cila vendoset në të tashmen e dëftores dhe nuk është transmetuar ironia e cila shprehet nëpërmjet habitores në këtë rast në shqip.

Në shembullin (7) ku folja në habitore *u dashka* është në zgjedhimin jovepror dhe luan rolin e një foljeje pavetore, në greqisht është dhënë me foljen *αρέσει (pëlqen)*, ndërkohë që mund të ishte dhënë edhe me foljet *χρειάζεται* ose *πρέπει (duhet)*.

3.4.2. Koha e pakryer

Edhe trajta e kohës së pakryer të habitores është një trajtë sintetike që formohet nga prapavendosja e formave të dala nga e pakryera e foljes *kam*, të cilat kanë pësuar disa ndryshime fonetike, të pjesorja e shkurtuar e foljes. Për të ndërtuar formën joveprorë edhe për këtë kohë trajtave të veprorës u paravendoset pjesëza *u*.

E pakryera e habitores së shqipes	
Pjesore e shkurtuar	Folje ndihmëse në të pakryerën
<i>mbjell-ë / ndenj-ur</i>	<i>kisha</i>
<i>mbjellkësha, ndenjështë /-këshe, -kësh (-kej), -këshim, -këshit, - këshin</i>	

Tabela 3. 36

E pakryera e habitores, sipas gramatikës së Akademisë, mund të shprehë habinë, dyshimin, apo mospajtimin e folësit për një veprim të caktuar që vazhdonte ende në një çast të caktuar të së shkuarës, që është përsëritur herë pas here në ë shkuarën apo ka vlerë mbarëkohore. Foljet në të pakryerën e habitores përdoren kryesisht në fjali të nënrenditura shembujt (2), (4), (5) por mund të përdoren edhe në fjali pavarura dhe kryesore, shembujt (3), (1).

- 1) Për këtë **dashkësh** të vriste veten ungji i vogël? (Ç. M. 19) – Ωστε γι' αυτό ο μικρός θεός **ήθελε** ν' αυτοκτονήσει; (I. T. 22)
- 2) Disa thoshin se ajo këngë **qenkej** më e vjetër dhe gabimisht ishte quajtur e Nuk Martinit. (Gj.U.V. 155) – Μερικοί υποστήριζαν πως το τραγούδι **ήταν** παλιότερο και εσφαλμένα είχε αποδοθεί στον Νικ Μαρτίνι. (Σ.Ν.Σ. 185)
- 3) Sipas tij, përpara se të ishte për t'u dhimbsur (si të mos i mjaftonin brenga e rënies së flokëve, na tani edhe kjo hata), ungji i vogël na **qenkësh** fshehtamadh dhe shitmends. (Ç. M. 7) – Κατ' αυτόν ο μικρός θεός πριν κατανήσει για λύπηση – σα να μην έφτανε το δράμα της τριχόπτωσής του, προστέθηκε τώρα και αυτή η συμφορά -, **ήταν** κρυφίνους και μουρλός. (I. T. 12)
- 4) Piri ia bëri prapë pu-pu, pastaj bëri një nga ato pyetjet që të prishin gjakun: kur **qenkësh** kaq e fuqishme përse fshihej? (Ç. M. 20) – Ο Πίρ ζανάκανε πω πω, κι ύστερα έκανε μια απ' αυτές τις ερωτήσεις που σου κόβουν το αίμα: αν **ήταν** πράγματι τόσο ισχυρό, γιατί κρυβόταν; (I. T. 24)
- 5) Po dilte se **qenkëshin** të tillë ca që s'pritej kurrsesi e, nuk **qenkëshin** ca të tjerë që, jo vetëm ata vetë, por gjithë bota i dinte për komunistë e kaluar komunistëve. (Ç. M. 55) – Μαθεύτηκε πως **ήταν** μερικοί πως ούτε θα φανταζόμασταν ποτέ πως άνηκαν, και δεν **ήταν** άλλοι που, όχι μόνο οι ίδιοι αλλά κι όλος ο κόσμος, τους θεωρούσε κομμουνιστές πρώτης γραμμής. (I. T. 53)

Nga përkthimi i të gjithë shembujve të mësipërm (1 - 5) ku kemi përdorim të foljeve në të pakryerën e habitores vëmë re se për t'i përkthyer ato është përdorur e pakryera e dëftores së greqishtes.

3.4.3. Koha e kryer

E kryera është një nga format kohore të habitores e cila përdoret më shumë, sepse ndjenja e habitës është pasojë e veprimeve të përfunduara²⁶⁷. E kryera është një nga format analitike të mënyrës habitore, e cila si edhe e kryera e dëftores formohet nga pjesorja e foljes duke i paravendosur foljet ndihmëse *kam* dhe *jam*, të cilat vendosen në të tashmen e habitores.

E kryera e habitores e shqipes		
Folje ndihmëse në të tashmen e habitores		Pjesore
<i>paskam</i>	<i>qenkam</i>	<i>mbjell-ë / ndenj-ur</i>

Tabela 3. 37

E kryera si edhe kohët e tjera të habitores shpreh habinë, dyshimin apo mospajtimin e folësit për një veprim, por në këtë rast veprimi ka përfunduar, por nuk i ka humbur lidhjet me çastin e ligjërimin. Foljet në të kryerën e habitores mund të përdoren në fjali të pavarura, shembujt (1), (6), (7), apo kryesore, shembujt (3),(5), si edhe në fjali të nënrenditura, shembujt (2), (4).

- 1) *Ku e paska gjetur këtë? – i tha dikush me zë të ulët shoferit të kamionit. (Gj.U.V. 147) – Πού τον βρήκες αυτόν εδώ; Είπε κάποιος ψιθυριστά στον οδηγό του φορτηγού. (Σ.Ν.Σ. 175)*
- 2) *Kush tha se ai paska ardhur? – tha, pa fshehur habinë. (Ç. M. 93) – Ποιος σου είπε πως ήρθε; είπε χωρίς να κρύψει την έκπληξη του. (I. T. 86)*
- 3) *Porsa ka marrë vesh që erdhëm ne, paska vënë medaljet, paska ngjeshur koburen dhe ka dalë përjashta. (Gj.U.V. 168)- Μόλις έμαθε πως ήρθαμε εμείς, κρέμασε τα μετάλλια, γέμισε το πιστόλι και βγήκε να κάνει βόλτες. (Σ.Ν.Σ. 200)*
- 4) *Në qoftë se ai është varri i parë, siç dyshoj, atëherë mund të thuhet se është ky rrezikzi, që e paska hequr këmbën zvarrë, siç thonë pleqtë e këtushëm. (Gj.U.V. 152) – Σε περίπτωση που είναι ο πρώτος τάφος, όπως υποψιάζομαι, τότε μπορούμε να πούμε πως είναι αυτός ο κακόμοιρος, που τον πήραν σβάρνα, όπως λένε οι ντόπιοι γέροντες. (Σ.Ν.Σ. 181)*

Për të dhënë në gjuhën greke format foljore të kohës së kryer të habitores në gjuhën greke mund të përdoren trajta të ndryshme kohore, kryesisht të dëftores. Kemi parasysh këtu se modaliteti i habitores është më afër atij të dëftores se sa të të gjitha mënyrave të tjera. Janë të dyja mënyra që shprehin modalitetin e vërtetësisë. Në shembujt (1), (2), (3), (4) foljet në të kryerën e habitores janë dhënë në greqisht me aoristin e dëftores.

²⁶⁷ E. Likaj, *vep. e cit.*, 1997, 111

- 5) *Merhumi i paska mësuar turqisht apo më bënë veshët? Thoshte njëra nga gratë.* (Ç. M. 86) – *Ο συχωρευμένος του είχε μάθει τούρκικα ή κάνω λάθος; έλεγε μια από τις γυναίκες.* (I. T. 79)
- 6) *E paska helmuar të voglin që kërthi.* (Ç. M. 86)- *Το είχε δηλητηριάσει απ’ τα γεννοφάσκια του, το μικρούτσικο.* (I. T. 79)
- 7) *Paske qenë i djegur për ato të shkreta cirilike.* (Ç. M. 63) - *Ούτε ερωτευμένος να ‘σουνα μ’ αυτά τα έρμα τα κυριλλικά.* (I. T. 59)

Në shembujt (5), (6) e kryera e habitores është dhënë në greqisht me më se të kryerën e dëftores. Ndoshta do të ishte shprehur më mirë lidhja e veprimit me çastin e ligjërimin nëse do të përdorej e kryera e dëftores, duke pasur parasysh që si e kryera e habitores ashtu edhe ajo e lidhjes tregojnë se përfundimi i veprimit nuk i ka shkëputur lidhjet me çastin e ligjërimin, e të përdorshin trajtat kohore *έχει μάθει, έχει δηλητηριάσει*, por përkthyesi ka zgjedhur të përdorë më se të kryerën.

Në shembullin (7) e kryera e habitores jepet me të pakryerën e dëftores paraprirë nga pjesëza *να, να ‘σουνα (të ishe)*, trajtë foljore e cila i përgjigjet në shqip së pakryerës së lidhjes.

3.4.4. Koha më se e kryer

Koha më se e kryer e habitores është një kohë analitike e cila formohet nga e pakryera e habitores së foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam* dhe pjesores së foljes.

Më se kryera e habitores e shqipes		
Folje ndihmëse në të pakryerën e habitores		Pjesore
<i>paskësha</i>	<i>qenkësha</i>	<i>mbjell-ë</i>

Tabela 3. 38

Edhe më se e kryera e habitores përdoret për të shprehur habinë, mospajtimin dhe dyshimin për një veprim i cili, si edhe në rastin e së kryerës së dëftores, ka përfunduar para një çasti të caktuar të së shkuarës. Trajtat foljore të më se të kryerës së habitores përdoren më shumë në fjali të nënrenditura, shembujt (1), (5), (7) por ato hasen edhe në fjali të pavarura, shembujt (8), (9) dhe kryesore, shembujt (2), (3), (4), (6).

Edhe pse konsiderohet se përdorimin më të dendur nga format e habitores e kanë forma e së tashmes dhe së kryerës, në dy romanet e shfrytëzuara për vjeljen e korpusit të shembujve rastet më të shumta janë hasur në më se të kryerën. Për të përkthyer këto forma kohore në gjuhën shqipe përdoren kryesisht forma kohore të dëftores. Kështu në shembujt (1), (2) përdoret aoristi i dëftores së greqishtes, ndërsa në shembujt (3), (4) përdoret e pakryera e dëftores. Në këta dy shembuj është më se e kryera e foljes *jam*, ajo që përkthehet dhe në gjuhën greke e vetmja kohë e së shkuarës që mund të formojë kjo

kohë është e pakryera. Edhe në shembullin (5) përdoret e pakryera e dëftores së greqishtes për të përkthyer shprehjen foljore *paskësh qenë fjala*, përdoret në fakt shprehja sinonimike foljore *γινόταν λόγος* (*bëhej fjalë*).

- 1) *Mendimi se mezi ç' paskësh pritur që t'ia zinte shezlongun, si të thuash...fronin, më dha një pickim në zemër. (Ç. M. 93) – Η σκέψη πως περίμενε με ανυπομονησία την ευκαιρία να καταλάβει αυτή την πολυθρόνα, πώς να το πω, αυτό το ... θρόνο, μ' έκανε να νιώσω ένα τσίμπημα στην καρδιά. (I. T. 85)*
- 2) *Ndryshe nga ç'i qe dukur në fillim: e fisme, lehtësisht e gërmueshme, dëborë paskësh qenë po aq e mbrapshtë sa edhe balta. (Gj.U.V. 186) – Διαφορετικά απ' ότι νόμισαν αρχικά, πως δηλαδή ήταν φίνο, κι εύκολο στο σκάψιμο, το χιόνι αποδείχθηκε χειρότερο κι απ' τη λάσπη. (Σ.Ν.Σ. 220)*
- 3) *Mirëpo ato paskëshin qenë mu aty, në hundë të tyre, e mendja s'i kishte shkuar askujt. (Ç. M. 55) – Κι όμως, αυτά ήταν ακριβώς εκεί, κάτω απ' τη μύτη τους και κανένας δεν το 'χε καταλάβει. (I. T. 53)*
- 4) *Nuk paskëshin qenë katër gratë vajtore, siç kisha kujtuar, por ai, vëllai misterioz i babazotit, që ishte pritur me ankth. (Ç. M. 89) – Δεν ήταν λοιπόν πως περίμεναν με τόση αγωνία τις τέσσερις μοιρολογίστρες, όπως είχα νομίσει, αλλά το μεγάλο μυστηριώδη αδελφό του μπαμπαζότ. (I. T. 82)*
- 5) *Sipas kësaj logjike dikush tha se qenkëshim mërzitur kot gjer tani dhe s'paskësh qenë fjala për hapjen e shtëpisë publike por të frontit të dytë. (Gj.U.V. 70) – Σύμφωνα μ' αυτή τη λογική κάποιος είπε πως άδικα είχαμε στεναχωρηθεί ως τώρα και στην πραγματικότητα δε γινόταν λόγος για άνοιγμα οίκου ανοχής αλλά για άνοιγμα δεύτερου μετώπου. (Σ.Ν.Σ. 85)*

Edhe në shembullin (6) përdoret e pakryera e dëftores së greqishtes, por e paraprirë në këtë rast me pjesëzën e lidhore *va (të)*. Format e më se të kryerës së habitores mund të jepen në greqisht edhe me më se të kryerën e dëftores së greqishtes, shembujt (7), (8), (9).

- 6) *Ky na paskësh qenë, me sa dukej, amaneti i fundit i babazotit. (Ç. M. 91) – Αυτή πρέπει να 'ταν μάλλον η στερνή επιθυμία του μπαμπαζότ. (I. T. 83)*
- 7) *Se ç' paskësh qenë kjo vetëtimë, ku e kishin gjetur nëpër qiej e si e paskëshin sjellë gjer në Gjirokastër, për t'u kacafytur për të, këtë një zot e dinte. (Ç. M. 35) – Τώρα τι ακριβώς ήταν αυτή η αστραπή, πώς τη βρήκαν στους ουρανό, και πώς την είχαν φέρει ως το Αργυρόκαστρο για να τσακωθούν γι' αυτή, μόνο ένας Θεός ξέρει. (I. T. 36)*
- 8) *Si mund ta dinte ai që unë isha vrasësi i fshehtë i babazotit? Dhe aq më tepër, si e paskësh zbuluar këtë nga shkronjat e hungarishtes? (Ç. M. 94) – Πώς μπορούσε να ξέρει πως εγώ ήμουν ο κρυφός δολοφόνος του μπαμπαζότ; Και κυρίως, πώς το είχε ανακαλύψει ανάμεσα στις ουγγρικές λέξεις. (I. T. 87)*
- 9) *Dhe ja, e papritura i paskësh ndodhur kolegut të tij. (Gj.U.V. 235) – Και να που, όμως, είχε συμβεί στο συνάδελφό του. (Σ.Ν.Σ. 277)*

3.4.5. Trajta të greqishtes përkthyer me habitoren e shqipes

Në gjuhën greke, siç u përmend edhe më sipër mënyra habitore nuk ekziston, nuk ekzistojnë as trajta foljore habitore. Megjithatë gjatë përkthimeve artistike nga greqishtja në shqip hasen në mjaft raste format kohore të habitores. Në të shumtën e rasteve përdoret e tashmja e habitores. Cilat janë format kohore të greqishtes që janë sjellë në shqip nëpërmjet të tashmes së habitores? Në të shumtën e rasteve është e tashmja e dëftores, shembujt (1), (2), (3), (4), (5), e cila nuk shoqërohet me asnjë mjet të veçantë gjuhësor që të tregojë habi, mosbesim apo dyshim siç ndodh me habitoren e shqipes. Është zgjedhja e përkthyesit që t'i japë këto forma me trajtën e habitores.

- 1) Πολλά φρόνιμος μου φαίνεσαι , είπε, και να με συμπαθάς. (B.Π. 23) - **Ardhke** i mbarë, më duket, - ia bëri, - mos ma merr për keq, or lum miku! (Z. 19)
- 2) Πού να πάω; συλλογίστηκα καλά είμαι εδώ. (B.Π. 24) - **Thashë** me vete. Mirë fare **qenkam** këtu. (Z. 20)
- 3) Ε, μωρέ, πώς φαίνεται πως δεν παίζεις κανένα όργανο. (B.Π. 24) - **Si u dukërka** menjëherë që s'i bie asnjë vegle. (Z. 21)
- 4) Πες, Ζόρμπα, πως κοπριά είναι ο άνθρωπος και λουλούδι είναι η ελευτερία. (B.Π. 34) - **Këtë më thua**, bre Zorba: se njeriu **qenka** një pleh e liria lule. (Z. 29)
- 5) Μωρέ, για κοίτα τη, μου κάνει κλείνοντάς μου το μάτι, σαν πάπια περπατά η αφιλότιμη. Πώς κουνιέται, πλαφ! πλαφ!(B.Π. 41) - **Pa shih**, pa shih - ma bënte me sy - si patë **shkoka** kuçka! **Si u tundka**: pllaf-pllaf! (Z. 36)

Një formë tjetër foljore e greqishtes e cila është përkthyer me habitoren e shqipes është lidhorja, e tashmja, shembulli (6) dhe aoristi, shembulli (7) i lidhores. Në shembullin (7) lidhorja në greqisht në mënyrën që është përdorur shpreh edhe habinë e folësit. Nëse do t'i qëndronim besnikë formës foljore të përdorur në greqisht në shqip do të thoshim: *Pra që të vijë liria në botë janë të nevojshme kaq vrasje e kaq pandershmëri?* Zgjedhja e habitores në këtë rast nga përkthyesi e jep mjaft mirë këtë formë foljore dhe modalitetin që ajo shpreh.

- 6) Κι αν ήταν κάθε άνθρωπος **να διαλέει** την Παράδεισό του στον ουρανό, σύμφωνα με τα γούστα του – έτσι πρέπει! Αυτό θα πει Παράδεισο! (B.Π. 35) - **Dhe na qenka** e vërtetë se njeriu **zgjedhka** një vend në parajsë sipas gustos (*Kështu qoftë! Kësaj i them parajsë!*). (Z. 30)
- 7) Για **να 'ρθει** λοιπόν η λευτεριά στον κόσμο χρειάζονται τόσα φονικά και τόσες ατιμίες; (B.Π. 33) - **Me demek** liria **ardhka** duke prerë e duke vrarë. (Z. 29)

E tashmja e habitores së shqipes është përdorur edhe për të përkthyer pjesë të tjera të ligjëratës, si në shembullin (8) ku ajo përdoret për të përkthyer emrin e përbërë *αντροχωρίστρα*, i cili mbart në vetvete edhe veprimin (*ajo që ndan burrat*).

- 8) Φτου σου, **αντρογονοχωρίστρα!** - έγρουγε και δάγκασε το ψαρό μουστάκι του. (B.Π. 16) - **Ptuh**, moj qene që **ndake** nuset nga burrat e i **bëke** vejushë, - vikati dhe kafshoi mustaqet e grivura. (Z. 11)

Gjatë përkthimit të poezisë “Shpirtrat e pleqve” të Kavafit nga origjinali nga dy përkthyes të ndryshëm, shembulli (9), vërejmë se e tashmja e shqipes në të dyja rastet e theksuara vetëm prej njërit është përkthyer nëpërmjet të tashmes së habitores, ndërsa i dyti ka zgjedhur që t’i përkthejë ato nëpërmjet të tashmes së dëftores. Në shembullin (10) përveç dy përkthimeve nga origjinali kemi shqyrtuar edhe një përkthim të poezisë “Termopilet” nga një gjuhë e tretë, për të parë se si dhe a mund të ndërmjetësojë gjuha e dytë në kuptimin modal të kohëve të foljes. Edhe në këtë rast vetëm njëri nga përkthyesit ka zgjedhur të tashmen e habitores për të dhënë të tashmen e dëftores së shqipes, ndërsa në dy përkthimet e tjera përkthimi i foljes është shmangur, pra ajo nuk jepet fare në përkthimin në shqip.

- 9) Πώς **τρέμουν** μην την χάσουνε και πώς την **αγαπούνε**/ οι σασιτισμένες και αντιφατικές (Κ. Οι ψυχές των γερόντων) - Si **u dridhkan** mos e humbin dhe sa e **dashurokan** / ata të hutuarit e kundërshtorët... (Κ, Α.Σ) **Tmerren** mos ta humbin, dhe si e **dashurojnë**/ të hutuar e të rënduara.... (Κ, L.Z)
- 10) Και περισσότερη τιμή τους **πρέπει**/ όταν προβλέπουν (και πολλοί προβλέπουν). (Κ, Θερμοπόλες) - Më shumë nder **u paska** hije / kur e dinë që më parë (dhe shumë e dinë) (Κ, Α.Σ) – Akoma më shumë lavdi për ta/ kur shikojnë larg (dhe shumë parashikojnë) (Κ, L.Z) Akoma dhe më shumë lavdi: / se shumë atje parashikuan (Κ., Κα.)

Përveç të tashmes kemi hasur në përkthimet nga gjuha greke edhe të pakryerën e habitores, shembujt (11), (12). Në shembullin (11) vërejmë se është e tashmja e dëftores e cila jepet nëpërmjet të pakryerës së habitores, ndërsa në shembullin (12) fjalia në gjuhën shqipe është e paplotë, pra i mungon folja. Në këtë rast përkthyesi ka zgjedhur dhe mjaft drejt që fjalinë: *Και τι γένια!* (*E çfarë mjekre*) ta zgjerojë në shqip duke përdorur foljen *paskëshin* dhe duke e bërë në këtë mënyrë më të gjallë ligjërimin.

- 11) Τριών λογιών **είναι** το λοιπόν οι άνθρωποι· εγώ, αφεντικό, δεν είμαι από τους χειρότερους μήτε πάλι από τους καλύτερους· στέκουμe στη μέση! (Β.Π. 79) - Pra te sërësh na **qenkëshin** njerëzit: unë, zotni nuk jam as te më të mirët, as tek më të ligjtë: qëndroj në mes. (Z. 70)
- 12) Με **ζέκαμαν**. Και τι γένια! (Β.Π. 50) - Më **dërrmuan**. Apo s’**paskishin** një mjekër! (Z. 44)

Të kryerën e habitores e kemi hasur në përkthimin e aoristit të dëftores së greqishtes, shembujt (13), (14). Në shembullin (13) është dhënë edhe një variant tjetër i përkthimit të vargjeve, po nga origjinali dhe vërejmë se në të është zgjedhur që aoristi i dëftores jepet me të kryerën e dëftores së shqipes. Në shembullin (14) kemi tri variante të përkthimit të vargjeve, ku i treti është bërë nga një gjuhë e dytë. Vërejmë se në variantin e dytë përkthyesi ka zgjedhur që të dyja foljet që ndodhen në aoristin e greqishtes t’i përkthejë me të kryerën e thjeshtë të shqipes, ndërsa në variantin e tretë përkthyesi aoristin e parë e ka përkthyer me të kryerën e dëftores me rend të përmbysur, ndërsa të dytin me të kryerën e thjeshtë të shqipes. Këto vargje përveç faktit se janë pyetëse e përmbajnë edhe elementin e habitës, ndaj përdorimi i habitores në përkthimin e tyre duket mjaft i drejtë.

- 13) *Τώρα δυο χρόνια πέρασαν που γράφω/ κ' ένα ειδύλλιο **έκαμα** μονάχα. (Κ. Το πρώτο σκαλί) U bënë dy vjet qyshse po shkruaj/ dhe vetëm një idil **paskam krijuar**. (K, A.S), Dy vjet kaluan që po shkruaj/ dhe **kam bërë** vetëm një idil. (K, L.Z)*
- 14) *Γιατί οι δυο μας ύπατοι κ' οι πραιτορες **εβγήκαν**/ σήμερα με τες κόκκινες, τες κεντημένες τόγες/ γιατί βραχιόλια **φόρεσαν** με τόσους αμεθύστους, και δαχτυλίδια με λαμπρά, γυαλιστερά σμαράγδια` (Κ., Περιμένοντας τους βαρβάρους) – Pse **paskan dalë** dy konsujt dhe pretorët/ me togat e tyre të kuqe sot qëndisur/pse **paskan vënë** byzylykë me kaq rruaza/dhe unaza me smeralde vezullues/ (K, A.S) Përse dy konsujt dhe pretorët tanë/**dolën** sot të veshur me togat e kuqe/pse **vunë** byzylykë mbushur me kuarce/ dhe unaza me smeralde të ndriçme/ (K, L.Z) Përse dy konsujt tanë, tok me pretorët/Togat e kuqe **hedhur kanë** mbi supe?/Pse **mbajnë** aq byzylykë me kuarce/Unaza me smeralde shkëlqimtare?/ (K., Ka.)*

Gjatë përkthimit në shqip është përdorur edhe më se e kryera, ndonëse më rrallë, shembulli (15). Në këtë rast ajo është përdorur për të përkthyer një folje në aoristin e dëftores së greqishtes, madje përkthyesi për analogji ka shtuar edhe një folje tjetër në këtë kohë (*paskish qenë*), e cila në tekstin në greqisht mungon.

- 15) *Για να φντρώσει ένα λουλούδι χρειάζεται ο σπόρος. Ποιος **έβαλε** έναν τέτοιο σπόρο στα βρωμερά σπλάχνα μας; (Β.Π. 34) - Që të mbijë lulja duhet farë. E kush na paskish qenë ai myteber që na **paskësh hedhur** farën. (Z. 29)*

Përfundime

- ❖ Mënyra habitore e shqipes së bashku me mënyrën dëftore shpreh modalitetin e vërtetësisë, por me habitoren folësi shpreh edhe ndjenjën e habisë. Por format e habitores përdoren relativisht dendur edhe për të shprehur një qëndrim ironizues, mosmiratues, kundërshtues të folësit.
- ❖ Habitoret e shqipes për nga tipi i ndërtimit është e veçantë dhe nuk haset në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane. Trajtat e habitores janë formuar nga pjesorja e shkurtuar dhe folja ndihmëse *kam*, argumentim ky i cili është mbështetur nga shumica e gjuhëtarëve. Format e tjera kohore të habitores (e pakryera, e kryera, më se e kryera, e kryera e mbipërbërë, më se e kryera e mbipërbërë, e ardhmja, e ardhmja e së shkuarës) janë ndërtuar nën ndikimin analogjik të formave kohore gjegjëse të mënyrës dëftore. Trajtat e habitores janë krijuar gjatë një procesi të gjatë dhe e kanë zanafillën para botimit të veprës së Buzukut.
- ❖ Format e habitores së shqipes kanë disa pikëtakime me mënyrën e ritregimit në bullgarisht e maqedonisht.
- ❖ Mënyra habitore ka dy kohë kryesore, të tashmen dhe të shkuarën, ku e shkuara ka tri nënndarje, të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën. Mund të hasen gjithashtu edhe forma të mbipërbëra të së kryerës (*paskam pasë larë*) dhe të së ardhmes (*do të lakam*).
- ❖ Trajta e kohës e tashme e habitores, e cila formohet nga prapavendosja e së tashmes së foljes *kam* te pjesorja e shkurtuar e foljes, është një nga kohët me përdorim më të shpeshtë të habitores. Ajo mund të shprehë habinë, dyshimin, apo mospajtimin e folësit për një veprim të caktuar që vazhdon të kryhet në çastin e ligjërit, që përsëritet herë pas here apo ka vlerë mbarëkohore. E tashmja e habitores së shqipes jepet në të shumtën e rasteve me të tashmen e dëftores së greqishtes, madje nuk shoqërohet as nga ndonjë mjet tjetër gjuhësor, i cili të tregojë modalitetin e habitores së shqipes.
- ❖ Trajta e kohës së pakryer të habitores është një trajtë sintetike që formohet nga prapavendosja e formave të dala nga e pakryera e foljes *kam*, të cilat kanë pësuar disa ndryshime fonetike, te pjesorja e shkurtuar e foljes. Për t'i përkthyer këto trajta në greqisht përdoret kryesisht e pakryera e dëftores së greqishtes.
- ❖ E kryera e habitores është një nga format kohore që përdoret më shumë. Ajo formohet nga pjesorja e foljes duke i paravendosur foljet ndihmëse *kam* dhe *jam* në të tashmen e habitores. Për të dhënë në gjuhën greke format foljore të saj mund të përdoren trajta të ndryshme kohore, kryesisht të dëftores si aoristi i dëftores, por ndonjëherë edhe e pakryera e dëftores paraprirë nga pjesëza *va*.

- ❖ Koha më se e kryer e habitores është një kohë analitike e cila formohet nga e pakryera e habitores së foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam* dhe pjesorja e foljes. Për të përkthyer format foljore të kësaj kohe në gjuhën greke përdoren kryesisht forma kohore të dëftores, si aoristi, e pakryera e dëftores apo më se e kryera e dëftores.
- ❖ Edhe pse në gjuhën greke habitorja nuk ekziston, gjatë përkthimit të letërsisë artistike hasen mjaft raste të përkthimit të formave foljore të greqishtes me habitoren e shqipes. Kryesisht përdoret e tashmja e habitores, por hasen edhe kohët e tjera të saj. Format e habitores së shqipes përdoren për të përkthyer kryesisht forma foljore të dëftores së greqishtes, por ka edhe raste kur ato shërbejnë për të dhënë forma foljore të lidhores, apo për të përkthyer edhe pjesë të tjera ligjërata veç foljes.

3.5. Mënyra kushtore

Mënyra kushtore²⁶⁸ shpreh modalitetin e mundësisë. Folja në mënyrën kushtore, tregon një veprim që mund të kryhej, nëse plotësohej një kusht i caktuar. Ky kusht zakonisht shprehet me një fjali të nënrenditur kushtore, folja e së cilës vendoset në të pakryerën ose në më se të kryerën e lidhores. Hasen raste kur mund të shprehet nëpërmjet ndajfoljes *ndryshe*, e cila në këtë rast do të përdorej me vlerën e një fjalie mungesore, ose me anë të një togu të ndërtuar nga parafjala *me* ose *pa* dhe një emër²⁶⁹.

Mënyra kushtore e shqipes ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën.

3.5.1. Koha e tashme

Format gramatikore të kohës së tashme të kushtores janë të njëjta me ato të së ardhmes të së shkuarës së dëftores. Ato dallohen vetë gjatë përdorimit në ligjërimit duke qenë se folja në të ardhmen e së shkuarës tregon një veprim i cili pritej të kryhej pas një çasti të caktuar të së shkuarës, ndërsa folja në të tashmen e kushtores tregon një veprim i cili mund të kryhet para ose pas çastit të ligjërimit, nëse plotësohet një kusht i caktuar. Këto dy trajta foljore ndryshojnë jo për nga forma, por nga modaliteti që shprehin. Përveç formës kryesore, *do* + të pakryerën e lidhores, ndeshet ashtu si edhe te e ardhmja e së shkuarës së dëftores edhe një formë tjetër, struktura e së cilës përbëhet nga e pakryera e foljes ndihmëse *kam* + *formën e pashtjelluar* të tipit *për të larë*.

E tashmja e kushtores			
Pjesëz	Formë foljore e së pakryerë së lidhores		
<i>do</i>	<i>të</i>	temë folore e së tashmes së dëftores	mbaresat e së pakryerës së lidhores
<i>do</i>	<i>të</i>	<i>lexoja/lexohesha</i>	

Tabela 3. 39

Siç do ta shohim edhe më poshtë, kushtorja nuk trajtohet si mënyrë foljore e mirëfilltë në gjuhën greke dhe modaliteti i mundësisë shprehet nëpërmjet pjesëzës *θα* dhe së pakryerës dhe më se të kryerës së dëftores. Në rastet kur përkthehet nga gjuha shqipe e tashmja e kushtores, në gjuhën greke përdoret struktura *θα* + të pakryerën e dëftores (shembujt 1-5).

- 1) *Sikur ata ta dinin ç'ka në kamion, do të fillonin të ulërinin.* (Gj.U.V. 221) – *Αλλά αν ήξεραν τι έχουμε στο φορτηγό, θ' άρχιζαν να ουρλιάζουν.* (Σ.Ν.Σ. 260)

²⁶⁸ Sipas K. Topallit, format foljore që trajtohen si mënyrë kushtore në gramatika të ndryshme, s'janë veçse forma të së ardhmes në të shkuarën të përdorura në periudha hipotetike dhe s'mund të trajtohen si mënyrë me vete. K. Topalli, *vep e cit.*, 2010

²⁶⁹ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995, 327

- 2) **Do të ishte** gjysma e së keqes sikur mërzia të mbetej te librat. (Ç. M. 25) – **Θα ‘ταν** λίγο το κακό, αν η πλήξη περιοριζόταν μόνο στα βιβλία. (I.T. 28)
- 3) **Do të më bënte përshtypje** kjo sikur të mos e dija se, për gjyshen dhe shoqet e saj, çdo gjëje i vinte koha të binte dhe, për to, një dru apo një qeveri, ishin pak a shumë e njëjta gjë. (Ç. M. 61) – **Θα με εντυπωσίαζε** το γεγονός, αν δεν ήξερα πως σύμφωνα με τη γιαγιά μου και τις φίλες της, για όλα ερχόταν ο καιρός της κατάρευσης και στα μάτια τους ένα δέντρο ή μια κυβέρνηση, ήταν περίπου το ίδιο πράγμα. (I.T. 57)
- 4) **Po të kishte vdekur në mëngjes, do të ishte tani në varrezën e Vasikojt.** (Ç. M. 80)- **Αν είχε ξεψυχίσει το πρωί, τώρα θα ήταν** στο νεκροταφείο του Βασιλικού. (I.T. 73)
- 5) **Sikur të mos ishte fillimi i vjeshtës, çdo njeriu tjetër, përveç gjeneralit të porsaardhur, do t’i dukej ky shi monoton një përkim i trishtuar.**(Gj.U.V. 13) – **Αν δεν ήταν αρχές φθινοπώρου, σε κάθε άλλον άνθρωπο, εκτός απ’ το νεοφερμένο στρατηγό, αυτή η μονότονη βροχή θα φαινόταν** σαν μια θλιβερή σύμπτωση. (Σ.Ν.Σ. 15)

Në të gjitha shembujt e mësipërm, në gjuhën shqipe, kushti shprehet nëpërmjet një fjalie të varur kushtore, ku folja ndodhet në të pakryerën e lidhores shembujt (1), (2), (3), (5), ose në më se të kryerën e lidhores, shembulli (4). Po me një fjali të nënrenditur kushtore shprehet kushti edhe kur përkthehet në gjuhën greke dhe folja vendoset në të pakryerën e dëftores paraprirë nga lidhëza kushtore *αν*, shembujt(1), (2), (3), (5) ose në më se të kryerën e dëftores paraprirë nga lidhëza kushtore *αν*, shembulli (4).

3.5.2. Koha e kryer

Foljet në të kryerën e kushtores dalin në të njëjtën formë si në të ardhmen e përparme të së shkuarës. Këto trajta foljore ndërtohen me *të ardhmen e së shkuarës së foljes ndihmëse kam+pjesore*. E kryera e kushtores tregon një veprim që mund të ishte kryer në të shkuarën, nëse do të ishte plotësuar një kusht i caktuar, por duke qenë se ky kusht nuk realizohet edhe veprimi paraqitur nga folja në të kryerën e lidhores paraqitet si i parealizuar deri në çastin e ligjërit²⁷⁰, ndryshe nga e ardhmja e përparme e së shkuarës e cila përdoret më shumë si një e shkuar e tipit *do të kem larë* për të shprehur një veprim të mundshëm të së shkuarës dhe më rrallë për të shprehur një veprim që mund të jetë kryer para një çasti të së shkuarës²⁷¹.

²⁷⁰ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1995, 328

²⁷¹ Po aty, 318

E kryera e kushtores së shqipes		
E ardhunja e së shkuarës së foljes <i>kam</i>		Pjesore
Pjesëza	Folje ndihmëse në të pakryerën e lidhores	Pjesore
<i>do</i>	<i>të kisha/të isha</i>	<i>mësuar</i>

Tabela 3. 40

Për përkthimin e foljeve në të kryerën e kushtores së shqipes, në greqisht përdoret më se e kryera e dëftores paraprirë nga pjesëza *θα*, shembujt (1), (2), por mund të përdoret edhe më se e kryera e dëftores paraprirë nga pjesëza e lidhores *να*, shembulli (3).

- 1) *Sikur të mos ishte fundi i vjeshtës, **do t'i ishte dukur** ajo lodër një kundërshti e trishtuar.* (Gj.U.V. 195) - *Αν δεν ήταν τέλος του φθινοπώρου, το νταούλι **θα του είχε φανεί** σαν θλιβερή αντίθεση.* (Σ.Ν.Σ. 229)
- 2) *Kjo natë e fundit **do të kishte shkuar** si të gjitha të tjerat dhe asgjë e veçantë s' do të kishte për t'u mbajtur mend, sikur gjenerali të kishte thithur edhe atë natë erën e veçantë të këtyre fshatrave shqiptare, një erë e lehtë, gati e pakapshme, por që tani ai do e njihje midis gjithë të tjerave.* (Gj.U.V. 194) - *Την τελευταία νύχτα **θα την περνούσαν** σαν όλες τις άλλες και δε θα τους άφηνε καμία ιδιαίτερη ανάμνηση, αν ο στρατηγός είχε περιοριστεί να ρουφήξει κι εκείνο το βράδυ τη χαρακτηριστική μυρωδιά των αλβανικών χωριών, μια λεπτή μυρωδιά, ακατάληπτη, αλλά που τώρα πια την αναγνώριζε ανάμεσα σ' όλες τις άλλες.* (Σ.Ν.Σ. 229)
- 3) *Ndoshta plaku nuk **do të kishte qëlluar** me revolver sikur të mos ishte kjo britmë.* (Gj.U.V. 77) - *Ίσως ο γέρος **να μην είχε πυροβολήσει**, αν αυτή δεν είχε ξεφωνίσει.* (Σ.Ν.Σ. 94)

Folja që përdoret për dhënien e kushtit, që shprehet nëpërmjet një fjalie të nënrenditur kushtore, vendoset në gjuhën shqipe në të pakryerën e lidhores, shembujt (1), (3) dhe këto në gjuhën greke jepen nëpërmjet të pakryerës së dëftores duke i paravendosur lidhëzën kushtore *αν*, ose nëpërmjet më se të kryerës së lidhores, shembulli (2), që në greqisht jepen me më se të kryerën e dëftores paraprirë nga lidhëza kushtore *αν*.

3.5.3. Modaliteti i mundësisë në gjuhën greke

Në gjuhën greke nuk ekziston mënyra kushtore si mënyrë foljore me trajta të posaçme. Modaliteti i mundësisë shprehet nëpërmjet të pakryerës dhe më se të kryerës së dëftores paraprirë nga pjesëza *θα*, e cila përdoret kryesisht për të formuar të ardhmen, por edhe kur u paravendoset formave të ndryshme foljore përdoret edhe për të shprehur modalitete të ndryshme. Në gramatikën tradicionale të Triandafilidhit²⁷² trajtohet si mënyrë sintaksore e foljes, *δυνητική* (e mundësisë) e cila tregon diçka që është e mundur të ndodhë dhe formohet me pjesëzën *θα* (do të) dhe të pakryerën ose më se të kryerën e dëftores. Mackridge²⁷³ duke iu referuar Kahane-s shprehet se karakteristikë e shprehjes “kushtoro – mundësore”, siç e quan ai trajtën foljore formuar nga pjesëza *θα* + të pakryerën dhe më se të kryerën e dëftores, është se është e vetmja formë në sistemin foljor të greqishtes së re që shpreh vetëm kuptimin e marrëdhënies dhe jo aspektit, pra jo vetëm që nuk shpreh domosdoshmërisht një kuptim kohor të caktuar, por nuk e shpreh asnjëherë aspektin e foljes. Sipas Kleris e Babiniotis e pakryera dhe më se kryera në rastin kur ato pasojnë pjesëzën *θα* nuk shprehin një distancë kohore, por distancën nga çasti i ligjëritimit. Më se e kryera, e cila kur ka kuptim kohor tregon një distancë të madhe kohore nga e tashmja, tregon se veprimi i supozuar nuk u krye sepse nuk u realizua kushti i domosdoshëm, dhe nuk ekziston më mundësia që të realizohet²⁷⁴. Ndërsa e pakryera, po sipas Kleris e Babiniotis, që kur ka kuptim kohor tregon thjesht të shkuarën, pa u interesuar për distancën nga e tashmja, mund të tregojë atë që tregon dhe më se e kryera, por gjithashtu mund të tregojë se veprimi i supozuar, mund të realizohet në të ardhmen, nëse plotësohet kushti i domosdoshëm.

Gjatë përkthimit të kësaj trajte foljore të greqishtes përdoret kushtorja e shqipes, shembulli (1).

- 1) *Αν πάλι δεν την έπαιρνε, θα το ‘χε μαράζι σε όλη του τη ζωή, γιατί θα θαρρούσε πως έχασε κανένα μεγάλο κελεπούρι.* (B.II. 173) – *Edhe po të mos martohej, përsëri do t’i mbetej peng për jetë, sepse do t’i dukej se kish humbur kushedi ç’ qelepir.* (Z. 155)
- 2) *Αν σου κάναμε το ίδιο, δε θα πονούσες κι η αφεντιά σου;* (B.II. 72) – *Po të t’i hiqnin zotrote?* (Z. 64)

Por edhe në raste kur gjatë përkthimit, shmanget dhënia e kësaj trajte nga ana e përkthyesit, shembulli (2), e cila mund të jepet në shqip me anë të kushtores. Pra shembulli (2) në shqip mund të jepet edhe me fjalinë: *Nëse të bënëin të njëjtën gjë, nuk do lëndoheshe zotrote?* Duke përdorur të tashmen e kushtores *do lëndoheshe*.

²⁷² M.Τριανταφυλλίδης, *ver. e cit.*, 2005, 315

²⁷³ P. Mackridge, *ver. e cit.*, 1990, 392

²⁷⁴ Χρ.Κλαίρης - Γ.Μπαμπινιώτης, *ver. e cit.*, 2004, 487

Përfundime

- ❖ Mënyra kushtore e shqipes shpreh modalitetin e mundësisë dhe ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën. Format gramatikore të kohës së tashme të kushtores janë të njëjta me ato të së ardhmes të së shkuarës së dëftores, ato dallohen vetëm nga modaliteti që shpreh folja gjatë përdorimit në ligjërime.
- ❖ Në gjuhën greke kushtorja nuk trajtohet si mënyrë foljore e mirëfilltë me trajta të posaçme, megjithëse në gramatikën tradicionale të Triandafilidhit trajtohet si mënyrë sintaksore e foljes, *δυνητική* (e mundësisë) e cila tregon diçka që është e mundur të ndodhë dhe modaliteti i mundësisë shprehet nëpërmjet pjesëzës *θα* dhe së pakryerës dhe më se të kryerës së dëftores.
- ❖ Në rastet kur përkthehet e tashmja e kushtores nga gjuha shqipe, në gjuhën greke përdoret struktura *θα* + të pakryerën e dëftores, ndërsa për përkthimin e foljeve në të kryerën e kushtores së shqipes, në greqisht përdoret më se e kryera e dëftores paraprirë nga pjesëza *θα*, por mund të përdoret edhe më se e kryera e dëftores paraprirë nga pjesëza e lidhore *να*.
- ❖ Gjatë përkthimit të kësaj trajtës foljore *θα* + të pakryerën e dëftores dhe *θα* + më se të kryerën e dëftores të greqishtes përdoret kushtorja e shqipes, përkatësisht e tashmja dhe më se e kryera e saj.

3.6. Mënyra dëshirore

Mënyra dëshirore është një nga mënyrat e foljes, e cila haset që në fazat e hershme të gjuhëve indoevropiane. Gjuha shqipe është një nga gjuhët në të cilat trajtat e dëshirores janë pjesë e sistemit të sotëm foljor, kur kjo mënyrë e greqishtes së vjetër nuk ekziston me trajta të veçanta foljore në greqishten e re dhe funksionet e saj kryhen nga mënyra të tjera, siç do të shqyrtojmë edhe në vazhdim. Në gjuhën shqipe foljet në mënyrën dëshirore paraqiten me trajta të posaçme, nëpërmjet të cilave folësi shpreh një dëshirë në formë urimi apo mallkimi. Foljet në mënyrën dëshirore, siç do të vërejmë edhe më poshtë përdoren kryesisht në fjali të pavarura, por mund të përdoren edhe në fjali të nënrenditura kushtore e lejore të paraprirë nga lidhëzat nënrenditëse, *në*, *edhe në* dhe shprehin kuptimin modal të mundshmërisë. Sipas Demirajt²⁷⁵ dëshirorja e shqipes duhet të ketë një moshë relativisht të vjetër, gjë që dëshmohet nga përdorimi i saj në të gjitha funksionet e njohura në të gjitha të folmet e shqipes, përfshirë këtu edhe ato të arbëreshëve të Greqisë dhe Italisë. Pikëpamje të ndryshme ekzistojnë edhe për rrugën e formimit të trajtave foljore të dëshirores. Sipas Meyer-it dhe Pekmezit zanafilla e dëshirores qëndron te e kryera e lidhore së latinishtes, ndërsa sipas Bopp-it dhe Pedersenit ajo e ka zanafillën te “aoristi” i lidhore, mendimin e këtij të fundit e mbështesin edhe Domi e Demiraj²⁷⁶.

Mënyra dëshirore në gjuhën shqipe ka dy kohë, të tashmen dhe të kryerën.

3.6.1. Koha e tashme

Dëshirorja formon trajta të posaçme foljore për secilën kohë. Trajtat e kohës së tashme janë forma sintetike të cilat formohen duke i shtuar temës së dëshirores mbarestat *-a*, *ø*, *-të*, *-im*, *-i*, *-in*. Tema e dëshirores formohet duke i shtuar temës së foljes, e cila zakonisht është tema e së kryerës së thjeshtë, por mund të jetë edhe tema e pjesores prapashtesën *-fsh-*, ose alomorfet e saj *-sh/-ç-*.

E tashmja e dëshirores		
Tema foljore	Prapashtesa	Mbaresa
<i>lexo-/hap-/zën-</i>	<i>-fsh-; -sh/-ç-</i>	<i>-a/-ø/-të/ -im/ -i/ -in</i>
<i>lexofsha/hapsha/zënça</i>		

Tabela 3.41

Folja në të tashmen e dëshirores shpreh dëshirën e folësit në formë urimi ose mallkimi, për kryerjen e një veprimi në çastin e ligjërit, ose pas tij, siç duket edhe në shembujt e mëposhtëm. Duke qenë se në greqishten e re nuk ekziston dëshirorja si mënyrë

²⁷⁵Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1986, 888

²⁷⁶Për një paraqitje të hollësishme të argumentave mbi zanafillën e dëshirores, si edhe për prejardhjen e formantit *-sh/-fsh-*, shih Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1986, 890 – 896.

me forma të posaçme, për t'i përkthyer format dëshirores së shqipes në shumicën e rasteve përdoret lidhorja, shembujt (1), (2), (3), e cila edhe në shqip në mjaft raste mund të përdoret në vend të dëshirores, pra për të shprehur të njëjtin modalitet.

- 1) *Jo më kot dërguan atë. Zoti e ndihmoftë!* (Gj.U.V. 18) – *Δεν τον έστειλαν άδίκα. Ο Θεός va τον βοηθήσει!* (Σ.Ν.Σ. 22)
- 2) *Ndoshta e kalon, - tha gjenerali. – Dhashtë Zoti!* (Gj.U.V. 173) – *Μπορεί να το ξεπεράσει, είπε ο στρατηγός. Ο κύριος va δώσει.* (Σ.Ν.Σ. 205)
- 3) *Mos qofshi! mallkonte ajo. S'ka tapi.* (Ç. M. 83) – *Να μη σώσετε! τους καταριόταν αυτή. Δεν υπάρχουν τίτλοι.* (Σ.Ν.Σ. 76)

Mohorja e dëshirores formohet me pjesëzën mohuese *mos*, shembulli (3) dhe në gjuhën greke ajo jepet nëpërmjet mohores së lidhore formuar përsëri nga pjesëza mohuese *μην* (*mos*). Për të përkthyer foljet në dëshirore në greqisht përdoret gjithashtu edhe urdhërorja, shembulli (4). Në shembullin (5), e njëjta shprehje *pash Zotin* është dhënë me shprehjen e greqishtes *για τ' όνομα του Θεού*, që për nga kuptimi dhe elementet leksikorë që e përbëjnë i afrohet më shumë asaj.

Edhe në shembullin (6) është përdorur urdhërorja *ζήτω* për të dhënë dëshiroren *rroftë*, e vetmja urdhërore e vetës së tretë të greqishtes së vjetër, e cila është ruajtur dhe përdoret edhe në greqishten e re.

- 4) *Mbushma edhe një herë, pash Zotin!* (Gj.U.V. 175) – *Ξαναγέμισέ μου το ποτήρι, κάνε μου τη χάρη!* (Σ.Ν.Σ. 208)
- 5) *Dëgjoheshin klithmat: “kthehu mor jevg”, “ndalojini ata”, “hiqe, pash Zotin, atë revole”.* (Ç. M. 90) - *Ακούγονταν κραυγές: «γύρνα από κει που ‘ρθες, μωρέ γύφτο!», «πιάστε τον!», «για τ' όνομα του Θεού, τι δουλειά έχει αυτό το πιστόλι;»* (I.T. 83)
- 6) *Si zakonisht, Iliri ishte në një mendje me mua për gjithçka, me përjashtim, ndoshta të britmave rroftë ky, rroftë ai, që mua më qenë dukur veçanërisht pa kuptim.* (Ç. M. 29) – *Όπως συνήθως, ο Ιλίρ συμεριζόταν σ'όλα τη γνώμη μου, εκτός ίσως από τις κραυγές ζήτω αυτό και ζήτω εκείνο, που εμένα μου ‘χαν φανεί εζαιρετικά ακατανόητες.* (I.T. 32)
- 7) *Tani mbetsh me shëndet, se po ikim.* (Gj.U.V. 100) – *Σε χαιρετάμε τώρα, πρέπει να φύγουμε.* (Σ.Ν.Σ. 121)

Në shembullin (7) përdoret dëftorja e greqishtes për të dhënë dëshiroren, përkatësisht e tashmja dhe e pakryera. Shprehja *mbetsh me shëndet* përkthehet nëpërmjet së tashmes së foljes përshëndes, *σε χαιρετάμε* (të përshëndesim).

- 8) *Armiku, armik mbetet edhe i vdekur qoftë.* (Gj.U.V. 176) – *Ο εχθρός, εχθρός μένει, έστω και πεθαμένος.* (Σ.Ν.Σ. 209)
- 9) *Po me se t'i zëvendësosh? tha ai. Në vend të “rroftë” të thuash “vdektë populli!”?* (Ç. M. 29) – *Όμως με τι να τις αντικαταστήσεις; είπε. Αντί για «ζήτω» να λέγαμε «θάνατος στον λαό!»;*

Në shembullin (8) dëshirorja *qoftë* jepet duke i paravendosur pjesores pasive *πεθαμένος*, ndajfoljen *έστω*, e cila ka funksion ndajfoljor në greqishten e re, por në greqishten e vjetër ishte veta e tretë e urdhërores së foljes (*εμί*) *jam*, pra në thelb kjo dëshirore jepet me një urdhërore.

Në shembullin (9) dëshirorja *vdektë* jepet me një emër (*vdekje*), pra shprehja “*vdektë populli*” jepet me një shprehje të barazvlefshme nga ana kuptimore «*vdekje popullit*» por jo folje + emër si në shqip, por emër + emër.

Kur e tashmja e dëshirores është në fjali të nënrenditura kushtore dhe lejore ajo mund të përdoret edhe për të shprehur veprime të mundshme të së ardhmes, pa shprehur dëshirën e folësit. Në këto raste këto fjali ndërtohen me lidhëzat nënrenditëse *në*, *edhe në*, shembujt (10), (11).

10) *Të ta them që tani, zotni, - ia bëri tek e fundit - në pastë ndonjë vejushë kësaj nahije, mos ma ki merakun, në mos..... (Z.33)*

11) *Dhe në e dëgjofsha, s'i bëj dot zë. (Z.20)*

Shembulli i dhënë në gramatikën e Akademisë: *Edhe në rënça do të arrij të mbështetem pas murit*, nëse përkthehet në gjuhën greke fjalia e nënrenditur lejore do të mbetet po e tillë e paraprirë prej lidhëzës lejore *και αν*, ndërsa folja do të vendoset në lidhore: *Και αν πέσω, θα καταφέρω να κρατηθώ από τον τοίχο*.

3.6.2. Koha e kryer

E kryera e mënyrës dëshirore është nga trajtat foljore të cilat nuk kanë përdorim të dendur gjatë ligjërimin. Ato janë trajta analitike të cilat formohen nga e tashmja e dëshirores së foljeve ndihmëse dhe nga pjesorja e foljes.

E kryera e dëshirores e shqipes		
Folje ndihmëse në të tashmen e dëshirores		Pjesore
<i>paça</i>	<i>qofsha</i>	<i>mbjell-ë / ndenj-ur</i>

Tabela 3.42

E kryera e dëshirores përdoret për të shprehur dëshirën e folësit, në formë urimi a mallkimi, për veprime të së shkuarës. Ajo haset kryesisht në shprehje të tipit: *Ju pastë lënë uratën!* etj. Në gjuhën greke kjo shprehje mund të jepet nëpërmjet lidhore : *Την ευχή του να χετε!* Kjo shprehje në fakt i referohet të ardhmes e jo të shkuarës, por është shprehja e cila ka kuptimin më të afërt me shprehjen e shqipes.

E kryera e dëshirores mund të përdoret gjithashtu, ndonëse rrallë, edhe në fjali të nënrenditura kushtores, ashtu si edhe e tashmja, ndërtuar me lidhëzën nënrenditëse *në*.

3.6.3. Modaliteti i dëshirës në gjuhën greke

Mënyra dëshirore (*ευκτική*) nuk ka trajta të posaçme foljore në greqishten e re, ndërkohë që ka qenë një ndër katër mënyrat foljore të greqishtes antike. Në të gjitha kohët foljet në mënyrën dëshirore merrnin mbaresat e kohëve historike, përveç vetës së parë njëjës dhe të tretë shumës. Karakteristikë e mënyrës dëshirore ishte se përpara mbaresave zanorja, ose grupet e zanoreve²⁷⁷. Por gjatë evolimit të gjuhës, dëshirorja u mënjanua nga përdorimi. Kështu në periudhën e koinesë dëshirorja humbet si mënyrë më vete, me përjashtim të disa formave të ngurtësuar. Ky fenomen, sipas Browning, nuk lidhet me ndryshime tingullore të formave foljore, sepse format e dëshirores kanë qenë të ndryshme nga ato të dëftores të paktën deri në shekullin e 10-të. Funkcionet e dëshirores u kryen në vazhdimësi nga lidhorja apo struktura të ndryshme perifrastike²⁷⁸.

Në greqishten e re në gramatikën tradicionale bëhet fjalë edhe për mënyra foljore sintaksore, një prej të cilave është edhe dëshirorja (*ευχετική*), e cila shpreh një urim dhe mund të formohet ose nëpërmjet lidhore duke ose pa i paravendosur një prej pasthirmave *μακάρι, άμποτε, είθε* (*ah sikur, sikur*), ose nga e pakryera, aoristi dhe më se e kryera e dëftores duke ose pa u paravendosur pjesëzat e lidhore *να, ας*²⁷⁹.

Modaliteti i dëshirores në greqisht mund të shprehet nëpërmjet lidhore, shembujt (1-6). Në të gjitha rastet vëmë re se përkthyesi me të drejtë ka zgjedhur të tashmen e dëshirores për përkthyer këto folje të lidhore së greqishtes që shprehin jo vetëm urime shembujt (1), (2), (3), (4), por edhe mallkime, shembujt (5), (6).

- 1) *Μωρέ τι να γίνεται ο καπετάν Λεμονής; φώναζε. Ο Θεός να βάλει το χέρι του.* (B.Π. 16) - *More, ç' bëhet vallë kapedan Lemonisi? – thirri. – Zoti e ndihhtë.* (Z.11)
- 2) *Μπουμπουλίνα μου, να σε χαρώ, μην κάμεις μπουμ! μπουμ!* (B.Π. 51) - *Bubulina, t'u bëfsha, mos bëj bum, bum!* (Z.45)
- 3) *Στην υγεία σου, μπαρμπα- Αναγνώστη, και να ζήσεις εκατό χρόνια, να πιάσεις και δισέγγονα!* (B.Π. 71) - *Shëndeti jua, xha Anagnosti, u bëfsh njëqind vjeç! U shtofsh në soj: me stërnipër e më tej.* (Z.63)
- 4) *Να γίνει καλός άνθρωπος, καλός νοικοκύρης, να παντρευτεί, να κάμει κι αυτός παιδιά και αγρόνια (B.Π. 72) - U bëftë njeri i mirë, nikoqir i zënë, u martoftë e u trashëgoftë me fëmijë e me nipër e mbesa.* (Z.64)
- 5) *Να κοπεί η γλώσσα σου, κουφάλιακα! Μουρμούρισε τρομαγμένος.* (B.Π. 72) - *T'u thaftë gjuha, zgërbonjë! - tha nëpër dhëmbë i lemerisur.* (Z.64)
- 6) *Ε μωρέ, που κατάντησαν οι άνθρωποι, φτου να χαθούνε!* (B.Π. 85) - *Eh, si u katandiska njeriu, puth e shpëlaftë mortja!* (Z.76)

Një mënyrë tjetër, e cila përdoret për të dhënë modalitetin e dëshirores është edhe mënyra urdhërore, shembulli (7). Në shembullin (8) vëmë re diçka të cilën e përmendëm edhe te përkthimi i dëshirores së shqipes, përdorimi i vetës së tretë të urdhërores së

²⁷⁷ I. Σταματάκου, *Ιστορική γραμματική αρχαίας ελληνικής*, Αθήνα, 1968, 246

²⁷⁸ R. Browning, *verp. e cit.*, 1991, 47

²⁷⁹ M. Τριανταφυλλίδης, *verp. e cit.*, 2005, 315

greqishtes antike ζήτω, i foljes ζω (jetoj), që në shqip është dhënë me dëshiroren e shqipes rroftë.

- 7) Έχε την ευχή μου, Ζορμπά, καλά έπεσες εδώ μέσα` (B.Π. 97) - **Paç** uratën, Zorba, ke rënë tamam në thela! (Z.86)
- 8) Και φώναζαν, φώναζαν ζήτω! ζήτω! Κι είχαν και μια σημαία... (B.Π. 50) - Ndërsa ata thërrisnin: **rroftë, rroftë** duke mbajtur nga një flamur në dorë... (Z.45)

Me dëshiroren e shqipes mund të jepen edhe shprehje foljore, shembulli (9), apo edhe shprehje emërore të cilat shprehin një dëshirë të folësit, shembujt (10 - 14). Në shembullin (9) ku folja ndodhet në lidhore, përkthyesi e ka dhënë në shqip këtë shprehje foljore me një shprehje me kuptim sinonimik, ku folja ndodhet në të tashmen e dëshirores.

- 9) Έμεινα τρεις μήνες μαζί της, ο Θεός να την έχει καλά, παράπονο δεν έχω. (B.Π. 95) – Qëndrova tre muaj me të. **I faltë zoti shëndet**, s'kam ankesa. (Z.84)
- 10) Πολλά τα έτη σας! Είπε απλώνοντας την παλάμη στο στήθος. (B.Π. 47) - **Mbeçi** me shëndet – tha duke vënë dorën në gjoks. (Z.41)
- 11) Φεύγω, είπα, καλή διασκέδαση, Ζορμπά και καλή δύναμη! (B.Π. 55) - Po iki, - i thashë. –E **kalofsh mirë** Zorba! Mbahu burrë. (Z.48)
- 12) Πάλι καλά, είπε, δόξα σοι ο Θεός! (B.Π. 70) - Gjene mirë, - ia bëri . Lavdëruar **qoftë** Ai atje lart. (Z.62)
- 13) Τι είπα; **Ανάθεμά με** αν ήξερα. (B.Π. 98) - Të **më therç** në kuptoja gjë nga ato që thosha. (Z.87)
- 14) Λέγονται αυτά, **στο Θεό σου**; (B.Π. 95) - Thuhen me fjalë këto gjëra, **pash** fenë tënde. (Z.84)

Gjatë përkthimit mund të hasen edhe raste ku është shtuar një dëshirore, ndërkohë që në gjuhën greke nuk ka asnjë element gjuhësor që ta justifikojë atë, shembulli (15), ku përkthyesi ka shtuar shprehjen ndjesë pastë, ndërkohë që te origjinali në greqisht emri παππούς nuk përcaktohet nga një fjalë a shprehje me të njëjtin kuptim apo me kuptim të përafërt.

- 15) Κι ο παππούς μου έριχνε την απαλάμη στο πρόσωπο της κορασίδας και το πασπάτευε σουρτά, τρυφερά, λιμασμένα. (B.Π. 90) - Dhe, **ndjesë pastë**, im gjysh lëshonte dorën faqeve të çupës, ia shkonte poshtë e lartë ledhas, me lezet e i panginjur. (Z.81)

Në shembujt (16), (17) dëshirorja e shqipes është përdorur në fjali të nënrenditura kushtore, paraprirë prej lidhëzës nënrenditëse në, duke përkthyer në këtë mënyrë lidhoren e greqishtes, (shembulli 16) dhe të ardhmen e dëftores, (shembulli 17), të cilat edhe në greqisht janë gjymtyrë të fjalive të nënrenditura kushtore.

- 16) *Άμα μου πει εμένα η γυναίκα μου περίσσιο λόγο, τι καρδιά θες να 'χω να παίζω σαντούρι; (B.Π. 24) - Në i shkafte gruas një fjalë më tepër, me ç' zemër t'i bie sandurit? (Z.21)*
- 17) «*Αν θα κάμω ποτέ μια γενναία πράξη στη ζωή μου – μουρμούρισε κοιτάζοντας τον απροσκύνητο, ανέλπιδο πολεμιστή – σε τούτον εδώ θα το χρωστώ...» (B.Π. 56) - “Në guxofsha të bëj diçka në jetën time – tha nëpër dhëmbë duke vështruar luftëtarin e pashpresë e të paepur – këtëj do t'ia kem për nder”. (Z.49)*

Përfundime

- ❖ Mënyra dëshirore është një nga mënyrat e foljes, e cila haset që në fazat e hershme të gjuhëve indoevropiane. Gjuha shqipe është një nga gjuhët në të cilat trajtat e dëshirores janë pjesë e sistemit të sotëm foljor, ndërsa në gjuhën e re greke ajo është mënjeluar nga përdorimi.
- ❖ Mënyra dëshirore në gjuhën shqipe ka dy kohë, të tashmen dhe të kryerën. Foljet në mënyrën dëshirore paraqiten me trajta të posaçme, nëpërmjet të cilave folësi shpreh një dëshirë në formë urimi apo mallkimi. Ato përdoren kryesisht në fjali të pavarura, por mund të përdoren edhe në fjali të nënrenditura kushtore e lejore të paraprirë nga lidhëzat nënrenditëse, *në*, *edhe në* dhe shprehin kuptimin modal të mundshmërisë.
- ❖ Folja në të tashmen e dëshirores shpreh dëshirën e folësit në formë urimi ose mallkimi, për kryerjen e një veprimi në çastin e ligjërit, ose pas tij. Për të përkthyer format dëshirores së shqipes në shumicën e rasteve përdoret lidhëza, por edhe urdhërorja dhe dëftorja.
- ❖ Mohorja e dëshirores formohet me pjesëzën mohuese *mos*, dhe në gjuhën greke ajo jepet nëpërmjet mohores së lidhës formuar përsëri nga pjesëza mohuese *μην* (*mos*).
- ❖ E kryera e mënyrës dëshirore është nga trajtat foljore të cilat nuk kanë përdorim të dendur gjatë ligjërit. Ato janë trajta analitike të cilat formohen nga e tashmja e dëshirores së foljeve ndihmëse dhe nga pjesorja e foljes. Në gjuhën greke ajo mund të jepet nëpërmjet lidhës.
- ❖ Modaliteti i dëshirores në greqisht mund të shprehet nëpërmjet lidhës dhe urdhërores, të cilat në të shumtën e rasteve mund të përkthehen me dëshiroren e shqipes.

IV. FORMAT E PASHTJELLUARA TË FOLJES

4.1. Pjesorja

Në gjuhën shqipe prej formave të pashtjelluara vetëm njëra është sintetike, pjesorja. Termi pjesore (greqisht *μετοχή*, latinisht *participium*, gjermanisht *partizipium*) përcakton një strukturë sintetike foljore e cila ka tipare gramatikore edhe të foljes, edhe të emrit edhe të mbiemrit. Kjo formë sintetike për nga kuptimi, funksionet dhe lloji i ndërtimit i përgjigjet të ashtuquajturës pjesore të perfektit pësor të gjuhëve indoevropiane.²⁸⁰ Ndërsa për sa i përket pjesores së tashme (participit prezent) të gjuhëve indoevropiane ekzistojnë pikëpamje të ndryshme për ekzistencën e saj ose jo në shqipen e dokumentuar. Supozimet se emrat që tregojnë vepruesin ose mjetin formuar me prapashtesat *-ës, -es* si p.sh.: *mbjellës, lexues*, ndofta e kanë prejardhjen të “pjesoret e vjetra të së tashmes” janë kundërshtuar. Aleksandër Xhuvani²⁸¹ kundërshton mendimin e Meyer-it dhe Da Lecce-s se emrat veprorë mund të merren si pjesore aktive, duke i krahasuar këta emra me participin prezent të frëngjishtes, thekson se emrat veprorë që mbarojnë me *-ës* dhe *-es* nuk funksionojnë kryekëput si pjesore aktive në shqip. Vërejmë se edhe kur i krahasojmë këta emra me greqishten e re në shumicën e rasteve barasvlerësi i tyre është emër dhe jo pjesore p.sh.: *lexues – αναγνώστης, mbledhës - συλλέκτης, shërbyes – υπηρέτης*, ndërsa në shembujt që merr Xhuvani *kanal vaditës* dhe *prishës i foleve* në gjuhën greke jepen përkatësisht me mbiemër *αρδευτική διάρρογα* dhe emër *χαλαστής φωλιών*. Gjatë përkthimit të romanit të I. Kadaresë “*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*” në gjuhën greke nga një folëse natyrore e greqishtes një togfjalësh i përafërt jepet me emër + emër në gjinore: *Nuk foli për ftohtësinë e vendasve, këngët e zymta, moskuptimin, por i përmendi prapë gjithë të tjerat: truallin e thyer, dimrin në alpe, kanalet ujitëse, që, siç mund ta dinin ata, në vendet komuniste ishin më të mëdha se ç’duhej, tërmetin e një viti më parë, që kishte dëmtuar shumë nga varret.* (Gj.U.V. 162) – *Δεν αναφέρθηκε στο τρομερό κρύο, στα λυπητερά τραγούδια, στις παρεξηγήσεις, αλλά επέμεινε ζανά σε όλα τα υπόλοιπα: το δύσβατο έδαφος, το χειμώνα στις αλβανικές Άλπεις, τα κανάλια του νερού, που, όπως γνώριζαν, στις κομμουνιστικές χώρες ήταν μεγαλύτερα απ’ό,τι έπρεπε, το σεισμό της προηγούμενης χρονιάς, που είχε καταστρέψει πολλούς τάφους.* (Σ.Ν.Σ. 192) Edhe sipas Demirajt²⁸² këta emra si për nga kuptimi ashtu edhe për nga veçoritë gramatikore paraqiten si emra, përkatësisht si mbiemra dhe nuk kanë asnjë veçori të karakterit foljor. Edhe mendimi i dytë që shfaqet nga G. Hahni dhe W. Cimochoowski, të cilët pranojnë si pjesore aktive të shqipes lokucionin e formuar prej formantit *duke* dhe *pjesores* së foljes, pra përcjelloren e shqipes së sotme, has kundërshtime. Përsëri sipas Xhuvanit²⁸³ po i njëjti particip prezent i frëngjishtes tregon një veprim që kryhet në një kohë dhe ka vlerën e një fjalie të tërë lidhore. Vërejmë këtu se përcjellorja e shqipes në të shumtën e rasteve i përgjigjet pjesores aktive të greqishtes së re²⁸⁴ p.sh.: *Një fshatar i vetëm po kalonte në*

²⁸⁰ Sh.Demiraj, *vep. e cit.*, 1976

²⁸¹ A.Xhuvani, vepra I, Tiranë 1980, 246

²⁸² Sh.Demiraj, *vep. e cit.*, 1976, 179

²⁸³ Po aty

²⁸⁴ Struktura e pjesores aktive të greqishtes së re nuk i korrespondon asaj të greqishtes së vjetër

udhë, duke tërhequr një kalë nga kapistalli.- Ένας χωρικός περνούσε στο δρόμο, σέρνοντας το άλογό του απ'τα γκέμια.

Mehmet Çeliku²⁸⁵ është i mendimit se pjesorja e shqipes ka dy trajta: trajta **punuar** dhe trajta **i punuar**, pra sipas tij mbiemrat prejpjesorë të paranyjzuar apo mbiemrat prejfoljorë janë pjesore dhe jo mbiemra.

Gjuha shqipe ka vetëm një pjesore, pjesoren e kohës së shkuar apo perfektit dhe në çdo funksion të saj, si në formimin e kohëve të përngjitura ashtu edhe në ndërtimin e lokucioneve të tjera është e pandryshueshme.

4.1.2 Struktura fjalëformuese dhe përdorimi i pjesores në gjuhën shqipe krahasuar me greqishten

Pjesorja e gjuhës shqipe formohet duke i shtuar temës së foljes prapashtesa temëformuese. Tema e foljes në shumicën e rasteve përkon me temën e foljeve në kohën e kryer të thjeshtë p.sh.: *jam, qe-sh-ë, qe-në / shoh, pa-sh-ë, pa-rë, / rri- ndenj-a, ndenj-ur*. Por ka edhe folje që e ndërtojnë pjesoren nga tema e kohës së tashme p.sh.: *mbjell, mboll-a, mbjell-ë, nxjerr, nxor-a, nxjerrë*. Ndërsa foljet e tipit *mësoj*, në pjesore e diftongojnë *o-në* e temës në *-ue/-ua* p.sh.: *punoj -punue- punuar*.

Pjesorja e shqipes		
Tema foljore		Prapashtesë
temë foljore e së kryerës së thjeshtë	temë foljore e së tashmes	prapashtesë
<i>qe-/ pa-</i>	<i>mbjell-/ nxjerr-</i>	<i>- në, -rë, -ë</i>

Tabela 4.1

Prapashtesat e pjesores që hasen në shqipen e dokumentuar sipas “Gramatikës historike të gjuhës shqipe”²⁸⁶ janë:

-r(e): *parë, punuar*; **-un(ë), -ur(ë)**: *hapun(ë)/hapur(ë), mbyllun(ë)/mbyllur(ë)*; **-ë**: *dalë, marrë, mbjellë, marrë*; **-në**: *qenë, thanë/thënë*; **-m**: *lam, sham, -të*: *pitë, vutë (Buzuku)*²⁸⁷; **-m-un**: *lamun, bamun*; **-n-un**: *lanun, thanun*

Prapashtesa **-m** e ka burimin te prapashtesa indoevropiane ***-meno-/mo-**. Prapashtesa **-meno** është ruajtur në pjesoren pasive të greqishtes së re: *διαβασμένος - i lexuar, δουλεμένος - i punuar*.

Pjesorja e shqipes në greqishten e re, në rastet kur përdoret për të formuar kohët analitike, jepet me formën e paskajores së greqishtes së re e cila nuk ka funksionet e një paskajoreje të mirëfilltë, apo të paskajores së greqishtes së vjetër, por përdoret vetëm për të formuar kohët analitike:

²⁸⁵ M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, 2006, 74

²⁸⁶ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2002, 402

²⁸⁷ Po aty

E kishte dëgjuar kaq herë ta flisnin fshatarët shqiptarë pranë varrezave, ku mblihdeshin për t'u ndihmuar. – Είχε ακούσει τόσες φορές να τα μιλάνε οι Αλβανοί χωριάτες δίπλα στους τάφους, όταν μαζεύονταν για να τους βοηθήσουν.

Kjo formë paskajore, që në fakt kryen funksionin e pjesores së shqipes, ka trajtë aktive e pasive për të formuar përkatësisht kohët analitike të formës veprare e joveprare: *έχω πλύνει - kam larë; έχω πλυθεί – jam larë.*

Mbiemri prejpjesor i shqipes formohet prej nyjzimit të pjesores së foljeve dhe ka në përgjithësi kuptim pësor²⁸⁸: *i larë (që është larë), i mbushur (që është mbushur)*, por mund të kenë edhe kuptim vepror si p.sh.: *i ngrënë (që ka ngrënë), i pirë (që ka pirë)*²⁸⁹, dukuri që e hasim edhe në gjuhën greke, në pjesoren pasive *φαγωμένος, πιωμένος*. Këta mbiemra prejpjesorë të gjuhës shqipe në gjuhën greke jepen në shumicën e rasteve me pjesoren pësore, shembujt (1-4):

- 1) *Gjithë ato rrugë të vështira, ato varre të lagura, aty – këtu grumbuj – grumbuj, aty – këtu të vetmuara, gjithë ajo baltë e mërzitshme, ato fortino gjysmë të shkatërruara (edhe fortinove, si ushtarëve, u kishin ngelur vetëm skeletet). (Gj.U.V.30) – Όλοι αυτοί οι δύσκολοι δρόμοι, οι υγροί τάφοι, άλλοτε δίπλα – δίπλα, αλλού μοναχικοί, όλη αυτή η ενοχλητική λάσπη, τα μισοκατεστραμμένα οχυρώματα (ακόμα και στα οχυρώματα, σαν τους στρατιώτες είχαν απομένει μόνο οι σκελετοί). (Σ.Ν.Σ. 36)*
- 2) *Gjenerali e ndoqi me sy varrmihësin e vjetër, që shkoi e u ul mbi një gur buzë udhës, nxori qesen e duhanit dhe zuri te dridhte një cigare, i lodhur. (Gj.U.V. 25) – Ο στρατηγός παρακολουθούσε τον ηλικιωμένο εργάτη που πήγε και κάθισε πάνω σε μια πέτρα στην άκρη του δρόμου, έβγαλε τη σακούλα με τον καπνό και άρχισε να στρίβει τσιγάρο, κουρασμένος. (Σ.Ν.Σ. 30)*
- 3) *Përreth ndihej era e këndshme e dheut të hapur. (Gj.U.V. 24) - Ολόγυρα ένιωθες την ευχάριστη μυρωδιά του σκαμμένου χώματος. (Σ.Ν.Σ. 29)*
- 4) *E gjeta, - tha gërmuesi i vjetër, dhe zëri i erdhi i thellë e i mbytur, sepse foli me kokën të ulur brenda në gropë (Gj.U.V. 24).- Να το, το βρήκα, είπε ο ηλικιωμένος εργάτης, κι η φωνή του ερχόταν βαθιά και πνιχτή, γιατί μιλούσε με το κεφάλι σκυμμένο μέσ' στο λάκκο. (Σ.Ν.Σ. 28)*
- 5) *Edhe gjithë ata të vranë me siguri e kanë dëgjuar këtë gjuhë fatale, mendoi. (Gj.U.V. 33) - Κι όλοι οι σκοτωμένοι σίγουρα άκουσαν κάποτε αυτή τη μοιραία γλώσσα, σκέφτηκε. (Σ.Ν.Σ. 40)*

Në shembullin (5) në gjuhën shqipe kemi të bëjmë me një mbiemër të emëruar, pra një emër të formuar nga emërimi i një mbiemri prejpjesor që në gjuhën greke jepet me një pjesore pësore të emëruar.

²⁸⁸ F. Agalliu është i mendimit se duke qenë se te mbiemrat foljorë kuptimi pësor është më i qartë dhe foljet kalimtare përbëjnë shumicën është mirë që këta mbiemra të përdoren kryesisht për këto folje. F. Agalliu, *Pjesorja në gjuhën shqipe*, SF, 2, 1972, 51.

²⁸⁹ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995

Përveç pjesores pasive të greqishtes së re, mbiemrat prejpjesorë të shqipes mund të jepen edhe me mbiemra, shembulli (6) ose me folje, shembujt (7), (8) fakt që tregon prejardhjen e tyre foljore:

- 6) *Gjenerali uli sytë mbi hirnoren e mbushur me bishta cigaresh. (Gj.U.V. 29) - Ο στρατηγός κοίταζε το γεμάτο αποσιγάρα τασάκι. (Σ.Ν.Σ. 36)*
7) *Ai ishte një gjeneral i huaj. Për më tepër i ngarkuar me një mision qeveritar. (Gj.U.V. 29) – Αυτός ήταν ένας ξένος στρατηγός. Ακόμη περισσότερο του είχαν αναθέσει μια κυβερνητική αποστολή. (Σ.Ν.Σ. 36)*
8) *Ç'pret nga skica varresh të bëra me ngut në tërheqje e sipër. (Gj.U.V. 26) – Τι περιμένεις.... Τα σχέδια των τάφων φτιάχτηκαν βιαστικά στην τελευταία υποχώρηση. (Σ.Ν.Σ. 31)*

Emrat prejpjesorë asnjans të tipit të *ecurit*, të *lexuarit*, të *folurit*, të *shkruarit*, nga ana kuptimore janë të njëjtë me paskajoren e së tashmes aktive të greqishtes së vjetër, e cila përdoret edhe në stilin libror e publicistik të greqishtes së sotme, si p.sh.: *γράφειν*, ndërsa në greqishten e re analogët e këtyre emrave janë emra prejfoljore, por jo të formuar nga tema e pjesores: *περπάτημα, ανάγνωση, ομιλία, γράψιμο*.

Emra prejpjesorë asnjans që hasen zakonisht në shprehje të ngurosur, në gjuhën greke mund të jepen me emra (jo me prejardhje foljore), shembujt (9), (10), ose me folje, shembulli (11):

- 9) *Ndaj të ngrysur ishte zverdhur në fytyrë dhe kërkoi të shtrihej. (Gj.U.V. 171) - Κατά το σούρουπο είχε κιτρινίσει και θέλησε να ζαπλώσει. (Σ.Ν.Σ. 203)*
10) *Ata të dy ecnin pa folur, mbështjellë me palltot e zeza, dhe në rrugicë ndiheshin hapat e tyre, hapat e mëdhenj dhe të rëndë të gjeneralit, që shkelte pa kujdes përmes pellgjeve, dhe e ecura e lehtë dhe më e shpejtë e priftit. (Gj.U.V. 198) - Τα βήματά τους αντηχούσαν στο δρομάκι: τα μεγάλα και βαριά βήματα του στρατηγού που τσαλαβουτούσε απρόσεχτα μες' στις λάσπες και τα ελαφριά και γρηγορότερα βήματα του ιερέα. (Σ.Ν.Σ. 233)*
11) *Ec e ec e udha s'kishte të sosur. (Gj.U.V. 184) - Δρόμο παίρνουν δρόμο αφήνουν, αλλά ο δρόμος δεν τελείωνε ποτέ. (Σ.Ν.Σ. 218)*

Pjesorja e gjuhës shqipe mund të përdoret gjatë ligjërimit edhe më vete, jo si pjesë e strukturës së një kohe analitike dhe e pashoqëruar nga treguesit *duke*, *për*, *pa*, shembujt (12), (13), (14). Në këto raste në gjuhën greke kjo pjesore e shqipes jepet me pjesoren pësore të greqishtes :

- 12) *Një frat i thinjur, veshur me zhgun u shfaq më në fund te pragu. (Gj.U.V. 153) - Ένας ασπρομάλλης καλόγερος, ντυμένος με μακρύ ράσο φραγκισκανού πρόβαλε τελικά στο κατώφλι. (Σ.Ν.Σ. 182)*
13) *Zakonisht ne e kalonim ditën ose duke pirë cigare mbështetur në parmakët e urës, ose te baraka e vogël prej druri, i zoti i së cilës kishte shkruar në hyrje me shkronja të shtrembra "Kafe-Arançata". (Gj.U.V. 164) - Συνήθως περνούσαμε τη μέρα μας είτε καπνίζοντας ακουμπισμένοι στο παραπέτο της γέφυρας, είτε στη*

μικρή ξύλινη παράγκα, που το αφεντικό της είχε γράψει στην είσοδο με άπσала γράμματα «Καφές - Πορτοκαλάδες». (Σ.Ν.Σ. 195)

- 14) *Arkëza druri, kompesatë e dyfishtë, 70 x 40 x 30 cm. Lyer me ngjyrë vaji të bardhë. (Gj.U.V. 189) - Μικρό ξύλινο φέρετρο, διπλό κοντραπλακέ, 70 x 40 x 30εκ. βαμμένο με άσπρη λαδομπογιά. (Σ.Ν.Σ. 223)*

Një strukturë tjetër në gjuhën shqipe e cila formohet me ndihmën e pjesores është struktura që ka si gjymtyrë të parë foljen pavetore *duhet* dhe ndiqet nga pjesorja, shembulli (15), (16):

- 15) *Duhet të pyesim për të, - tha prifti, - duhet bërë diçka. (Gj.U.V. 193) - Πρέπει να ρωτήσουμε γι'αυτόν, είπε ο ιερέας, πρέπει κάτι να κάνουμε. (Σ.Ν.Σ. 228)*
16) *S'duhet shkuar atje. Ne kemi zi. (Gj.U.V. 196) - Δεν πρέπει να πάμε εκεί. Εμείς έχουμε πένθος. (Σ.Ν.Σ. 232)*

Në këto raste në gjuhën greke kjo strukturë jepet me foljen pavetore *πρέπει (duhet)*+ foljen në lidhore.

Pjesorja e shqipes përdoret edhe për të formuar forma të tjera të pashtjelluara duke iu paravendosur treguesit *duke, për të, pa, një të, me të*, por këto raste do të shqyrtohen në kapitullin në lidhje me format e pashtjelluara.

4.1.3 Struktura fjalëformuese dhe përdorimi i pjesores në gjuhën greke krahasuar me shqipen

Gjuha e re greke ka një numër më të kufizuar pjesorësh se sa sistemi foljor i greqishtes së vjetër²⁹⁰. Në greqishten e vjetër folja pothuajse për çdo kohë, si në formën veprorë dhe atë joveprorë, formonte pjesoren përkatëse. Ndërsa në gjuhën e re greke pjesorja është një nga dy format emërore të foljes. Termi pjesore përcakton në greqishten e re tri struktura gramatikore: struktura foljore me formantin *-οντας (ώντας)*, struktura foljore me formantin *-ούμενος ose -άμενος*, dhe struktura foljore me formantin *-μένος*.

1) Pjesorja që mbaron në *-οντας (ώντας)*. Pjesorja e këtij tipi është e paeptueshme dhe formohet nga tema e foljes në kohën e tashme: *μιλώ – μιλώντας, διαβάζω – διαβάζοντας*. Kleris dhe Babiniotis në gramatikën e tyre strukturofunksionale – komunikative i quajnë këto pjesore ndajfoljore²⁹¹ për arsye të funksionit të tyre në ligjërim. Këtë pjesore e formojnë pothuajse të gjitha foljet në formën veprorë²⁹² dhe nuk shoqërohet asnjëherë nga nyje. Pjesorja që mbaron me *-οντας (ώντας)* formohet nga tema e kohës së tashme të foljes:

²⁹⁰ Χρ. Κλαίρης – Γ. Μπαμπινιώτης, *ver. e cit.*, 2004

²⁹¹ Ρο aty

²⁹² Mund të ndodhë që të formojnë këtë pjesore edhe folje të formës pësore: *διηγούμαι – διηγώντας, κάθομαι – κάθοντας, συλλογίζομαι – συλλογίζοντας* (Αχιλλ. Τζάτρτζανος, *Νεοελληνική σύνταξις*, Δεύτερη έκδοση, 1991). Κέτο pjesore zakonisht hasen në gjuhën e folur popullore, ose në atë letrare.

Pjesorja aktive e greqishtes së re	
Temë foljore	Prapashtesë
Temë foljore e së tashmes	Prapashtesë
διαβάζ-/κατοικ-	- οντας/ - ώντας

Tabela 4.2

Kjo pjesore ka gjithmonë funksion ndajfoljor: *Ακούστηκαν τα κύματα που σπούσαν **μουγκρίζοντας** και μέσα στον καφερέ μερικοί ναργιλέδες που γουργούριζαν.* (B.Π. 16).

Këto pjesore në gjuhën shqipe zakonisht jepen me formën e pashtjelluar përcjellore, shembujt (1 - 5):

- 1) *Ναι, αποκρίθηκα πάλι, **προσπαθώντας** να μην ξανοιχτώ σε μεγάλη φράση – δεν ήμουν βέβαιος πώς θα μπορούσα να κυβερνήσω τη φωνή μου, να μην τρέμει.* (B.Π. 18) – *Po- përsërita rishtas nëpër dhëmbë **duke u munduar** të mos zgjatesha në stërholime frazash, ngaqë s'isha i bindur se mund të sundoja plotësisht ç'ka do të thoshja e s'do të më dridhej zëri.* (Z. 14)
- 2) *Πολλές χαρές έχει ο κόσμος ετούτος – γυναίκες, φρούτα, ιδέες· μα να 'ναι χινόπωρο τρυφερό και να σκίζεις το πέλαο ετούτο, **μουρμουρίζοντας** το όνομα του κάθε νησιού θαρρώ δεν υπάρχει χαρά που να βυθίζει περισσότερο την καρδιά του ανθρώπου στην Παράδεισο.* (B.Π. 27) – *Shumë kënaqësi të dhënka kjo botë: gra, fruta, ide. Por vjeshta e brishtë e këtij deti kur ti lundron ngeshëm ballë ishujve, **duke përmendur** me vete emrin e secilit, kjo është kënaqësia më e madhe.* (Z. 23)
- 3) *Έτσι για το πείσμα σου· κι από χαρτοπόντικας έγινα, **σκάβοντας, κάνοντας** λαγούμια στη γης, τυφλοπόντικας.* (B.Π. 102) *Për inatin tënd! Dhe nga mi letrash u ktheva në urith **duke rrëmihur e duke hapur** llagëme.* (Z. 90)
- 4) *Συχνά, **περιπαίζοντάς** με, λες πως είσαι μαθητής μου.* (B.Π. 102) – *Shpesh, **duke u tallur** me mua, më thua se je nxënësi im.* (Z. 90)
- 5) *Να πώς, **ακλουθώντας** τη διδασκαλία του μαθητή μου, έφτασα στην Κρήτη.* (B.Π. 102) – *Ja përse, **duke ndjekur** mësimet e nxënësit tim, erdha në Kretë.* (Z. 90)

Por këto pjesore mund të jepen në gjuhën shqipe me folje shoqëruar me lidhëza nënrenditëse ose me emra me parafjalë duke treguar kështu në çdo rast funksionin e tyre ndajfoljor, shembujt (6-7):

- 6) *Χάρηκα· **ξέροντας** πια τ'όνομα της κακομοιριάς μου, μπορούσα ίσως ευκολότερα να τη νικήσω.* (B.Π. σελ. 20) – *U bëra me hare **ngaqë e dija** emrin e mizerjes që më kish mbërthyer, sepse kështu e kisha më të thjeshtë ta vija përposhtë e ta mundja.* (Z. fq. 16)
- 7) *Το ανασήκωσα στα χέρια μου, το ξεφύλλισα **διστάζοντας**.* (B.Π. σελ. 20) – *E mora në dorë dhe fillova ta shfletoja **me njëfarë ngurimi**.* (Z. fq. 16)

2) Pjesorja që mbaron në *-ούμενος, -όμενος* ose *-άμενος*. Edhe pjesoret e këtij tipi formohen nga tema e kohës së tashme, janë pjesore të së tashmes pësore.

Pjesorja e së tashmes pasive të greqishtes së re	
Temë foljore	Prapashtesë
Temë foljore e së tashmes	- <i>ούμενος, -όμενος, -άμενος</i>

Tabela 4. 3

Nuk janë të shumta foljet që e formojnë këtë pjesore, kanë tendencën për ta formuar vetëm foljet që mund të përdorë katharevusa²⁹³, shembulli (8):

8) *Η δίκη έληξε με απαλλαγή των κατηγορουμένων δημοσιογράφων, οι οποίοι εκρίθη ότι έκαναν το καθήκον τους.* (To Βήμα 09/01/2011) – *Gjyqi përfundoi me shfajësimin e gazetarëve të akuzuar, për të cilët u gjykua se bënë detyrën e tyre.*

Përveç rasteve kur kjo pjesore në gjuhën shqipe jepet me mbiemër prejpjesor si në rastin e saposhqyrtuar, ka edhe raste kur nuk mund të jepet veçse me përcjellore, shembulli (9):

9) *Στεκούμενοι μπροστά στο έξοχο πόνημα του ζέγους Ψιλάκη.....*(To Βήμα 09/06/2002) – *Duke qëndruar para kësaj eseje të shkëlqyer të çiftit Psilaqi ...*

Folja *στέκομαι – qëndroj* në fakt, si edhe mjaft folje të tjera të quajtura aporetike, nuk e formon formën veprorë dhe për të dhe në kuptimin e pjesores aktive, e cila në shumicën e rasteve luan rolin e përcjellores së shqipes, përdoret pjesorja pësore, shembujt (10), (11). Në gjuhën shqipe në këtë rast kjo folje nuk mund të formojë mbiemër prejpjesor. Pjesorja e këtij tipi haset edhe në disa folje të cilat janë të gjuhës popullore: *στεκούμενα νερά, - ujëra të ndenjura, τρεχούμενα νερά – ujëra të rrjedhshme.*

10) *Φωνές χαρούμενες ζέσπασαν.* (B.II. 19) – *U dëgjuan zëra të gëzuara.* (Z.15)

11) *Ο Ζορμπάς, καθούμενος αντίκρυ μου, ρουφούσε με ζωική αναγάλλιαση τον καφέ του.* (B.II. 31) - *Zorba, ulur kundruall, surbte me ashk kafen.* (Z.15)

Këto pjesore, përveç funksionit mbiemëror e ndonjëherë edhe ndajfoljor, mund të përdoren edhe si pjesë përbërëse e shprehjeve frazeologjike popullore si p.sh.: *στα καλά καθούμενα* (duke ndenjtur mirë e bukur)

Disa prej këtyre pjesoreve, të cilat në pjesën e tyre më të madhe përdoren në stilin publicistik, juridik apo në terminologjinë ushtarake, janë emëruar dhe përdoren edhe në fusha të tjera të ligjërimit, si edhe në ligjërimitin e përditshëm, ato nuk ndeshen më si pjesore, por janë emra p.sh.: *το περιεχόμενο- përmbajtja, τα λεγόμενα – të thënat, προϊστάμενος – përgjegjësi (shefi) η ομιλουμένη (καθομιλουμένη) – gjuha e folur, por*

²⁹³ P.Mackridge, *vep. e cit.*, 1990, 286

hasim edhe pjesore të tilla të emëruara që janë huazuar si emra edhe në gjuhë të tjera, ndërmjet të cilave edhe shqipja: *φαινόμενο* – *fenomen*.


3) Pjesorja që mbaron në *-μένος*. Është pjesorja e së kryerës pasive e cila mbart karakteristika emërore, përkatësisht mbiemërore (gjini, rasë) dhe karakteristika foljore (aspekti, koha, forma, diateza). Kjo pjesore formohet nga tema e aorisit pasiv, por pa ndajshitesën *-θη, -τη*, apo *-η*²⁹⁴: *- διαβάστηκα – διαβασμένος, ντόνω – ντύθηκα – ντυμένος γράφω – γράφτηκα – γραμμένος, κόβω – κόπηκα – κομμένος*,

<i>Folja në të tashmen aktive</i>	<i>Tema e aorisit pasiv</i>	<i>φ (-θη, -τη, -η)</i>	<i>+ -μένος</i>
<i>διαβάζ-ω</i>	<i>διαβάστ-ηκα</i>	<i>διαβασ-</i>	<i>διαβασμένος</i>
<i>ντόν-ω</i>	<i>ντύθ-ηκα</i>	<i>ντυ-</i>	<i>ντυμένος</i>
<i>κόβ-ω</i>	<i>κόπ-ηκα</i>	<i>κοπ-</i>	<i>κοπ-μένος</i> → <i>κομμένος</i>
<i>γράφ-ω</i>	<i>γράφ-ηκα</i>	<i>γραφ-</i>	<i>γραφ-μένος</i> → <i>γραμμένος</i> ²⁹⁵

Tabela 4.4

Por për disa folje, kryesisht të stilit publicistik apo juridik kjo skemë do të zgjerohej pak duke shtuar në fillim apo trup të pjesores një rrokje formuar nga bashkëtingëllorja e parë e temës së foljes (dhe kur ajo është formuar me parashtesim nga bashkëtingëllorja e temës së foljes së parme dhe vendoset para saj d.m.th. në trup të foljes së prejardhur) dhe *ε, βεβιασμένος, δεδομένος, εγκεκριμένος, εκτεταμένος*.

Foljet të cilat fillojnë me zanore apo nga bashkëtingëlloret *ρ, ζ, ξ, ψ*, nga dy apo tre bashkëtingëllore e formojnë pjesoren, jo më me shtimin e një rrokjeje, por nëpërmjet augmentit. Në këtë rast do të kishim:



Paraqitje grafike 4.1

Foljet nga të cilat formohet kjo pjesore mund të kenë vetëm formën pësore (apotetike): *μεταχειρίζομαι – μεταχειρισμένος* (*i përdorur*), *εγγυώμαι – εγγυημένος* (*i garantuar*), folje që mund të vendosen në të dyja format, por edhe folje të cilat gjenden vetëm në formën veprare, pavarësisht se mund të jenë të diatezës veprare apo pësore p.sh.: *διψάω – διψασμένος*, (*kam etje – i etur*), *θυμώνω – θυμωμένος* (*zemërohem – i zemëruar*), *ιδρώνω – ιδρωμένος* (*djersit – i djersitur*). Në shumicën e tyre kanë funksion analog me atë të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe:

²⁹⁴ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *vep. e cit.*, 1991, 330.

²⁹⁵ Pjesorja pësore e foljeve, zanorja e fundit e temës së të cilave është *π, β, φ, πτ*, shkruhet me dy *μ*.

- 1) *Τα μάτια όλα σηκώθηκαν και κοίταζαν όζω τη λασπωμένη μέρα.* (B.Π. 16)- *Të tërë ngritën sytë dhe i shtinë përjashtë për të parë dritën e përllëcur.* (Z.11)

Por mund të jepen edhe me një mbiemër të thjeshtë apo thjesht me pjesoren e shqipes:

- 2) *Ο, τι απ' όλα μου 'κανε εντύπωση ήταν τα μάτια του, περιγελαστικά, θλιμμένα, όλο φλόγα.* (B.Π. 21) - *Ç'ka më bëri shumë përshtypje ishin sytë e tij, ballanikë, të trishtë, gjithë shqetësim, ndezakë.* (Z.17)
- 3) *Καρφωμένη τα χρόνια εκείνα η ράτσα μας στους ίδιους βράχους, φώναζε.* (B.Π. 17) – *Mbërthyer gjithashtu asokohe raca jonë pas po atyre shkëmbinjve, grahte.* (Z.13)
- 4) *Ο Ζορμπάς, τυλιγμένος σε χοντρή καφετιά κουβέρτα, κοίταζε αχόρταγα την Κρήτη.* (B.Π. 31) *Zorba, mbështjellë i tëri me një batanije mishtake të errët, shikonte Kretën dhe s'kish të ngopur.* (Z.26)

Pjesorja pasive shërben edhe për të formuar në mënyrë alternative kohën më se të kryer të mënyrës joveprore edhe pse nuk ka kuptim sinonimik me strukturën parësore të formimit të kësaj kohe në gjuhën greke, e cila është kisha + paskajoren pësore të greqishtes së re:

- 5) *Μπήκε λοιπόν που λέτε η θάλασσα στο καράβι, μουσκεύτηκαν τα κάρβουνα που ήμουν φορτωμένος, βάρυναν.* (B.Π. 21) – *Që ta ngas muhabetin, deti vërshoi nëpër anije, u njom qymyri që pata ngarkuar, u rëndua.* (Z.17)

4) Pjesoret që mbarojnë me -ων(-ούσα, -ον), -εις(-εισα, -εν), -ας(-ασα, -αν) janë më të pakta dhe përdoren kryesisht në ligjërimin libror (publicistik) apo në shprehje të ngurtësuar nga greqishtja e vjetër dhe mund të kenë rolin e një emri, mbiemri apo edhe të një fjalie të nënrenditur.

a) Pjesoret që mbarojnë me -ων, -ούσα, -ον janë pjesore të së tashmes aktive, ndërsa pak prej tyre janë te aoristit aktiv apo pasiv të greqishtes së vjetër.

- 1) *Σήκωσε το κεφάλι, με κοίταζε καλά, σα να 'θελε να ξεκρίνει τι ιδέαν έχω για μέλλουσες ζωές και βασιλείς των ουρανών και γυναίκες και παπάδες.* (B.Π. 30)- *Ngriti kokën, më nguli sytë si të donte të dallonte ç'mendim kisha për jetën e përtejme, për mbretërinë e qiejve, për gratë, për shenjtorët.* (Z.25).
- 2) *Ο γράφων δεν έχει κανένα πρόβλημα να παραδεχθεί ότι όλη αυτή η κατάσταση είναι περισσότερο άθλια παρά ευχάριστη.* (Το Βήμα 21/12/1997) – *Shkruesi nuk ka asnjë problem të pranojë se gjithë kjo situatë është më shumë e mjerueshme sesa e këndshme.*

Interes paraqet të shohim se si është dhënë në shqip nga dy përkthyes të ndryshëm një pjesore e këtij tipi:

- 3) *Τιμή σ'εκείνους όπου στη ζωή των/ώρισαν και φυλάγουν Θερμοπόλες./Ποτέ από το χρέος τους μη κινούντες (Θερμοπόλες, Καβάφης) – Lavdi atyre që jetën/ ngujuan dhe ruajnë Thermopilet./Kurrë detyrës nuk iu shmangën.*(K, L.Z) – *Lavdi atyre që me jetë/morën në sy të mbrojnë Termopile./Detyrës pa iu shmangur asnjëherë.* (K, A.S).

Në rastin e parë përkthyesi e jep këtë pjesore me një fjali, ndërsa në rastin e dytë ajo jepet me një trajtë të pashtjelluar. Fakti se në të dyja rastet jepet me struktura foljore tregon karakterin foljor të kësaj pjesoreje përveç atij mbiemëror. Gjinia asnjënjë e disa prej këtyre pjesoreve është emërzuar dhe ato përdoren si emra asnjënjë në greqishten e re p.sh.: *το μέλλον -e ardhmja, το ενδιαφέρον - interesimi, το παρελθόν - e shkuara, το περιβάλλον – ambienti*. Por mund të ndodhë që të jetë emërzuar edhe pjesorja e gjinisë mashkullore: *παράγων – faktor*.

b) Pjesoret që mbarojnë me *εις, -εισα, -εν* janë pjesore të aoristit pasiv të greqishtes së vjetër dhe kanë funksion emëror apo mbiemëror në greqishten e re. Në rastin e mposhtëm pjesorja *συλληφθείς*, përdoret si emër dhe jepet në shqip me një emër me prejardhje nga një mbiemër prejpjesor i cili është substantivuar:

- 4) *Διαπιστώθηκε μάλιστα ότι κλειδί που είχε στην κατοχή του ο συλληφθείς άνοιξε την πόρτα του συγκεκριμένου σπιτιού.* (Η καθημερινή 28/01/11) – *Madje u konstatua se çelësi që dispononte i arrestuari hapte derën e shtëpisë në fjalë.*

Siç do të vërejmë në shembullin e mposhtëm dy përkthyes të ndryshëm (L.Z., A.S.) e kanë përcjellë në të njëjtën mënyrë pjesoren e këtij tipi, nëpërmjet një fjalie të nënrenditur lidhore:

- 5) *Ο αρνηθείς δεν μετανιώνει.* (Καβάφης, *Che fece ...il gran rifiuto*) - *Ai që mohon nuk pendohet.*

c) Pjesoret që mbarojnë me *-ας, -ασα, -αν* janë pjesore të aoristit aktiv të greqishtes së vjetër. Në gjuhën shqipe pjesoret e këtij tipi të gjuhës greke jepen nëpërmjet mbiemrave prejpjesorë (të ose jo të emërzuar).

- 1) *Την άποψη αυτή επικρότησαν και δύο - τρεις βουλευτές του ίδιου κόμματος που διαδέχθηκαν τον προλαλήσαντα σοσιαλιστή στο μικρόφωνο.* (Το Βήμα 21/12/1997) – *Këtë pikëpamje e mbështetën dhe dy tre deputetë të së njëjtës parti që vijuan para mikrofonit pas socialistit parafolës.*

4.2. Forma e pashtjelluar paskajore

Paskajorja si kategori foljore përfaqëson kulmin e abstraksionit gramatikor në sistemin foljor të një gjuhe. Ajo është një kategori foljore, që nuk është zhvilluar vetëm në familjen e gjuhëve indoevropiane, por edhe në familje të tjera gjuhësore, si p.sh. në gjuhët semite. Por edhe në gjuhët e një familjeje, siç është rasti i gjuhëve indoevropiane, vihen re ndryshime të rëndësishme duke kaluar nga njëra gjuhë në tjetrën. Paskajorja në gjuhët indoevropiane ka zhvilluar disa tipare qenësore, që e dallojnë atë nga format e tjera foljore, të shtjelluara e të pashtjelluara. Ajo emërton një veprim si proces, ka kategoritë gramatikore të foljes përkatëse dhe përdoret në një varg funksionesh sintaksore, ndër të cilat përfshihen patjetër edhe funksioni kryefjalor, kallëzuesor dhe kundrinor²⁹⁶. Si karakteristikë e gjuhëve ballkanike, konsiderohet edhe mënjanimi i paskajores, pasi diçka e tillë haset me karakteristika të veçanta për çdo gjuhë natyrisht, pothuajse në të gjitha gjuhët ballkanike. Për sa i përket kësaj dukurie, ekzistojnë tri pikëpamje të cilat mbrohen nga studiuesit të cilët e kanë shqyrtuar: hipoteza e substratit, mendimi se diçka e tillë ka ndodhur nën ndikimin e greqishtes, dhe mendimi se kjo është një dukuri që ka ndodhur si rezultat i zhvillimeve të brendshme të secilës gjuhë. Joseph mendon se mënjanimi i paskajores duhet të ketë filluar me kontaktin (ndërmjet gjuhëve), por vazhdoi vetëm kur gjendja e secilës gjuhë e lejoi.... Kjo do të thotë, sipas tij, se ky proces mënjanimi në një gjuhë mund të vazhdojë e në një tjetër, jo²⁹⁷.

4.2.1. Paskajorja e shqipes

Diskutime të shumta ka ngjallur në veçanti edhe paskajorja e shqipes. Sot si trajta të paskajores në gjuhën shqipe pranohet trajta *me ba*, *me punue*, *me mbjellë*, e cila përdoret kryesisht në dialektin geg. Krahas kësaj përdoret me funksione karakteristike për paskajoren, dhe trajta *për të bërë*, e cila është krijuar relativisht më vonë. Ajo ndeshet në të gjitha të folmet e shqipes dhe nuk përdoret në të gjitha funksionet e paskajores, ndaj është karakterizuar si një paskajore me funksione sintaksore të kufizuara²⁹⁸.

Mendime të ndryshme ekzistojnë edhe për faktin nëse shqipja ka pasur një paskajore sintetike ashtu si edhe gjuhët e tjera indoevropiane. Mendimin se shqipja mund të ketë pasur një paskajore sintetike e mbështesin gjuhëtarë si Piana, Xhuvani, Domi, Çabej, Demiraj etj., ndërsa mendimin se gjuha shqipe nuk ka pasur ndonjë herë paskajore sintetike e mbështesin Hahn-i, Meyer-i, Sandfeld-i, Weingand-i, Gabinski etj²⁹⁹. Ndërsa sipas Joseph – it, duhet të pranohet se paskajorja e shqipes u kufizua disi, por nuk humbi tërësisht, d.m.th. gjendja ishte si ajo e greqishtes mesjetare. Në shqip, në vend që të humbiste kjo kategori u rikrijua, ndërsa në greqisht humbi³⁰⁰.

Forma analitike e tipit *me ba*, e cila përdoret me të gjitha funksionet e paskajores formohet duke i paravendosur pjesores së foljes pjesëzën *me*. Paskajorja nga pikëpamja

²⁹⁶ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 2004, 149 - 153

²⁹⁷ B. Joseph, *To अपαρήμεφατο στις βαλκανικές γλώσσες*, Γλωσσολογία 2-3, (1983 - 1984), 91 - 98

²⁹⁸ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, 1986, 1004

²⁹⁹ Po aty, 1010

³⁰⁰ B. Joseph, *vep. e cit.*, Γλωσσολογία 2-3, (1983 - 1984), 91 - 98

funkzionale sipas Mansakut³⁰¹ ruan mjaft tipare emërore, por nga pikëpamja formalo-gramatikore nuk ruan asnjë nga kategoritë gramatikore të emrit. Ajo nuk ka as mundësinë dhe as volinë për t'u substantivuar në kuptimin e vërtetë të fjalës, ndaj kuptimet gramatikore të saj shihen në raport me kuptimet dhe kategoritë gramatikore të foljes. Kjo trajtë ka kategorinë gramatikore të diatezës dhe të kohës. Si kohë e tashme konvencionalisht merret trajta e tipit *me ba*, ndërsa si formë e së kryerës merret trajta *me pasë la*, e cila ka një përdorim të rrallë, shembulli (1). Për sa i përket diatezës kjo formë analitike paraqitet në dy forma *me ba* dhe *me u ba*, shembulli (2).

- 1) *Si ata e zeza m'i pasët mblue!* (L.M.5)
- 2) *Hollë e gjatë e ka qortue/ si me u sjellë e si me u prue* (L.M.14)

Për përkthimin e paskajores së shqipes në greqisht përdoret lidhorja, e cila ka zëvendësuar për nga funksioni në greqishten e re paskajoren e greqishtes së vjetër, shembujt (3), (4), (5).

- 3) *E askurrkujë n' kto troje t' veta / mos me i ba kurr tungjatjeta..(L.M.3) – Σε κανέναν στα εδάφη του αυτά / va μην πει ποτέ του Για ...*
- 4) *Edhe Europës tregun m'i a pre/ mos m'e lanë me shitë, me ble.. (L.M.8) – Και της Ευρώπης την αγορά να κλείσει/ να μην την αφήσει ν' αγοράσει, να πουλήσει.*
- 5) *Për me pa e për me ndi/ si luftohet në Shqyprni... (L.M.234)- Για ν' ακούσουν και va duon/ στην Αλβανία πώς πολεμούν...*

Trajta tjetër e shqipes e cila nga përmbajtja kuptimore ka vlerë paskajoreje është trajta e tipit *për të bërë*. Ajo shërben për të dhënë një veprim si proces, pa iu referuar një vete të caktuar dhe përdoret në shumicën e funksioneve të paskajores, por në disa nga funksionet e paskajores si funksioni kryefjalor dhe ai kundrinor ajo ka një përdorim të kufizuar, ndaj dhe është quajtur formë analitike foljore me vlerën e një paskajoreje me funksione sintaksore të kufizuara³⁰². Edhe kjo trajtë e pashtjelluar përdoret në diatezën veprorë, shembujt (1), (2), (3) dhe në diatezat joveprorë, shembujt (4), (5), (6). Kjo trajtë paskajoreje gjatë përdorimit në diatezën veprorë, përkthehet në gjuhën greke nëpërmjet lidhore, e cila mund të paraprihet nga lidhëza qëllimore *για (va)* në rastet kur kjo trajtë paskajore përdoret në funksion qëllimor, shembulli (1).

- 1) *Po ndiqnin me vëmendje hapjen e varrit të parë për të mësuar rregullat që do të ndiqeshin gjatë gërmimit. (Gj.U.V. 19) – Παρακολουθούσαν με προσοχή το άνοιγμα του πρώτου τάφου για να μάθουν τους κανόνες και την τακτική που θ' ακολουθούσαν στο σκάψιμο. (Σ.Ν.Σ. 23)*
- 2) *Gjeneralit iu duk përsëri se nuk kishte gjë për të thënë. (Gj.U.V. 15)- Ο στρατηγός ζανασκέφτηκε πως δεν είχε τίποτε να του πει. (Σ.Ν.Σ. 18)*
- 3) *Madje ai e kuptoi se nuk kishte asgjë për të menduar më. (Gj.U.V. 15) – Και μάλιστα κατάλαβε πως κι ο ίδιος δεν είχε να σκεφτεί τίποτε πια. (Σ.Ν.Σ. 18)*

³⁰¹ S. Mansaku, *Paskajorja dhe kategoritë gramatikore të saj*, SF 1, 1982

³⁰² *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995, 339

Edhe në rastet kur kjo trajtë përdoret në diatezat joveprore përkthehet në greqisht kryesisht nëpërmjet lidhore, shembulli (4), por në ndonjë rast kjo formë është shmangur gjatë përkthimit, shembulli (5).

- 4) *E kishte dëgjuar kaq herë ta flisnin fshatarët shqiptarë pranë varrezave, ku mblihdeshin për t'u ndihmuar.* (Gj.U.V. 33) – *Είχε ακούσει τόσες φορές να τα μιλάνε οι Αλβανοί χωριάτες δίπλα στους τάφους, όταν μαζεύονταν για να τους βοηθήσουν.* (Σ.Ν.Σ. 37)
- 5) *Gjatë bisedimeve paraprake me zyrtarët shqiptarë, një nga pikat e vështira për t'u marrë vesh kishte qenë moslejimi i kalimit të eshtrave mes për mes qyteteve.* (Gj.U.V. 30) – *Κατά τη διάρκεια των προκαταρκτικών συνομιλιών με τους Αλβανούς αξιωματούχους, ένα από τα πιο δύσκολα σημεία ήταν εκείνο της διέλευσης των λειψάνων μέσ' απ' τις πόλεις.* (Σ.Ν.Σ. 37)
- 6) *Gjeneralit i kujtoheshin copëza tregimesh të ushtarëve veteranë, që i kishin shkuar në shtëpi përpara nisjes së tij për t'u interesuar për varret e shokëve të tyre të mbetur nëpër Shqipëri.* (Gj.U.V. 22) – *Ο στρατηγός θυμόταν αφηγήσεις βετεράνων στρατιωτών, που είχαν πάει στο σπίτι του για να τον βρουν πριν την αναχώρησή του από ενδιαφέρον για τους σκοτωμένους συντρόφους τους που είχαν μείνει στην Αλβανία.* (Σ.Ν.Σ. 27)

Në shembullin (6), përkthyesi ka zgjedhur që trajtën *për t'u interesuar* ta përkthejë me parafjalë + emër, *από ενδιαφέρον*, ndërkohë që mund të ishte dhënë edhe nëpërmjet lidhore pasive (*για*) *να ενδιαφερθούν*.

Në rastet kur kjo trajtë paskajore e shqipes përdoret për të formuar tipin e dytë të së ardhmes, pra paraprihet nga folja *kam*, në gjuhën greke jepet me trajtën *kam* + lidhore, trajtë e cila përdoret edhe në gjuhën shqipe për të dhënë kuptimin kohor të së ardhmes, shembujt (7), (8).

- 7) *Edhe unë po çohem, - tha civili. - Kam për të shkruar një letër.* (Gj.U.V. 62) – *Κι εγώ ανεβαίνω, είπε ο δήμαρχος. Έχω να γράψω ένα γράμμα.* (Σ.Ν.Σ. 76)
- 8) *Mbaruat? Sa mirë. Atëherë unë kam për të parë edhe më.* (Gj.U.V. 233) - *Τελειώσατε; Τι καλά, πόσο σας ζηλεύω. Επομένως εγώ έχω να δω πολλά ακόμη.* (Σ.Ν.Σ.274)

4.2.2. Paskajorja e greqishtes

Në gramatikën tradicionale të greqishtes së re³⁰³ trajta foljore *διαβάσει, διαβασεί* trajtohet si një prej mënyrave foljore pavetore që emërtohet paskajore. Po kjo paskajore, të cilën Joseph e quan pseudopaskajore dhe sipas tij një kategori e tillë nuk duhet të ekzistojë në gramatikën e greqishtes së re sepse funksioni i saj i vetëm është përdorimi i saj në formimin e së kryerës, më se të kryerës dhe së ardhmes së përparme³⁰⁴ në greqishten e re nuk ka funksionet e një paskajoreje të mirëfilltë. Funksioni i saj është të formojë kohët analitike paraprirë nga folja ndihmëse *έχω (kam)*. Ajo mund të përdoret në formën veprorë dhe atë joveprorë, për të formuar përkatësisht format aktive e pasive të kohëve analitike. Forma veprorë e kësaj trajte formohet nga tema e aoristit aktiv + *-ει (διαβάσει)*, ndërsa forma joveprorë nga tema e aoristit pasiv + *-ει (διαβασεί)*. Ndërsa në greqishten e vjetër paskajorja është njëra nga tri trajtat emërore të foljes. Ajo emërtohet *απαρέμφοτο* sepse nuk shfaq, nuk tregon dhe as shpreh asgjë në lidhje me vetën, numrin apo mënyrën³⁰⁵. Paskajorja e greqishtes së vjetër ishte një emër foljor, por që kishte kategorinë gramatikore të kohës dhe diatezës, p.sh.: *λύειν*, (e tashme aktive) *λύ-εσθαι* (e tashme mesore) *λύ-σειν* (e ardhme aktive) *λύ-σεσθαι* (e ardhme mesore) *λύσαι*, (aoristi i parë aktiv) *λύ-σασθαι* (aoristi i parë diateza mesore), *λελυκέναι* (e kryer aktive) *λε-λύ-σθαι* (e kryer mesore) *λυθῆναι* (aoristi i parë pasiv)³⁰⁶. Me evolimin e greqishtes gradualisht kjo trajtë paskajore u mënjana duke u zëvendësuar me trajta të tjera foljore, kryesisht me lidhore. Paskajorja vazhdoi të përdorej gjatë periudhës helenistike dhe asaj romake, madje edhe në shekujt e parë të mesjetës. Në këtë periudhë paskajorja përdoret me kuptim qëllimor - rrjedhimor dhe funksionon si kundrinor për një numër të madh foljesh, ose përdoret si emër i nyjshëm. Gjatë kësaj periudhe, ndoshta edhe më herët, paskajorja gjendej në një proces desistematizimi. Por paskajorja, mbijetoi në gjuhën e gjallë edhe pas kësaj periudhe³⁰⁷, madje disa paskajore në formë të ngurtësuar përdoren edhe në greqishten e sotme, p.sh.: *λέγειν, δούναι και λαβείν, απαγορεύεται το καπνίζειν* etj. Me prejardhje prej paskajores janë edhe disa emra të gjinisë asnjane të cilat vijnë nga përdorimi i paskajores me nyjen e gjinisë asnjane, të cilët më vonë kanë përshtatur edhe ortografinë e tyre me emrat e gjinisë asnjane, kanë zëvendësuar mbaresën *-ει* me mbaresën e emrave asnjane *-ι*, p.sh.: *το φιλί, το μεθύσι, το φαί, το έχει*³⁰⁸. Në greqishten e re funksioni i paskajores së greqishtes së vjetër kryhet nga lidhja ose nga emrat prejfoljore asnjane.

³⁰³ M. Τριανταφυλλίδης, *vep. e cit.*, 2005

³⁰⁴ B. Joseph, *vep. e cit.*, Γλωσσολογία 2-3, (1983 - 1984), 91 - 98

³⁰⁵ I. Σταματάκου, *vep. e cit.*, 1968, 235

³⁰⁶ Αχιλλ. Τζάρτζανος, *Γραμματική της αρχαίας ελληνικής γλώσσας*, Αθήνα, 1967, 96

³⁰⁷ R. Browning, *vep. e cit.*, 1991, 89

³⁰⁸ N. Ανδριώτης, *vep. e cit.*, 1995, 128

4.3. Forma e pashtjelluar përcjellore

Përcjellorja³⁰⁹ është një nga trajtat e pashtjelluara të shqipes, në të cilën folja shpreh një veprim, i cili shoqëron veprimin e foljes drejtuese me të cilin kryhet zakonisht në të njëjtën kohë. Ndaj edhe kuptimi kohor i përcjellores është i kushtëzuar nga kuptimi kohor i foljes drejtuese dhe sipas kontekstit ajo mund të ketë kuptimin e së tashmes, së shkuarës ose së ardhmes³¹⁰. Por ka raste kur mund të haset edhe një formë e mbipërbërë e përcjellores e tipit *duke pasë bërë*, e cila sipas Gramatikës së Akademisë quhet koha e kryer dhe forma e tipit *duke larë* konvencionalisht në kundërvënje me të, quhet koha e tashme³¹¹.

Trajta e përcjellores siç kemi vënë edhe më sipër përdoret edhe për të formuar trajtat dytësore të së tashmes dhe të së pakryerës, përkatësisht *jam duke bërë* dhe *isha duke bërë*.

- a) *Gjenerali ishte duke punuar në studion e tij, kur shërbyesja e lajmëroi se dikush e priste në sallon.* (Gj.U.V. 40) – *Δούλευε στο γραφείο του όταν η υπηρέτρια τον ειδοποίησε πως κάποιος τον περίμενε στο σαλόνι.* (Σ.Ν.Σ. 49)
- b) *Madje disa prej tyre ishin duke shkruar një artikull mjaft të guximshëm për ta botuar në ndonjë revistë, kur në qytetin e vogël mbërriti grupi i kërkuesve të eshtrave të ushtarëve.* (Gj.U.V. 34)- *Δύο απ' αυτούς μάλιστα είχαν γράψει κι ένα αρκετά τολμηρό άρθρο με σκοπό να δημοσιευτεί σε κάποιο περιοδικό, όταν στην κωμόπολη έφτασε μια ομάδα που έψαχνε τα οστά των στρατιωτών.* (Σ.Ν.Σ. 41)

Një strukturë e tillë foljore nuk ekziston në gjuhën greke, madje as një strukturë e përbërë prej pjesores aktive, e cila ka të njëjtin kuptim me përcjelloren e shqipes e paraprirë nga folja *jam*. Në rastin e përkthimit të kësaj trajte në gjuhën greke mund të përdoret e pakryera, si në rastin (a). Kjo trajtë edhe në gjuhën shqipe është e barazvlefshme me të pakryerën. Në rastin (b) për të përkthyer të pakryerën e tipit *isha + përcjellore* është përdorur më se e kryera, e cila në fakt tregon se veprimi ka përfunduar dhe jo atë që shpreh e pakryera që veprimi nuk ka përfunduar ende. Në këtë rast mund të ishte përdorur e pakryera për të dhënë jo vetëm kohën e kryerjes së veprimit, por edhe aspektin e foljes.

Përcjellorja mund të përdoret me kuptim mënyror, shembujt (1), (2) ose me kuptim kohor, shembulli (3). Në shembullin (1), kjo përcjellore është dhënë në gjuhën greke me pjesoren aktive të foljes, e cila në këtë rast përdoret po me funksion mënyror si edhe përcjellorja e shqipes. Në shembullin (3) përcjellorja jepet në greqisht me të pakryerën e foljes *χτυπώ - χτυπούσα* paraprirë nga ndajfolja *όπως* që në këtë rast ka kuptimin kohor *ndërsa*.

³⁰⁹ Për këtë formë të pashtjelluar është përdorur edhe termi gjerund, si nga Kristoforidhi, A. Xhuvani, K. Cipo etj.

³¹⁰ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995, 336

³¹¹ Po aty, 337

- 1) *Ja medaljoni, - tha dhe ia tregoi gjeneralit, **duke e mbajtur** me pincë. (Gj.U.V. 24)- Ένα μενταγιόν, είπε και το 'δειξε στο στρατηγό, **κρατώντας** το με μια λαβίδα. (Σ.Ν.Σ. 29)*
- 2) *Gjysmën e ushtri... gjysmën e mbretërisë për një banjë, - shtoi **duke qeshur**. (Gj.U.V. 193) – Το μισό μου στράτευμα..... το μισό μου βασίλειο για ένα μπάνιο, πρόσθεσε **γελώντας**. (Σ.Ν.Σ.228)*
- 3) *Kama ime ndeshte nëpër gurët e vegjël dhe, **duke u fërkuar** me ta, lëshonte një tingull ngjethës. (Gj.U.V. 22) – Η ξιφολόγη μου έβρισκε στα χαλίκια και, **όπως χτυπούσε** πάνω τους, άφηνε ένα ανατριχιαστικό ήχο. (Σ.Ν.Σ. 27)*

Përcjellorja e shqipes mund të përdoret gjithashtu me funksion shkakor, shembulli (4), ose, siç ndodh në shumicën e rasteve, për të shprehur një veprim dytësor i cili kuptimisht është i bashkërenditur me atë të foljes drejtuese, shembujt (5-8).

- 4) ***Duke mos ditur** ç'të bënte, nisi të lexonte përsëri. (Gj.U.V. 39)- Μην **ξέροντας** τι να κάνει, άρχισε να ζαναδιαβάσει. (Σ.Ν.Σ. 47)*
- 5) *Domethënë filloi, mendoi i tronditur gjenerali, **duke vështruar** plisat e parë të lagur, që u rrokullisën në këmbët e tyre. (Gj.U.V. 19) – Ξεκινήσαμε λοιπόν, σκέφτηκε ταραγμένος ο στρατηγός, **κοιτώντας** τους πρώτους βρεγμένους σβώλους, που κατρακυλούσαν στα πόδια τους. (Σ.Ν.Σ. 23)*
- 6) *Një fshatar i vetëm po kalonte në udhë, **duke tërhequr** një kalë nga kapistalli. (Gj.U.V. 22)- Ένας χωρικός περνούσε στο δρόμο, **σέρνοντας** το άλογό του απ'τα γκέμια. (Σ.Ν.Σ. 24)*
- 7) *Specialisti shqiptar se ç'i thoshte vazhdimisht, **duke i treguar** me dorë diçka, i përkulur i tëri te buza e gropës. (Gj.U.V. 22)- Ο Αλβανός επιστάτης του μιλούσε συνέχεια, **δείχνοντάς** του κάτι με το χέρι, διπλωμένος στα δύο στην άκρη του λάκκου. (Σ.Ν.Σ. 27)*
- 8) *Pas dezinfektimit specialisti i mati një nga një disa eshtra dhe pastaj një copë herë seç njehsoi në bllokun e tij, **duke mbajtur** stilografin shtrembër midis gishtave të hollë. (Gj.U.V. 27)– Λίγο αργότερα κάτι έψαζε στο σημειωματάριό του, **κρατώντας** σφιχτά το στυλό ανάμεσα στα λεπτά του δάχτυλα. (Σ.Ν.Σ. 30)*

Në të gjithë shembujt (4-8) për të dhënë përcjelloren e shqipes është përdorur pjesorja aktive e foljeve përkatëse, e cila siç e vumë re ka të njëjtin kuptim dhe përdoret me pothuajse të njëjtit funksione me paskajoren e shqipes.

4.4. Forma e pashtjelluar e tipit *pa larë*

Për formën e pashtjelluar të tipit *pa larë* dhe për mënyrën e formimit të saj ka shumë interpretime. Ajo është interpretuar si trajtë e përbërë nga pjesëza *pa + paskajore*, *pa + pjesore*, *pa + emër prejpjesor*, ekziston madje edhe pikëpamja se kjo nuk është një formë pashtjelluar analitike, sepse pjesët e saj përbërëse janë dy fjalë të veçanta. Sipas Gramatikës së Akademisë, dy pjesët përbërëse të kësaj forme të pashtjelluar janë të lidhura aq ngushtë me njëra tjetrën sa që nuk mund të veçohen nga njëra tjetra dhe kur folja vendoset në këtë formë, shpreh moskryerjen e një veprimi kryesisht në të shkuarën ose në të ardhmen. Por me qenë se pjesëza *pa* e ruan kuptimin e saj mohor konvencionalisht kjo formë analitike quhet formë e pashtjelluar mohore³¹².

Ashtu si edhe përcjellorja kuptimi kohor i kësaj forme është i kushtëzuar nga kuptimi i foljes drejtuese, por ajo mund të vendoset në kundërvënien veprorë – joveprorë. Në gjuhën e shkruar haset edhe forma e mbipërbërë *pa pasë larë*.

Një formë analoge për nga formimi nuk haset në gjuhën greke. Për të dhënë kuptimin e saj në gjuhën greke përdoret kryesisht lidhorja paraprirë nga parafjala *χωρίς (pa)*, *shembujt (1), (2)*.

- 1) *Ç' të ketë pasur vallë midis tyre? Pyeti përsëri veten gjenerali, pa ia hequr sytë. (Gj.U.V. 28)- Τι va είχε συμβεί άραγε μεταξύ τους; αναρωτήθηκε ζανά ο στρατηγός χωρίς να σταματήσει να παρατηρεί τον ιερέα. (Σ.Ν.Σ. 34)*
- 2) *I trazoi një copë herë, pa u përqendruar dot në asnjërën. (Gj.U.V. 225) - Τα ανακάτεψε για λίγο όλα, χωρίς να διαβάσει προσεκτικά τίποτε. (Σ.Ν.Σ. 264)*

Në rastin kur kjo formë përdoret me kuptim kohor, pra tregon parakohësi në gjuhën greke mund të jepet me lidhore paraprirë nga ndajfolja kohore *πριν (para, përpara)* me kuptim parafjalor, *shembujt (3), (4)*.

- 3) *Pa rënë mbrëmja, aviatori, dhe dy ushtarë u gjetën. (Gj.U.V. 53) – Πριν νυχτώσει τα οστά του πιλότου και των δυο στρατιωτών είχαν βρεθεί. (Σ.Ν.Σ. 65)*
- 4) *E mbloodhi shuk pa e lexuar gjer në fund dhe e hodhi në hirnore. (Gj.U.V. 248) – Το τσαλάκωσε πριν να το διαβάσει ολόκληρο και το πέταξε στο τασάκι. (Σ.Ν.Σ. 292)*
- 5) *Ç' bukuroshe që ishte! Mendoi, dhe vuri duart nën zverk pa i hequr sytë nga pjerrësia e tendës. (Gj.U.V. 84) – Τι όμορφη που ήταν! Σκέφτηκε βάζοντας τα χέρια κάτω απ' το σβέρκο και έχοντας το βλέμμα καρφωμένο στην κλίση της σκηνής. (Σ.Ν.Σ. 102)*

Në shembullin (5) forma *pa i hequr sytë* është përkthyer me shprehjen *έχοντας το βλέμμα καρφωμένο (duke patur vështrimin mbërthyer)*, duke shmangur kështu përkthimin e drejtpërdrejtë në greqisht të formës së pashtjelluar .

³¹² M. Çeliku e quan përcjellore mohore, ose trajta e përcjellores së parakohësisë, M. Çeliku, *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2010, 173

4.5. Format e tipit *me të larë, një të larë*

Këto dy forma të pashtjelluara formohen nga emri prejfoljor asnjans në formën e kallëzores së pashquar, i cili tashmë është ngurtësuar duke paravendosur parafjalën *me* dhe numërorin *një*. Pra kemi të bëjmë me gramatikalizim të togjeve të lira pasi as elementi i parë nuk shërben si parafjalë, përkatësisht numëror dhe as elementi i dytë si emër, gramatikalizim i cili ka ndodhur në një fazë relativisht të vonë të gjuhës shqipe³¹³.

Forma e pashtjelluar e tipit *me të larë*, e cila përdoret vetëm në funksion kohor, emërton një veprim, që është kryer ose pritët të kryhet, menjëherë para veprimit të shprehur nga folja drejtuese. Veprimi i shprehur nga forma pashtjelluar mund të jetë kryer në të shkuarën apo pritët të kryhet në të ardhmen³¹⁴. Kjo trajtë e pashtjelluar mund të zëvendësohet nga e kryera e thjeshtë, kur i referohet një veprimi në të shkuarën dhe nga e tashmja e lidhore kur veprimi ka kuptimin kohor të ardhmes.

Në gjuhën greke nuk ekziston një trajtë analoge për sa i përket formimit. Për të shprehur kuptimin e saj në gjuhën greke mund të përdoret aoristi i dëftores paraprirë nga ndajfolja kohore *μόλις* (*sapo*), shembulli (a).

Me t'u veshur, dola shpejt e shpejt në rrugët e qytetit. (T.G. 65)

a) *Μόλις ντύθηκα, βγήκα βιαστικά στους δρόμους της πόλης.*

b) *Με το που ντύθηκα, βγήκα βιαστικά στους δρόμους της πόλης.*

Për të dhënë kuptimin e foljes kur vendoset në këtë formë të pashtjelluar në greqisht mund të përdoret edhe struktura *με το που* + folje në aorist, shembulli (b), strukturë e cila ka gjithmonë kuptim kohor. Interesant është fakti se edhe kjo strukturë ka si gjymtyrë të parë parafjalën *με* (*me*).

Forma e pashtjelluar e tipit *një të larë* haset në gjuhën e sotme letrare, kryesisht në gjuhën e folur, në vend të formës së tipit *me të larë*, në rastet kur ajo ka kuptim kohor, për të shprehur një veprim i cili është kryer ose pritët të kryhet menjëherë pas veprimit të shprehur nga folja drejtuese.

Një të marrë flakë dhe u bë shkrumb e hi. (H.N. 28)

a) *Μόλις πήρε φωτιά και έγινε στάχτη.*

b) *Με το που πήρε φωτιά, έγινε στάχτη.*

Edhe në rastin e kësaj trajte të pashtjelluar në gjuhën greke nuk ka një trajtë analoge për nga formimi. Për të dhënë kuptimin e saj në gjuhën greke përdoren si edhe për formën e tipit *me të larë*, ose aoristi i dëftores paraprirë nga ndajfolja e kohës *μόλις* (*sapo*), shembulli (a), ose struktura *με το που* + folje në aorist, shembulli (b).

³¹³ Sh. Demiraj, *vep.e cit.*, 1986, 979

³¹⁴ *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1995,341

Përfundime

- ❖ Pjesorja e gjuhës shqipe dhe ajo e gjuhës greke janë forma sintetike foljore të cilat kanë tipare gramatikore edhe të foljes, edhe të emrit edhe të mbiemrit. Ndërsa në gjuhën e sotme shqipe termi pjesore përcakton vetëm një strukturë, në greqishten e re përcakton tri struktura gramatikore: struktura foljore me formantin *-οντας (-ώντας)*, struktura foljore me formantin *-ούμενος* ose *-όμενος*, dhe struktura foljore me formantin *-έμος*.
- ❖ Për sa i përket anës strukturore si pjesorja e shqipes ashtu edhe ajo e greqishtes formohen nga tema e foljes, e cila mund të jetë në kohën e tashme ose në të kryerën e thjeshtë (aoristin për greqishten) dhe nga prapashtesa. Nga prapashtesat që shërbejnë për të formuar pjesoren në të dyja gjuhët është e përbashkët prapashtesa indoevropiane **-meno-/mo-*, tek cila e ka burimin prapashtesa *-m* e shqipes, dhe prapashtesa *-μενος* e pjesores pasive të greqishtes së re. Pjesorja e shqipes në greqishten e re jepet me formën e paskajores së greqishtes së re e cila nuk ka funksionet e një paskajoreje të mirëfilltë.
- ❖ Mbiemrat prejpjesorë të gjuhës shqipe në gjuhën greke jepen në shumicën e rasteve me pjesoren pësore, por edhe me mbiemra ose me folje, fakt që tregon prejardhjen e tyre foljore.
- ❖ Emrat prejpjesorë asnjans të tipit *të ecurit, të lexuarit, të folurit, të shkruarit*, nga ana kuptimore janë të njëjtë me paskajoren e së tashmes aktive të greqishtes së vjetër, ndërsa në greqishten e re analogët e këtyre emrave janë emra prejfoljorë, por jo të formuar nga tema e pjesores. Emrat prejpjesorë asnjans që hasen zakonisht në shprehje të ngurosura në gjuhën greke mund të jepen me emra (jo me prejardhje foljore), ose me folje.
- ❖ Në rastet kur pjesorja e gjuhës shqipe përdoret gjatë ligjërimit më vete, jo si pjesë e strukturës së një kohe analitike dhe e pashoqëruar nga treguesit *duke, për, pa* në gjuhën greke jepet me pjesoren pësore të greqishtes.
- ❖ Struktura e cila formohet me ndihmën e pjesores dhe ka si gjymtyrë të parë foljen pavetore *duhet* jepet në gjuhën greke me foljen pavetore *πρέπει (duhet)*+ foljen në lidhore.
- ❖ Pjesorja e greqishtes që mbaron në *-οντας (-ώντας)* ka gjithmonë funksion ndajfoljor dhe në gjuhën shqipe jepet zakonisht me formën e pashtjelluar përcjellore. Kjo pjesore mund të jepet në gjuhën shqipe edhe me folje shoqëruar me lidhëza nënrenditëse ose me emra me parafjalë duke treguar kështu në çdo rast funksionin e saj ndajfoljor.

- ❖ Pjesorja e greqishtes së re që mbaron në *-όμενος, -όμενος* ose *-άμενος*. në gjuhën shqipe mund të jepet me mbiemër prejpjesor, por hasen edhe raste kur nuk mund të jepet veçse me përcjellore.
- ❖ Pjesorja e së kryerës pasive të greqishtes që mbaron në *-μένος* dhe mbart karakteristika emërore, përkatësisht mbiemërore (gjini, rasë) dhe karakteristika foljore (aspekti, koha, forma, diateza) në shumicën e rasteve ka funksion analog me atë të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe. Pjesorja pasive shërben edhe për të formuar në mënyrë alternative kohën më se të kryer të mënyrës joveprore edhe pse nuk ka kuptim sinonimik me strukturën parësore të formimit të kësaj kohe në gjuhën greke, e cila është *kisha + paskajoren pësore* të greqishtes së re.
- ❖ Pjesoret e së tashmes aktive të greqishtes së vjetër që mbarojnë me *-ων, -ούσα, -ον*, pjesore të aoristit pasiv e greqishtes së vjetër që mbarojnë me *εις, -εισα, -εν* dhe pjesoret e aoristit aktiv të greqishtes së vjetër që mbarojnë me *-ας, -ασα, -αν* që përdoren kryesisht në ligjërimin libror (publicistik) apo në shprehje të ngurtësuara nga greqishtja e vjetër jepen në gjuhën shqipe me një trajtë të pashtjelluar, me një fjali ose nëpërmjet mbiemrave prejpjesorë (të ose jo të emëruar).
- ❖ Paskajorja si kategori foljore nuk është zhvilluar vetëm në familjen e gjuhëve indoevropiane, por edhe në familje të tjera gjuhësore. Paskajorja në gjuhët indoevropiane ka zhvilluar disa tipare qenësore, që e dallojnë atë nga format e tjera foljore, të shtjelluara e të pashtjelluara. Karakteristikë e gjuhëve ballkanike është edhe mënjanimi i paskajores.
- ❖ Në gjuhën shqipe si trajtë e paskajores pranohet trajta *me ba*, e cila përdoret kryesisht në dialektin geg dhe përdoret kryesisht me funksione karakteristike për paskajoren, dhe trajta *për të bërë*, e cila është krijuar relativisht më vonë, ndeshet në të gjitha të folmet e shqipes dhe nuk përdoret në të gjitha funksionet e paskajores.
- ❖ Forma analitike e tipit *me ba*, e cila përdoret me të gjitha funksionet e paskajores formohet duke i paravendosur pjesores së foljes pjesëzën *me*. Kjo trajtë ka kategorinë gramatikore të diatezës dhe të kohës. Për përkthimin e paskajores së shqipes në greqisht përdoret lidhorja.
- ❖ Trajta e tipit *për të bërë* shërben për të dhënë një veprim si proces, pa iu referuar një vete të caktuar dhe përdoret në shumicën e funksioneve të paskajores, por në disa nga funksionet e paskajores si funksioni kryefjalor dhe ai kundrinor ajo ka një përdorim të kufizuar. Kjo trajtë paskajoreje gjatë përdorimit në diatezën veprare, përkthehet në gjuhën greke nëpërmjet lidhores, e cila mund të paraprihet nga lidhëza qëllimore *για (va)* në rastet kur kjo trajtë paskajore përdoret në funksion qëllimor. Në rastet kur kjo trajtë paskajore e shqipes përdoret për të formuar tipin e dytë të së ardhmes, pra paraprihet nga folja *kam*, në gjuhën greke jepet me trajtën *kam + lidhore*.

- ❖ Paskajorja e greqishtes së re, e cila nuk ka funksionet e një paskajoreje të mirëfilltë, në gramatikën tradicionale trajtohet si një prej mënyrave foljore pavetore dhe funksioni i saj është të formojë kohët analitike paraprirë nga folja ndihmëse *έχω* (*kam*). Në greqishten e vjetër paskajorja është njëra nga tri trajtat emërore të foljes. Ajo ishte një emër foljor, por që kishte kategorinë gramatikore të kohës dhe diatezës dhe me evolimin e greqishtes gradualisht kjo trajtë paskajore u mënjanua duke u zëvendësuar me trajta të tjera foljore, kryesisht me lidhore. Disa paskajore në formë të ngurtësuar përdoren edhe në greqishten e sotme.
- ❖ Përcjellorja është një nga trajtat e pashtjelluara të shqipes, në të cilën folja shpreh një veprim, i cili shoqëron veprimin e foljes drejtuese me të cilin kryhet zakonisht në të njëjtën kohë. Trajta e përcjellores përdoret edhe për të formuar trajtat dytësore të së tashmes dhe të pakryerës, përkatësisht *jam duke bërë* dhe *isha duke bërë*. Një strukturë e tillë foljore nuk ekziston në gjuhën greke, dhe në rastin e përkthimit të kësaj trajte në gjuhën greke mund të përdoret pjesorja aktive e foljes ose e pakryera.
- ❖ Kur folja vendoset në formën e pashtjelluar të tipit *pa larë* shpreh moskryerjen e një veprimi kryesisht në të shkuarën ose në të ardhmen. Kuptimi kohor i kësaj forme është i kushtëzuar nga kuptimi i foljes drejtuese, por ajo mund të vendoset në kundërvënien veprorë – joveprorë. Një formë analoge për nga formimi nuk haset në gjuhën greke. Për të dhënë kuptimin e saj në gjuhën greke përdoret kryesisht lidhorja paraprirë nga parafjala *χωρίς* (*pa*), apo nga ndajfolja kohore *πριν* (*para, përpara*) me kuptim parafjalor.
- ❖ Forma e pashtjelluar e tipit *me të larë*, e cila përdoret vetëm në funksion kohor, emërton një veprim, që është kryer ose pritet të kryhet, menjëherë para veprimit të shprehur nga folja drejtuese. Duke qenë se në gjuhën greke nuk ekziston një trajtë analoge për sa i përket formimit, për të shprehur kuptimin e saj ashtu si edhe për formën e tipit *një të larë* në gjuhën greke mund të përdoret aoristi i dëftores paraprirë nga ndajfolja kohore *μόλις* (*sapo*), apo struktura *με το που* + folje në aorist strukturë e cila ka gjithmonë kuptim kohor.

V. PËRSHTATJA NË GJUHËN SHQIPE E FOLJEVE TË HUAZUARA NGA GJUHA GREKE

Në gjuhën shqipe në periudha të ndryshme historike kanë hyrë mjaft fjalë nga gjuha greke. Pjesa më e madhe e tyre në leksikun e sotëm të shqipes kanë kaluar në kundërvënien stilistikore si fjalë të thjeshtligjërimit a të gjuhës bisedore³¹⁵. Ne do të trajtojmë vetëm foljet të cilat kanë hyrë në leksikun e shqipes nga gjuha greke sidomos në të folmet jugore dhe të folmen e Çamërisë dhe si janë përshtatur ato me sistemin fonetik e morfologjik të shqipes. Disa prej këtyre foljeve si: *psonis, cimbis, mballos, zalis, zalisje, kopanis, kumbis, mbodhis, anangas, feks, cuks, farmakos, gremis, kolit - kolis, honeps, karfos, moleps, taks, kakaris, lips, piks, stis, tromaks, zileps* përbëjnë lema të veçanta në fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe 1980, madje shumë prej tyre formojnë edhe vargje paradigmaticë p.sh.: *moleps, molepsës, molepsje, i molepsur/ stolis, stolisje, i stolisur/ zalis, zalisje, i zalisur*. Pra, janë futur tashmë në sistemin gjuhësor të shqipes. Janë përshtatur me këtë sistem nga ana fonetike, morfologjike e kuptimore.

Në të folmet jugore përdoren mjaft folje të huazuara nga gjuha greke si: *moleps (ndot, i ngjit dikujt një sëmundje), mballos (vë një mballomë), anangas (ngacmoj, trazoj), piks (mpiks, ngjiz), cimbis (pickoj), vithis, vithisem (fundos, humb, shemb), zalis, kopanis (rrah rrobat me kopan kur i laj), mbodhis (vonoj, pengoj), kumbis (mbështet kokën, trupin për të fjetur), cuks (djeg, përcëllon), farmakos (helmoj dike), nakatos, vaptis, gremis, dhangas (kafshoj), dhaskaleps, kakaris, kallafatis (e kallafatisi punen), qëndis, kolit - kolis (ngjit), stis, psonis (bëj pazar, blej), honeps, taks, karfos (ngul), llagaros (pastroj, kulloj), dhokanis (e lodh, e mërzit), potis (ujit), kallafatis (ha, përpjij), profatas (arrij), mollois (tregoj, rrëfej), anastisem (ringjallem), arravonjas (fejoj), ksemollois (i tregoj ngjarje etj. për të shtyrë kohën etj, bëj muhabet), vllojis (bekoj), stolis³¹⁶.*

Edhe në të folmen e Çamërisë, hasim shumë folje të huazuara nga greqishtja. Disa prej tyre janë të njëjta me ato të të folmeve jugore, por ka edhe mjaft që janë karakteristike për ligjërimit bisedor të kësaj zone. Foljet me origjinë nga greqishtja të kësaj të folmeje janë: *anangas (shpejtoj, nxitoj), apofasis (vendos), gremis, hajdheps (përkëdhel), haraks (bie drita, zbardh) horaks (gërhas), hos (fus), kakaris, karfosem (mbetem në vend, gozhdohem), karpos (lidh, mbërthej), kolis (ngjis), ksegoras (kërkoj ksegorë - shumë të hollash që kërkonin hajdutët njerëzve të pasur), ksehas (kënaq), ksepolis (liroj nga ushtria), kumbis (vendos), lanofeks (sapo bie drita, sapo agon), lavos (plagos), lefteroj dhe lefteros (liroj), lejmonis (mëshiroj), leros (ndot, ndyj, i, e lerosur), ligjis - lijis (përkulem), lips (mungoj zhdukem), llamburit (shkëlqen mdriçon) manganis (shtyp me mangë), mbolas (shartoj ullinj të), mellos (vë grepit karema), mellos bakllavanë (bëj me sherbet), muhlasat (myket), nois (bëhem pishman), ndrrips (bluaj), orgos (çaj tokën e thyej), pagoset (ngrin), pajgoris (ngushëlloj), paps (ndal, pushon),*

³¹⁵ Androkli Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*, 1972

³¹⁶ Për grumbullimin e foljeve të të folmeve jugore është shfrytëzuar : Sofia Delijorgji, *Huazimet greke në dialektin jugor dhe në të folmet jugore të shqipes*,

peleqis (gdhend), penes (mburr, lavdëroj), petaks (çudis, rri me gojë hapur), pikset (ngrin), piraks (ngacmoj), preps (duhet), rrohaks (gërhas), rrovonjas (fejoj), rrufis (përpij), spleks (pleks), taraks (trondit, prish gjakun), teliks (mbështjell), tianis (tiganis, fërgoj), tiliks (ngatërroj) trohis (mpreh), tromaks (tremb), vais (anon, kthehet nga një anë), (nxituj), vodhis (kundërmon, bie erë të këndshme), vulaks (humb, fundos), vulis (bie, shembet), vuvosem (bëhem memec), zeps (vë në zgjedhë), zileps (kam zili)³¹⁷.

5.1. Përshtatja me sistemin fonetik

5.1.1. Theksimi

Të gjitha foljet që kanë hyrë nga greqishtja në gjuhën shqipe, në përputhje me normën e gjuhës shqipe ku te foljet theksi bie gjithnjë në rrokjen e fundit të temës³¹⁸, janë oksitone pavarësisht se në cilën rrokje bie theksi te këto folje në gjuhën greke. Shumica e këtyre foljeve në gjuhën greke janë paroksitone: ζαλίζω - *zalís*, ψωνίζω - *psonís*, μπαλώνω - *mballós*, φαρμακώνω - *farmakós*, φέγγω - *féks*, λείπω - *líps*, τσούζω - *cuks*.

5.1.2. Përshtatja tingullore

Fjalët e huaja që vijnë nga Greqishtja e vjetër, latinishtja dhe gjuhët romane dhe që në këto gjuhë kanë l të thjeshtë apo dyfishe në gjuhën shqipe shqiptohen me l³¹⁹. Foljet, të cilat po shqyrtojmë i përkasin ligjërimin bisedimor dhe shpesh i shmangen normës së ngulitur. Kështu ato folje që në gjuhën greke kanë në strukturë e tyre tingullin [l], kanë hyrë në gjuhën shqipe herë me l, e herë me ll, sipas së folmes së Greqisë veriore dhe të Minoritetit etnik grek në Shqipëri ku përpara zanoreve të pasme, tingulli [l] shqiptohet [l]. Kështu para zanoreve *a, o, u* vëmë re se folja në gjuhën shqipe ka hyrë me ll si: *mellos, mollois, kallafatis, llamburit, mballos, vllojis, ksemollois*, ndërsa kur ndiqet nga zanoret *e, i* folja ka hyrë me tingullin [l] si: *zileps tiliks, peleqis lips, lefteros, ksepolis, kolit - kolis, moleps*. Por hasen edhe folje të cilat nuk i nënshtrohen këtij rregulli si p.sh.: folja *lavos*.

Folje të cilat në gjuhën greke përmbajnë tinguj si: grykoret [γ], [χ] të cilët gjuha shqipe nuk i ka, kur kanë hyrë në gjuhën shqipe këta tinguj janë përshtatur me sistemin fonetik të shqipes. Tingulli [γ] është dhënë me grykoren g si p.sh.: *pajgoris, pagoset, orgos*. Kur në gjuhën greke ky tingull qiellzorëzohet kur ndiqet nga zanoret e parme, atëherë edhe në gjuhën shqipe jepet me qiellzoret j ose gj p.sh.: *vjas, vllojis, ligjis - lijis*. Tingulli [χ] në këto folje të huazuara zëvendësohet nga grykorja e shurdhët h p. sh.: *muhlaset, honeps, hajdheps, ksheas, haraks*.

Kur grykorja [k] në gjuhën greke qiellzorëzohet para zanoreve të përparme dhe nyjëtohet si [c], te këto folje në gjuhën shqipe ky tingull jepet me qiellzoren e shurdhët q p.sh.: *peleqis*.

³¹⁷ Për grumbullimin e foljeve të të folmes së Çamërisë është shfrytëzuar: Qemal Haxhihasani, *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Çamërisë*, Dialektologjia shqiptare II, Tiranë, 1974

³¹⁸ A.Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, 173

³¹⁹ Po aty, 230

Gjatë huazimit të këtyre foljeve nga greqishtja në shqip kanë ndodhur edhe procese të ndryshme fonetike. Haset kështu fenomeni i aferezës si p.sh.: *kumbis- ακουμπώ*, *vllojis- εβλογώ*, *mbodhis- εμποδίζω*, protezës si p.sh.: *spleks – πλέκω*, *mballos – μπαλώνω*, sinkopës si p.sh.: *tianis (që e hasim edhe tiganis) – τηγανίζω*, *mollois- ομολογώ* (këtu kemi njëkohësisht edhe aferezë), *pajgoris – παρηγορώ*, apo asimilimit në distancë si p.sh.: *rrovonjas- αρραβωνιάζω*.

5.2. Përshtatja me sistemin morfologjik

Karakteristikë e përbashkët e të gjitha këtyre foljeve të huazuara nga gjuha greke është se formohen jo nga tema e kohës së tashme të foljes në gjuhën greke, por nga tema e aoristit. Në gjuhën greke këto folje formojnë aoristin sigmatik, ndaj dhe të gjitha foljet e huazuara në shqip mbarojnë me s. Siç duket edhe nga shembujt e mësipërm, vetëm pak nga këto folje, dy prej të cilave kanë dy forma *lefteroj - lefteros* dhe *kolit – kolis*, dhe folja *llamburit* paraqesin bashkëtingëllore tjetër fundore :. Të gjitha foljet e tjera mbarojnë me s dhe përfshihen në klasën e parë të zgjedhimit të dytë sipas klasifikimit të foljeve në zgjedhime që bëhet në gramatikën e gjuhës shqipe³²⁰. Si të tilla kanë të njëjtën temë në kohën e tashme, të kryerën e thjeshtë dhe në pjesore: *stolis – stolisa – stolisur*, *nakatos – nakatosa – nakatosur*, *zileps – zilepsa – zilepsur* etj. Këto folje i formojnë dhe përdoren në të gjitha kohët dhe mënyrat e sistemit foljor të gjuhës shqipe.

Koha e tashme e dëftores siç e përmendëm, formohet nga tema sigmatike e aoristit të foljes në greqisht dhe përdoret si në formën veprare ashtu dhe në atë joveprare: *Nuk honepset ai njeri. (FGJSSH). Dhia e zgjebosur moleps gjithë kopenë. (FGJSSH)*. Disa prej këtyre foljeve nuk përdoren vetëm në ligjërimin bisedimor, por edhe në krijimtarinë letrare. Kështu e pakryera e dëftores, e cila formohet me temën e së tashmes dhe mbaresën vetore *–ja* si te foljet e tjera të shqipes, haset p.sh.: *Kur shkoi qeleshja e bardhë që fekste Europës/ Që mburrej shqiptari fatkeq me të huajt? (Dritëro Agolli, Qeleshja)*. E kryera e thjeshtë e dëftores së foljeve të huazuara nga greqishtja ka të njëjtën temë me të tashmen me mbaresa vetore *–a, –e, –i, ëm, –ët, –ën: zileps – zilepsa, stolis – stolisa, mollois – molloisa. E anangasi me fjalë. (FGJSSH). U karfosën e s'i ndanin dot. kacafytem (FGJSSH)*(Në këtë rast kemi edhe ndryshim të kuptimit të foljes në gjuhën e origjinës). Pjesorja formohet nga tema foljore e kohës së tashme plus prapashtesën – **ur**: *stolis – stolisur, mbodhis – mbodhisur, arravonjas- arravonjasur, piks- piksur, moleps- molepsur, leros- lerosur, zalis- zalisur*. Ka raste kur pjesorja përdoret në shprehje të ligjërimin bisedimor si p.sh.: *Lipsur qoftë! (në djall të vejë) (FGJSSH)*. Shumë prej këtyre foljeve formojnë edhe mbiemra prejpjesorë p.sh.: *i lerosur, i mballosur: Sigurisht që mund të zgjatesha më tej në përçartjet letrareske të kësaj veprë të servitur si roman, i mballosur me gjithfarë etiketash marketingu (për fatin e keq të autorit), por jam kaq i lodhur nga përpjekja për ta çuar deri në fund leximin e mundimshëm të këtij libri, sa meritoj, njësoj si ju, një çlodhje (Gazeta “Albania”, 18 maj 2008). Duket si i zalisur, se sapo ka arritur nga Athina, pas një udhëtimi të lodhshëm nate. (Tirana Observer, 6 gusht 2010)*. Kohët analitike formohen sipas rregullave të sistemit foljor të shqipes me foljet ndihmëse *kam* dhe *jam* plus pjesoren. *Ish taksur për kallogre. (FGJSSH). E kishn lavosur hajdutë. (DSH II)*. Këto folje i gjejmë të përdorura në të gjitha trajtat kohore e

³²⁰ Gramatika e gjuhës shqipe 1, Tiranë 1995

mënyrore si edhe në forma të pashtjelluara p.sh.: *Akoma nuk paska farmakosur? (FGJSSH) Anangasu për të ngrënë se vate vonë. (DSH II) Gremisu që këtej! (FGJSSH).Ta hajdheps një çikë se ishtë djalë i vetëm. (DSH II) Të hoçça në dhe. (DSH II). Lipsu që këtej!shokët u detyruan t'i jepnin një këshillë miqësore për të mirën e tij, duke e kopanisur e duke ia zbutur kurrizin, e më në fund e hipën në një tren dhe e porositën që ta lërë bosh përgjithmonë atë vend që zinte zakonisht në shtëpinë e pushimit. (Gazeta "Shekulli", 13/05/2009)*

Si përfundim mund të themi se foljet e huazuara nga greqishtja janë përshtatur në sistemin gjuhësor të shqipes si në sistemin fonetik ashtu edhe në atë morfologjik duke adaptuar rregullat dhe normat e tyre. Janë folje që përdoren kryesisht në ligjërimin bisedimor, por hasen edhe në atë letrar dhe publicistik. Marrin ngjyrimet e ndryshme kuptimore e stilistike, që disa herë janë të ndryshme nga gjuha e prejardhjes.

VI. PËRFUNDIME

1. Gjuha shqipe dhe gjuha greke kanë një sistem foljor me larmi formash gramatikore i cili ka evoluar nga ai i gjuhës indoevropiane duke ruajtur në disa raste karakteristika të tij, e në raste të tjera ka pasur një zhvillim të mëvetësishëm në secilën gjuhë. Në to hasen disa tipare të përbashkëta të cilat rrjedhin nga burimi i përbashkët indoevropian si supletivizmi dhe forma e aoristit sigmatik.
2. Tipare të përbashkëta të sistemeve foljore të të dyja gjuhëve janë a) zgjedhimi vepror dhe zgjedhim jovepror, të cilat formohen nëpërmjet mbaresash vetore – kohore dhe mjetesh të tjera si foljet ndihmëse *kam* e *jam*, b) kategoria e diatezës ku në të dyja gjuhët dallohen katër diateza, në shqip diateza vepror, diateza pësore, diateza vetvetore dhe diateza mesore dhe në greqisht vepror, pësore, mesore dhe asnjësore, të cilat dallojnë nga kriteri i përdorur për grupimin e foljeve në diateza në secilën gjuhë, c) kategoria e mënyrës ku në gjuhën shqipe dallohen gjashtë mënyra të foljes: dëftorja, habitorja, lidhorja, kushtorja, dëshirorja dhe urdhëdhorja, ndërsa në gjuhën greke dallohen tri mënyra vetore: dëftore, lidhore dhe urdhërore dhe dy pavetore ku përfshihen pjesorja dhe paskajorja d) kategoria e vetës ku si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën greke kemi folje pavetore, ose njëvetore.
3. Në gjuhën shqipe aspekti i foljes nuk trajtohet si kategori e mirëfilltë gramatikore, vetëm disa forma foljore sistemit foljor të shqipes dallohen ndërmjet tyre për nga ngjyrimet aspektore, në gjuhën greke aspekti zë një vend mjaft të rëndësishëm. Kundërvënja kryesore është aspekti perfektiv – imperfektiv, por ekziston edhe aspekti i kryer (perfekti).
4. Mjetet gjuhësore që përdoren për të ndërtuar format sintetike të shqipes dhe të greqishtes janë a) temat foljore, ku në gjuhën shqipe shumica e foljeve i ndërtojnë të gjitha format gramatikore me një temë të vetme, temën e kohës së tashme, por ka edhe folje të cilat gjatë paradigmës së tyre paraqiten me dy tema, tri tema, apo edhe me katër tema të ndryshme, ndërsa në gjuhën greke tri janë temat të cilat shërbejnë për të formuar trajtat që merr folja gjatë paradigmës së saj, tema e së tashmes aktive, tema e aoristit aktiv dhe tema e aoristit pasiv, b) mbaresat vetore ku si ato të shqipes ashtu edhe të greqishtes janë të shumëkuptimshme dhe për kohët analitike mbaresat vetore i marrin foljet ndihmëse ndërsa pjesorja e shqipes dhe paskajorja e greqishtes së re mbeten të pandryshuara gjatë zgjedhimit, c) prapashtesat trajtëformuese nëpërmjet të cilave zgjerohet tema e disa foljeve gjatë paradigmës së tyre dhe d) bashkëtingëlloret kundër hiatit, tinguj bashkëtingëllore të cilët shtohen në forma të ndryshme të sistemit foljor midis temës foljore e cila mbaron në zanore dhe mbaresës vetore e cila nis përsëri me zanore për të prishur hiatin e krijuar nga takimi i këtyre dy zanoreve të cilat nuk formojnë diftong, e) augmenti ϵ -, i trashëguar që nga greqishtja antike, i cili përdoret vetëm në gjuhën greke për ndërtimin e formave sintetike dhe kur gjendet në trup të foljes quhet augment i brendshëm, ndërsa kur ndërrohet zanorja fillestare me η -, augmenti quhet augment kohor.

5. Për ndërtimin e formave analitike si në gjuhën greke ashtu edhe në shqip përdoren foljet ndihmëse *jam* dhe *kam* dhe pjesëzat trajtëformuese. Foljet *kam* dhe *jam* si folje të mëvetësishme në gjuhën shqipe mund t'i formojnë të gjitha trajtat kohore si ato sintetike edhe ato analitike, në ndryshim nga gjuha greke ku këto dy folje mund të formojnë vetëm të tashmen dhe të pakryerën e dëftores. Pjesëzat trajtëformuese të njëjta si për gjuhën shqipe edhe për gjuhën greke janë: pjesëza *do-θα*, e cila në të dyja gjuhët ka origjinë foljore dhe përdoret për formimin e kohëve të së ardhmes, por në shqip edhe për të formuar kohët e mënyrës kushtore, pjesëza *të - va*, e cila ka origjinë lidhëzore dhe përdoret si tregues i kohëve të mënyrës lidhore në të dyja gjuhët. Në gjuhën shqipe kemi gjithashtu edhe pjesëzën *u*, e cila përdoret për të formuar disa nga trajtat foljore të diatezës joveprore dhe pjesëzat *për, me, pa* dhe *duke*, të cilat përdoren për formimin e trajtave të pashtjelluara të foljes, ndërsa në greqisht kemi dhe pjesëzën *ας (le të)*, e cila përdoret në greqishten e re për të formuar kohët e mënyrës lidhore.
6. Për të dyja gjuhët mënyra dëftore është mënyra më e pasur në forma kohore. Në gjuhën shqipe kjo mënyrë ka dhjetë trajta kohore ndërsa në gjuhën greke tetë. Shumica e këtyre kohëve janë të njëjta në të dyja gjuhët si e tashmja, e pakryera, e kryera e thjeshtë (aotisti), e kryera, më se e kryera, e ardhmja, e ardhmja e përparme, në shqip hasim edhe të ardhmen e së shkuarës, formim i cili trajtohet si modalitet në greqisht, dhe të kryerën e tejshkuar, ndërsa në gjuhën greke, hasim dy forma të së ardhmes, të ardhmen e thjeshtë dhe të ardhmen e vazhduar, me ndryshime aspektore ndërmjet tyre, të cilat i përgjigjen të dyja së ardhmes së shqipes.
7. Koha e tashme e dëftores ka pothuajse të njëjtat përdorime në të dyja gjuhët, ajo karakterizohet nga aspekti i pakryer (imperfektiv) dhe tema e saj përdoret në gjuhën greke për të formuar kohët që karakterizohen nga aspekti i pakryer. Folja në kohën e tashme të shqipes mund të përdoret edhe me pjesëzën aktualizuese *po*, ndërsa në gjuhën greke nuk ekziston një pjesëz e tillë dhe në shumicën e rasteve kjo formë e së tashmes së shqipes jepet thjesht me të tashmen e greqishtes e pashoqëruar nga ndonjë mjet tjetër gjuhësor, por hasim edhe raste kur shprehet me aoristin e shoqëruar me ndajfoljen kohore *ende*.
8. Koha e pakryer e dëftores në gjuhën greke formohet nga tema e kohës së tashme të foljes, ndërsa në gjuhën shqipe jo të gjitha foljet e formojnë të pakryerën nga tema foljore e së tashmes, foljet të cilat pësojnë shndërrime tingullore në vetën e dytë shumës i ruajnë ato edhe në kohën e pakryer, në të gjitha format vetore. Në gjuhën greke në përbërje të strukturës së foljes në këtë kohë është edhe augmenti, i cili përdoret për të formuar të pakryerën foljeve që fillojnë me bashkëtingëllore dhe në të pakryerën paraqiten me më pak se tri rrokje. Për të përkthyer foljet në këtë kohë nga shqipja në greqisht dhe anasjelltas, përdoret e pakryera, por mund të përdoret përkatësisht edhe e tashmja e lidhore së greqishtes apo më se e kryera e shqipes. Kur e pakryera e greqishtes shoqërohet me pjesëza (*θα, va*) atëherë ajo përdoret për të shprehur zakonisht modalitete. Kur e pakryera e greqishtes shoqërohet me pjesëzën *θα (të)*, atëherë e pakryera nuk përdoret me kuptim kohor

- por me kuptim modal dhe si nga ana strukturore edhe nga ana semasiologjike i përgjigjet së pakryerës së lidhore së shqipes.
9. Aoristi i dëftores në gjuhën greke, në varësi të temës, ndahet në sigmatik dhe në jo-sigmatik. Gjurmë të aoristit sigmatik hasim edhe te disa folje të gjuhës shqipe. E kryera e thjeshtë, përkatësisht aoristi mund të përdoret edhe me kuptim mbarëkohor, apo me kuptimin e së ardhmes apo të së kryerës. Foljet në këtë kohë përkthehen nga shqipja në greqisht dhe anasjelltas zakonisht nëpërmjet kohës së kryer të thjeshtë (aoristit), por edhe me kohë të tjera si: e pakryera e greqishtes, lidhorja e thjeshtë, apo aoristi i lidhore së greqishtes, e kryera apo e kryera e tejshkuar e shqipes etj. Në greqisht aoristi përdoret edhe i paraprirë nga pjesëza *θα* dhe nga pjesëza *va* e në të dyja rastet trajtohet si modalitet. Struktura foljore analoge nuk hasen në gjuhën shqipe, por kuptimi i tyre shprehet përkatësisht me të ardhmen e përparme të mënyrës dëftore she me të kryerën, ose më se e kryera e lidhore.
10. Kohët analitike të formës veprare, përveç së ardhmes, në gjuhën greke formohen nëpërmjet foljes ndihmëse *kam + trajtën paskajore të formës veprare*, ose me foljen ndihmëse *kam + kallëzoren e pjesores pësore të së kryerës*. Struktura e parë është edhe ajo që ka përdorimin më të gjerë. Ndërsa në gjuhën shqipe kjo kohë formohet nëpërmjet foljes ndihmëse *kam + pjesoren*. Për sa i përket formës joveprare kohët e përbëra në greqisht formohen me foljen ndihmëse *kam + trajtën paskajore të formës joveprare*, ose me foljen ndihmëse *jam + emëroren e pjesores pësore ose mesore të së kryerës*. Në gjuhën shqipe kohët e përbëra të formës joveprare formohen me foljen ndihmëse *jam + pjesoren*.
11. E kryera e dëftores së shqipes formohet nga e tashmja e foljes ndihmëse *kam*, për formën veprare, dhe *jam*, për formën joveprare plus pjesoren e foljes, ndërsa në gjuhën greke e kryera formohet ngafolja *kam + paskajore*, ku për formën veprare paskajorja formohet nga tema foljore e aoristit aktiv + sufiksin *-ει*, ndërsa për formën joveprare nga tema foljore e aoristit pasiv + sufiksin *-ει*. Ekziston edhe një formë tjetër alternative e së kryerës ku në vend të trajtës paskajore përdoret kallëzorja e njëjësit të gjinisë asnjënjëse e pjesores pasive të greqishtes së re. Këto dy forma nuk janë semasiologjikisht të barazvlefshme. Rendi i dy përbërësve të kësaj kohe në gjuhën shqipe është i ngulitur dhe ndërmjet tyre nuk mund të ndërfiten elementë të tjerë, ndërsa në strukturën e kohës më se të kryer të greqishtes ndërmjet foljes ndihmëse dhe paskajores së greqishtes së re të foljes mund të ndërfiten elementë të tjerë gjuhësorë. Gjuha shqipe, ashtu si edhe greqishtja, por edhe gjuhë të tjera indoevropiane në një fazë më të hershme e kanë shprehur kuptimin e së kryerës me anë formash sintetike. E kryera analitike e formës veprare të shqipes në gjuhën greke jepet në mjaft raste me analogen e saj, pra me të kryerën e greqishtes, por mund të jepet gjithashtu me aoristin e greqishtes.
12. Më se e kryera e dëftores së shqipes formohet prej së pakryerës së foljes ndihmëse *kam, kisha + pjesore*. Për gjuhën greke më se e kryera fillimisht ka qenë kohë

sintetike, ndërsa në greqishten e re formohet nga folja *kisha* + *paskajore*. Ajo mund të formohet edhe në një mënyrë alternative, e cila nuk është aq e përdorur sa forma parësore. Për formën veprorë kjo strukturë alternative është e *pakryera e foljes kam* (*είχα*) + *pjesoren pasive të së kryerës* (*είχα διαβασμένο*), ndërsa për formën joveprorë: *e pakryera e foljes jam* (*ήμουν*) + *pjesoren pasive të së kryerës* (*ήμουν διαβασμένος*). Në shumicën e rasteve koha më se e kryer e shqipes jepet me më se të kryerën e greqishtes. Më se e kryera e greqishtes në të shumtën e rasteve jepet në gjuhën shqipe nëpërmjet më se të kryerës së shqipes. Ka raste kur më se kryera e greqishtes jepet me të kryerën e tejkshuar të shqipes, ose me të kryerën e thjeshtë të shqipes.

13. E kryera e tejkshuar e dëftores në gjuhën shqipe formohet nga e kryera e thjeshtë e foljes *kam/jam, pata/qeshë* + *pjesoren*. Kjo trajtë kohore nuk ekziston në gjuhën greke, ndaj kur lind nevoja për ta dhënë këtë kohë të shqipes në greqisht, atëherë mund të përdoret më se e kryera, ose kohë sintetike të së shkuarës së greqishtes si aoristi apo e pakryera. Ka raste kur e kryera e tejkshuar e mënyrës joveprorë të shqipes në greqisht jepet me foljen ndihmëse *jam* në të pakryerën (*ήμουν*) + *pjesoren pasive*, një formë alternative të më se të kryerës.
14. E ardhmja e shqipes dhe e greqishtes kanë tipar të përbashkët për sa i përket strukturës formimit të tyre nëpërmjet foljes volitive *dua* (*θέλω*). Në gjuhën shqipe kuptimi kohor i së ardhmes shprehet nëpërmjet dy tipave formash analitike: nga pjesëza foljore *do* dhe nga e tashmja e lidhore e pajisur ose jo me pjesëzën *të*. nga folja *kam* + *paskajoren* (e tipit *me lexu* dhe *për të lexuar*) dhe *kam* + *të tashmen e lidhore*. Në gjuhën e lashtë greke koha e ardhme formohej në mënyrë sintetike. Në greqishten e re si edhe në shqip e ardhmja formohet nga pjesëza *θα* + *folja në lidhore*. Edhe në gjuhën greke përdoret struktura *kam* + *lidhore* si barasvlerës i së ardhmes, strukturë që është evolim i strukturës *έχω* (*kam*) + *paskajore*. Në gjuhën greke kemi dy të ardhme, me ndryshime aspektore midis tyre, të ardhmen e vazhduar ku folja ka temën e kohës së tashme dhe tregon vazhdimësi veprimi *θα διαβάζω*, dhe të ardhmen e thjeshtë ku folja ka temën e aoristit dhe veprimi kryhet në një çast të vetëm *θα διαβάσω* - *do të lexoj*. Në shumicën e rasteve foljet në të ardhmen e shqipes, si në formën veprorë edhe në joveprorë, jepen në greqisht me të ardhmen e thjeshtë, po edhe me të ardhmen e vazhduar. Në rastet kur folja shoqërohet nga rrethana e kohe që tregojnë vazhdimësi apo përsëritje të veprimit atëherë në greqisht përdoret e ardhmja e vazhduar. E ardhmja e greqishtes si e thjeshta ashtu edhe e vazhduara nuk paraqesin ndonjë vështirësi për t'u përcjellë në gjuhën shqipe, pasi që të dyja jepen me të ardhmen e shqipes pavarësisht aspektit.
15. Në gjuhën shqipe e ardhmja e përparme formohet me strukturën *do të* + *folje ndihmëse* + *pjesore*. Kjo kohë për nga emërtimi bën pjesë në kohët e së ardhmes, por përdoret më shumë për të shprehur veprime të mundshme të së shkuarës. Në greqishten e re e ardhmja e përparme ndërtohet nëpërmjet pjesëzës *θα* dhe kohës së kryer të foljes themelore dhe tregon se veprimi do të jetë kryer në të ardhmen, d.m.th. do të jetë i përfunduar në një çast të së ardhmes që ka në mendje folësi.

- Kjo kohë përveç analoges së saj mund të përcillet nga shqipja në greqisht edhe me strukturën *do të (θα) + të pakryerën* ose *do të (θα) +jam(είμαι)+pjesore pasive*, ndërsa e ardhmja e përparme e greqishtes jepet në gjuhën shqipe përmes kohës analoge me të, pra të ardhmes së përparme.
16. Në gjuhën shqipe hasim si kohë edhe të ardhmen e së shkuarës dhe të ardhmen e përparme të së shkuarës, të cilat nuk i gjejmë në gjuhën greke. E ardhmja e së shkuarës formohet duke u paravendosur formave vetore të kohës së pakryer të mënyrës lidhore të foljes pjesëzën *do*. E ardhmja e përparme e së shkuarës formohet me *të ardhmen e së shkuarës së foljes ndihmëse kam+pjesore*. Përkthimi në greqisht i kësaj kohe është bërë duke përdorur strukturat *θα + më se të kryerën* ose *θα +të pakryerën*.
17. Mënyra lidhore në gjuhën shqipe shpreh kryesisht modalitetin e mundësisë, por ka raste kur ajo mund të shprehë edhe modalitetin e dëshirës apo të detyrimit. Të gjitha format kohore të mënyrës lidhore të gjuhës shqipe kanë të paravendosur pjesëzën *të*, ashtu si edhe ato të greqishtes pjesëzën *va (ας)*, por në greqisht ka edhe raste kur folja në lidhore përdoret vetëm pa iu paravendosur kjo pjesëz. Mënyra lidhore e gjuhës shqipe ka dy kohë: *të tashmen* dhe *të shkuarën*, ku e shkuara ka tri nënndarje, *të pakryerën*, *të kryerën* dhe *më se të kryerën*. Kohët gramatikore të mënyrës lidhore të greqishtes janë: *e tashmja* ose lidhorja e vazhduar, *aoristi*, ose lidhorja e thjeshtë dhe *e kryera*. E tashmja dhe aoristi i lidhores, ndryshe nga shqipja kanë vetëm dallime aspektore midis tyre.
18. Si për gjuhën greke ashtu edhe për shqipen tema foljore e kohës së tashme të lidhores për të gjitha foljet, përveç foljeve *kam* dhe *jam* në shqip, është e njëjtë me temën e së tashmes së dëftores. Kësaj teme i paravendoset pjesëza *të/ va*. E tashmja e lidhores si në shqip edhe në greqisht mund të përdoret edhe me vlerën e mënyrës urdhërore, me vlerën e dëshirores.
19. Si në shqip edhe në greqisht koha kryer e lidhores ndërtohet duke i paravendosur përkatësisht pjesores dhe formës paskajore së foljes format vetore të lidhores të së tashmes së foljes ndihmëse *kam*. E kryera e lidhores së shqipes mund të jepet me të kryerën e dëftores së greqishtes, me të pakryerën e foljes *είμαι (jam)* të prirë nga pjesëza *va.*, me të kryerën e lidhores së greqishtes.
20. Aoristi i lidhores së greqishtes, kohë që nuk haset në gjuhën shqipe, përdoret pothuajse gjithmonë duke i paravendosur një apo më shumë tregues të lidhjes me nënrenditje, por mund të hasen edhe raste në të cilat të mos paravendosen këta tregues si në rastin e disa strukturave sintaksore të përbëra nga çifte fjalish me kuptim të kundërt ku shprehet indiferentizmi për atë ç'ka do të ndodhë. Në shqip aoristi i lidhores mund të jepet me të tashmen e lidhores së shqipes, me të pakryerën e lidhores së shqipes, me përcjelloren e shqipes apo me të tashmen e dëftores.

21. E pakryera dhe më se e kryera e lidhore janë forma kohore të cilat i hasim vetëm në gjuhën shqipe. Kur folja e fjalisë kryesore është në të pakryerën e lidhore, në gjuhën greke ajo jepet me aoristin e lidhore. Kur e pakryera e lidhore shërben si folje e fjalisë kryesore, në gjuhën greke ajo jepet nëpërmjet së pakryerës së dëftores paraprirë nga pjesëza *va*. Për të përkthyer të pakryerën e lidhore me këtë funksion në greqisht përdoret e pakryera e dëftores prirë nga lidhëza kushtore. Më se e kryera e lidhore formohet me foljen ndihmëse *kam* në të pakryerën e lidhore dhe pjesoren e foljes. Në greqisht kjo kohë në këto raste jepet me anë të më se të kryerës së dëftores, nëpërmjet të pakryerës së dëftores paraprirë nga pjesëza *va*, apo nëpërmjet më se të kryerës së dëftores, paraprirë përkatësisht nga pjesëzat *va* dhe *av*.
22. Ndërtimi *kam + lidhore*, në gjuhën greke ka një përdorim mjaft të gjerë ndërsa përdorimi i tij në gjuhën shqipe si formë e së ardhmes është zbehur. Me këtë kuptim në vend të saj përdoret forma *kam* + formën paskajore, e cila ka gjithashtu edhe kuptimin e domosdoshmërisë apo sigurisë sipas rastit. Këtë strukturë në të dyja gjuhët mund ta hasim a) në formën *kam + folje në lidhore*, në formën e një strukture të lirë, brenda së cilës mund të vendoset një gjymtyrë tjetër dhe b) në formën e një strukture të ngurtësuar. Mund të themi se në të dyja gjuhët kemi të bëjmë me një sintagmë e cila po shkon drejt gramatikalizimit duke qenë se elementët e saj e kanë humbur pavarësinë kuptimore në një masë të madhe apo të vogël.
23. Si në gjuhën shqipe edhe në atë greke mënyra urdhërore përdoret për të shprehur modalitetin e dëshirës në formë urdhri, kërkese, këshille, porosie, lutjeje, grishjeje, lejimi etj. Me vlerën e mënyrës urdhërore përdoren edhe trajtat e lidhore, jo vetëm për vetat të cilat nuk mund të formohen në urdhërore, veta e parë dhe veta e tretë, por edhe për vetat për të cilat urdhërorja ka trajtat e veta foljore. Me vlerën e urdhërores mund të përdoret në disa raste në gjuhën shqipe edhe e ardhmja e dëftores, ndërsa në gjuhën greke veta e parë shumë e së tashmes së dëftores.
24. Në trajtat e mënyrës urdhërore nuk krijohet në gjuhën shqipe një kundërvënie kohore, pra nuk mund të flasim në këtë mënyrë për kategorinë gramatikore të kohës, por këto trajta i referohen kryesisht të ardhmes, ndërsa në gjuhën greke mënyra urdhërore ka dy kohë të tashmen dhe aoristin, por me ndryshime aspektore ndërmjet tyre dhe jo ndryshime në lidhje me momentin e veprimit.
25. Mënyra urdhërore e shqipes, si edhe ajo e greqishtes së re, ka forma gramatikore vetëm për vetën e dytë njëjës dhe shumë. Në disa raste në shqip trajta e shkurtër mund t'i bashkëngjitet formës së urdhërores, kurse në gjuhën greke kjo nuk mund të ndodhë. Mohimi në urdhërore në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën greke kryhet nëpërmjet pjesëzës mohuese *mos* (*μην*).
26. Habitorja e shqipes për nga tipi i ndërtimit është unike dhe nuk haset në asnjë gjuhë tjetër indoevropiane. Trajatat e habitores janë formuar nga pjesorja e

- shkurtuar dhe folja ndihmëse *kam*, argumentim ky i cili është mbështetur nga shumica e gjuhëtarëve. Mënyra habitore ka dy kohë kryesore, të tashmen dhe të shkuarën, ku e shkuara ka tri nëndarje, të pakryerën, të kryerën dhe më se të kryerën. Mund të hasen gjithashtu edhe forma të mbipërbëra të së kryerës (*paskam pasë larë*) dhe të së ardhmes (*do të lakam*). Trajta e kohës e tashme e habitores, e cila formohet nga prapavendosja e së tashmes së foljes *kam* te pjesorja e shkurtuar e foljes, është një nga kohët me përdorim më të shpeshtë të habitores. Ajo jepet në të shumtën e rasteve me të tashmen e dëftores së greqishtes, madje nuk shoqërohet as nga ndonjë mjet tjetër gjuhësor, i cili të tregojë modalitetin e habitores së shqipes. Trajta e kohës së pakryer jepet në greqisht kryesisht me të pakryerën e dëftores së greqishtes. E kryera e habitores është një nga format kohore që përdoret më shumë. Për të dhënë në gjuhën greke format foljore të saj mund të përdoren trajta të ndryshme kohore, kryesisht të dëftores si aoristi i dëftores, por ndonjëherë edhe e pakryera e dëftores paraprirë nga pjesëza *va*. Koha më se e kryer e habitores formohet nga e pakryera e habitores së foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam* dhe pjesores së foljes. Për të përkthyer format foljore të kësaj kohe në gjuhën greke përdoren kryesisht forma kohore të dëftores, si aoristi, e pakryera e dëftores apo më se e kryera e dëftores.
27. Edhe pse në gjuhën greke habitortja nuk ekziston, gjatë përkthimit të letërsisë artistike hasen mjaft raste të përkthimit të formave foljore të greqishtes me habitoren e shqipes. Kryesisht përdoret e tashmja e habitores, por hasen edhe kohët e tjera të saj. Format e habitores së shqipes përdoren për të përkthyer kryesisht forma foljore të dëftores së greqishtes, por ka edhe raste kur ato shërbejnë për të dhënë forma foljore të lidhores, apo për të përkthyer edhe pjesë të tjera ligjërata veç foljes.
28. Mënyra kushtore e shqipes shpreh modalitetin e mundësisë dhe ka dy kohë: të tashmen dhe të kryerën. Format gramatikore të kohës së tashme të kushtores janë të njëjta me ato të së ardhmes të së shkuarës së dëftores, ato dallohen vetëm nga modaliteti që shpreh folja gjatë përdorimit në ligjërime. Ndërsa në gjuhën greke kushtortja nuk trajtohet si mënyrë foljore e mirëfilltë me trajta të posaçme. Në rastet kur përkthehet e tashmja e kushtores nga gjuha shqipe në gjuhën greke përdoret struktura $\theta\alpha$ + të pakryerën e dëftores, ndërsa për përkthimin e foljeve në të kryerën e kushtores së shqipes, në greqisht përdoret më se e kryera e dëftores paraprirë nga pjesëza $\theta\alpha$, por mund të përdoret edhe më se e kryera e dëftores paraprirë nga pjesëza e lidhores *va*. Gjatë përkthimit të trajtave foljore $\theta\alpha$ + të pakryerën e dëftores dhe $\theta\alpha$ + më se të kryerën e dëftores të greqishtes përdoret kushtortja e shqipes, përkatësisht e tashmja dhe më se e kryera e saj.
29. Gjuha shqipe është një nga gjuhët në të cilat trajtat e dëshirores janë pjesë e sistemit të sotëm foljor, ndërsa në gjuhën e re greke dëshirortja është mënjanuar nga përdorimi. Në gjuhën shqipe ajo ka dy kohë, të tashmen dhe të kryerën. Ato përdoren kryesisht në fjali të pavarura, por mund të përdoren edhe në fjali të nënrenditura kushtore e lejore të paraprirë nga lidhëzat nënrenditëse, *në*, *edhe në* dhe shprehin kuptimin modal të mundshmërisë. Për të përkthyer format dëshirores

- së shqipes në shumicën e rasteve përdoret lidhorja, por edhe urdhërorja dhe dëftorja. Mohorja e dëshirores formohet me pjesëzën mohuese *mos*, dhe në gjuhën greke ajo jepet nëpërmjet mohores së lidhore formuar përsëri nga pjesëza mohuese *μην* (*mos*). Modaliteti i dëshirores në greqisht mund të shprehet nëpërmjet lidhore dhe urdhërores të cilat në të shumtën e rasteve mund të përkthehen me dëshiroren e shqipes.
30. Pjesorja e gjuhës shqipe dhe ajo e gjuhës greke janë forma sintetike foljore e cila ka tipare gramatikore edhe të foljes, edhe të emrit edhe të mbiemrit. Ndërsa në gjuhën e sotme shqipe termi pjesore përcakton vetëm një strukturë, në greqishten e re përcakton tri struktura gramatikore: struktura foljore me formantin *-οντας* (*-ώντας*), struktura foljore me formantin *-ούμενος* ose *-όμενος*, dhe struktura foljore me formantin *-μένος*. Për sa i përket anës strukturore si pjesorja e shqipes ashtu edhe ajo e greqishtes formohen nga tema e foljes, e cila mund të jetë në kohën e tashme ose në të kryerën e thjeshtë (aoristin për greqishten) dhe nga prapashtesa. Nga prapashtesat që shërbejnë për të formuar pjesoren në të dyja gjuhët është e përbashkët prapashtesa indoevropiane **-meno-/mo-*, tek cila e ka burimin prapashtesa *-m* e shqipes, dhe prapashtesa *-μένος* e pjesores pasive të greqishtes së re.
31. Pjesorja e shqipes në greqishten e re jepet me formën e paskajores së greqishtes së re e cila nuk ka funksionet e një paskajoreje të mirëfilltë. Mbiemrat prejpjesorë të gjuhës shqipe në gjuhën greke jepen në shumicën e rasteve me pjesoren pësore, por edhe me mbiemra ose me folje, fakt që tregon prejardhjen e tyre foljore. Emrat prejpjesorë asnjans të tipit *të ecurit*, *të lexuarit*, *të folurit*, *të shkruarit*, nga ana kuptimore janë të njëjtë me paskajoren e së tashmes aktive të greqishtes së vjetër, ndërsa në greqishten e re analogët e këtyre emrave janë emra prejfoljore, por jo të formuar nga tema e pjesores. Emrat prejpjesorë asnjans që hasen zakonisht në shprehje të ngurosura në gjuhën greke mund të jepen me emra (jo me prejardhje foljore), ose me folje.
32. Pjesorja e greqishtes që mbaron në *-οντας* (*-ώντας*) ka gjithmonë funksion ndajfoljor dhe në gjuhën shqipe jepet zakonisht me formën e pashtjelluar përcjellore. Pjesorja e greqishtes së re që mbaron në *-ούμενος*, *-όμενος* ose *-όμενος* në gjuhën shqipe mund të jepet me mbiemër prejpjesor, por hasen edhe raste kur nuk mund të jepet veçse me përcjellore. Pjesorja e së kryerës pasive të greqishtes që mbaron në *-μένος* dhe mbart karakteristika emërore, përkatësisht mbiemërore (gjini, rasë) dhe karakteristika foljore (aspekti, koha, forma, diateza) në shumicën e rasteve ka funksion analog me atë të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe. Pjesoret e së tashmes aktive të greqishtes së vjetër që mbarojnë me *-ων*, *-ούσα*, *-ον*, pjesoret e aoristit pasiv të greqishtes së vjetër që mbarojnë me *εις*, *-εισα*, *-εν* dhe pjesoret e aoristit aktiv të greqishtes së vjetër që mbarojnë me *-ας*, *-ασα*, *-αν* që përdoren kryesisht në ligjërimin libror (publicistik) apo në shprehje të ngurtësuar nga greqishtja e vjetër jepen në gjuhën shqipe me një trajtë të pashtjelluar, me një fjali ose nëpërmjet mbiemrave prejpjesorë (të ose jo të emëruar).

33. Në gjuhën shqipe si trajta të paskajores pranohen trajta *me ba*, e cila përdoret kryesisht në dialektin geg me funksione karakteristike për paskajoren, dhe për përkthimin e saj në greqisht përdoret lidhorja, dhe trajta *për të bërë*, e cila është krijuar relativisht më vonë, ndeshet në të gjitha të folmet e shqipes dhe nuk përdoret në të gjitha funksionet e paskajores. Ajo përkthehet në gjuhën greke nëpërmjet lidhores, e cila mund të paraprihet nga lidhëza qëllimore *για (va)* në rastet kur kjo trajtë paskajore përdoret në funksion qëllimor. Në rastet kur kjo trajtë paskajore e shqipes përdoret për të formuar tipin e dytë të së ardhmes, pra paraprihet nga folja *kam*, në gjuhën greke jepet me trajtën *kam* + lidhore.
34. Paskajorja e greqishtes së re, e cila nuk ka funksionet e një paskajoreje të mirëfilltë, në gramatikën tradicionale trajtohet si një prej mënyrave foljore pavetore dhe funksioni i saj është të formojë kohët analitike paraprirë nga folja ndihmëse *έχω (kam)*. Në greqishten e vjetër paskajorja është njëra nga tri trajtat emërore të foljes. Ajo ishte një emër foljor, por kishte kategorinë gramatikore të kohës dhe diatezës dhe me evolimin e greqishtes gradualisht kjo trajtë paskajore u mënjanua duke u zëvendësuar me trajta të tjera foljore, kryesisht me lidhore. Disa paskajore në formë të ngurtësuar përdoren edhe në greqishten e sotme.
35. Përcjellorja është një nga trajtat e pashtjelluara të shqipes. Kur folja vendoset në këtë trajtë shpreh një veprim që shoqëron veprimin e foljes drejtuese me të cilin kryhet zakonisht në të njëjtën kohë. Trajta e përcjellores përdoret edhe për të formuar trajtat dytësore të së tashmes dhe të pakryerës, përkatësisht *jam duke bërë* dhe *isha duke bërë*. Një strukturë e tillë foljore nuk ekziston në gjuhën greke, dhe në rastin e përkthimit të kësaj trajte në gjuhën greke mund të përdoret e pjesorja aktive e foljes ose e pakryera.
36. Kur folja vendoset në formën e pashtjelluar të tipit *pa larë* shpreh moskryerjen e një veprimi kryesisht në të shkuarën ose në të ardhmen. Kuptimi kohor i kësaj forme është i kushtëzuar nga kuptimi i foljes drejtuese, por ajo mund të vendoset në kundërvënien veprorë – joveprorë. Një formë analoge për nga formimi nuk haset në gjuhën greke. Për të dhënë kuptimin e saj në gjuhën greke përdoret kryesisht lidhorja paraprirë nga parafjala *χωρίς (pa)*, apo nga ndajfolja kohore *πριν (para, përpara)* me kuptim parafjalor.
37. Forma e pashtjelluar e tipit *me të larë*, e cila përdoret vetëm në funksion kohor, emërton një veprim, që është kryer ose pritet të kryhet, menjëherë para veprimit të shprehur nga folja drejtuese. Duke qenë se në gjuhën greke nuk ekziston një trajtë analoge për sa i përket formimit, për të shprehur kuptimin e saj ashtu si edhe për formën e tipit *një të larë* në gjuhën greke mund të përdoret aoristi i dëftores paraprirë nga ndajfolja kohore *μόλις (sapo)*, apo struktura *με το που* + folje në aorist, strukturë e cila ka gjithmonë kuptim kohor.

BIBLIOGRAFIA

- AGALLIU, F. (1972) *Pjesorja në gjuhën shqipe*, SF, 2, Tiranë.
- (1968) *Vëzhgime mbi kuptimet e disa trajtave kohore*, SF 2, Tiranë.
 - (1982) *Mbi pjesëzën po në gjuhën shqipe*, SF 2, Tiranë.
 - (1972) *Rreth problemit të klasifikimi të foljeve në zgjedhime*, Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, Tiranë.
 - (1972) *Pjesorja në gjuhën shqipe (analizë e kategorive dhe funksioneve të saj)*, SF 2, Tiranë.
 - (1983) *Vëzhgime mbi formën gramatikore pa + pjesore*, SF 3, Tiranë.
- AGOURAKI, G., (1993). *Spec/Head licensing: The cases of Foci, Clitic Constructions and Polarity Items. A study in Modern Greek*, PhD thesis. University College London.
- AJETI, I. (1969) *Historia e gjuhës shqipe (Morfologjia historike)*. Prishtinë.
- AKADEMIA E SHKENCAVE TË SHQIPËRISË (1976) *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II*, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë.
- (1995) *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- ALEXIADOU, A. & E. ANAGNOSTOPOULOU (1999) *Non-active morphology and the direction of transitivity alternations*, North East Linguistic Society 29, 27-40.
- (2007) *On the morpho-syntactic composition of Greek adjectival participles*, Paper presented at the 8th International Conference on Greek Linguistics, Ioannina, 30 Aug-2 Sept 2007.
- ÁNAGNOSTOPOULOU, E. (2003) *Participles and voice*, In A. Alexiadou, M. Rathert and A. von Stechow (eds), *Perfect Explorations* Berlin: Mouton de Gruyter, 1-36.
- ΑΝΑΣΤΑΣΙΑΔΗ – ΣΥΜΕΩΝΙΔΗ, Α. (1996) *Ζητήματα Νεοελληνικής Γλώσσας*, 97 -120, Ρέθυμνο: Τομέας Γλωσσολογίας- Τμήμα Φιλολογίας – Πανεπιστήμιο Κρήτης.
- ΑΝΔΡΙΩΤΗΣ, Ν.Π. (1934) *Υπάρχει υποτακτική στη νέα ελληνική;*, NE 15, 445 – 50.
- (1995) *Ιστορία της ελληνικής γλώσσας (τέσσερις μελέτες)*, Θεσσαλονίκη.
- ASENOVA, P. (1996) *Habitorja e shqipes dhe mënyra e ritregimit e bullgarishtes*, Seminari i XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare.

- BAKKER W.F.(1970) *The aspectual differences between the present and aorist subjunctives in Modern Greek*, Ελληνικά 23, 78 – 108.
- BARIÇ, H. (1961) *La parte de l' infinitiv fans les langues balkaniques*, Godisnjak, II, Sarajevo.
- BARRI, N. (1981) *Aoristic present, "subjunctive" and converters in Modern Greek*, Studies presented to Hans Jakov Polotsky, 1-20.
- ΒΑΣΙΛΑΚΗ, Σ. (1989) *Η μορφολογία της παθητικής φωνής στα νέα ελληνικά*, Μελέτες για την ελληνική γλώσσα, Θεσσαλονίκη, 185 – 204.
- BECI, B. (1978) *Rreth tipareve karakteristike të dy dialekteve të shqipes*, SF 4.
- BOKSHI, B. (1998) *Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik)*, Prishtinë.
- BOYTYPAΣ, E.(2007) *Η εισαγωγή του αλφαβήτου*, Ιστορία της ελληνικής Γλώσσας, Ινστιτούτο Νεοελληνικών σπουδών, Πέμπτη ανατύπωση.
- BROWNING, R. (1991) *Η ελληνική γλώσσα μεσαιωνική και νέα*, μετάφρ. Μ. Κονόμη, Αθήνα.
- BUBENIK, V. (2007) *Η δημιουργία κοινής*, μετάφραση: Ε. Μπακαγιάννη, Ιστορία της ελληνικής Γλώσσας, Ινστιτούτο Νεοελληνικών σπουδών, Πέμπτη ανατύπωση.
- BUCHHOLZ, O., FIEDLER W. (1987) *Albanische Grammatik*, Leipzig.
- BURGIER, P. (1960) *Histoire de l'infinitif en grec*, Paris.
- BUXHELI, L. (1983) *Emrat prejfoljorë të paranyjëzuar me kuptimin e veprimit në gjuhën e sotme letrare shqipe*, SF 2.
- BYBEE, J. (1985) *Morphology: A study of the relation between meaning and form*, Amsterdam: Benjamins.
- CAMARDA, D. (1864) *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno.
- (1866) *Appendice al saggio di grammatologia sulla lingua Albanese*, Prato.
- CARSTAIRS, A. (1987) *Allomorphy in Inflection*, London, Croom Helm.
- CHANTRAINE, P. (1990) *Ιστορική μορφολογία της ελληνικής γλώσσας*, μετάφρ. Ν. Αγκαβανάκη, Αθήνα.

- CIPO, K. (1949) *Gramatika shqipe*, Tiranë.
- (1952) *Sintaksa*, Tiranë.
- CLARKSON, J. (2007) *Η διαμόρφωση της ελληνικής γλώσσας, μετάφραση: I.*
Βλαχόπουλος, Ιστορία της ελληνικής Γλώσσας, Ινστιτούτο Νεοελληνικών
σπουδών, Πέμπτη ανατύπωση.
- ÇABEJ, E. (1942) *Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe*, SF 2.
- (1989) *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe I (Fonetika historike e shqipes)*,
Ribotim.
- (1963) *Rreth disa problemeve të historisë së gjuhës shqipe*, Buletimi i
Universitetit shtetëror të Tiranës, Seria shkencat Shoqërore, 3.
- (1976) *Studime gjuhësore I-II*, Prishtinë.
- (1976 - 1996) *Studime etimologjike në fushë të shqipes I–IV*, Tiranë.
- ÇELIKU, M. (2006) *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*.
- (1984) *Karakterizimi i formave të pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme
shqipe (gjerundi)*, SF1, Tiranë.
- (2006) *Problemi i paskajores në shqipen standarde*, Çështje të shqipes
standarde, Tiranë.
- (1984) *Trajtat e përcjellores në gjuhën e sotme letrare shqipe*, S F2,
Tiranë.
- (1986) *Kuptimet dhe përdorimet sintaksore të përcjellores mohore në
gjuhën e sotme letrare shqipe (trajta e tipit “pa punuar”)*, SF 3.
- (1988) **Kam për të bërë dhe do të bëj**, Gjuha jonë 1.
- (1991) *Gerundi i rrethanës në gjuhën e sotme letrare shqipe*, SF 3-4.
- DA LECCE, Fr. M. (1716) *Observazioni grammaticali nella lingua albanese*, Romë.
- DECKER, Rodney J. (2007) *Koine Greek Reader: Selections from the New Testament,
the Septuagint, and early Christian writers*. Grand Rapids: Kregel
Publications.
- DEMIRAJ, Sh. (1976) *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Pjesa II, Tiranë.
- (2002) *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.
- (1972) *Rreth klasifikimit të foljeve në zgjedhime*, Çështje të fonetikës dhe
gramatikës së sotme, Tiranë.
- (1977) *Rreth kategorive gramatikore të mënyrës dhe të kohës në gjuhën
shqipe*, SF 3.
- (1986) *Gramatika Historike e Gjuhës Shqipe*, Tiranë.
- (2004) *Gjuhësi ballkanike*, Tiranë.
- (1970) *Rreth formave të së ardhmes në gjuhën shqipe*, SF 3, Tiranë.
- (1971) *Habitorja dhe mosha e saj*, SF 3, Tiranë .
- (1971) *Rreth zhdukjes së paskajores në gjuhën shqipe*, SF 1.
- (1988) *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë.
- DODI, A. (2004) *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë.

- (1968) *Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe*, SF 1.

DOMI, M. (1961) *Morfologjia historike e shqipes*, Konspekt leksionesh, Tiranë.

DOZON, A. (1879) *Manual de la langu e chkipe ou albanaise*, Paris.

DUHOUX Y. (2007) *Γραμμική Α*, μετάφραση: Ε. Τσελέντη – Α. Καραστάση, Ιστορία της ελληνικής Γλώσσας, Ινστιτούτο Νεοελληνικών σπουδών, Πέμπτη ανατύπωση.

DHRIMO, A. (1965) *Një vështrim mbi foljet me më shumë se një reksion në shqipen e sotme letrare*, SF 2.

- (1986) *Paralelizma kuptimorë ndërmjet trajtave foljore me po (po punoj) dhe ja (jam duke punuar)*, Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit, Tiranë.

EBBESEN, S. (1979) «*Contact verbs*» in *modern Greek*, Ελληνικά 31, 65 – 107.

EFSTASIADIS, S. (1974) *Tense and aspect in Greek and English*, ΕΕΦΣΠΘ 13, 37-71.

FARKAS, D. F. (1985) *Intensional Descriptions and the Romance subjunctive mood*, Garland.

FIEDLER, W. (1975) *Zhvillimi i infinitivit gegë nga aspekti i ballkanologjisë*, Gjurmime albanologjike.

FORTSON IV, BENJAMIN W. (2009) *Indo-European language and kulture*, 2nd ed. Oxford:Blackwell Publishing

FRASHËRI, S. (1886) *Shkronjëto e gjuhësë shqip*, Bukuresht

FRIEDMAN, V. (1995) *Mënyra habitore në gjuhën shqipe dhe gjuhën arumune – paralele dhe ndikime*, Seminari i XVII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare.

- (1996) *Habitorja e shqipes dhe “prezumtivul” e rumanishtes*, Seminari i XVIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare.
- (2003). *Evidentiality in the Balkans with special attention to Macedonian and Albanian*. In Alexandra Aikhenvald & R. M. W. Dixon (eds.), *Studies in evidentiality*, 189–218. Amsterdam: John Benjamins Publishing Co.

GALANI, A. (2005) *The Morphosyntax of Verbs in Modern Greek*, Ph.D Thesis, University of York.

GIORGI, A. & F. PIANESI (1998) *Tense and Aspect: from Semantics to Morphosyntax*, Oxford University Press.

- GOODWIN, W. W. 1875. *Syntax of the moods and tenses of the Greek verb*. New York: St Martin's Press.
- HAHN, G. (1853) *Albanesische studien*, Vjen.
- HAMP, E. (1961) *To rήμα εν τη σημερινή ομιλούμενη Ελληνική Γλώσσα*, Αθηνά 65, 101-128, Αθήνα.
(1980) *Albanian është*. In Kathryn Klar, Margaret Langdon & Shirley Silver (eds.), *American Indian and Indoeuropean studies: Papers in honor of Madison S.*
- HAXHIHASANI, Q.(1974) *Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e Çamërisë*, DSH 2, Tiranë.
- HOLTON, D. – MACKRIDGE, P. – WARBURTON – ΦΙΛΙΠΠΑΚΗ, ΕΙΡ. (1999) *Γραμματική της ελληνικής γλώσσας, μετάφρ. Β. Σπυρόπουλος*, Αθήνα.
- HYSA, E. (1975) *Rreth përdorimit të së pakryerës së dëftores në gjuhën shqipe*, SF 3.
- ΙΑΚΩΒΟΥ, Μ. (1999) *Τροπικές κατηγορίες στο ρηματικό σύστημα της Νέας Ελληνικής*, Διδακτορική διατριβή, Πανεπιστήμιο Αθηνών.
- IATRIDOU, S., E. ANAGNOSTOPOULOU & R. IZVORSKI (2003) *Observations about the form and meaning of the Perfect*. In A. Alexiadou, M. Rathert and A. von Stechow (eds.), *Perfect explorations*. Berlin: Mouton de Gruyter, 153-204.
- ΙΟΡΔΑΝΙΔΟΥ, Α. (1996) *Τα ρήματα της νέας ελληνικής*, Αθήνα.
- JANDA, R. & B. JOSEPH (1992) *Pseudo-aglutinativity in Modern Greek verb-inflection and 'elsewhere'*. Papers from the 28th Regional Meeting of the Chicago Linguistics Society (1992), Vol. 1, 251-266.
- JANNARIS, A. (1968) *An historical Greek grammar chiefly of the Attic dialect*, Hildesheim: Georg Olms.
- JOSEPH, B. & SMIRNIOTOPOULOS J. (1993) *The morphosyntax of Greek verb as morphology and not syntax*, Linguistic Inquiry 24, 388-398.
- JOSEPH, B. – WARBURTON I. (1987) *Modern Greek*, London.
- JOSEPH, B.(1983 – 1984) *To απαρέμφατο στις βαλκανικές γλώσσες*, Γλωσσολογία 2-3, 91 – 98
- (2011) *The puzzle of albanian po*, Indo-European syntax and pragmatics: contrastive approaches, Oslo Studies in Language, 3(3), 27–40.

- (1983) *The synchrony and the diachrony of the Balkan infinitive, A study in aerial and historical linguistics*, Cambridge studies in linguistics 18. New York: Cambridge universit Press.
- (2002) *On some control structures in hellenistic greek: A comparison with classical and modern Greek*. The Ohio State University.

KAPLLANI, K. (1984) *Mbi kuptimet dhe përdorimet e së kryerës së thjeshtë në gjuhën shqipe*, SF 2.

KARANASTASIS, A. (1997) *Grammar of the Greek dialects of Southern Italy [Γραμματική των Ελληνικών ιδιωμάτων της Κάτω Ιταλίας]*, Athens, Athens Academy.

KATSOYΔA, Γ. (2011) *Εξεραίσεις στο σχηματισμό της προστακτικής της κοινής Νέας Ελληνικής*, Μέντορας 3, 62 – 69, Αθήνα.

KAZAZIS, K. (1976) *Greek and Arvanitika in Corinthia*, Balkanistica 3, 42 – 51.

KELMENDI, T. (1981) *Funksionet sintaksore të ndërtimeve me paskajore në gjuhën shqipe*, Gjurmime albanologjike.

- (1980) *Paskajorja në funksion kryefjalor (sipas folklorit)*, Gjurmime albanologjike X.

ΚΛΑΙΡΗΣ, ΧΡ.-ΜΠΙΑΜΠΙΝΙΟΤΗΣ, Γ. (2004) *Γραμματική της νέας ελληνικής*, 10^η έκδοση

KOSTALLARI, A. (1972) *Parimet themelore për hartimin e Fjalorit të gjuhës së sotme Shqipe*.

- (1982) *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*, SF 2.

KOUTSOUDAS, A. (1962) *Verb morphology of modern Greek*, The Hague/Mouton.

KYPIAZΗΣ, Δ. (2001) *Ελληνικές επιδράσεις στην Αλβανική*, Διδακτορική διατριβή, Θεσσαλονίκη.

LAFE, E. (1975) *Mbi habitoren dhe disa trajta të saj*, SF 2.

- (1969) *Trajtat e pjesores te Gjon Buzuku*, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë.

LA PIANA, M. (1949) *Studi linguistici albanesi*, Palermo.

LIKAJ, E. (1970) *Disa çështje të kategorisë së diatezës në gjuhën shqipe*, SF 4..

- (1997) *Format analitike në gjuhën shqipe*, Tiranë.
- (1981) *Analogjia në fomimin e trajtave të mënyrës dëftoret foljeve në gjuhën shqipe*, SF 3.

- (1978) *Mbi format analitike në gjuhën shqipe*, SF 3
- MACKRIDGE, P. (1990) *H νεοελληνική γλώσσα*, μετάφρ. Κ.Ν. Πετρόπουλος, Εκδόσεις Πατάκη.
- MALIKOUTI-DRACHMAN, A. & DRACHMAN, G. 1989. *Stress in Greek*. Studies in Greek Linguistics 1989, 127-143.
- MANOLESSOU, I. (2005) *From participles to gerunds*, Amsterdam: J. Benjamins, 241-283
- MANN, S. (1932) *A short Albanian grammar with vocabularies, and selected passages for reading*. London: D. Nutt.
- MANSAKU, S. (1980) *Ndërtimet me foljen ndihmëse kam + paskajore te autorët e vjetër*, SF 2.
 - (1979) *Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet te Gjon Buzuku*, SF 3.
 - (1982) *Paskajorja dhe kategoritë gramatikore të saj*, SF 1.
 - (1983) *Funksionet sintaksore të paskajores te autorët e vjetër*, SF2.
 - (2011) *Tipologjia e së ardhmes së tipit kam të shkoj në kontekstin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, Albanohellenica 4.
- MANZINI, M.R. & L. SAVOIA (2007) *A unification of morphology and syntax. Studies in Romance and Albanian dialects*, London: Routledge.
 - *Non-active voice in Albanian: Implications for the theory of Movement*, To appear in Memushaj, R. (ed), Festschrift Chomsky. Tirana: University of Tirana.
- MARKOPOULOS, Th. (2009) *The future in Greek: From Ancient to Medieval*, Oxford: Oxford University Press.
- MATTHEWS, P.H. (1967) *The main features of Modern Greek verb inflection*, FL 3, 262-84.
- MEMISHA, V. (2008) *Participial adjectives in Albanian and Greek*, Albanohellenica 3.
- MENSCHING, G. (2000) *Infinitive constructions with specified subjects: A syntactic analysis of the romance languages*, Oxford University Press.
- MEYER, G. (1888) *Kurzgefasste albanesische Grammatik*, Laipzig.
 - (1896) *Beiträge zur Kenntnis der in Griechenland Gesprochenen Albanesischen Mundarten*, Albanesische Studien V. Wien: Wiener Akademie Sitzungsberichte.
 - (1891) *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*, Strassburg: K. Trübner.

- MIRAMBEL, A. (1942) *De l'emploie l'aoiste en grec moderne*, Transactions of the Philological Society, 15 - 39.
- (1978) *Η ελληνική γλώσσα (περιγραφή και ανάλυση)*, μετάφρ. Στ. Καρατζάς, Θεσσαλονίκη.
- ΜΟΝΟΓΥΙΟΣ, Δ.Ν., Β.Ε. ΜΟΣΚΟΒΗΣ, Ε.Γ. Πρεβελάκης, Γ.Σ. Φυλακτόπουλος (1976) *Συντακτικό της Δημοτικής*, Αθήνα: Κολλέγιο Αθηνών.
- MOSER, A. (1988) *The history of the perfect periphrases in Greek*, Doctoral Dissertation, University of Cambridge.
- ΜΟΖΕΡ, Α. (1986) *Προβλήματα που προκύπτουν από τη διαχρονική εξέλιξη και τη σύγχρονη χρήση του παρακειμένου*, Μελέτες για την ελληνική γλώσσα, Θεσσαλονίκη, 149 – 161.
- (2005) *Άποψη και χρόνος στην ιστορία της Ελληνικής*, Αθήνα.
 - (2007α). *Άποψη, χρόνος και ιστορία*, Μελέτες για την Ελληνική Γλώσσα, Πρακτικά της 27ης Ετήσιας Συνάντησης του Τομέα Γλωσσολογίας του Αριστοτελείου Πανεπιστημίου Θεσσαλονίκης, 6-7 Μαΐου 2006, 286-299.
 - (2007) *Υποτακτική, χρόνος και παρεμφατικότητα*, Τομέας Γλωσσολογίας Παν/μίου Αθηνών (επιμ.), Γλωσσικός Περίπλους. Μελέτες αφιερωμένες στη Δήμητρα Θεοφανοπούλου-Κοντού, Αθήνα, 212-223.
- ΜΠΑΜΠΙΜΙΩΤΗΣ, Γ. (1972) *Το ρήμα της ελληνικής*, Αθήνα.
- (1998) *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*, Αθήνα.
 - (1986) *Συνοπτική ιστορία της ελληνικής γλώσσας*, Αθήνα.
- ΜΠΑΜΠΙΝΙΩΤΗΣ, Γ. – ΚΟΝΤΟΣ, Π. (1967) *Συγχρονική γραμματική της Νέας Ελληνικής*, Αθήνα.
- MYDERRIZI, O. (1944) *Gramatika e re e shqipes*, Tiranë.
- NEWMARK, L. (1982) *Standard Albanian. A reference grammar for students*. Stanford University Press. Stanford, California.
- NEWTON, B. E. (1979) *Scenarios, modality and verb aspect in Modern Greek*, Language 55, 139 – 67.
- NEWTON, B. & I. VELOUDIS (1980) *Necessity, obligation, and the Greek verbal aspect*, Lingua 50, 25-43.
- ΟΙΚΟΝΟΜΟΥ, Μ.Χ. (1933) *Νεοελληνική γραμματική (της κοινής νεοελληνικής)*, Αθήνα.
- PALMER, F.R. (2001) *Mood and Modality*, Cambridge University Press.

- PALLH, A. (2011) *Μορφολογία, Αθήνα*.
- PALLH – XATZHIPANAGIΩΤΟΥ, A. (1984) *Μορφολογία του ελληνικού ρήματος και θεωρία του λεξικού: μερικές προκαταρκτικές παρατηρήσεις*, Μελέτες για την ελληνική γλώσσα, Θεσσαλονίκη, 61 –80.
- PAPANGELI, D. – LAVIDAS, N. (2007) *Deponents and non- finite constructions in Greek*, Academy of Athens, University of Athens.
- PASCH, H. (1997) Sango. In Sarah G. Thomason (ed.), *Contact languages. A wider perspective*, 209–270. Amsterdam: John Benjamins.
- PENTHEROUDAKIS, J. (1976) *The redublication of indefinite direct objects in Albanian and Modern Greek*, Language 52, 198 – 403.
- PHILIPPAKI-WARBURTON, I. & V. SPYROPOULOS (1999) *On the boundaries of inflection and syntax: Greek pronominal clitics and particles*, In: Booij, G. & J. Van Marle (eds.), *Yearbook of Morphology 1998*. Dordrecht: Kluwer Academic Publishers,45-72.
- PHILIPPAKI-WARBURTON, I. & I. VELOUDIS (1984). *The subjunctive in complement clauses*, Studies in Greek Linguistics 5, 87-104.
- PHILIPPAKI-WARBURTON, I. (1998) *Functional categories and Modern Greek syntax*, The Linguistic Review 15, 158-186.
- (1993) *The subjunctive mood and the syntactic status of the particle na in Modern Greek*, Folia Linguistica XXVIII/3-4, 297-326.
 - (1985) *Word order in Modern Greek*, Transactions of the Philological Society 7, 113-143.
- PINKER, S. & M. ULLMAN (2002) *The past and future of the past tense*, Trends in Cognitive Science 6, 456-463.
- QIRIAZI, Dh. (1999) *Huazimet greke në shqipen e sotme – vështrim stilistik*, Albanohellenica 1.
- RALLI, A. (1999) *Inflectional features and the Morphological Module hypothesis*, Working Papers in Theoretical and Applied Linguistics 6. Thessaloniki, English Department, Aristotle University, 111-142
- (1988) *Éléments de la Morphologie du Grec Moderne: La Structure de la Verbe*, Ph.D. Thesis, University of Montreal
 - (2003) *Morphology in Greek linguistics: The State of the Art*, Journal of Greek Linguistics 4: 77-129.
- RIVERO, M. L. – RALLI. A. (2001) *Comparative Syntax of Balkan languages*, Oxford University Press.

- RIVERO, M.-L. (1990) *The location of non-active voice in Albanian and modern Greek*, Linguistic Inquiry 21, 135-146.
- RIZA, S. (1994) *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Tiranë.
- ROBINS, R. (1989) *Σύντομη ιστορία της γλωσσολογίας*, μετάφρ. Α. Μουδοπούλου, Αθήνα.
- ROUCHOTA, V. (1994) *Na in questions*, Studies in Greek Linguistics.
- SMIRNIOTOPOULOS, J. C. and B. D. JOSEPH (1998) *Syntax versus the lexicon: Incorporation and compounding in Modern Greek*, Journal of Linguistics 34, 447-488.
- ΣΤΑΜΑΤΑΚΟΥ, Ι., *Ιστορική γραμματική της αρχαίας ελληνικής*, Αθήνα, 1968, 246
- ΣΥΜΕΩΝΙΔΗΣ, Χ. (1990) *Ιστορικοσυγκριτική γραμματική των ινδοευρωπαϊκών γλωσσών*, Θεσσαλονίκη.
- SHEPERI, I.D. (1927) *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe sidomos e toskërishtes*, Vlorë.
- SHKURTAJ, GJ. (1975) *Vështrim mbi trajtat foljore të mënyrës dëftore të të folmeve arbëreshe*, SF 2.
- TANTALOU, N. (2004) *Gerunds in modern Greek*, Department of cognitive science, Johns Hopkins University.
- TONNET, H. (1986) *Σημείωμα για τους τρόπους ενέργειας (aspects) στα νέα ελληνικά*, Γλώσσα 12, 15- 20.
- TOPALLI, K. (2010) *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- (1980) *Koha e ardhme e dëftores në gjuhën shqipe*, SF 4.
 - (1998) *Për burimin e tajtës foljore të mënyrës dëshirore në gjuhën shqipe*, SF3-4.
- TOTONI, M. (1964) *E folmja e Bregdetit të poshtëm*, SF 1.
- (1965) *Trajtat e pjesores së foljeve me temë likuide më toskërishten*, SF 4.
 - (1968) *Konstrukte me folje aspekteve të fillimit të veprimtimit në gjuhën shqipe*, SF 1.
- ΤΡΙΑΝΤΑΦΥΛΛΙΔΗΣ, Μ. (2005) *Νεοελληνική γραμματική της δημοτικής*, Θεσσαλονίκη.
- (1981) *Άπαντα, Γ' τόμος (Νεοελληνική γραμματική – Ιστορική εισαγωγή)*. Θεσσαλονίκη.

- TSANGALIDIS A. (1999) *Will and Tha: A Comparative Study of the Category Future*, Thessaloniki:University Studio Press.
- TSAPKINI K., G. JAREMA & E. KEHAYIA (2002) *A morphological processing deficit in verbs but not in nouns: a case study in a highly inflected language*, Journal of Neurolinguistics 10 (3), 265-288.
- TSIMPLI, I.-M. (1989) *On the properties of the passive affix in Modern Greek*, UCL Working Papers in Linguistics 1, 235-260.
- (2001) *Gerunds in Greek*, Journal of Greek Linguistics 1, 133-169.
 - (1990) *Clause structure and word order in Modern Greek*, In UCL Working Papers in Linguistics 2, 226-255. University College London.
- ΤΣΟΜΠΙΑΝΑΚΗΣ, Α. (1994) *Νεοελληνική γραμματική*, Θεσσαλονίκη.
- TZAPTZANOS, A. (1967) *Γραμματική της αρχαίας ελληνικής γλώσσας*, Αθήνα.
- (1932) *Δεν υπάρχει υποτακτική στη νέα ελληνική*; NE 12, 826-7.
 - (1934) *Κι όμως υπάρχει!* NE 15, 515-516 (Απάντηση στον Ανδριώτη 1934)
 - (1991) *Νεοελληνική σύνταξις*, Τόμος Α, Εκδοτικός Οίκος Αδελφών Κυριακίδη, Θεσσαλονίκη.
- TZITZIΛΗΣ, Χ. (2007) *Ελληνική και Ιλλυρική*, Ιστορία της ελληνικής Γλώσσας, Ινστιτούτο Νεοελληνικών σπουδών, Πέμπτη ανατύπωση.
- THEOPHANOPOULOU-KONTOU, D. (2004) *The structure of the VP and the mediopassive morphology. The passives and anticausatives in Modern Greek*, Παρουσία 15-16: 173-206.
- ΘΕΟΦΑΝΟΠΟΥΛΟΥ – ΚΟΝΤΟΥ, Δ. (1982) *Τα μέσα ρήματα της νέας ελληνικής: μερικές προκαταρκτικές παρατηρήσεις στο σύστημα των διααθέσεων*, Μελέτες για την ελληνική γλώσσα, Θεσσαλονίκη, 51 – 78.
- UHLISCH, G. (1964) *Neugriechische lehnwörter im Albanischen*, Dissertation, Leipzig.
- VELOUDIS, I. (1980) *Intention, destination and Greek verbal aspekt*, Lingua 52, 269 – 84.
- (1983/1984) *The subjunctive in relative clauses*, Glossologia 2-3, 11-135.
- VESELAJ, N. (2000) *Paskajorja çështje të shqipes standarte*, Prishtinë.
- (2006) *Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë.
- XATZIΔΑΚΙΣ, Γ. (1905-1907) *Μεσαιωνικά και νέα ελληνικά*, 2 τόμοι, Αθήνα.
- ΧΡΙΣΤΟΦΟΡΙΔΗΣ, Κ. (1882) *Γραμματική της Αλβανικής Γλώσσας*

XHUVANI, A. (1980) *Vepra I*, Tiranë

- (1980) *Paskajorja në shqipet*, Vepra I.

ZOMBOLOU, K. (2004) *Verbal alternations in Greek: a semantic analysis*, Doctoral Dissertation. University of Reading

ZOYKHS, Γ. (1934) *Συμβολή στη γραμματική της νέας ελληνικής γλώσσας, (Η υποτακτική έγκλησις)*, Αθήνα.

WARBURTON, I. (1970) *On the Verb of Modern Greek*. The Hague, Mouton & Co.

- (1973) *Modern Greek verb conjugation: Inflectional morphology in a Transformational Grammar*, *Lingua* 32, 193-226.

Letërsi e vjelë

- (Gj.U.V.) *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Ismail Kadare.
- (S.N.S.) *O Στρατηγός της νεκρής στρατιάς*, Ισμαήλ Κανταρέ, μετάφραση από το πρωτότυπο Κωνσταντίνα Ευαγγέλου.
- (B.Π.) *Βίος και πολιτεία του Αλέξη Ζορμπά*, Νίκος Καζαντζάκης.
- (Z.) *Zorba*, Kazanxaqis, përktheu nga origjinali Stavri Dajo.
- (X.Ξ.) *O Χριστός ζανασταυρώνεται*, Νίκος Καζαντζάκης
- (K.K.P.) *Krishti kryqëzohet përsëri*, Kazanxaqis, përktheu nga origjinali Harallamb Qesko.
- (Ç. M.) *Çështje të marrëzisë*, Ismail Kadare.
- (I.T.) *Ιστορίες τρέλας*, Ισμαήλ Κανταρέ, μετάφραση από το πρωτότυπο Δημήτρης Δ. Ηλιόπουλος.
- (K.) *Ποιήματα*, Καβάφης.
- (L.Z.) *Konstantinos Kavafis, Poezi*, përkthyer nga origjinali nga Luan Zyka.
- (A.S.) *Kostandin Kavafis, Vepra poetike*, përkthyer nga origjinali nga Aristotel Spiro.
- (K., Ka.) Poezi të Kavfit përkthyer nga Ismail Kadare, marrë nga Antologjia e e poezisë greke.
- (L.M.) *Lahuta e Malcis*, Gjergj Fishta.
- (T.G.) *Trëndafili në gotë*, Dritëro Agolli.
- (H.N.) *Hijet e natës*, Vedat Kokona.
- (FGJSSH) *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1981*
- (DSH II) *Dialektologjia shqiptare II*
- (E.) *Ελύτης, Η συναυλία των γρακίνθων, Μαρία Νεφέλη.*

Nga shypi periodik

Gazeta “Shekulli”
Η καθημερινή
Το Βήμα

Indeks i tabelave dhe paraqitjeve grafike

- Tabela 1.1* – Ndarja e foljeve të shqipes në zgjedhime, 7
Tabela 1.2 - Ndarja e foljeve të greqishtes në zgjedhime, 8
Tabela 1.3 - Trajtat kohore e mënyrore të shqipes e greqishtes, 16
Tabela 3.1- Koha e tashme e dëftores së shqipes, 41
Tabela 3.2 - Mbaresat vetore të foljeve në kohën e tashme të dëftores së shqipes, 41
Tabela 3.3 - Mbaresat vetore të foljeve në kohën e tashme të dëftores së greqishtes, 44
Tabela 3.4 - Koha e pakryer e dëftores së shqipes, 47
Tabela 3.5 - Mbaresat vetore të foljeve në kohën e pakryer të dëftores së shqipes, 47
Tabela 3.6 - Koha e pakryer e dëftores së greqishtes, 50
Tabela 3.7 - Mbaresat vetore të foljeve në kohën e pakryer të dëftores së greqishtes, 51
Tabela 3.8 – Koha e kryer e thjeshtë e dëftores së shqipes, 55
Tabela 3.9 – Aoristi i dëftores së greqishtes, 58
Tabela 3.10 - Mbaresat vetore të foljeve në aoristin e dëftores së greqishtes, 58
Tabela 3.11 - Kohët analitike të zgjedhimit vepror të gjuhës greke dhe asaj shqipe, 64
Tabela 3.12 - Kohët analitike të zgjedhimit jovepror të gjuhës greke dhe asaj shqipe, 64
Tabela 3.13 - E kryera e dëftores së shqipes, 65
Tabela 3.14 - E kryera e dëftores së greqishtes, 68
Tabela 3.15 - Më se e kryera e shqipes, 70
Tabela 3.16 - Më se e kryera e greqishtes, 72
Tabela 3.17 - E kryera e tejshkuar e gjuhës shqipe, 74
Tabela 3.18 – E ardhmja e dëftores së shqipes, 77
Tabela 3.19 - E ardhmja e vazhduar e greqishtes, 78
Tabela 3.20 - E ardhmja e thjeshtë e greqishtes, 78
Tabela 3.21 - E ardhmja e përparme e shqipes, 79
Tabela 3.22 - E ardhmja e përparme e greqishtes, 80
Tabela 3.23 - E ardhmja e së shkuarës e shqipes, 80
Tabela 3.24 - E ardhmja e përparme e së shkuarës së shqipes, 81
Tabela 3.25 - Koha e tashme e lidhores së shqipes, 91
Tabela 3.26 - E tashmja e lidhores apo lidhorja e vazhduar e greqishtes, 96
Tabela 3.27 - Aoristi i lidhores së greqishtes, 100
Tabela 3.28 – E pakryera e lidhores së shqipes, 106
Tabela 3.29 – E kryera e lidhores së shqipes, 110
Tabela 3.30 - E kryera e lidhores së greqishtes, 111
Tabela 3.31- Më se e kryera e lidhores së shqipes, 112
Tabela 3.32 - E tashmja e urdhërores aktive të greqishtes, 123
Tabela 3.33 - Aoristi i urdhërores aktive, 124
Tabela 3.34 - Aoristi i urdhërores pasive, 124
Tabela 3.35 - E tashmja e habitores së shqipes, 130
Tabela 3.36 – E pakryera e habitores së shqipes, 132
Tabela 3.37 - E kryera e habitores së shqipes, 133
Tabela 3.38 - Më se e kryera e habitores së shqipes, 134

- Tabela 3. 39* – E tashmja e kushtores së shqipes, 141
Tabela 3. 40 – E kryera e kushtores së shqipes, 143
Tabela 3.41 – E tashmja e dëshirores së shqipes, 146
Tabela 3.42 - E kryera e dëshirores së shqipes, 148
Tabela 4.1- Pjesorja e gjuhës shqipe, 154
Tabela 4.2 – Pjesorja aktive e greqishtes së re, 158
Tabela 4. 3- Pjesorja e së tashmes pasive e greqishtes së re 159
Tabela 4.4- Pjesorja e së kryerës pasive së greqishtes së re, 165

- Paraqitje grafike 3.1*- Format kohore të mënyrës dëftore të shqipes, 38
Paraqitje grafike 3.2 - Format kohore të mënyrës dëftore të greqishtes, 39
Paraqitje grafike 3.3 - Kohët sintetike të mënyrës dëftore, 40
Paraqitje grafike 3.4 – Kohët e lidhores së shqipes, 88
Paraqitje grafike 3.5 - Kohët e lidhores së greqishtes, 90
Paraqitje grafike 3.6 - - Kohët e lidhores së greqishtes dhe shqipes, 90
Paraqitje grafike 4.1- Pjesorja e së kryerës pasive së greqishtes së re, 160